# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2025 – Numri: 61

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E mërkurë, 2 prill 2025**

## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i Kuvendit nr. 29/2025, datë 17.3.2025 | Për miratimin e Planit Vjetor 2025 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022–2026............................................................... | 7313 |
| Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 00-2024-2161 (167), datë 4.7.2024 | Akuzuar për kryerjen e veprës penale "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese", parashikuar nga neni 79, shkronja "a" i Kodit Penal........... | 7396 |

**VENDIM**
**Nr. 29/2025**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT VJETOR 2025 PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË STATISTIKAVE ZYRTARE 2022–2026**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 9, pika 5, të ligjit nr. 17/2018, "Për statistikat zyrtare", i ndryshuar, dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet Plani Vjetor 2025 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022–2026.

II. Plani Vjetor 2025 botohet në Fletoren Zyrtare.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
**Elisa Spiropali**

Miratuar në datën 17.3.2025.

SISTEMI KOMBËTAR STATISTIKOR

PLANI VJETOR 2025
**Për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022–2026**

I. Lista e shkurtimeve
II. Hyrje
III. Objektivat zhvillimorë
IV. Aktivitetet statistikore
Fusha 1 "Statistikat demografike dhe sociale"
Fusha 2 "Statistikat ekonomike"
Fusha 3 "Statistikat sektoriale"
Fusha 4 "Statistikat e mjedisit dhe multidomain"
Botime përmbledhëse
Censet
V. Sistemi i menaxhimit të cilësisë
VI. Integrimi evropian dhe bashkëpunimet ndërkombëtare
VII. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG)
VIII. Burimet financiare dhe njerëzore
IX. Analiza SWOT
X. Analiza e risqeve dhe problemet e pritshme për kryerjen e aktiviteteve
XI. Notë shpjeguese për përdorimin e aneksit
XII. Aneksi

## I. Lista e shkurtimeve

| | |
|---|---|
| AS | Aktivitet statistikor |
| BA | Burim administrativ |
| CAPI | Intervistë me kompjuter (*Computer Assisted Personal Interview*) |
| CATI | Intervistë me telefon (*Computer-Assisted Telephone Interview*) |
| CAWI | Intervistë me link (*Computer Assisted Web Interview*) |
| DEGURBA | Klasifikimi i njësive administrative urbane |
| ECB | Banka Qendrore Evropiane (*European Central Bank*) |
| EDP | Procedura e deficitit të tejkaluar (*Excessive Deficit Procedure*) |
| ESA | Sistemi Evropian i Llogarive Kombëtare dhe Rajonale (*European system of national and regional accounts*) |
| ESSPROS | Sistemi i Integruar Evropian për Mbrojtjen Sociale (*European system of integrated social protection statistics*) |
| FAO | Organizata për Bujqësinë dhe Ushqimin (*Food and Agriculture Organization*) |
| FMN | Fondi Monetar Ndërkombëtar |
| GDP | Produkti i brendshëm bruto (*Gross Domestic Product*) |
| GFS | Statistikat financiare të qeverisë (*Government Finance Statistics*) |
| GFSM | Manuali për statistikat financiare të qeverisë (*Government Finance Statistics Manual*) |
| GIS | Sistemi i Informacionit Gjeografik (*Geographic information system*) |
| GSBPM | Manuali për Planifikimin e Fazave të Prodhimit Statistikor (*Generic Statistical Business Process Model*) |
| DEGURBA | Klasifikimi i njësive administrative urbane |
| ECB | Banka Qendrore Evropiane (*European Central Bank*) |
| EDP | Procedura e deficitit të tejkaluar (*Excessive Deficit Procedure*) |
| ICCS | Klasifikimi Ndërkombëtar i Krimeve për Qëllime Statistikore (*International Classification of Crime for Statistical Purposes*) |
| ICD | Klasifikimi Ndërkombëtar për Sëmundjet (*International Statistical Classification of Diseases*) |

| | |
|---|---|
| IÇK | Indeksi i Çmimeve të Konsumit |
| INSPIRE | Infrastruktura për Informacionin Gjeohapësinor në Evropë |
| IOM | Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (*International Organization for Migration*) |
| IPA | Instrumenti i paraanëtarësimit |
| ISCO | Klasifikimi Ndërkombëtar Standard i Profesioneve (*International Standard Classification of Occupations*) |
| NUTS | Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat (*Nomenclature of Territorial Units for Statistics*) |
| NjEF | Njësi ekonomike familjare |
| OECD | Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin (*Organisation for Economic Co-operation and Development*) |
| OZHQ | Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm |
| NUTS | Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat (*Nomenclature of Territorial Units for Statistics*) |
| PRODCOM | Statistikat e Produkteve Industriale (*Production Communautaire*) |
| PSZ | Programi i Statistikave Zyrtare |
| UNDESA | Departamenti i Kombeve të Bashkuara për Çështjet Ekonomike dhe Sociale |
| UNDP | Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara |
| VS | Vrojtim statistikor |
| SKS | Sistemi Kombëtar Statistikor |
| ZC | Zonat e Censit |
| AKBN | Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore |

## II. Hyrje

Plani Vjetor 2025 i paraqitet për miratim Kuvendit të Shqipërisë në zbatim të neneve 9 dhe 10, të ligjit nr. 17/2018, "Për statistikat zyrtare". Dokumenti shërben për parashikimin e veprimtarive statistikore në përmbushje të objektivave strategjikë dhe rezultateve të pritshme të parashikuara në ligjin nr. 30/2022, "Për miratimin e programit të statistikave zyrtare 2022–2026".

Dokumenti paraqet aktivitetet statistikore që do të kryhen nga Sistemi Kombëtar Statistikor, INSTAT-i, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore gjatë vitit 2025, sipas fushave përkatëse statistikore që mbulojnë, afatet dhe periodicitetet e zbatimit, si dhe indikatorët që do të prodhohen nga zbatimi i këtyre aktiviteteve. Në të njëjtën linjë paraqiten edhe institucionet përgjegjëse për dhënien e informacionit statistikor dhe frekuenca e transmetimit të këtij informacioni. Sipas kërkesave të ligjit për statistikat zyrtare, me qëllim që të sigurohet mbarëvajtja e veprimtarive të parashikuara dhe parandalimi i risqeve të mundshme, dokumenti përmban një analizë të risqeve dhe problemeve të pritshme gjatë vitit 2025.

Plani Vjetor 2025 është në përputhje me dokumentin e ngjashëm, i cili aplikohet nga vendet e tjera, anëtare të BE-së, mbështetur në nenin 17, të rregullores (KE) 223/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 mars 2009, mbi statistikat evropiane, e cila shfuqizon Rregulloren (KE, Euroatom) nr. 1101/2008, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, mbi dërgimin e të dhënave, të cilat i nënshtrohen konfidencialitetit statistikor, Zyrës Statistikore të Komuniteteve Evropiane, Rregullores së Këshillit (KE) nr. 322/97, mbi Statistikat e Komunitetit dhe vendimin e Këshillit 89/382/EEC, Euroatom për krijimin e një komisioni mbi programet statistikore të Komuniteteve Evropiane.

Legjislacioni shqiptar për statistikat zyrtare parashikon instrumentet e monitorimit të zbatimit të Planit Vjetor. Drejtori i përgjithshëm i INSTAT-it duhet t'i paraqesë Këshillit të Statistikave raporte 4-mujore, ndërsa Kuvendi i Shqipërisë diskuton raportin vjetor të ecurisë së Planit Vjetor mbi veprimtarinë e INSTAT-it dhe Sistemit Kombëtar Statistikor. Instrumente të tjera monitoruese të rëndësishme janë ndjekja e rekomandimeve të dala nga raportet *Peer Review* dhe raportet vjetore të BE-së për ecurinë e nivelit të përputhshmërisë së kapitullit 18 "Statistikat" në vendin tonë.

Për të rritur transparencën dhe besueshmërinë e publikut në statistikat zyrtare, përveç botimit në Fletoren Zyrtare, Plani Vjetor publikohet edhe në faqen zyrtare të INSTAT-it. Gjithashtu, në faqen elektronike zyrtare publikohen raportet 4-mujore për zbatimin e planit.

## III. Objektivat zhvillimorë

Objektivat zhvillimorë të Sistemit Kombëtar Statistikor, të parashikuar në Programin e Statistikave Zyrtare 2022–2026 dhe masat prioritare janë:

| | |
|---|---|
| ***Zhvillimi i SKS për të përmbushur plotësisht acquis communautaire lidhur me statistikat dhe të mbështesë plotësisht procesin e integrimit Evropian*** | • Të përcaktojë kërkesat prioritare që do të mundësojnë progresin drejt *acquis*<br>• Të sigurojë pavarësinë profesionale të të gjithë prodhuesve të statistikave zyrtare dhe zbatimin e parimeve statistikore<br>• Prodhimi i treguesve përkatës sipas specifikimeve të përcaktuara nga Eurostat-i |
| ***Plotësimi i kërkesave të përdoruesit për statistika zyrtare*** | • Rritja e përdorimit të të dhënave dhe rekordeve administrative për qëllime statistikore<br>• Prodhimi i treguesve që të përputhen me nevojat e përdoruesve të statistikave brenda vendit<br>• Prodhimi i treguesve që të përputhen me nevojat e përdoruesve ndërkombëtarë të statistikave<br>• Të ofrohet qasje e lehtësuar në statistikat zyrtare për të gjithë përdoruesit në një gamë të përshtatshme formatesh dhe sipas praktikave ndërkombëtare |
| ***Prodhimi i statistikave zyrtare të një niveli të lartë cilësie, që të përputhen me standardet e pranuara Evropiane dhe ndërkombëtare*** | • Përmirësimi i cilësisë së të dhënave dhe rekordeve administrative të siguruara nga institucionet përkatëse<br>• Të ndërtohet, mirëmbahet dhe promovohet menaxhimi i cilësisë dhe sistemi i kontrollit të cilësisë për SKS-në |
| ***Rritja e numrit të institucioneve pjesë e Sistemit Kombëtar Statistikor*** | • Rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve për përfitimet si rezultat i funksionimit brenda PSZ<br>• Vendosja dhe përmirësimi i bashkëpunimit dhe partneritetit mes institucioneve prodhuese të statistikave<br>• Miratimi i akteve rregullatore nga ana e institucioneve të tjera prodhuese statistikore që të jenë në mbështetje të funksioneve statistikore zyrtare<br>• Përafrimi dhe zbatimi i mekanizmave që nxisin ndarjen efikase dhe transparente të fondeve publike |
| ***Modernizimi i proceseve, metodave, produkteve dhe shërbimeve statistikore për të përmirësuar cilësinë, dorëzimin në kohë dhe efiçencën në kosto të statistikave zyrtare*** | • Modernizimi i mëtejshëm i sistemeve për grumbullimin e të dhënave<br>• Zgjerimi i përdorimit të burimeve jotradicionale të të dhënave të papërpunuara<br>• Modernizimi i mëtejshëm i sistemeve për përpunimin statistikor dhe ruajtjen dhe shpërndarjen<br>• Fuqizimi i bashkëpunimit me botën akademike për zhvillimin e metodave të reja, produkteve dhe shërbimeve statistikore<br>• Zhvillimi i sistemeve të informacionit për të reduktuar ngarkesën e komunikimit dhe për të rritur cilësinë statistikore |
| ***Rritja e besimit të publikut në Sistemin Kombëtar Statistikor dhe njohja e tij si strukturë institucionesh me performancë të duhur dhe profesionalisht të pavarur*** | • Të përftohet një rritje e përdorimit dhe njohurive të produkteve statisikore të SKS-së<br>• Fuqizimi dhe promovimi i rolit të INSTAT-it në SKS, në rajon dhe arenën ndërkombëtare<br>• Zbatimi i plotë i dispozitave ligjore dhe praktike për të mbrojtur konfidencialitetin statistikor |

Për të matur performancën e Sistemit Kombëtar Statistikor në drejtim të zbatimit të këtyre objektivave dhe në përputhje me parashikimet e Programit të Statistikave Zyrtare 2022–2026, janë përcaktuar treguesit kyç të performancës me vlerat për vitin bazë 2022 dhe pritshmëritë për vitin 2025.

Tabelat e mëposhtme paraqesin këtë informacion për secilin objektiv zhvillimor dhe parashikimet për vitin 2025.

*Tabela nr. 1: Objektivi strategjik 1, aktivitetet statistikore dhe treguesit e performancës*

| Objektivat strategjikë | Objektiva specifikë | Treguesite performancës | Vlerat për vitin bazë 2022 | 2025 |
|---|---|---|---|---|
| **Objektivi strategjik 1:**<br>**Zhvillimi i SKS për të përmbushur plotësisht *acquis communautaire* lidhur me statistikat dhe të mbështesë plotësisht procesin e integrimit Evropian** | 1.1 Të përcaktojë kërkesat prioritare që do të mundësojnë progresin drejt acquis<br><br>1.2 Të sigurojë pavarësinë profesionale të të gjithë prodhuesve të statistikave zyrtare dhe zbatimin e parimeve statistikore<br><br>1.3 Prodhimi i indikatorëve përkatës sipas specifikimeve të përcaktuara nga Eurostat-i | 1.1 Numri i të dhënave (data points) të shfaqura në databazën statistikore të Eurostat-it për Shqipërinë | **4.579.293** | |
| | | 1.2 Numri i akteve të reja ligjore të përafruara me acquis (Sipas PKIE) | **1** | **7** |
| | | 1.3 Rekomandime të Eurostatit (nga raporti *Peer Review 2018*), të zbatuara (në %) | **89%** | Janë kryer në masën 100% gjatë vitit 2023 |

*Tabela nr. 2: Objektivi strategjik 2, aktivitetet statistikore dhe treguesit e performancës*

| Objektivat strategjikë | Objektiva specifikë | Treguesit e performancës | Vlerat për vitin bazë 2022 | 2025 |
|---|---|---|---|---|
| **Objektivi strategjik 2:**<br>**Plotësimi i nivelit të plotë të kërkesave të përdoruesit për statistika zyrtare** | 2.1- Rritja e përdorimit të të dhënave dhe rekordeve administrative për qëllime statistikore<br><br>2.2 Prodhimi i treguesve që të përputhen me nevojat e përdoruesve të statistikave brenda vendit | 2.1 Numri i të dhënave (data points) të shfaqura në databazën e INSTAT (në %) | **3.820.369** | **4.983.532** |
| | | 2.2 Numri i vizitave në faqen e internetit të INSTAT-it | **3.585.663** | **+10** nga viti para-ardhës |
| | | 2.3 Niveli i kënaqësisë së përdoruesve të statistikave të prodhuara nga INSTAT | **3.93/78.6%** | **4.1/82.0%** |
| | | 2.4 Numri i takimeve me përdoruesit (mbledhjet me grupin e përdoruesve, etj.) | **3** | **5** |
| | | 2.5 Numri treguesve të OZHQ-së të prodhuar nga SKS | **56** | **66** |
| | | 2.6 Numri i aktiviteteve statistikore në nivel qarku dhe bashkie | **21** | **21** |

*Tabela nr. 3: Objektivi strategjik 3, aktivitetet statistikore dhe treguesit e performancës*

| Objektivat strategjikë | Objektiva specifikë | Indikatorët e performancës | Vlerat për vitin bazë 2022 | 2025 |
|---|---|---|---|---|
| **Objektivi strategjik 3:**<br>**Prodhimi i statistikave zyrtare të një niveli të lartë cilësie, që të përputhen me standardet e pranuara Evropiane dhe ndërkombëtare** | 3.1. Përmirësimi i cilësisë të të dhënave dhe rekordeve administrative të siguruara nga institucionet përkatëse<br><br>3.2 Të ndërtohet, mirëmbahet dhe promovohet menaxhimi i cilësisë dhe sistemi i kontrollit të cilësisë për SKS | 3.1 Numri i klasifikimeve statistikore ndërkombëtare të reja të adoptuara në vend | **1** | **1** |
| | | 3.2 Numri i raporteve të cilësisë të publikuara | **52** | **63** |

*Tabela nr. 4: Objektivi strategjik 4, aktivitetet statistikore dhe treguesit e performancës*

| Objektivat strategjikë | Objektiva specifikë | Treguesit e performancës | Vlerat për vitin bazë 2022 | 2025 |
|---|---|---|---|---|
| **Objektivi strategjik 4: Përfshirja e institucioneve shtesë prodhues në Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare** | 4.1 Rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve për përfitimet si rezultati i funksionimit brenda PKSZ<br>4.2 Vendosja dhe përmirësimi i bashkëpunimit dhe partneriteti mes institucioneve prodhues të statistikave<br>4.3Miratimi i akteve rregullatore nga ana e institucioneve të tjera prodhuese statistikore që të jenë në mbështetje të funksioneve statistikore zyrtare<br>4.4 Përafrimi dhe zbatimi i mekanizmave që nxisin ndarjen efikase dhe transparente të fondeve publike<br>4.4 Përfshirja në strukturat organizative të institucioneve publike struktura të veçanta të dedikuara vetëm për prodhimin statistikor | 4.1 Numri i agjencive statistikore në PSZ | 3 | 4 |
| | | 4.2 Numri i institucioneve furnizuese me të dhëna administrative mikro | 4 | 4 |
| | | 4.3 Numri i temave të trajnimeve të organizuara nga INSTAT | 11 | 16 |
| | | 4.4 Numri i regjistrave administrativë të përdorur për prodhim statistikor (skedarët mikro që merr INSTAT nga institucionet e tjera) | 15 | 15 |

*Tabela nr. 5: Objektivi strategjik 5, aktivitetet statistikore dhe treguesit e performancës*

| Objektivat strategjikë | Objektiva specifikë | Treguesit e performancës | Vlerat për vitin bazë 2022 | 2025 |
|---|---|---|---|---|
| **Objektivi strategjik 5: Modernizimi i mëtejshëm i proceseve, metodave, produkteve dhe shërbimeve statistikore për të përmirësuar cilësinë, dorëzimin në kohë dhe efiçencën në kosto të statistikave zyrtare** | 5.1 Modernizimi i mëtejshëm i sistemeve për grumbullimin e të dhënave<br>5.2 Zgjerimi i përdorimit të burimeve jotradicionale të të dhënave të papërpunuara<br>5.3 Modernizimi i mëtejshëm i sistemeve për përpunimin statistikor dhe ruajtjen dhe shpërndarjen<br>5.4 Fuqizimi i bashkëpunimit me botën akademike për zhvillimin e metodave të reja, produkteve dhe shërbimeve statistikore<br>5.5 Zhvillimi i sistemeve të informacionit për të reduktuar ngarkesën e komunikimit dhe për të rritur cilësinë statistikore | 5.1 Numri i aplikacioneve të ndërtuara/përditësuara për grumbullimin e të dhënave me CATI/CAWI | 1/8 | 8 |
| | | 5.2 Numri i aplikacioneve të ndërtuara/përditësuara me CAPI | 1/22 | 25 |
| | | 5.3 Numri i aktiviteteve statistikore tek të cilat do të përdoren software | 96 | 113 |

*Tabela nr. 6: Objektivi strategjik 6, aktivitetet statistikore dhe treguesit e performancës*

| Objektivat strategjikë | Objektiva specifikë | Treguesit e performancës | Vlerat për vitin bazë 2022 | 2025 |
|---|---|---|---|---|
| **Objektivi strategjik 6: Rritja e besimit të publikut në**<br>**Objektivi strategjik 6: Rritja e besimit të publikut në SKS dhe njohja e tij si strukturë institucionesh me performancë të duhur dhe profesionalisht të pavarur** | 6.1 Të përftohet një rritje e përdorimit dhe njohurive të<br>6.1 Të përftohet një rritje e përdorimit dhe njohurive të produkteve statisikore të SKS-së<br>6.2 Fuqizimi dhe promovimi i rolit të INSTAT-it në SKS, në rajon dhe arenën ndërkombëtare<br>6.3 Zbatimi i plotë i dispozitave ligjore dhe praktike për të mbrojtur konfidencialitetin statistikor | 6.1 Përqindja e përdoruesve që shprehin besim/besueshmëri në statistikat kombëtare (në një vrojtim) | 3,94/78,8 % | 4.0/ 80% |
| | | 6.2 Numri i referimeve ndaj produkteve të SKS-së në media:gazeta, tv, portale online | 27,972 | 29,000 |
| | | 6.3 Numri i eventeve të kryera për ndërgjegjësimin e statistikave | 11 | 13 |

*Tabela nr. 7: Aspektet përmirësuese për vitin 2025 krahasimisht me vitin bazë 2022*

| Aspekte përmirësuese | Vlerat për vitin bazë 2022 | Vlera e pritshme për vitin 2025 | Progresi (në %) |
|---|---|---|---|
| Numri i të dhënave (data points) të shfaqura në databazën e INSTAT (në %) | 3.820.369 | 4.983.532 | 30% |
| Numri i vizitave në faqen e internetit të INSTAT-it | 3.585.663 | 3.9 milion | 10% |
| Numri i takimeve me përdoruesit (mbledhjet me grupin e përdoruesve, etj.) | 3 | 5 | 66.6% |
| Niveli i kënaqësisë së përdoruesve të statistikave të prodhuara nga INSTAT | 78,6% | 82% | 3.4% |
| Numri i referimeve ndaj produkteve të SKS-së në media, p.sh., në gazetat ditore kryesore ose në televizione | 27.972 | 29000 | 3.67% |

**IV. Aktivitetet statistikore**

Lista e aktiviteteve statistikore paraqitet duke ndjekur strukturën e klasifikimit të fushave dhe temave statistikore, të parashikuara në shtojcën 1, të ligjit nr. 17/2018, "Për statistikat zyrtare", si dhe duke ruajtur linjën e klasifikimeve të fushave statistikore e temave përkatëse, të përcaktuara në Programin e Statistikave Zyrtare 2022–2026. Lista e aktiviteteve për pjesën e Censit të Popullsisë dhe Banesave, dhe Censin e Bujqësisë pasqyrohet më hollësisht në seksione të veçanta të dokumentit.

- **Përmbledhje: Arritjet 2024 – Pritshmëritë 2025**

- **Agjencitë statistikore dhe përgjegjësitë sipas Programit**

**Gjatë vitit 2024** Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore mori statusin 'Agjenci Statistikore'. Sistemi Kombëtar Statistikor realizoi 106 aktivitete statistikore. INSTAT-i u angazhua për realizimin e 93 aktiviteteve statistikore, duke siguruar prodhimin e treguesve në katër fushat e Programit të Statistikave Zyrtare si: fusha e statistikave demografike dhe sociale, fusha e statistikave ekonomike, fusha e statistikave sektoriale dhe fusha e statistikave të mjedisit dhe multidomain. Banka e Shqipërisë realizoi 9 aktivitete për mbulim me tregues në fushën e statistikave ekonomike dhe në fushën e statistikave sektoriale. Ministria e Financave kontribuoi në realizimin e 2 aktiviteteve në fushën e statistikave ekonomike. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore u angazhua në realizimin e aktiviteteve që lidhen me bilancin energjetik tremujor dhe vjetor. **Për vitin 2025** Sistemi ka planifikuar të realizojë 113 aktivitete statistikore. INSTAT-i planifikon të realizojë 100 aktivitete në 4 fushat statistikore të programit, Banka e Shqipërisë 9 aktivitete në fushën e statistikave ekonomike dhe në fushën e statistikave sektoriale, Ministria e Financave do të realizojë 2 aktivitete në fushën e statistikave ekonomike, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore do të realizojë 2 aktivitete statistikore.

- **Aktivitetet dhe treguesit statistikorë**

**Gjatë vitit 2024** në fushën e statistikave demografike dhe sociale u realizuan 30 aktivitete statistikore nga të cilat u prodhuan 446 tregues, duke mbuluar me të dhëna nënfushat, si: popullsia me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri dhe jashtë saj, puna dhe kostot e punës, arsimi dhe trajnimet, shëndetësia, të ardhurat dhe shpenzimet e konsumit, mbrojtja sociale, drejtësia dhe krimi, kultura; 20 aktivitete në fushën e statistikave ekonomike, nga të cilat u prodhuan 241 tregues mbi statistikat makroekonomike, statistikat financiare të qeverisë, fiskale dhe të sektorit publik dhe statistikat e biznesit; në fushën e statistikave sektoriale u realizuan 45 aktivitete nga të cilat u prodhuan 354 tregues duke mbuluar nënfushat, si: statistikat e bujqësisë, peshkimit dhe pyjeve, energjia, transporti, turizmi, tregtia e jashtme, bilanci i pagesave, çmimet, shkenca, teknologjia dhe inovacioni; në fushën e statistikave të mjedisit dhe multidomain u realizuan 11 aktivitete për prodhimin e 50 treguesve statistikorë mbi llogaritë monetare dhe fizike në mjedis, mbetjet, ujin, biodiversitetin etj. **Për vitin 2025** për fushat dhe nënfushat e sipërpërmendura parashikohen: 33 aktivitete në fushën e statistikave demografike dhe sociale për prodhimin e 496 treguesve statistikorë; 20 aktivitete në fushën e statistikave ekonomike, duke synuar prodhimin e 241 treguesve; 47 aktivitete në fushën e statistikave sektoriale, shoqëruar me prodhimin e 361 treguesve; 13 aktivitete në fushën e statistikave të mjedisit dhe multidomain, për prodhimin e 56 treguesve statistikorë.

- **Aktivitetet e reja. Në vitin 2024** u realizuan 2 aktivitete të reja. Në fushën e statistikave demografike dhe sociale u ndërmorën disa aktivitete lidhur me studimin e aspekteve metodologjike, mbi statistikat e shëndetit dhe sigurisë në punë. U kryen disa takime për të kuptuar situatën dhe u reflektuan nevojat për klasifikimet e nevojshme për t'u përdorur. Në fushën e statistikave ekonomike u realizua vrojtimi i regjistrave të biznesit (ARB), rezultatet e së cilës shërbejnë për përditësimin e regjistrave të biznesit. **Gjatë vitit 2025** planifikohet realizimi i një aktiviteti të ri që lidhet me publikimin e dedikuar për statistikat e Krimeve.

- **Klasifikimet statistikore. Gjatë vitit 2024** ka vijuar zbatimi i klasifikimeve të miratuara në vitet paraardhëse, si dhe filloi puna për zbatimin e NACE Rev. 2.1. Tabela e korrespondencës midis NACE Rev. 2 dhe Rev. 2.1 u krijua dhe u transmetua në Eurostat. NACE Rev. 2.1 u përkthye në shqip dhe u diskutua në Komisionin Kombëtar të Nomenklaturave, i cili udhëheq aktivitetet për përshtatjen dhe zbatimin e klasifikimeve zyrtare ekonomike dhe sociale, në përputhje me klasifikimet evropiane dhe ndërkombëtare. NACE Rev. 2.1 është përfshirë në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026 dhe pritet të miratohet nga Këshilli i Ministrave gjatë katërmujorit të parë të **vitit 2025**.

- **Menaxhimi i cilësisë.** Në planin e **vitit 2024** u parashikuan dy audite statistikore, një në fushën e statistikave ekonomike dhe një në fushën e statistikave sektoriale, rezultatet e të cilave do të përcaktojnë perspektivën e përmirësimeve metodologjike dhe aksioneve të nevojshme për implementimin e tyre gjatë vitit 2025. Gjithashtu, në planin e vitit 2024 u parashikuan të realizohen 2 pyetësorë vetëvlerësimi, përkatësisht 1 për fushën e statistikave sociale dhe demografike dhe 1 për fushën e statistikave ekonomike. **Gjatë vitit 2025** parashikohet realizimi i 2 pyetësorëve të vetëvlerësimit në fushën e statistikave sektoriale. **Gjatë vitit 2024** u parashikuan matja e kostos për 56 aktivitete statistikore, ndërsa **gjatë vitit 2025** parashikohet matja e kostos për 60 aktivitete statistikore. Sa i përket raporteve të cilësisë gjatë vitit 2024, INSTAT-i planifikoi publikimin e 63 raporteve të cilësisë edhe për vitin 2025 parashikohet publikimi i 63 raporteve të cilësisë.

Informacion më i detajuar rreth aktiviteteve statistikore të parashikuara për t'u realizuar gjatë vitit 2025 jepet në seksionet e mëposhtme sipas fushave statistikore, si dhe në aneksin e këtij dokumenti, ku aktivitetet janë shoqëruar me informacion të kategorive:

- Lloji i aktivitetit;
- Tipi i aktivitetit;
- Periodiciteti i aktivitetit;
- Përqindja e të dhënave të siguruara nga burimi administrativ/vrojtimi;
- Treguesit statistikorë;
- Institucioni përgjegjës për prodhimin e të dhënave;
- Institucioni përgjegjës për furnizimin me të dhëna;
- Afati i grumbullimit të të dhënave;
- Afati i përpunimit të të dhënave;
- Afati i publikimit të të dhënave;
- Risqet dhe nivelet e risqeve;
- Burimet e financimit.

**Fusha 1 "Statistikat demografike dhe sociale"**

Statistikat sociale përfshijnë një sërë fushash që lidhen me statistikat e: popullsisë, tregut të punës dhe pagave, arsimit, shëndetësisë, të ardhurave dhe shpenzimeve të konsumit dhe përdorimit të kohës, mbrojtjes sociale, drejtësisë dhe krimit, kulturës.

Qëllimi kryesor i statistikave sociale është që të sigurojnë të dhëna në kohë dhe me cilësi të lartë të treguesve statistikorë, të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave sociale dhe ekonomike, me qëllimin final të zhvillimit dhe përmirësimit të mirëqenies shoqërore, si dhe për monitorimin e ndikimit të këtyre politikave në aspekte të ndryshme të jetës në vend.

Objektivi kryesor për vitin 2025 për statistikat sociale do të jetë rritja e cilësisë dhe plotshmërisë së serive kohore për treguesit me frekuencë tremujore dhe vjetore, duke synuar rritjen e nivelit të përafrimit me *acquis* përkatëse.

Një ndër aktivitetet kryesore në këtë fushë statistikore do të jetë përgatitja për vlerësimin e projeksioneve të popullsisë bazuar në rekomandimet ndërkombëtare, llogaritja dhe vlerësimi i statistikave të diasporës shqiptare dhe kryerja e vrojtimit të grupimeve të treguesve të shumëfishtë (MICS) me fokus social, kryesisht të kushteve të jetesës, nënat dhe fëmijët, edukimi, shëndetësia, si dhe shumë fusha të tjera. Gjithashtu, një tjetër aktivitet i rëndësishëm, në kuadër të Censit

të Popullsisë dhe Banesave 2023, do të jetë kryerja e analizave të thelluara me tematikat përkatëse.

Agjencia statistikore përgjegjëse: INSTAT-i.

Kjo fushë përbëhet nga 8 tema statistikore:

Në tabelën nr. 8 paraqitet numri i aktiviteteve për kategoritë: periodiciteti/burimi i të dhënave/ niveli minimal i publikimit/institucioni përgjegjës.

*Tabela nr. 8: Përmbledhje e numrit të aktiviteteve për fushën "Statistikat sociale dhe demografike"*

| 1. Statistikat Sociale dhe Demografike | Nr. i aktiviteteve Statistikore (AS) | Nr. AS / Periodiciteti * | Nr. AS / Burimi i të dhënave** | Nr. AS / Niveli minimal i publikimit | Nr. AS / Institucioni përgjegjës |
|---|---|---|---|---|---|
| Popullsia me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri dhe jashtë saj | 10 | 1- T<br>5 - V<br>2 - 5V<br>1 - 10V<br>1 – Tjetër | 1 VS<br>3 BA<br>5 VS+BA<br>1 Cens | 6 Vendi<br>2 Qarku<br>2 Bashki | 10 INSTAT |
| Puna dhe Kostot e Punës | 4 | 3 - T<br>1 - 4V | 2 VS<br>2 BA | 3 Vendi<br>1 Qarku | 4 INSTAT |
| Arsimi dhe trajnimet | 3 | 3 – V | 3 BA | 3 Vendi | 3 INSTAT |
| Shëndetësia | 3 | 3 – V | 3 BA | 1 Vendi<br>2 Qarku | 3 INSTAT |
| Të Ardhurat dhe Shpenzimet e Konsumit | 3 | 3 – V | 2 VS<br>1 VS+BA | 2 Vendi<br>1 Qarku | 3 INSTAT |
| Mbrojtja Sociale | 2 | 1 - V<br>1 – Tjetër | 2 BA | 2 Vendi | 2 INSTAT |
| Drejtësia dhe Krimi | 4 | 4 – V | 4 BA | 3 Qark<br>1-NA | 4 INSTAT |
| Kultura | 4 | 4 – V | 2 BA<br>2 VS+BA | 4 Vendi | 4 INSTAT |
| **Gjithsej** | **32** | **4 - T<br>23 - V<br>1- 4V<br>2 - 5V<br>1- 10 V<br>2- Tjetër** | **5 VS<br>19 BA<br>8 VS+BA<br>1 Cens** | **21 Vendi<br>9 Qarku<br>2 Bashki<br>1- NA** | **33 INSTAT** |

*M-mujor; T-tremujor; V-vjetor;
** VS-vrojtim statistikor; BA-burim administrativ; NA-nuk aplikohet.

**Tema 1.1 "Popullsia me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri dhe jashtë saj"**

INSTAT-i, si institucioni përgjegjës prodhues, parashikon të kryejë aktivitete të fokusuara në tri nëntema: *1.1.1 "Demografi, migracion dhe projeksione"*, *1.1.2 "Censi i popullsisë dhe banesave, azilkërkuesit dhe të huajt"* dhe *1.1.3 "Statistikat gjinore"*.

Në lidhje me nëntemën e parë do të kryhen tri aktivitete statistikore me frekuencë vjetore dhe tremujore. Prodhimi i statistikave të popullsisë dhe statistikave të migracionit kryhet me frekuencë vjetore. Ndërkohë, statistikat e ngjarjeve jetësore mbi numrin e lindjeve, vdekjeve dhe shtesa natyrore e popullsisë do të prodhohen me frekuencë tremujore. Për kryerjen e këtyre aktiviteteve do të përdoren burimet që INSTAT-i disponon, si: vrojtimi i forcave të punës dhe të dhënat administrative që merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Gjithashtu, për plotësimin e informacionit integrohen të dhënat nga burime ndërkombëtare, si: Eurostat, Departamenti i Çështjeve Ekonomike dhe Sociale në Kombet e Bashkuara (UNDESA), Programi i Zhvillimit në Kombet e Bashkuara (UNDP) dhe statistikat pasqyrë nga disa shtete të tjera.

Brenda kësaj nënteme do të kryhet nga INSTAT-i prodhimi i statistikave të azilit dhe të huajve, me frekuencë vjetore, duke përdorur të dhënat administrative të marra nga Ministria e Brendshme dhe Departamenti i Kufirit dhe Migracionit.

Aktiviteti i projeksioneve të popullsisë që kryhet zakonisht çdo pesë vjet, jep informacion në lidhje me numrin e ardhshëm, strukturën demografike dhe shpërndarjen territoriale të banorëve sipas hipotezave më të mundshme të prirjeve në sjelljet demografike.

Gjatë vitit 2025 parashikohet të kryhet publikimi mbi statistikat e diasporës shqiptare, aktivitet i cili prodhon të dhëna sipas destinacioneve kryesore,

piramidën e diasporës etj., duke vlerësuar karakteristikat bazë demografike dhe sociale.

Gjithashtu, gjatë vitit 2025 parashikohet të kryhet vrojtimi i grupimeve të treguesve të shumëfishtë (MICS), qëllimi kryesor i të cilit është të sigurojë të dhëna të nevojshme, dhe me cilësi të lartë të një sërë treguesish të fushave të ndryshme me fokus fëmijët, kryesisht kushtet sociale të jetesës, nënat dhe fëmijët, edukimin, shëndetësinë etj. Ky vrojtim pritet të realizohet nëpërmjet koordinimit ndërsektorial të INSTAT-it.

Statistikat gjinore dhe indeksi i barazisë gjinore do të prodhohen sipas aktivitetit vjetor që do të kryejë INSTAT-i, duke përdorur të dhënat administrative dhe vrojtime statistikore të INSTAT-it, si edhe burime administrative nga institucione të tjera si: Banka e Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Avokati i Popullit etj.

**Treguesit kryesorë:** tregues statistikorë mbi popullsinë më 1 janar, të detajuar sipas grup-moshës, gjinisë, qarqeve, si dhe tregues mbi komponentët e popullsisë, si: lindshmëria, vdekshmëria, shtesa natyrore e popullsisë, migracioni i brendshëm dhe i jashtëm, numri i emigrantëve dhe imigrantëve bazuar në vrojtimin e forcave të punës; tregues statistikorë të lindshmërisë, vdekshmërisë, martesave dhe divorceve me frekuencë vjetore, si dhe numri i lindjeve dhe i vdekjeve (shtesa natyrore e popullsisë) sipas qarqeve, me frekuencë tremujore.

Gjithashtu, nën këtë temë statistikore do të prodhohen tregues statistikorë të diasporës shqiptare sipas grup-moshës, gjinisë dhe vendit të rezidencës; tregues statistikorë të projeksioneve të popullsisë sipas grup-moshës dhe gjinisë; Tregues statistikorë mbi azilkërkuesit dhe të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri sipas grup-moshës, gjinisë, motivit të lejes së qëndrimit dhe sipas vendit të origjinës.

**Përputhshmëria me *acquis:*** *Statistikat demografike, të migracionit dhe popullsisë* janë pjesërisht të përputhshme me Rregulloren (BE) nr. 1260/2013. Nga kjo rregullore lind nevoja për të prodhuar tabela më të detajuara për popullsinë me vendbanim të zakonshëm, lindjet e gjalla dhe vdekjet. Të dhënat demografike të siguruara nga INSTAT-i bazohen në përkufizimin e popullsisë banuese, nivelin rajonal NUTS dhe përkufizimet e ngjarjeve jetësore që janë plotësisht në përputhje me Rregulloren e BE-së nr. 1260/2013.

*Statistikat e Azilkërkuesve, lejeve të qëndrimit, dhe shtetësisë* janë përfshirë për herë të parë në Programin e Statistikave Zyrtare 2017–2021. Lidhur me statistikat e azilkërkuesve dhe lejeve të qëndrimit edhe pse nuk janë në përputhje me rregulloren, INSTAT-i synon përshtatjen me Rregulloren (KE) nr. 862/2007, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11 korrik 2007, "Mbi statistikat për migracionin dhe mbrojtjen ndërkombëtare", nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet furnizuese të të dhënave administrative për të prodhuar statistika më të mira dhe cilësore për migracionin, azilkërkuesit dhe të huajt.

**Tema 1.2 "Puna dhe kostot e punës"**

Tema 1.2 përbëhet nga dy nëntema: *1.2.1 "Punësimi dhe papunësia"* dhe *1.2.2 "Kostoja e punës dhe të ardhurat nga puna"*. Siguron informacion tremujor dhe vjetor mbi karakteristikat e tregut të punës dhe variablave socio-demografikë të individëve dhe familjeve. Përgjegjës për prodhimin e statistikave sipas kësaj teme është INSTAT-i. Për nëntemën e parë, INSTAT-i do të kryejë një aktivitet statistikor me frekuencë tremujore: "Statistika të tregut të punës". Për prodhimin e statistikave të tregut të punës do të shfrytëzohen të dhënat nga vrojtimi i forcave të punës. Për nëntemën e dytë, INSTAT-i do të prodhojë statistikat mbi pagat me frekuencë tremujore dhe vjetore, si dhe vrojtimin e kostos së punës, për vitin 2025. **Treguesit kryesorë:** Tregues statistikorë mbi forcat e punës, punësimin dhe papunësinë sipas gjinisë, aktivitetit ekonomik, grup-profesioneve, grup-moshave, nivelit arsimor, në nivel qarku; tregues statistikorë mbi strukturën e kostos së punës sipas aktivitetit ekonomik, madhësisë dhe pronësisë së ndërmarrjes etj.; tregues statistikorë mbi pagën orare, mujore dhe vjetore bruto, dhe hendekun gjinor në paga sipas aktiviteteve ekonomike, grup-profesioneve; tregues statistikorë mbi pagën mesatare mujore për të punësuarit me pagë në sektorin shtetëror dhe për të gjithë sektorët ekonomikë sipas aktiviteteve ekonomike dhe grup-profesioneve, hendekun gjinor në paga sipas aktiviteteve ekonomike dhe grup-profesioneve dhe treguesit e strukturës së të ardhurave nga puna.

**Përputhshmëria me *acquis*:** *Statistikat e forcave të punës* lidhur me punësimin dhe papunësinë bazohen në Rregulloren kuadër (KE) nr. 1700/2019 dhe në rregulloret implementuese përkatëse. Aktualisht, niveli i përputhshmërisë me këto

rregullore është i ulët. Klasifikimet mbi të cilat bazohet përpunimi i të dhënave janë në përputhje përkatësisht me klasifikimet ISCO-08 për profesionet dhe NVE Rev2, për aktivitetet ekonomike.

*Statistikat strukturore mbi koston e punës dhe të ardhurave nga puna* bazohen në rregulloret (KE) nr. 530/1999 dhe nr. 1737/2005, "Mbi vrojtimin e kostos së punës 2024". Përkufizimet e përdorura janë kryesisht në përputhje me këto rregullore. Statistikat mbi koston e punës janë pjesërisht në përputhje me rregulloret përkatëse.

**Tema 1.3 "Arsimi dhe trajnimet"**

Qëllimi kryesor i kësaj teme është që të sigurojë të dhëna të krahasueshme dhe të harmonizuara, në kohë dhe me cilësi të lartë mbi arsimin zyrtar.

Kjo temë përbëhet nga 2 nëntema: a) *1.3.1 "Arsimi"*, e cila përfshin tri aktivitete statistikore me frekuencë vjetore të cilat duhet të përmbushen nga INSTAT-i: "Statistika të regjistrimeve në arsim", "Statistika të diplomimeve në arsim" dhe "Statistika të arsimit sipas fushave të studimit në arsimin e lartë". Të dhënat sigurohen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, e cila mbulon statistikat mbi arsimin profesional; b) 1.3.2 *"Trajnimi profesional dhe të mësuarit gjatë të gjithë jetës"*, që përfshin kryesisht statistika nga vrojtimi i arsimit të të rriturve, me periodicitet 5-vjeçar.

Në vitin 2025, INSTAT-i do vijojë punën për plotësimin dhe transmetimin e pyetësorëve të UNESCO–OECD–Eurostat me të dhëna të detajuara për arsimin, për vitin akademik 2023–2024, për diplomimet dhe për vitin akademik 2024–2025, për regjistrimet.

**Treguesit kryesorë:** Tregues statistikorë mbi regjistrimet që llogariten me bazë vjetore, sipas niveleve të arsimit, gjinisë, institucioneve publike/private, fushave të studimit (arsim i lartë), stafit mësimdhënës, qarqeve etj.; tregues statistikorë mbi diplomimet që llogariten me bazë vjetore, sipas niveleve të arsimit, gjinisë, institucioneve publike/private, qarqeve, fushave të studimit (arsimi lartë) etj.; tregues mbi shpenzimet gjithsej të buxhetit të shtetit për arsimin dhe përqindjen ndaj prodhimit të brendshëm bruto (PBB); tregues statistikorë kryesorë të përllogaritur bazuar në vrojtimin e forcave të punës mbi pjesëmarrjen e popullsisë 25–64 vjeç në arsim dhe trajnim, sipas gjinisë, grup-moshave dhe nivelit arsimor të arritur. Tregues mbi arsimimin e të rriturve bazuar në vrojtimin e arsimit të të rriturve.

**Përputhshmëria me *acquis*:** *Statistikat e formimit profesional dhe të të mësuarit gjatë të gjithë jetës* janë pjesërisht në përputhje me rregulloren e Komisionit Evropian (KE) nr. 452/2008, "Për prodhimin dhe zhvillimin e statistikave të arsimit dhe të të mësuarit gjatë të gjithë jetës". *Statistikat e arsimit* janë pjesërisht në përputhje me statistikat evropiane të kësaj fushe. Të dhënat e pyetësorit të përbashkët të UNESCO-s, OECD-së dhe Eurostatit do të transmetohen në kohë në Eurostat në vitin 2025. Përpjekjet do të përqendrohen në përpilimin e të dhënave mbi të regjistruarit për herë të parë, lëvizshmërinë e të mësuarit, si dhe në përpilimin e pyetësorit me të dhëna rajonale. Shqipëria nuk ka kryer ende një vrojtim të formimit profesional të vazhdueshëm (CVTS) dhe nuk ka plane për ta zbatuar atë në një të ardhme të afërt.

**Tema 1.4 "Shëndetësia"**

Qëllimi kryesor i statistikave të shëndetësisë është që të sigurojnë të dhëna të krahasueshme dhe të harmonizuara, në kohë dhe me cilësi të lartë të treguesve statistikorë mbi shëndetin publik.

Kjo temë përbëhet nga nëntema *1.4.1 "Shëndeti publik"* dhe nëntema *1.4.2 "Statistikat e shëndetit dhe sigurisë në punë"*. Për realizimin e nëntemës së parë INSTAT-i do të kryejë dy aktiviteteve statistikore me frekuencë vjetore: statistikat mbi shkaqet e vdekjeve dhe statistikave mbi shëndetin publik. Për statistikat e shkaqeve të vdekjeve do të përdoret si burimi i të dhënave administrative Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Ndërsa për statistikat e shëndetit publik do të përdoren të dhënat administrative që sigurohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Instituti i Shëndetit Publik dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Për realizimin e nëntemës së dytë INSTAT-i do të kryejë aktivitetin mbi statistikat e shëndetit dhe sigurisë në punë, duke e pasuruar më tej me të dhëna nënfushën e statistikave të shëndetësisë.

**Treguesit kryesorë:** tregues mbi shkaqet e vdekjeve me frekuencë vjetore sipas grup-sëmundjeve bazuar në klasifikimin ndërkombëtar (ICD-9), gjinisë, grup-moshës dhe qarqeve; tregues statistikorë mbi shërbimin e institucioneve me shtretër, konsultorin e gruas dhe fëmijës, aktivitetin e qendrave shëndetësore; abortet sipas grup-moshave të nënës, nivelit arsimor të nënës, aftësisë

së kufizuar, tregues mbi shëndetin dhe sigurinë në punë etj.

**Përputhshmëria me *acquis*:** përafrimi i statistikave të shkaqeve të vdekjeve është pjesërisht në linjë me rregulloren e Komisionit (EU) nr. 328/2011, "Për shëndetin publik dhe shkaqet e vdekjeve", pasi INSTAT-i ende përdor klasifikimin ndërkombëtar ICD-9. Për sa i takon klasifikimit ICD-10, INSTAT-i synon të publikojë statistikat e shkaqeve të vdekjeve me klasifikimin e ri, por vështirësi ende ekzistojnë pasi një pjesë e mjekëve ende përdorin ICD-9. Statistikat e shpenzimeve në shëndetësi, nuk janë në përputhje me kërkesat e rregullores (EC) nr. 2015/359, "Për statistikat e shpenzimeve në shëndetësi".

**Tema 1.5 "Të ardhurat dhe shpenzimet e konsumit"**

Për të prodhuar statistikat e kësaj teme, nga INSTAT-i do të përdoren të dhënat nga realizimi i dy aktiviteteve statistikore me frekuencë vjetore: "Vrojtimi i buxhetit të NjEF-së", objektiv i të cilit është sigurimi i të dhënave të harmonizuara mbi buxhetin e familjes, dhe "Vrojtimi i të ardhurave dhe nivelit të jetesës", objektiv i të cilit është të sigurojë të dhëna të harmonizuara mbi të ardhurat e familjeve, përfshirjen sociale dhe kushtet e jetesës. Të dhënat e mbledhura nëpërmjet këtyre dy vrojtimeve do të sigurojnë informacion mbi buxhetin e NjEF-së, të ardhurat, përfshirjen sociale, nivelin e jetesës etj.

**Treguesit kryesorë:** tregues statistikorë mbi përshkrimin e nivelit dhe strukturës së shpenzimeve për konsum të njësive ekonomike familjare (NjEF) në Shqipëri, si dhe të treguesve të tjerë me bazë shpenzimet e konsumit; tregues mbi varfërinë dhe përjashtimin social, shpërndarjen e të ardhurave, pabarazinë dhe kushtet e banimit, tregues mbi cilësinë e jetës etj.

**Përputhshmëria me *acquis*:** *vrojtimi i buxhetit të familjes* dhe *vrojtimi i të ardhurave dhe nivelit të jetesës* kryhen bazuar në rregulloren bazë të Komisionit Evropian (KE) 2019/1700, "Për statistikat lidhur me personat dhe familjet", duke krijuar një kuadër ligjor të përbashkët lidhur me statistikat për njësitë ekonomike familjare dhe individët të mbledhura përmes kampionëve të zgjedhur.

*Vrojtimi i buxhetit të familjes,* gjithashtu, bazohet në marrëveshjen e mirëkuptimit (*gentlemen's agreement*), ku secili shtet anëtar vendos objektivat, metodologjinë dhe frekuencën e kryerjes së vrojtimit. Bazuar në këtë marrëveshje, plotshmëria e të dhënave të vrojtimit është në përputhje të plotë me objektivat e përcaktuara nga INSTAT-i.

*Vrojtimi i të ardhurave dhe nivelit të jetesës* kryhet bazuar edhe në rregullore të tjera të Komisionit Evropian që lidhen specifikisht me zbatimin e këtij vrojtimi si: rregullorja (BE) 2020/258, "Për të ardhurat dhe nivelin e jetesës" dhe rregullorja (BE) 2019/2242, "Për rregullimin e disa specifikimeve, lidhur me raportet e cilësisë dhe organizimin e vrojtimit mbi të ardhurat dhe nivelin e jetesës", si dhe rregulloret shtesë që ndihmojnë në zbatimin e përvitshëm të këtij vrojtimi.

**Tema 1.6 "Mbrojtja sociale"**

Kjo temë përbëhet nga nëntemat *1.6.1 "Mbrojtja sociale"* dhe *1.6.2 "ESSPROS" Statistikat e mbrojtjes sociale janë shume të rëndësishme për të vlerësuar efektivitetin e masave dhe për të përmirësuar kushtet e jetesës së qytetareve.* Treguesit e mbrojtjes sociale përfaqësohen me të dhëna administrative që kanë të bëjnë me përfituesit në skemën e sigurimeve shoqërore, përfituesit në skemën e ndihmës ekonomike dhe pagesës për aftësinë e kufizuar, përfituesit në pagesë papunësie, përfituesit në kujdesin rezidencial dhe atë ditor në qendrat e kujdesit social, si dhe nga treguesit për fëmijët. INSTAT-i prodhon të dhëna mbi mbrojtjen sociale në nivel vendi dhe në nivel qarku, të cilat publikohen çdo vit në faqen e *web*-it të INSTAT-it dhe në vjetarin rajonal.

Treguesit statistikorë nga sistemi ESSPROS (Statistikat e integruara evropiane të mbrojtjes sociale), përfaqësohen nga sistemi bazë që përfshin të dhëna vjetore mbi të ardhurat, shpenzimet dhe përfitimet në fushën e mbrojtjes sociale sipas skemave të ESSPROS-së dhe gjithsej, të cilat shërbejnë si instrument për të analizuar dhe krahasuar flukset financiare në fushën e mbrojtjes sociale, si dhe nga modulet të cilat përmbajnë informacion shtesë statistikor mbi aspekte të veçanta të mbrojtjes sociale si: Moduli i Përfituesit dhe Pensioneve, dhe Përfitimet neto të mbrojtjes sociale.

**Treguesit kryesorë**: Variablat kryesorë nga të dhënat administrative mbi mbrojtjen sociale grupohen në këto kategori kryesore, si: pagesa e papunësisë, pagesa e aftësisë së kufizuar, ndihma ekonomike, pensionet urbane dhe rurale, qendrat rezidenciale, fëmijë në përkujdesje shoqërore etj. Nga këto variabla dalin tregues, si: skemat e mbrojtjes sociale, të ardhurat dhe shpenzimet për

mbrojtjen sociale, përfitimet e mbrojtjes sociale sipas funksionit të kujdesit shëndetësor, aftësisë së kufizuar, pleqërisë, pensioneve familjare, familjes dhe fëmijëve, papunësisë, strehimit dhe përjashtimit social të prodhuar me zbatimin e plotë të sistemit ESSPROS, të cilët bëjnë të mundur arritjen e nivelit të plotë të përputhshmërisë me Sistemin e Integruar Evropian të Mbrojtjes Sociale.

**Përputhshmëria me *acquis:*** Të dhënat e Sistemit të Integruar Evropian për Mbrojtjen Sociale (ESSPROS) bazohen në Rregulloren e Parlamentit dhe Këshillit Evropian nr. 458/2007, "Për sistemin evropian të statistikave të integruara të mbrojtjes sociale", si dhe nga rregulloret e Komisionit nr. 1322/2007, "Për formatin e duhur të transmetimit dhe kriteret e matjes së cilësisë së ESSPROS" nr. 10/2008, "Për klasifikimet dhe rregullat e shpërndarjes së statistikave të ESSPROS"; nr. 110/2011, "Për formatin e duhur të transmetimit dhe kriteret e matjes së cilësisë së ESSPROS"; nr. 263/2011, "Për lançimin e mbledhjes së plotë të të dhënave të ESSPROS" dhe janë pjesërisht të përputhshme me kërkesat e këtyre rregulloreve.

**Tema 1.7 "Drejtësia dhe krimi"**

Të dhënat e drejtësisë dhe krimit janë të bazuara në të dhëna zyrtare, të grupuara, nga burimet administrative.

Kjo temë përbëhet nga nëntema 1.7.1 "*Statistikat e kriminalitetit dhe drejtësisë*", e cila do të zbatohet nga INSTAT-i nëpërmjet përmbushjes së aktiviteteve statistikore me frekuencë vjetore, si: "Statistikat e kriminalitetit, veprave penale, procedimeve penale", "Statistikat e personave të dyshuar, të pandehur dhe të burgosur", "Statistikat e personave të dënuar dhe të pafajshëm", "Zbatimi i klasifikimit ndërkombëtar të krimeve për qëllime statistikore (ICCS)".

Statistikat mbi veprat penale dhe autorët do të prodhohen nëpërmjet përpunimit të të dhënave administrative të siguruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë; statistikat mbi procedimet penale dhe të pandehurit do të prodhohen nëpërmjet përpunimit të të dhënave administrative të siguruara nga Prokuroria e Përgjithshme; statistikat mbi të burgosurit do të prodhohen nëpërmjet përpunimit të të dhënave administrative të siguruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve; statistikat mbi të dënuarit dhe çështjet penale do të prodhohen nëpërmjet përpunimit të të dhënave administrative të siguruara nga Ministria e Drejtësisë.

Miratimi i klasifikimit pritej të bëhej gjatë vitit 2023, por për shkak të ndryshimeve të reja në Kodin Penal, ky proces është ndërprerë dhe pritet të rinisë me miratimin e Kodit të ri Penal.

**Treguesit kryesorë:** tregues mbi veprat penale të evidentuara nga policia bazuar në nenet e Kodit Penal; personat e dyshuar nga policia në kryerjen e një vepre penale; tregues mbi procedime penale dhe të pandehur të regjistruar nga Prokuroria; tregues mbi të burgosurit sipas veprave specifike penale, grup-moshës dhe gjinisë; të dënuarit me burg dhe të paraburgosur sipas gjinisë, veprave penale dhe grup-moshës. Tregues mbi çështje penale dhe të dënuarit nga Gjykatat e Shkallës së Parë, të ndarë sipas gjinisë, dy ndarjeve të mëdha moshore dhe veprave penale.

**Përputhshmëria me *acquis*:** *Statistikat e drejtësisë dhe krimit* bazohen në legjislacionin kombëtar dhe normat kombëtare të numërimit të veprave dhe personave në sistemin e drejtësisë. Kjo e bën të vështirë krahasueshmërinë e statistikave me ato të vendeve tjera. Për këtë arsye, përfundimi dhe miratimi i klasifikimit ndërkombëtar të statistikave të krimeve për qëllime statistikore (ICCS) do të sigurojë një kornizë për prodhimin e statistikave të krahasueshme.

**Tema 1.8 "Kultura"**

Statistikat e kulturës janë të përftuara nga grumbullimi i informacionit në disa fusha, sociale, ekonomike, të biznesit.

Kjo temë përbëhet nga nëntema 1.8.1 "*Statistikat e kulturës dhe sportit*". Statistikat e kulturës bazohen në burime administrative dhe në vrojtimet sociale dhe ekonomike që INSTAT-i kryen. Të dhënat administrative sigurohen nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, të dhëna të cilat mbulojnë statistika mbi institucionet qendrore të artit dhe trashëgimisë kulturore dhe statistika lidhur me arsimin për fushën e kulturës. Vrojtimi i të ardhurave dhe nivelit të jetesës, vrojtimi i përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), vrojtimi i forcave të punës, si dhe vrojtimi i çmimeve të konsumit, përdoren si burim në pasurimin e mëtejshëm të treguesve vjetorë të kulturës. Gjithashtu, gjatë vitit 2025 do të prodhohen statistikat mbi sportin, bazuar në vrojtimet që INSTAT-i kryen për këtë qëllim.

**Treguesit kryesorë:** Statistika mbi numrin e shfaqjeve dhe spektatorëve në institucionet qendrore të kulturës; numri i vizitorëve vendas dhe

të huaj në muze, kala dhe parqe arkeologjike, tregues nga biblioteka kombëtare; statistikat mbi edukimin për fusha të lidhura me kulturën; punësimin në kulturë, lidhur me profesione dhe aktivitete ekonomike të lidhura me kulturën, statistika mbi përdorimin e internetit për qëllime kulturore, tregues mbi sportin etj.

**Përputhshmëria me *acquis*:** *Statistikat e kulturës* janë pjesërisht të përafruara me rregulloren (BE) nr. 1295/2013, "Për statistikat e kulturës". Për zhvillimin e mëtejshëm të statistikave në linjë me rregulloren, INSTAT-i do të vijojë ndjekjen dhe konsultimin me metodologjinë e Eurostatit.

*Tabela nr. 9: Lista e vrojtimeve për fushën "Statistikat sociale dhe demografike"*

| Vrojtimi | Burimi i financimit |
|---|---|
| Vrojtimi i grupimeve të treguesve të shumëfishtë (MICS) | Buxhet shteti+Donatorë |
| Vrojtimi i forcës së punës | Buxhet shteti |
| Vrojtimi i kostos së punës | Buxhet shteti |
| Vrojtimi i buxhetit të Njësive Ekonomike Familjare | Buxhet shteti |
| Vrojtimi i të ardhurave dhe nivelit të jetesës | Buxhet shteti |

*Tabela nr. 10: Niveli i përputhshmërisë me acquis për fushën "Statistikat sociale dhe demografike"*

| Aktiviteti | Niveli i përputhshmërisë |
|---|---|
| Statistikat e Popullsisë | I lartë |
| Statistikat e Migracionit Ndërkombëtar dhe lëvizjet e brendshme | I mesëm |
| Statistikat e Ngjarjeve Jetësore | I mesëm |
| Cens i Popullsisë dhe Banesave | I lartë |
| Statistikat e azilit dhe të huajve | I mesëm |
| Statistika të Punësimit dhe papunësisë | I ulët |
| Statistika mbi Koston e Punës dhe të Ardhurat nga Puna | I mesëm |
| Statistika të Fitimeve dhe Kostos së Punës | I mesëm |
| Statistika të Arsimit dhe Trajnimit | I mesëm |
| Shëndeti publik dhe Shkaqet e vdekjeve | I ulët |
| Vrojtimi i të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës | I mesëm |
| Statistika të mbrojtjes sociale (ESSPROS) | I mesëm |
| Statistika të krimeve dhe drejtësisë penale | I mesëm |
| Statistika të kulturës dhe sportit | I ulët |

**Fusha 2 "Statistikat ekonomike"**

Statistikat ekonomike përfshijnë temat statistikore, si: statistikat makroekonomike, statistikat financiare të qeverisë, fiskale dhe sektorit publik dhe statistikat e biznesit, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në hartimin e politikave ekonomike dhe përbëjnë bazën kryesore të informacionit për analiza të mëtejshme mbi zhvillimin dhe ndryshimet strukturore të ekonomisë së vendit.

Qëllimi kryesor i statistikave ekonomike është që të sigurojnë të dhëna në kohë dhe me cilësi të lartë të treguesve statistikorë, të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave ekonomike, si dhe në monitorimin dhe menaxhimin e këtyre fushave.

Objektivi kryesor për vitin 2025 për statistikat ekonomike është realizimi i të gjithë objektivave, sipas Programit të Statistikave Zyrtare 2022–2026, me fokus rritjen e cilësisë dhe plotshmërisë së serive kohore për treguesit me frekuencë mujore, tremujore dhe vjetore, duke synuar rritjen e nivelit të përafrimit me *acquis* përkatëse. Një ndër zhvillimet e reja të parashikuara në vitin 2025, do të jetë përgatitja e serive kohore 1995–2017, në kuadër të revizionimit madhor të llogarive kombëtare, në terma vjetorë dhe tremujorë, ku synohet integrimi i të gjithë përmirësimeve të ndërmarra në këtë fushë nën asistencën e Eurostatit.

**Agjencitë statistikore përgjegjëse**: INSTAT-i, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave.

Në tabelën e mëposhtme (tabela nr. 11) paraqitet numri i aktiviteteve të kësaj fushe, për kategoritë: periodiciteti/burimi i të dhënave/niveli minimal i publikimit/institucioni përgjegjës.

*Tabela nr. 11: Përmbledhje e numrit të aktiviteteve për fushën "Statistikat ekonomike"*

| 2. Statistikat Ekonomike | Nr. i aktiviteteve Statistikore (AS) | Nr. AS / Periodiciteti * | Nr. AS / Burimi i të dhënave** | Nr. AS / Niveli minimal i publikimit | Nr. AS / Institucioni përgjegjës |
|---|---|---|---|---|---|
| Makroekonomike | 5 | 1-T<br>4-V | 5 VS+BA | 4 Vendi<br>1 Qark | 5 INSTAT |
| Statistikat Financiare të Qeverisë, Fiskale dhe të Sektorit Publik | 6 | 1-M<br>1-T<br>2-V<br>2-6M | 4 BA<br>2- Tjetër | 6 Vendi | 2 BSH<br>2 MFE<br>2 INSTAT |
| Statistikat e Biznesit | 9 | 3-T<br>4-V<br>1- rastësisht<br>1- çdo 5 vite | 4 VS<br>1 BA<br>4 VS+BA | 7 Vendi<br>2 Bashki | 9 INSTAT |
| **Gjithsej** | **20** | **1-M<br>5-T<br>10-V<br>2- 6M<br>1-5v<br>1-Rastësisht** | **4 VS<br>5 BA<br>9 VS+BA<br>2-Tjetër** | **17 Vendi<br>1 Qark<br>2 Bashki** | **16 INSTAT<br>2 BSH<br>2 MFE** |

*M-mujor; T-tremujor; V-vjetor;
** VS-vrojtim statistikor; BA-burim administrativ; NA-nuk aplikohet.

Fusha "Statistikat ekonomike" përbëhet nga 3 tema statistikore:

**Tema 2.1 "Makroekonomike"**

Në këtë temë përfshihen statistikat e llogarive kombëtare, si: llogaritë jofinanciare sipas sektorëve institucionalë, prodhimi i brendshëm bruto në terma tremujorë dhe vjetorë, tabelat burime-përdorime dhe llogaritë rajonale.

Llogaritë kombëtare pasqyrojnë zhvillimet makroekonomike të një vendi dhe i ofrojnë përdoruesve treguesit kryesorë dhe informacionin bazë për zhvillimin ekonomik të tij. Këto statistika tregojnë se sa është kapaciteti prodhues i vendit, sa konsumohet, investohet dhe shkëmbehet me vendet e tjera të botës. Vlerësimi i këtyre treguesve realizohet duke përdorur informacionin e siguruar nga burime të ndryshme statistikore dhe administrative. Struktura e temës përbëhet nga këto nëntema:

*2.1.1 "Llogaritë jofinanciare sipas sektorëve institucionalë në terma vjetorë"* paraqesin një pasqyrë koherente të të gjitha proceseve ekonomike dhe ndërveprimet e sektorëve të ndryshëm në ekonomi, duke përfshirë lidhjet midis ekonomisë kombëtare si një e tërë dhe pjesës tjetër të botës. Aktualisht, INSTAT-i publikon llogaritë jofinanciare sipas sektorëve institucionalë në terma vjetorë, në përputhje me Sistemin Evropian të Llogarive (ESA2010). Nën asistencën e vazhdueshme të programeve IPA shumëpërfituese është punuar për përpilimin e sekuencës së plotë të llogarive, me qëllim krijimin e plotshmërisë në seri kohore dhe tregues statistikorë. Në vitin 2025 do të realizohet publikimi dhe transmetimi në Eurostat i sekuencës së plotë të llogarive jofinanciare sipas sektorëve institucionalë për periudhën 2013–2017, duke rritur nivelin e plotshmërisë në seri kohore sipas programit të transmetimit ESA 2010.

*2.1.2 "Llogaritë kombëtare tremujore dhe vjetore, agregatët kryesorë"*, e cila ndahet në dy aktivitete kryesore, duke u bazuar në frekuencën e treguesit.

*"Llogaritë kombëtare tremujore"* pasqyrojnë në frekuenca tremujore ecurinë e treguesit të produktit të brendshëm bruto (PBB), i vlerësuar me metodën e prodhimit, si dhe vlerësimin e disa prej komponentëve kryesorë të metodës së shpenzimeve me çmime korrente, çmimet e vitit paraardhës dhe lidhje zinxhir, të përshtatura dhe jo të përshtatura sezonalisht.

*"Llogaritë kombëtare vjetore"* pasqyrojnë në frekuencë vjetore treguesin "Produkti i brendshëm bruto (PBB)", i vlerësuar me metodën e prodhimit, të shpenzimeve dhe të të ardhurave. Vlerësimi i të dhënave bazohet në kombinimin e burimeve të siguruara nga INSTAT-i, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, në varësi të frekuencës së treguesit. Gjatë vitit 2025, nën asistencën e programit IPA 2022 shumëpërfituese, do të vijojë puna për rritjen e nivelit të

përputhshmërisë me kërkesat e BE-së sipas programit të transmetimit ESA 2010.

*2.1.3 "Tabelat burime-përdorime dhe tabelat input-output"*, pasqyrojnë në mënyrë të detajuar qarkullimin e produkteve dhe shërbimeve sipas aktiviteteve ekonomike gjatë vitit. Nga ana e burimeve paraqitet outputi, importet, marzhet tregtare dhe të transportit, ndërsa nga ana e përdorimeve paraqitet konsumi ndërmjetës, konsumi final, formimi bruto i kapitalit fiks dhe eksportet. Këto tabela prodhohen me frekuencë vjetore nëpërmjet përpunimit të të dhënave administrative dhe të dhënave të mbledhura nga vrojtimet statistikore. Në vitin 2025, nën asistencën e IPA 2022 shumëpërfituese, do të vijojë puna në drejtim të përmirësimeve metodologjike për rritjen e nivelit të përputhshmërisë me ESA 2010 për përpilimin e këtyre tabelave.

*2.1.4 "Llogaritë rajonale"* pasqyrojnë zhvillimet makroekonomike sipas rajoneve statistikore të një vendi dhe i ofrojnë përdoruesve treguesit kryesorë dhe informacionin bazë për zhvillimin ekonomik rajonal. Këto statistika janë, gjithashtu, me frekuencë vjetore dhe prodhohen nëpërmjet kombinimit të të dhënave administrative dhe të dhënave të siguruara nga vrojtimet statistikore që zhvillon INSTAT-i. Llogaritë rajonale mbështeten në klasifikimin sipas rajoneve statistikore në nivel 1, 2 dhe 3, i cili bazohet në Nomenklaturën e Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian. Në vitin 2025 fokusi do të jetë në drejtim të implementimit të përmirësimeve metodologjike të treguesve të llogarive rajonale, si dhe në përmirësimin e treguesve si: formimi bruto i kapitalit, të ardhurat e familjeve dhe kompensimi i punonjësve, në nivel rajonal, sipas kërkesave të programit të transmetimit ESA 2010 për llogaritë rajonale.

**Treguesit kryesorë:** Seti i plotë i llogarive sipas sektorëve institucionalë: PBB-ja vjetore me metodën e prodhimit, metodën e shpenzimeve dhe të ardhurave; PBB-ja tremujore me metodën e prodhimit dhe shpenzimeve, me çmime korrente, çmimet e vitit të mëparshëm dhe "*të lidhura zinxhir*", sipas aktivitetit ekonomik, të përshtatura dhe jo të përshtatura sezonalisht; tabelat burime -përdorime me çmime korrente dhe me çmimet e vitit të mëparshëm; tabela input-output, prodhim i brendshëm, importe me çmime bazë; treguesi i PBB-së dhe i vlerës së shtuar bruto (VSHB-së), sipas rajoneve statistikore dhe degëve kryesore të ekonomisë në seri kohore; vlerësim i PBB-së dhe PBB-së për frymë, sipas rajoneve statistikore dhe aktiviteteve ekonomike; vlerësimi i PBB-së për frymë sipas rajoneve statistikore shprehur në termat e paritetit.

**Përputhshmëria me *acquis*:** Eurostati vlerëson llogaritë kombëtare pjesërisht në përputhje me nivelin e përputhshmërisë të llogarive kombëtare me standardet e *acquis communautaire*. Mbështetur në programin e monitorimit të përputhshmërisë, Shqipëria nën asistencën teknike të Eurostatit, ka rritur në mënyrë të ndjeshme nivelin e përputhshmërisë së statistikave të llogarive kombëtare veçanërisht me rritjen e plotshmërisë së treguesve statistikorë, serive kohore dhe përmirësimeve metodologjike të implementuara.

**Tema 2.2 "Statistikat financiare të qeverisë, fiskale dhe të sektorit publik"**

Për prodhimin e statistikave të kësaj teme janë përgjegjës INSTAT-i, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave, sipas nëntemave si vijon:

*2.2.1 "Llogaritë financiare sipas sektorëve institucionalë"* – janë një sistem statistikor i integruar, që pasqyron marrëdhëniet financiare ndërmjet sektorëve të ekonomisë. Këto statistika paraqesin një pamje të plotë dhe gjithëpërfshirëse të situatës financiare dhe marrëdhënieve financiare në ekonomi, për sa i përket sektorëve ekonomikë dhe instrumenteve financiarë, përfshirë edhe marrëdhëniet me jorezidentët. Llogaritë financiare ofrojnë një pasqyrë mbi operacionet dhe strukturën e sistemit financiar duke identifikuar kanalet kryesorë të përdorura për të përftuar dhe investuar burimet financiare.

Llogaritë financiare sipas sektorëve institucionalë, me frekuencë vjetore, hartohen nga Banka e Shqipërisë. Për hartimin dhe raportimin e tyre, Banka mbështetet në standardet metodologjike ndërkombëtare mbi të cilat është ngritur dhe funksionon hartimi dhe raportimi i llogarive financiare në vendet anëtare të Bashkimit Evropian, si më poshtë:

- Sistemi Evropian i Llogarive Kombëtare, ESA 2010;
- Manuali mbi burimet dhe metodat e hartimit të llogarive financiare – edicioni i dytë;
- Rregullorja 549/2013 (BE), mbi Sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Rajonale në Bashkimin Evropian.

Hartimi i të dhënave bazohet në kombinimin e burimeve të siguruara nga Banka e Shqipërisë,

INSTAT-i, Ministria e Financave, Qendra Kombëtare e Biznesit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe burime të tjera administrative. Të dhënat merren në mënyrë direkte nga institucionet raportuese si burim primar ose në mënyrë indirekte nga informacioni kundërparti. Për mbledhjen e të dhënave primare, statistikat e llogarive financiare përdorin gjerësisht të dhënat, të cilat Banka e Shqipërisë i mbledh nëpërmjet Sistemit të Unifikuar të Raportimit Rregullator (ERRS) dhe raportimeve të tjera në Bankën e Shqipërisë. Ndërkohë që burime suplementare përdoren për të plotësuar mangësitë në burimet primare ose për të përmirësuar cilësinë e statistikave. Banka e Shqipërisë bashkëpunon me Institutin e Statistikave dhe Ministrinë e Financave në mënyrë që të përdoren maksimalisht dhe në mënyrë eficiente të dhënat administrative, veçanërisht për hartimin e të dhënave të sektorit të qeverisë së përgjithshme dhe korporatave jofinanciare.

*2.2.2 "Tregues monetarë dhe financiarë"* - Banka e Shqipërisë prodhon dhe publikon treguesit monetarë me frekuencë mujore dhe tremujore, që lidhen me agregatët monetarë, depozitat, kreditë, normat e interesit, si dhe bilancet sektoriale dhe paraqitjet monetare të korporatave depozituese. Për përgatitjen e statistikave monetare dhe financiare si burim informacioni shërbejnë pasqyrat financiare të Bankës së Shqipërisë, Sistemi Raportues i Unifikuar Rregullator (ERRS) për bankat para-depozituese, sistemi raportues për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre, sistemi raportues nga institucionet financiare jobanka, si dhe informacion i mbledhur nga Autoriteti për Mbikëqyrjen Financiare, në përputhje me formatet metodologjike dhe udhëzimet e Bankës së Shqipërisë për kompanitë e sigurimit, fondet e pensioneve dhe fondet e investimeve. Në kuadër të harmonizimit të standardeve të raportimit me kërkesat e BE-së, statistikat e normave të interesit të institucioneve monetare financiare (bankat e nivelit të dytë) hartohen bazuar në rregulloren nr. 48/2017, "Për raportimet në Bankën e Shqipërisë të statistikave të normave të interesit" e cila përafron rregulloren (KE) nr. 1072/2003, 24.9.2013 (ECB/2013/34), ndryshuar me rregulloren e Bankës Qendrore Evropiane të datës 8.7.2014 (ECB/2014/30), ndërsa në dhjetor të vitit 2021, u miratua rregullorja nr. 73, datë 22.12.2021, "Për raportimet në Bankën e Shqipërisë të zërave të bilancit të institucioneve të kreditit dhe të institucioneve monetare financiare", e cila përafroi rregulloren e Bankës Qendrore Evropiane (BE) nr. 2021/379.

*2.2.3 "Statistikat financiare të qeverisë sipas GFSM2014 dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisë"* është nëntemë e cila mbulohet nga Ministria e Financave në bashkëpunim me INSTAT-in dhe Bankën e Shqipërisë. Kjo ministri, nën cilësinë e agjencisë statistikore, kryen aktivitetin e prodhimit të statistikave financiare të qeverisë sipas GFSM-2014 dhe pasqyrave financiare të konsoliduara të qeverisë, të cilat publikohen me frekuencë vjetore. Prodhimi i këtyre statistikave mundësohet nëpërmjet përpunimit të informacionit të ofruar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme (institucione qendrore, vendore dhe fondet speciale).

*2.2.4 "Statistikat e borxhit të sektorit buxhetor të qeverisë dhe borxhit të garantuar"* është nëntemë e cila mbulohet, gjithashtu, nga Ministria e Financave duke prodhuar statistikat e borxhit të sektorit buxhetor të qeverisë dhe borxhit të garantuar, me frekuencë tremujore dhe vjetore. Për prodhimin e këtyre statistikave, ministrisë i duhet të shfrytëzojë të dhënat që disponon INSTAT-i dhe nga Banka e Shqipërisë.

*2.2.5 "Statistikat financiare të qeverisë sipas ESA-2010"* është nëntemë e cila mbulohet nga INSTAT-i në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë. INSTAT-i kryen aktivitetin e prodhimit statistikor mbi statistikat financiare të qeverisë sipas ESA2010, me status "jo për publikim". Të dhënat janë me frekuencë tremujore dhe vjetore referuar Programi të Transmetimit ESA-2010. Statistikat financiare të qeverisë vlerësohen nëpërmjet përpunimit të informacionit të marrë për të gjitha njësitë e klasifikuara në sektorin e qeverisjes së përgjithshme (S.13) sipas metodologjisë ESA-2010. Vlerësimet janë të ndara dhe sipas nënsektorëve të qeverisë: qeveria qendrore (S.1311), qeveria federale (S.1312), qeveria lokale (S.1313) dhe fondet e sigurimeve (S.1314).

*2.2.6 "Procedura e deficitit të tejkaluar"* është nëntemë e cila mbulohet, gjithashtu, nga INSTAT-i, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë. INSTAT-i kryen aktivitetin e prodhimit statistikor mbi tabelat e procedurës së deficitit të tejkaluar sipas formatit të përcaktuar nga Eurostati, duke ndjekur metodologjinë ESA-2010. Këto të dhëna kanë

status "jo për publikim". Të dhënat transmetohen dy herë në vit prill/tetor, sikurse kërkohen nga Eurostati për vendet kandidate të Bashkimit Evropian.

Në vitin 2025, nën asistencën e IPA 2022 shumëpërfituese, do të vijojë puna në drejtim të përmirësimeve metodologjike për rritjen e nivelit të përputhshmërisë me ESA-2010 për përpilimin e këtyre tabelave.

**Treguesit kryesorë:** Përgatitja e informacionit shpjegues metodologjik; tregues statistikorë mbi llogaritë financiare të sektorit të korporatave financiare, të jorezidentëve (pjesës tjetër të botës), të sektorit të qeverisë së përgjithshme, sektorit të korporatave jofinanciare, të ekonomive familjare dhe institucioneve jo me qëllim fitimi, në shërbim të ekonomive familjare; tregues statistikorë mbi agregatët monetarë; bilancin sektorial dhe paraqitjen monetare të bankës qendrore, të bankave paradepozituese të bankave të tjera depozituese; paraqitjen monetare të korporatave depozituese; depozitat e përfshira në paranë e gjerë; kredinë për ekonominë; tregues statistikorë mbi normat e interesit për depozitat e reja, huat e reja, depozitat gjendje në fund të periudhës, kreditë gjendje në fund të periudhës; tregues statistikorë mbi bilancin sektorial dhe paraqitjen monetare të korporatave të tjera financiare. Tregues statistikorë financiare të qeverisë sipas GFSM 2014 dhe mbi pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisë; informacion mbi borxhin e qeverisë qendrore buxhetore dhe borxhin e garantuar sipas instrumenteve, maturimit dhe monedhës, tipit të interesit, koncensionalitetit, si dhe borxhin e pushtetit lokal ndaj sektorit bankar (kredi). Tregues statistikorë financiare të qeverisë sipas ESA-2010; informacion mbi treguesit e borxhit të qeverisë të tabelave të procedurës së deficitit të tejkaluar etj.

**Përputhshmëria me *acquis*:** Mbështetur në programin e monitorimit të përputhshmërisë, Eurostat-i vlerëson mesatarisht të përputhshëm nivelin e implementimit të ESA 2010 në llogaritë financiare të qeverisë. INSTAT-i do të punojë në drejtim të rritjes së përputhshmërisë së kuadrit ligjor dhe të intensifikimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, me qëllim përpilimin e tabelave të statistikave financiare të qeverisë (GFS (angl.)) dhe tabelave të procedurës së deficitit të tejkaluar (EDP (angl.)) sipas standardeve evropiane. Statistikat monetare hartohen në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare bazuar në manualin e Statistikave Monetare dhe Financiare, FMN 2016 dhe manualin e Statistikave të Institucioneve Monetare Financiare, ECB, 2019.

**Tema 2.3 "Statistikat e biznesit"**

Statistikat e biznesit prodhohen nga INSTAT-i dhe ndahen në nëntemat si vijon:

*2.3.1 "Statistikat strukturore të ndërmarrjeve",* INSTAT-i kryen vrojtimin vjetor pranë ndërmarrjeve ekonomike, për prodhimin e statistikave strukturore në nivel kombëtar dhe rajonal për treguesit kryesorë. Për të siguruar vazhdimësinë dhe përmirësimin e cilësisë së treguesve statistikorë të ndërmarrjeve, INSTAT-i do të shfrytëzojë gjithnjë e më shumë burimet administrative për kontrollin, llogaritjen dhe publikimin e të dhënave. Gjatë vitit 2025, në mënyrë që statistikat strukturore të ndërmarrjeve të përafrohen më shumë me rregulloren evropiane të statistikave të biznesit, fokus do të jetë rritja e mbulimit të sa më shumë aktiviteteve ekonomike me synimin për të kaluar nga një nivel 2-shifror në një nivel 4-shifror për zgjedhjen e kampionit të vrojtimit strukturor të ndërmarrjeve. Gjithashtu, do të analizohen burimet e mundshme administrative në dispozicion, me qëllim zgjerimin e mbulimit të ASN-së për sa i përket aktivitetit ekonomik, duke përfshirë ndërmarrjet financiare. Gjatë 2025, puna do të vijojë me analizën e statistikave rajonale dhe vlerësimin e situatës aktuale për prodhimin e statistikave rajonale të biznesit në nivel të disagreguar.

*2.3.2 "Statistikat mbi produktet industriale të ndërmarrjeve (PRODCOM)"*, këto statistika të cilat prodhohen nga INSTAT-i janë rezultat i të dhënave nga vrojtimi vjetor që kryhet për listën e produkteve industriale. Duke filluar nga viti 2023, në vrojtimin PRODCOM janë bërë disa përmirësime në metodologjinë e mbledhjes së të dhënave. Ky vrojtim realizohet me metodën CAPI dhe me një kampion të zgjeruar me përfaqësim në nivel produkti, duke përdorur versionin më të fundit të listës së produkteve industriale të miratuar nga Eurostat. Duke filluar nga viti 2023 është realizuar për herë të parë publikimi dhe transmetimi i të dhënave të PRODCOM-it në Eurostat, duke respektuar afatet e përcaktuara në rregullore. Gjatë vitit 2025 do të vijohet me vrojtimin, publikimin dhe transmetimin e rregullt të treguesve sasior të produkteve industriale.

*2.3.3 "Statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve"*, ku përfshihen tri aktivitete statistikore që kryen INSTAT-i:

i. Statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve ekonomike – për prodhimin e statistikave tremujore të kësaj kategorie. Gjatë vitit 2025, burimet administrative do të vazhdojnë të përdoren për analizën dhe prodhimin e treguesve afatshkurtër, duke marrë në konsideratë ndryshimet e kuadrit ligjor në institucionet ofruese të të dhënave administrative. Në rast të mungesës së burimit administrativ do të përdoret kontakti me anketues me metodën CAPI për ndërmarrjet. Gjithashtu, pas vlerësimit dhe analizës së të dhënave të pesë aktiviteteve të përfshira në fushën e shërbimeve për statistikat afatshkurtra për një periudhë kohore trevjeçare (INSTAT-i ka nxjerrë në terren pyetësorët për mbledhjen e të dhënave që prej muajit janar 2022), do të bëhet përpunimi i tyre në mënyrë që seritë të publikohen dhe të transmetohen në Eurostat.

Gjatë këtij viti do të vijojë puna për llogaritjen e indekseve mujore për treguesit e shitjeve në industri në statistikat afatshkurtra dhe treguesve të demografisë së biznesit, si: regjistrimet dhe falimentimet. Në kuadër të programit IPA 2022 shumëpërfitues për statistikat afatshkurtra do të punohet lidhur me analizën dhe krijimin e një tabele korrespondence për të evidentuar se cilat aktivitete në NACE Rev. 2.1 riklasifikohen me NACE Rev. 2, dhe si do të ndikojë ky ndryshim në disa grupe dhe aktivitete. Çështje që janë në fokus për t'u arritur gjatë vitit 2025, kanë të bëjnë me prodhimin e indeksit mujor të vëllimit të shitjeve për sektorin e tregtisë dhe për sektorët e shërbimeve;

ii. Vrojtimi tremujor për statistikat e çmimeve në ndërmarrjet ekonomike;

iii. Prodhimi i statistikave mbi lejet e ndërtimit, të miratuara në territorin e Republikës së Shqipërisë, me frekuencë tremujore, duke shfrytëzuar të dhënat administrative nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe INSTAT-it.

*2.3.4 "Statistikat e regjistrave të biznesit"* përfshijnë aktivitetet mbi mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave administrative, dhe statistikore për përditësimin e tyre. INSTAT-i mirëmban dhe përditëson:

- Regjistrin e Ndërmarrjeve;
- Regjistrin e Njësive Lokale;
- Regjistrin e Grupeve të Ndërmarrjeve.

Anketa e regjistrave të biznesit zhvilluar në shtator 2024, shërbeu për përditësimin e regjistrave dhe njësive statistikore, si dhe vlerësimin e cilësisë së tyre. Gjatë vitit 2024 është punuar për të kodifikuar regjistrat e biznesit edhe në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike Rev.2.1. Ky kodifikim i dyfishtë në NVE Rev 2 dhe NVE Rev 2.1 do të realizohet për tre vite. Lidhur me aktivitetin "Regjistri i ndërmarrjeve", në vitin 2025, INSTAT-i do të përditësojë Regjistrin e Ndërmarrjeve në kohë reale për qëllime të metodologjisë së vrojtimeve statistikore. Burimet kryesore janë institucionet, si: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Banka e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe të dhënat e vrojtimeve të INSTAT-it. Nga regjistri i ndërmarrjeve janë prodhuar dhe transmetuar në Eurostat dy tabela lidhur me ndërmarrjet e reja dhe falimentimet. INSTAT-i me mbështetjen e ekspertizës së Eurostat gjatë vitit 2025 do të shtojë treguesit lidhur me ngjarjet demografike të ndërmarrjeve.

Sa i përket aktivitetit "Regjistri i Njësive Lokale", ky regjistër është ndërtuar në vitin 2010 dhe përditësohet çdo vit. Anketa e regjistrave të biznesit e zhvilluar në vitin 2024 do të shërbejë për përditësimin e tij dhe përmirësimin e cilësisë.

Regjistri i grupeve të ndërmarrjeve shumëkombëshe është ndërtuar në vitit 2018. Për shkak të globalizimit, krahasueshmëria ndërkombëtare e të dhënave statistikore është bërë shumë e rëndësishme dhe anketa e regjistrave të biznesit shërben për përditësimin e tij. Gjatë vitit 2025 do të analizohen burimet administrative për përditësimin e tij.

Ndërtimi i infrastrukturës IT për dokumentimin, ruajtjen, mirëmbajtjen dhe përditësimin e regjistrave të biznesit në kohë reale do të përmirësojë cilësinë e statistikave ekonomike gjatë vitit 2025.

**Treguesit kryesorë:** Tregues mbi aktivitetet ekonomike, punësimin, të ardhurat e shpenzimet, investimet, dhe të dhëna specifike për ndërtimin, tregtinë dhe bar-kafetë e restorantet etj.; tregues statistikorë kryesorë ekonomikë në nivel rajonal; tregues në volum dhe vlerë mbi produktet industriale; tregues statistikorë mbi aktivitetin ekonomik, shitjet, prodhimin, numrin e personave të punësuar, fondin e pagave, treguesit specifikë të ndërtimit, si dhe statistikat e grupeve kryesore industriale; tregues mbi numrin, sipërfaqen dhe

vlerën e lejeve të ndërtimit të miratuara në territorin e Republikës së Shqipërisë; tregues lidhur me regjistrat e biznesit, si: numrin e ndërmarrjeve dhe njësive lokale, pronësinë, formën ligjore, tregues të ngjarjeve demografike, aktivitetin ekonomik, xhiro vjetore, të punësuar gjithsej dhe të punësuar me pagesë, si dhe tregues të tjerë për përditësimin dhe matjen e cilësisë së regjistrave statistikorë të njësive ekonomike.

**Përputhshmëria me *acquis***: *Statistikat e biznesit* janë pjesërisht në përputhje me rregulloren (EC) nr. 2019/2152, "Për statistikat evropiane të biznesit" dhe rregulloret tjera zbatuese të saj, ndërkohë që zbatojnë të njëjtat përkufizime dhe klasifikime. Projekte statistikore të ndryshme të programit IPA shumëpërfitues kanë ndihmuar dhe vazhdojnë të ndihmojnë në zhvillimin e statistikave të biznesit.

*Tabela nr. 12: Lista e vrojtimeve për fushën "Statistikat ekonomike"*

| Vrojtimi | Burimi i financimit |
|---|---|
| Vrojtimi strukturor i ndërmarrjeve | Buxhet shteti |
| Vrojtimi i produkteve industriale | Buxhet shteti |
| Vrojtimi tremujor pranë ndërmarrjeve | Buxhet shteti |
| Vrojtimi i çmimeve të prodhimit | Buxhet shteti |
| Vrojtimi i çmimeve të importit | Buxhet shteti |
| Vrojtimi për indeksin e kostos në ndërtim (në banesa) | Buxhet shteti |
| Vrojtimi i regjistrave të biznesit | Buxhet shteti |

*Tabela nr. 13: Niveli i përputhshmërisë me acquis për fushën "Statistikat ekonomike"*

| Aktiviteti | Niveli i përputhshmërisë |
|---|---|
| Sistemi Evropian i Llogarive | I mesëm |
| Llogaritë jo-financiare sipas sektorëve institucional | I ulët |
| Llogaritë kombëtare vjetore dhe tremujore – Agregatët Kryesorë | I mesëm |
| Tabelat Burim – Përdorime | I lartë |
| Llogaritë Rajonale | I mesëm |
| Llogaritë Financiare sipas Sektorëve Institucionalë | I mesëm |
| Statistikat Financiare të Qeverisë sipas GFSM2014 | I mesëm |
| Statistikat Financiare të Qeverisë sipas ESA 2010 | I mesëm |
| Statistikat e Procedurës së Deficitit të Tejkaluar | I mesëm |
| Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve | I mesëm |
| Statistikat e Produkteve Industriale (PRODCOM) | I plotë |
| Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve | I ulët |
| Statistikat e Regjistrave të Biznesit | I mesëm |

**Fusha 3 "Statistikat sektoriale"**

Statistikat sektoriale përfshijnë një sërë nënfushash heterogjene, si: statistikat e bujqësisë, peshkimit dhe pyjeve, statistikat e energjisë, transportit, turizmit, statistikat mbi tregtinë e jashtme dhe bilancin e pagesave, statistikat e çmimeve, shkencës dhe teknologjisë, inovacionit.

Qëllimi kryesor i statistikave sektoriale është që të sigurojnë të dhëna në kohë dhe me cilësi të treguesve statistikorë të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave të përbashkëta mbi fushat e sipërpërmendura, si dhe në monitorimin dhe menaxhimin e tyre.

Objektivi kryesor për vitin 2025, për statistikat sektoriale, realizimi i të gjithë objektivave sipas Programit të Statistikave Zyrtare 2022–2026, me fokus rritjen e cilësisë dhe plotshmërisë së serive kohore për treguesit me frekuencë mujore, tremujore dhe vjetore, duke synuar rritjen e nivelit të përafrimit me *acquis* përkatëse.

**Agjencitë statistikore përgjegjëse**: INSTAT-i, Banka e Shqipërisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

Në tabelën e mëposhtme (tabela nr. 14) paraqitet numri i aktiviteteve të kësaj fushe, për kategoritë: periodiciteti/burimi i të dhënave/niveli minimal i publikimit/institucioni.

*Tabela nr. 14: Përmbledhje e numrit të aktiviteteve për fushën "Statistikat sektoriale".*

| 3. Statistikat Sektoriale | Nr. i aktiviteteve Statistikore (AS) | Nr. AS / Periodiciteti * | Nr. AS / Burimi i të dhënave** | Nr. AS / Niveli minimal i publikimit | Nr. AS / Institucioni përgjegjës |
|---|---|---|---|---|---|
| Statistikat e Bujqësisë, Peshkimit dhe Pyjeve | 20 | 5-M<br>1-T<br>13-V<br>1-10V | 9 VS<br>10 BA<br>1- Cens | 13 Vendi<br>3 Bashki<br>4 NA | 20 INSTAT |
| Energjia | 3 | 2-T<br>1-V | 3 BA | 3 Vendi | 1 INSTAT<br>2 AKBN |
| Transporti | 3 | 1-M<br>1-T<br>1-V | 3 BA | 3 Qarku | 3 INSTAT |
| Turizmi | 3 | 2-M<br>1-T | 2 VS<br>1 BA | 1 Vendi<br>1 Rajoni<br>1 Qarku | 3 INSTAT |
| Tregtia e Jashtme | 4 | 1-M<br>1-T<br>2-V | 2 BA<br>2 VS+BA | 4 Vendi | 2 INSTAT<br>2 BSH |
| Bilanci i Pagesave | 5 | 2-M<br>3-T | 2 BA<br>3 VS+BA | 5 Vendi | 5 BSH |
| Çmimet | 5 | 3-M<br>1-T<br>1-V | 4 VS<br>1 BA | 5 Vendi | 5 INSTAT |
| Shkenca, Teknologjia dhe Inovacioni | 4 | 3-V<br>1-2V | 2 VS<br>1 BA<br>1 VS+BA | 4 Vendi | 4 INSTAT |
| **Gjithsej** | **47** | **14-M**<br>**10-T**<br>**21-V**<br>**1-10V**<br>**1-2V** | **17 VS**<br>**23 BA**<br>**6 VS+BA**<br>**1 Cens** | **35 Vendi**<br>**1 Rajoni**<br>**4 Qarku**<br>**3 Bashki**<br>**4 NA** | **38 INSTAT**<br>**7 BSH**<br>**2AKBN** |

*M-mujor; T-Tremujor; V-Vjetor;
** VS-vrojtim statistikor; BA-burim administrativ; NA-nuk aplikohet.

**Fusha "Statistikat sektoriale" përbëhet nga 8 tema statistikore:**

**Tema 3.1 "Statistikat e bujqësisë, peshkimit dhe pyjeve"**

Kjo temë përfshin nëntemat, si:

*3.1.1 "Statistikat e pyjeve"*, për prodhimin e statistikave të kësaj kategorie me frekuencë vjetore, INSTAT-i mbledh dhe përpunon të dhëna administrative nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve, si dhe realizon vrojtimin vjetor mbi përdorimin e lëndës drusore në industri.

*3.1.2 "Statistikat e bujqësisë"* nëndarja sipas specifikave që kjo temë mbulon është si vijon:

*"Statistikat e produkteve bimore".* INSTAT-i është përgjegjës të prodhojë statistikat e kësaj kategorie nëpërmjet mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave administrative të siguruara nga burimi administrativ. Gjithashtu, INSTAT-i bashkëpunon me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për sigurimin e të dhënave nga "Vrojtimi vjetor në bujqësi", të cilat parashikohen të mblidhen nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me mbështetjen metodologjikë të INSTAT-it. Gjatë vitit 2025 do të vazhdojë realizimi i aktivitetit "Statistikat e produkteve bimore" të gjeneruara nga "Vrojtimi mbi sipërfaqen e mbjellë", i cili, gjithashtu, realizohet nga bashkëpunim i INSTAT-it me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

"Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve". Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve do të sigurohen nga burimi administrativ dhe "Vrojtimi vjetor në bujqësi". Sipas metodologjisë së parashikuar, mbledhja e të dhënave do të kryhet nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ndërkohë që INSTAT-i do të kryejë përpunimin e tyre si institucion që gëzon statusin e prodhuesit të statistikave zyrtare. Përveç këtyre dy aktiviteteve, me qëllim nxjerrjen e statistikave të kësaj kategorie me frekuencë mujore, INSTAT-i do të kryejë aktivitetin "Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve", të siguruara nga vrojtimet mujore mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve (për gjedhë, derra dhe të imta dhe shpendë) dhe aktivitetit të pularive për prodhimin e vezëve (konsum njerëzor).

*"Statistikat e qumështit dhe nënprodukteve të tij".* Për prodhimin e statistikave të kësaj kategorie, ashtu si dhe për kategoritë e tjera të sipërpërmendura, do të ketë një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet INSTAT-it dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. INSTAT-i do të kryejë aktivitetin statistikor, me frekuencë vjetore, "Statistikat e qumështit dhe nënprodukteve të tij", të prodhuara nga vrojtimi vjetor në të gjitha fabrikat dhe baxhot

që grumbullojnë dhe përpunojnë qumësht dhe aktivitetin me frekuencë mujore "Statistikat e qumështit dhe nënprodukteve të tij" të siguruara nga vrojtimi mujor në fabrikat që grumbullojnë dhe përpunojnë qumështin e lopës. Ndërkohë, do të vazhdojë mbledhja dhe përpunimi i statistikave vjetore të qumështit dhe nënprodukteve të tij, të siguruara nga burimi administrativ.

*"Statistikat strukturore të fermës"* përfshijnë përpunimin në tërësi të të dhënave të siguruara nga Censi i Bujqësisë dhe Fermave Bujqësore. Nëpërmjet kryerjes së këtij aktiviteti madhor, si dhe vrojtimeve të tjera ndërmjet dy censeve, sigurohet informacion thelbësor në aspektet e përgjithshme statistikore, të tilla si: toka, blegtoria, forca e punës bujqësore dhe aktivitete të tjera fitimprurëse, masat e zhvillimit rural, makineritë dhe pajisjet, ujitja, strehimi i kafshëve dhe administrimi i plehut, administrimi i tokës, vreshtat dhe pemëtaria.

*"Llogaritë ekonomike në bujqësi"*, aktiviteti përfshin përpunimin në tërësi të të dhënave të siguruara nga burimi administrativ dhe nga tre vrojtimet që INSTAT-i kryen në përmbushje të këtij aktiviteti, vrojtimet mujore të çmimeve të prodhimeve bujqësore, vrojtimi tremujor i çmimeve të inputeve në bujqësi dhe vrojtimi tremujor i kafshëve për mbarështim.

*3.1.3 "Statistikat e peshkimit"*, për realizimin objektivave të së cilës, INSTAT-i do të kryejë aktivitetet: "Statistikat e peshkimit" të siguruara nga burimi administrativ, për prodhimin e statistikave mbi prodhimin e peshkut me frekuencë tremujore dhe *"Statistikat e peshkimit dhe akuakulturës"* të siguruara nga burimi administrativ për prodhimin e statistikave me frekuencë vjetore.

*3.1.4 "Statistikat e prodhimeve organike në bujqësi"* të siguruara nga burimi administrativ do të mblidhen gjatë vitit 2025, sipas legjislacionit shqiptar dhe do të publikohen bazuar në kërkesat ndërkombëtare.

*3.1.5 "Statistikat e agromjedisit"* të siguruara nga burimi administrativ. Për realizimin e këtij aktiviteti INSTAT-i do të kryejë përpunimin e të dhënave të marra nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për prodhimin e indikatorëve përkatës.

**Treguesit kryesorë:** Tregues mbi pyjet, kullotat; të dhënat kadastrale të fondit për pyjet, kullotat dhe kundërvajtjet në pyje, strukturën dhe bilancet në pyje e kullota, si dhe bilanci burim-përdorim i produkteve pyjore; tregues mbi sipërfaqen, prodhimin, rendimentin dhe përmbajtjen e lagështisë për drithërat dhe bishtajoret, në nivel kombëtar dhe rajonal; bimët e tjera të mbjella në tokë arë, në nivel rajonal; pemët frutore, vreshtat, agrumet dhe ullirin, në nivel rajonal; tregues statistikorë, mbi: a) numrin e krerëve, prodhimin e mishit sipas kategorive të blegtorisë dhe produktet e tjera blegtorale; b) strukturën e blegtorisë dhe shpendëve, peshën e gjallë dhe peshë e therur sipas kategorive statistikore përkatëse të therura në fermë/thertore; tregues mbi numrin e shpendëve të therur gjatë vitit në thertore sipas llojeve, peshën e gjallë dhe peshën e therur; tregues mbi prodhimin e shpendëve dhe vezëve për treg; tregues mbi qumështin dhe produktet e tij sipas përmbajtjes së yndyrës dhe proteinave, mbi strukturën e fabrikave dhe baxhove që grumbullojnë dhe përpunojnë qumësht; tregues mbi sasinë e qumështit të lopës të grumbulluar, si dhe sasinë e nënprodukteve kryesore të prodhuara; tregues mbi sasinë e qumështit të prodhuar në fermë sipas llojeve: lopë, dele, dhi, me periodicitet vjetor në nivel prefekture dhe bashkie; tregues mbi llogaritë ekonomike në bujqësi; indeksi i çmimeve të produkteve bujqësore; indeksi i çmimeve të inputeve në bujqësi; tregues mbi prodhimin e peshkut, molusqeve, strukturën e ndërmarrjeve prodhuese, si dhe numrin e të punësuarve; peshkimin detar sipas porteve; numrin e anijeve dhe zënien e peshkut sipas porteve; tregues për peshkimin në ujërat e brendshme dhe për numrin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në akuakulturë dhe molusqe; tregues mbi sasitë e zënies së peshkut sipas kategorive ujore; tregues mbi operatorë organikë të regjistruar dhe certifikuar, si: prodhues, përpunues, importues dhe të tjerë, gjatë vitit referues, si dhe të rinj gjatë vitit, të cilët nuk kanë plotësuar kriteret e certifikimit me periodicitet vjetor; sipërfaqet organike të certifikuara dhe në proces konvertimi dhe prodhimet organike bimore me periodicitet vjetor; blegtorinë e certifikuar, prodhimin e produkteve organike me origjinë blegtorale me periodicitet vjetor; përpunimin e produkteve organike sipas aktivitetit ekonomik; tregues mbi: sasinë e plehrave kimike të përdorura sipas grup-kulturave me periodicitet vjetor; sipërfaqet e plehëruara me plehra kimike me periodicitet vjetor; sasinë e pesticideve të përdorura sipas grup kulturave me periodicitet vjetor; sipërfaqet e trajtuara me pesticide sipas llojit të pesticideve dhe grup kulturave me periodicitet vjetor; tregues mbi: mbulimin dhe përdorimin e

tokës me periodicitet vjetor; tokën e punueshme, livadhet dhe kullotat, tokën e zënë me pemëtore (pemë frutore, ullinj, agrume dhe vreshta) dhe tokë tjetër jobujqësore me periodicitet vjetor.

**Përputhshmëria me *acquis*:** *Statistikat në fushën e prodhimit bimor* realizohen duke zbatuar metodologjitë sipas standardeve evropiane, konkretisht bazuar në rregulloren (KE) nr. 543/2009, "Për statistikat vjetore të bimëve", ku mbulohen anekset 1.2.3.4 dhe vlerësohen si të pjesshme në rregulloren e KE 834/2007, "Statistikat për prodhimet organike" që mbulohet po ashtu në mënyrë të pjesshme.

*Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve* përputhen pjesërisht me rregulloren (KE) nr. 1165/2008, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit "Për statistikat e blegtorisë dhe të mishit", ku mbulohen anekset I–IV, si dhe synohet mbulimi i aneksit V. Përkufizimet e përdorura janë kryesisht në përputhje me rregulloret e KE-së.

*Statistikat e qumështit dhe nënprodukteve të qumështit* bazohen dhe janë pjesërisht të përafruara me rregulloren nr. 1165/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, "Për statistikat e blegtorisë dhe të mishit", si dhe direktiva 96/16/KE në vrojtimet statistikore për qumështin dhe produktet e tij.

*Statistikat e strukturës së njësive ekonomike bujqësore.* INSTAT-i do të punojë për përafrimin e këtyre statistikave me rregulloren e re: rregullorja (BE) 2018/1091 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit "Për statistikat e integruara të fermave" përkufizimet që do të përdoren do të jenë në përputhje me rregulloret e KE-së.

*Llogaritë ekonomike në bujqësi dhe çmimet* bazohen në rregulloren e (KE) nr. 138/2004, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit "Për llogaritë ekonomike në bujqësi". Në zbatim të kërkesave të kësaj rregulloreje, llogaritë ekonomike në bujqësi dhe çmimet klasifikohen si pjesërisht të përafruara. Përkufizimet e përdorura janë kryesisht në përputhje me rregulloren e KE-së. *Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore* publikohet në përputhje me rregulloren e KE-së me periodicitet vjetor dhe tremujor.

*Statistikat e peshkimit* bazohen në rekomandimet e FAO-s dhe rregulloret: rregullorja (EC) nr. 216/2009, mbi "Statistikat e zënieve të peshkut, për peshkimin në zona të caktuar përveç Atlantikut të Veriut" dhe rregullorja (KE) nr. 762/2008 mbi "Statistikat e akuakulturës". Përkufizimet e përdorura janë kryesisht në përputhje me rregulloret e KE-së.

*Certifikimi i fermave organike* nga trupat e certifikimit bazohet në ligjin nr. 106/2016, "Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre" përafrimi me rregulloren (KE) nr. 834/2007, 28 qershorit 2007, mbi "Produktet organike dhe etiketimin e produkteve organike".

*Statistikat e agromjedisit* vlerësohen si pjesërisht të përafruara me rregulloren (KE) nr. 1185/2009, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit "Për statistikat mbi pesticidet".

**Tema 3.2 "Energjia"**

Kjo temë përmban nëntemën 3.2.1 "*Statistikat e energjisë–prodhimi*"

Prodhimi i statistikave të energjisë në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore do të mbështetet nga INSTAT-i, në cilësinë e koordinatorit të Sistemit Kombëtar Statistikor. AKBN-ja do të prodhojë dhe publikojë statistikat në volum të bilancit të përgjithshëm të energjisë me frekuencë vjetore, si dhe qymyrit, naftës dhe gazit, me frekuencë tremujore, aktivitete për të cilat kontribuojnë me të dhëna administrative Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, Enti Rregullator i Energjisë, "Albpetrol" sh.a., Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, bashkitë e Shqipërisë etj.

INSTAT-i do të vazhdojë të publikojë me periodicitet tremujor statistikat e bilancit të energjisë elektrike.

Përmirësimet në kuadër të parafrimit me rregulloret gjatë vitit 2025 do të fokusohen në rritjen e numrit të indikatorëve të transmetuar në Eurostat, si dhe në cilësinë e të dhënave të transmetuara.

**Treguesit kryesorë:** Tregues statistikorë mbi prodhimin neto vendas të energjisë elektrike, qymyrit, naftës dhe gazit, si dhe importin dhe eksportin bruto të energjisë elektrike, qymyrit dhe produkteve të naftës, humbjet në rrjet të energjisë elektrike, si edhe konsumin e tyre final në vendin tonë; tregues statistikorë mbi bilancin energjetik, i cili paraqet situatën aktuale në sektorin e energjisë në vend për origjinën dhe përdorimin specifik sipas burimeve të energjisë, duke siguruar të dhëna mbi konsumin e energjisë për banorë, intensitetin e

energjisë, kontributin e burimeve të rinovueshme në konsumin final etj.

**Përputhshmëria me *acquis*:** *Statistikat e energjisë* janë pjesërisht të përafruara me rregulloren (KE) nr. 1099/2008, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për statistikat e energjisë". Një numër i madh indikatorësh mbi statistikat e energjisë transmetohen aktualisht në Eurostat përmes pyetësorëve të energjisë. Përmirësimi dhe rritja e cilësisë, dhe numrit të indikatorëve të transmetuar në Eurostat, përmirësimi i mbledhjes së të dhënave të produkteve të naftës, si dhe përpilimi i konsumit final sipas sektorëve është një nga prioritetet kryesore në të ardhmen.

**Tema 3.3 "Transporti"**

Tema e statistikave të transportit përfshin dy nëntema: 3.3.1 "*Statistikat e transportit*" dhe 3.3.2 "*Statistikat mbi sigurinë në transport*". Statistikat e nëntemës së parë kanë përkatësisht frekuencë tremujore dhe vjetore, të cilat prodhohen nga INSTAT-i, duke kryer publikimet "Statistika mbi transportin ajror, detar, hekurudhor dhe rrugor" dhe "Statistika mbi karakteristikat e mjeteve të transportit rrugor". Për realizimin dhe publikimin e këtyre statistikave, INSTAT-i përpunon të dhënat administrative të marra nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Për sa i takon nëntemës 3.3.2 "Statistikat mbi sigurinë në transport", INSTAT-i kryen aktivitetin statistikor me frekuencë mujore "Statistika mbi aksidentet rrugore" dhe tregues vjetor për aksidentet hekurudhore. Për realizimin e këtyre statistikave INSTAT-i përpunon të dhënat administrative të siguruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Gjatë vitit 2025, do të rritet numri i treguesve të prodhuar mbi llojet e transportit dhe mbi sigurinë në transport bazuar në rregulloret evropiane, si dhe transmetimi i treguesve të prodhuar për statistikat e transportit në Eurostat dhe institucionet e tjera ndërkombëtare. Gjithashtu, në kuadër të programit IPA 2022 shumëpërfitues, për statistikat e transportit dhe në vijimësi të vrojtimit pilot të realizuar për "Transportin rrugor të mallrave", gjatë vitit 2025, do të realizohet vrojtimi i plotë i statistikave të transportit rrugor të mallrave.

**Treguesit kryesorë:** Tregues mbi transportin ajror, detar, ujor të brendshëm dhe hekurudhor, rrugor të mallrave dhe pasagjerëve, në nivel kombëtar dhe sipas rajoneve; tregues mbi karakteristikat e mjeteve të transportit rrugor; tregues mbi numrin e aksidenteve rrugore, numrin e të aksidentuarve (të vdekur dhe të plagosur) dhe numrin e aksidenteve hekurudhore, në nivel kombëtar dhe sipas rajoneve.

**Përputhshmëria me *acquis:*** *Statistikat mbi transportin* janë pjesërisht në përputhje me rregulloret e Parlamentit dhe Këshillit Evropian nr. 2018/643, "Mbi statistikat e transportit hekurudhor", nr. 2018/974, "Mbi statistikat e transportit të mallrave përmes rrugëve ujore brenda vendit", nr. 70/2012, "Mbi kthimet statistikore në lidhje me transportin e mallrave me rrugë", nr. 93/704, "Mbi krijimin e një baze të të dhënave të Komunitetit për aksidentet rrugore", nr. 437/2003, "Mbi kthimet statistikore në lidhje me transportin ajror të udhëtarëve, mallrave dhe postës", si dhe direktivën e Parlamentit dhe Këshillit Evropian nr. 2009/42, "Mbi kthimet statistikore në lidhje me transportin e mallrave dhe udhëtarëve nga deti".

**Tema 3.4 "Turizmi"**

Statistikat e kësaj kategorie përfshijnë tri nëntema:

*3.4.1 "Statistikat mbi strukturat akomoduese"*, për prodhimin e të cilave, INSTAT-i kryen vrojtimin statistikor mujor "Vrojtimi i strukturave akomoduese" pranë hoteleve dhe strukturave të ngjashme. Informacioni do të vazhdojë të mblidhet çdo muaj nëpërmjet metodës CAPI për të gjitha strukturat akomoduese që ushtrojnë aktivitetin e tyre në vend. Treguesit mujor të statistikave të akomodimit që përbëjnë ofertën turistike në vend, gjatë vitit 2025, do të publikohen në përputhje me rregulloren, 6 javë pas periudhës së referencës. Do të vazhdojë mbledhja e informacionit, lidhur me numrin e strukturave akomoduese që kanë një ose më shumë dhoma gjumi të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara (përfshirë personat që përdorin karriget me rrota).

*3.4.2 "Statistikat e turizmit në njësitë ekonomike familjare (NjEF)",* statistikat vjetore të së cilës, prodhohen nëpërmjet aktivitetit të INSTAT-it si vrojtimi i turizmit pranë NjEF-ve, "Pushime dhe udhëtime", në përputhje me rekomandimet e parashikuara në rregulloren (BE) nr. 692/2011, "Për statistikat e turizmit". Publikimi i rezultateve të vitit 2024 për vrojtimin e turizmit në NjEF-të do të vijojë sipas parashikimit, në vitin 2025. Për të siguruar mbarëvajtjen e aktivitetit dhe vlerësimin e të

dhënave të transmetuara në Eurostat, INSTAT-i do të zbatojë të gjitha rekomandimet dhe udhëzimet e Eurostatit.

*3.4.3 "Statistikat e lëvizjes së shtetasve"*, ku përfshihet aktiviteti me frekuencë mujore për prodhimin e statistikave mbi lëvizjen (hyrje/daljet) e shtetasve të huaj dhe shqiptarë, i cili kryhet nga INSTAT-i nëpërmjet përpunimit të të dhënave të siguruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

**Treguesit kryesorë:** Tregues mbi lëvizjet (hyrje/daljet) e shtetasve të huaj dhe shqiptarë, sipas mënyrës së transportit, sipas shteteve, sipas mënyrës së qëllimit të vizitës; tregues statistikorë mbi turizmin në Shqipëri; tregues mbi kapacitetin e njësive akomoduese, numrin e turistëve, netë-qëndrimet, numrin e turistëve sipas shteteve, kapacitetin shfrytëzues; tregues mbi përshkrimin e nivelit dhe strukturës së turizmit në familje, ana e kërkesës (*demand side*) për periudha tremujore dhe vjetore, në përputhje me kërkesat e rregullores së KE-së nr. 692/2011 (aneksi II) dhe kërkesave të përdoruesve të brendshëm.

**Përputhshmëria me *acquis*:** *Statistikat e turizmit* nga ana e ofertës (*supply side*) dhe kërkesës *(demand side)* janë pjesërisht të përafruara me rregulloren (KE) nr. 692/2011, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për statistikat e turizmit". Në mënyrë periodike transmetohen në Eurostat të dhënat mujore dhe vjetore lidhur me këto statistika.

**Aktivitete në funksion të nevojave kombëtare për tregues të turizmit**

Referuar komunikimit shkresor të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, datë 12.11.2024, ku kërkohet marrja e angazhimeve nga INSTAT-i për vitin 2025 e në vijim, në lidhje me adoptimin e paketës së vrojtimeve në kuadër të jetësimit të projektit të Bankës Botërore për "Sistemin e menaxhimit të informacionit të turizmit dhe përmirësimit të statistikave", INSTAT-i do të angazhohet në realizimin e këtyre aktiviteteve.

Duke qenë se, në respektim të afateve ligjore për projektbuxhetin e shtetit, INSTAT-i ka paraqitur tashmë kërkesat buxhetore për vitin 2025 në kuadër të PBA 2025–2027 dhe në zbatim të ligjit nr. 30/2022, "Për programin e statistikave zyrtare 2022–2026", vrojtimet e kërkuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk kanë mbulim financiar për vitin 2025. Megjithatë, në kushtet e nevojave kombëtare për tregues mbi aktivitetin e turizmit, gjatë vitit 2025, INSTAT-i do të kërkojë mbështetje financiare dhe njerëzore, jo vetëm nga buxheti i shtetit, por edhe institucione dhe organizata të tjera donatore.

**Tema 3.5 "Tregtia e jashtme"**

Kjo temë është e ndarë në 2 nëntema:

*3.5.1 Statistikat e investimeve të huaja direkte dhe tregtisë ndërkombëtare të shërbimeve*

Statistikat e investimeve të huaja janë pjesë integrale e statistikave të bilancit të pagesave dhe pozicionit të investimeve ndërkombëtare dhe si statistika specifike me ndarje sipas aktivitetit ekonomik NVE dhe ndarje gjeografike (shteteve), statistika të cilat prodhohen nga Banka e Shqipërisë me frekuencë tremujore. Të dhënat për llogaritjen e statistikave të investimeve të huaja, sigurohen nga raportimet mujore të sistemit bankar, nga bilancet mujore dhe tremujore të institucioneve financiare (banka dhe jobanka), nga raportimet direkte të kompanive të mëdha me kapital të huaj dhe të përbashkëta shqiptare – të huaja; nga institucione të tjera administrative, si Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Qendra Kombëtare e Biznesit, dhe informacione nga shkëmbime të ndërsjella dypalëshe me Kosovën. Në përgatitjen e statistikave të investimeve të huaja, Banka e Shqipërisë zbaton kërkesat dhe standardet e manualeve metodologjike të FMN-së (BPM6-2009) dhe OECD-së (BD4).

Statistikat e tregtisë ndërkombëtare të shërbimeve mbulohen, gjithashtu, nga Banka e Shqipërisë. Statistikat e tregtisë ndërkombëtare të shërbimeve janë pjesë integrale e statistikave të bilancit të pagesave në frekuencë tremujore, si dhe si statistika specifike me ndarje gjeografike me frekuencë vjetore. Statistikat e shërbimeve prodhohen nga përpunimi i të dhënave të siguruara nga Banka e Shqipërisë, INSTAT-i, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Qendra Kombëtare e Biznesit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, si dhe të dhëna të tjera nga vrojtime statistikore pranë kompanive private dhe individëve. Në përgatitjen e statistikave ndërkombëtare të shërbimeve aplikohen rekomandimet e manualit për bilancin e pagesave (BPM6-FMN), si dhe rekomandimet e përshkruara në manualin e tregtisë ndërkombëtare të shërbimeve (2010).

*3.5.2 "Statistikat e tregtisë së jashtme të mallrave"*. Në këtë nëntemë përfshihen statistikat mbi eksportet/importet e mallrave, të cilat do të

prodhohen nga INSTAT-i me frekuencë mujore, nëpërmjet përpunimit të të dhënave të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe statistikat mbi eksportet/importet e mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve, të cilat do të prodhohen nga INSTAT-i me frekuencë vjetore nëpërmjet përpunimit të të dhënave të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe skedarit të ndërmarrjeve që disponon INSTAT-i.

**Treguesit kryesorë:** Tregues statistikorë mbi investimet e huaja fluks dhe stok sipas shteteve; tregues statistikorë mbi investimet e huaja fluks dhe stok sipas aktivitetit ekonomik. Tregues statistikorë mbi tregtinë ndërkombëtare të shërbimeve me ndarje gjeografike (sipas shteteve). tregues statistikorë mbi eksportet/importet e mallrave; tregues statistikorë mbi eksportet/ importet e mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve.

**Përputhshmëria me *acquis*:** Mbështetur në programin e monitorimit të përputhshmërisë, Eurostati vlerëson pjesërisht në përputhje me nivelin e implementimit të metodologjisë *së investimeve të huaja direkte* dhe *tregtisë ndërkombëtare të shërbimeve*, si dhe kritereve të transmetimit të këtyre të dhënave.

*Statistikat e tregtisë së jashtme* janë përafruar pjesërisht me rregulloren (KE) nr. 2019/2152, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për statistikat e evropiane të biznesit". Të dhënat e hollësishme të tregtisë së jashtme transmetohen rregullisht në Eurostat çdo muaj. Statistikat e tregtisë sipas monedhës së faturës (tabelat TIC) dërgohen rregullisht në Eurostat një herë në dy vjet. Statistikat e tregtisë së jashtme kanë implementuar plotësisht sistemin statistikor në formatin e ri të transmetimit, të detajuar në vitin mars 2023.

**Tema 3.6 "Bilanci i pagesave"**[1]

Kjo temë përbëhet nga dy nëntema:

*3.6.1 Statistikat mujore dhe tremujore të bilancit të pagesave* – Banka e Shqipërisë është institucioni përgjegjës që prodhon dhe publikon statistikat e bilancit të pagesave. Në përgatitjen e këtyre statistikave, Banka e Shqipërisë mbledh informacion nëpërmjet raportimit direkt nga institucionet financiare; raportimit direkt nga burime administrative, si: Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, INSTAT-i, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Ministria e Brendshme, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Qendra Kombëtare e Biznesit, si edhe nëpërmjet vrojtimeve të realizuara në kompani private dhe individë. Të dhënat e grumbulluara nga burimet e mësipërme raportohen pjesërisht me frekuencë mujore dhe në pjesën më të madhe me frekuencë tremujore, duke mundësuar përgatitjen dhe publikimin e statistikave të bilancit të pagesave me frekuencë tremujore, dhe duke filluar nga viti 2020 me frekuencë mujore. Statistikat e bilancit të pagesave prodhohen në bazë të manualeve metodologjike të FMN-së (BPM6-2009, EDS 2013), OECD-së (BD4), manualit të statistikave të tregtisë ndërkombëtare të shërbimeve dhe kodit evropian të statistikave.

*3.6.2 Statistikat tremujore të pozicionit të investimeve ndërkombëtare* – Banka e Shqipërisë është institucioni përgjegjës për prodhimin dhe publikimin e statistikave të pozicionit të investimeve ndërkombëtare. Në përgatitjen e këtyre statistikave merren të dhënat nga Banka e Shqipërisë, INSTAT-i, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Qendra Kombëtare e Biznesit, si dhe të dhëna nga vrojtimet statistikore pranë kompanive private të huaja dhe të përbashkëta shqiptare – të huaja. Gjithashtu, për përgatitjen e këtyre statistikave përdoren të dhëna nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe informacione nga shkëmbime të ndërsjella dypalëshe me Kosovën. Të dhënat e grumbulluara nga burimet e mësipërme raportohen pjesërisht me frekuencë mujore dhe në pjesën më të madhe me frekuencë tremujore, duke mundësuar përgatitjen dhe publikimin e statistikave të pozicionit të investimeve ndërkombëtare me frekuencë tremujore.

Statistikat e pozicionit të investimeve ndërkombëtare prodhohen në bazë të manualeve metodologjike të FMN-së (BPM6-2009, EDS 2013), OECD-së (BD4) dhe Kodit Evropian të Statistikave. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë realizon aktivitetin mbi statistikat mujore të rezervës ndërkombëtare dhe aktivitetin mbi statistikat tremujore të borxhit të jashtëm.

**Treguesit kryesorë:** Tregues statistikorë mbi bilancin tremujor të pagesave; tregues statistikorë mbi bilancin mujor të pagesave. Tregues statistikorë mbi pasqyrën e pozicionit të investimeve

[1] Bilanci i pagesave është tregues financiar.

ndërkombëtare me frekuencë tremujore; tregues me frekuencë mujore mbi rezervën ndërkombëtare dhe tregues me frekuencë tremujore mbi borxhin e jashtëm.

**Përputhshmëria me *acquis*:** Mbështetur në programin e monitorimit të përputhshmërisë, Eurostati e vlerëson pjesërisht të përputhshëm me rregulloren (KE) 184/2005, "Bilanci i pagesave, tregtia ndërkombëtare e shërbimeve dhe investimet e huaja direkte", nivelin e implementimit të metodologjisë së bilancit të pagesave dhe pozicionit të investimeve ndërkombëtare BPM6, si dhe kriteret e transmetimit të të dhënave.

**Tema 3.7 "Çmimet"**

Statistikat e çmimeve janë ndarë në disa nëntema, si më poshtë:

*3.7.1 "Statistikat e çmimeve të konsumit"* e matur nëpërmjet tre treguesve kryesorë: "Indeksi i çmimeve të konsumit (IÇK)", "Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit (IHÇK)" dhe "Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit me çmime konstante". Këto indekse prodhohen çdo muaj nga INSTAT-i nëpërmjet kryerjes së vrojtimit mujor të çmimeve të një shporte fikse mallrash dhe shërbimesh pranë njësive të tregtisë me pakicë, si dhe duke shfrytëzuar të dhëna të tjera të marra nga Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, bashkitë, Enti Rregullator i Ujit/Ujësjellës-Kanalizimeve Tiranë, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe universitetet.

*3.7.2 "Indeksi i nivelit të çmimeve dhe prodhimi i brendshëm bruto për frymë në standardin e fuqisë blerëse"* është nëntemë e veçantë dhe parashikon kryerjen e aktivitetit statistikor "Matja e fuqisë blerëse (MFB)". Statistikat e kësaj kategorie do të prodhohen nga Eurostati me frekuencë vjetore, duke përdorur të dhënat e vrojtimeve të ndryshme të çmimeve të konsumit, ndërtimit, makinerive dhe pajisjeve, qirave, spitaleve dhe të dhëna të tjera shtesë të realizuara nga INSTAT-i për llogaritjen e këtyre treguesve.

*3.7.3 "Indeksi i çmimeve të banesave"* është aktivitet statistikor në formë studimi, ku INSTAT-i parashikon që, në vitin 2026, të prodhojë statistika me frekuencë tremujore, duke shfrytëzuar të dhënat administrative të marra nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës ose nga vrojtimet statistikore.

**Treguesit kryesorë:** Indeksi mujor i çmimeve të konsumit, ndryshimi vjetor, ndryshimi mujor, indeksi mesatar vjetor; ndryshimi mesatar vjetor, indeksi i mujor i harmonizuar i çmimeve të konsumit, indeksi i nivelit të çmimeve, PBB-ja për frymë në standardin e fuqisë blerëse.

**Përputhshmëria me *acquis*:** *Statistikat e çmimeve të konsumit* janë pjesërisht në përputhje me rregulloren (EC) nr. 2016/792, "Për indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumit dhe indeksin e çmimeve të banesave", ndërkohë që zbatojnë të njëjtat përkufizime dhe klasifikime. Të dhënat e çmimeve transmetohen dhe publikohen rregullisht në Eurostat, çdo muaj. INSTAT-i ndjek dhe zbaton rregullisht ndryshimet metodologjike të rregullores dhe i zbaton në trajtimin dhe llogaritjen e treguesit. Për sa i përket statistikave të matjes së fuqisë blerëse, të gjitha aktivitetet që lidhen me këtë nëntemë statistikore kryhen në përputhje të plotë me rregulloren (BE) nr. 193/2011, "Për kontrollin e cilësisë së matjes së fuqisë blerëse".

**Tema 3.8 "Shkenca, teknologjia dhe inovacioni"**

Në këtë temë përfshihen këto nëntema:

*3.8.1 "Statistikat e shkencës dhe teknologjisë"* – për statistikat e kësaj kategorie, INSTAT-i, gjatë vitit 2025, do të mbledhë dhe përpunojë të dhëna administrative mbi fondet e alokuara në buxhetin e shtetit për aktivitetin e kërkimit shkencor (statistikat GBARD), për vitin referencë 2024. Këto të dhëna do të transmetohen në Eurostat.

*3.8.2 "Statistikat e inovacionit"* – INSTAT-i, gjatë vitit 2025, do të përpunojë të dhënat e vrojtimit e inovacionit në ndërmarrje, të realizuar në dhjetor të 2024-s (CIS 2024), për periudhën kohore 2022–2024. Treguesit e inovacionit për periudhën kohore 2022–2024, do të publikohen dhe transmetohen në Eurostat në vitin 2026.

*3.8.3 "Statistikat e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit"* – Për prodhimin e statistikave të kësaj nënteme, INSTAT-i do të kryejë dy vrojtime:

a) Vrojtimin vjetor mbi "Teknologjinë e informacionit dhe komunikimit" pranë ndërmarrjeve ekonomike, për të cilin INSTAT-i do të kryejë mbledhjen e të dhënave për vitin referencë 2025 dhe publikimin e këtyre treguesve, duke u bazuar në rregulloren zbatuese për vitin referues. Gjithashtu, gjatë vitit 2025, këto tregues dhe raporti i cilësisë do të transmetohen në Eurostat.

b) Vrojtimin mbi "Përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit" në njësitë ekonomike familjare (NjEF), ku edhe për këtë

aktivitet, INSTAT-i do të kryejë mbledhjen e të dhënave për vitin referencë 2025 dhe publikimin e këtyre treguesve duke u bazuar në rregulloren zbatuese për vitin referues. Gjithashtu, gjatë vitit 2025, të dhënat mikro, si dhe raporti i cilësisë do të transmetohen në Eurostat nëpërmjet sistemit *Metadata Handler*.

Statistikat e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit do të kenë frekuencë vjetore. Statistikat e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në njësitë ekonomike familjare kryhen bazuar në rregulloren (BE) 2019/1700, "Për statistikat lidhur me individët dhe NjEF-të", duke krijuar një kuadër ligjor të përbashkët lidhur me statistikat për njësitë ekonomike familjare dhe individët, të mbledhura përmes kampionëve të zgjedhur.

**Treguesit kryesorë:** Tregues lidhur me përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në ndërmarrje ekonomike me 10 e më shumë të punësuar; tregues mbi nivelin e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit nga familjet (NJEF) dhe individët në nivel kombëtar me periodicitet vjetor.

**Përputhshmëria me *acquis:*** Statistikat mbi *shkencën, inovacionin* dhe *teknologjinë* janë pjesërisht në përputhje me rregulloren e Komisionit (KE) nr. 2019/2152, "Për statistikat evropiane të biznesit", rregulloren zbatuese të Komisionit Evropian (EU) 2022/1092, "Për statistikat e inovacionit", si dhe rregulloren zbatuese të Komisionit Evropian (EU) 2023/1507, "Për statistikat e teknologjisë së informacionit në ndërmarrje". Gjatë vitit 2024 u prodhuan dhe publikuan disa tregues kryesor mbi statistikat e kërkimit shkencor. *Statistikat për nënfushën e shkencës* kanë përputhshmëri të ulët me rregulloren BE. *Statistikat për nënfushën e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në ndërmarrje* janë pjesërisht në përputhje me rregulloren bazë të Komisionit Evropian 2023/1507. *Statistikat për nënfushën e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në NjEF dhe individë* janë në përputhje me rregulloren bazë të Komisionit Evropian 2019/1700, duke siguruar një kuadër ligjor të përbashkët, lidhur me vrojtimin e teknologjisë së informacionit në NjEF-të, të mbledhura përmes kampionëve të përzgjedhur me objekt popullsinë 16–74 vjeç. Hartimi i pyetësorit, përkufizimet dhe metodologjia e përdorur është në përputhje me rregulloret zbatuese për secilin vit në të cilin vrojtimi zhvillohet.

Treguesit statistikorë për *nënfushën e inovacionit* janë pjesërisht të përputhshme me rregulloren e Komisionit (KE) nr. 2019/2152, "Për statistikat evropiane të biznesit", rregulloren zbatuese të Komisionit Evropian (BE) për statistikat e inovacionit për raundin e vrojtimit të inovacionit të Komunitetit, CIS 2024.

*Tabela nr. 15: Lista e vrojtimeve për fushën "Statistikat sektoriale"*

| Vrojtimi | Burimi i financimit |
|---|---|
| Vrojtimi vjetor në bujqësi | Buxhet shteti |
| Vrojtimi mbi sipërfaqen e mbjellë | Buxhet shteti |
| Vrojtimi i përdorimit të lëndës drusore në industri | Buxhet shteti |
| Vrojtimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve për gjedhë, derra dhe të imta | Buxhet shteti |
| Vrojtimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve të shpendëve | Buxhet shteti |
| Vrojtimi mujor i aktivitetit të pularive për prodhimin e vezëve (konsum njerëzor) | Buxhet shteti |
| Vrojtimi vjetor në të gjitha fabrikat dhe baxhot që grumbullojnë dhe përpunojnë qumësht | Buxhet shteti |
| Vrojtimi i çmimeve bujqësore | Buxhet shteti |
| Vrojtimi i  Strukturave Akomoduese | Buxhet shteti |
| Vrojtimi i Turizmit në Familje "Pushime dhe Udhëtime" | Buxhet shteti |
| Vrojtimi i çmimeve të konsumit | Buxhet shteti |
| Vrojtimi i  Paritetit të Fuqisë Blerëse | Komisioni Evropian |
| Vrojtimi mbi Kërkim Zhvillimin | Buxhet shteti |
| Vrojtimi i TIK në ndërmarrje | Buxhet shteti |
| Vrojtimi i TIK në familje | Buxhet shteti |

*Tabela nr. 16: Niveli i përputhshmërisë me acquis për fushën "Statistikat sektoriale"*

| Aktiviteti | Niveli i përputhshmërisë |
|---|---|
| Statistikat e pyjeve – administrative | I ulët |
| Statistikat e Prodhimit Bimor | I mesëm |
| Statistikat e Blegtorisë, Mishit dhe Vezëve | I ulët |
| Statistikat e Qumështit dhe Nënprodukteve të tij | I ulët |
| Statistikat e peshkimit | I mesëm |
| Statistikat e prodhimeve organike në bujqësi | I ulët |
| Statistikat e agromjedisit | I ulët |
| Statistikat e energjisë | I mesëm |
| Statistikat e transportit ajror, detar, rrugor dhe hekurudhor | I ulët |
| Statistikat e sigurisë në transport | I mesëm |
| Statistikat e Turizmit nga ana e Ofertës dhe Kërkesës | I mesëm |
| Statistikat tremujore të fluksit dhe stokut të Investimeve Direkte | I lartë |
| Statistikat e Tregtisë ndërkombëtare të shërbimeve | I plotë |
| Statistikat e Tregtisë së jashtme të mallrave | I ulët |
| Klasifikimet pwr Statistikat e Tregtisë së jashtme të mallrave | I lartë |
| Statistikat tremujore të Bilancit të Pagesave | I mesëm |
| Statistikat mujore të Bilancit të Pagesave | I mesëm |
| Statistikat tremujore të Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare | I mesëm |
| Statistikat tremujore të Borxhit të Jashtëm | I mesëm |
| Statistikat e Çmimeve të Konsumit | I mesëm |
| Vrojtimet e Matjes së Fuqisë Blerëse | I plotë |
| Indekset e Çmimeve të Banesave | I papërputhshëm |
| Statistikat e Shkencës | I ulët |
| Statistika mbi Inovacionin në Ndërmarrje | I ulët |
| Statistikat e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në ndërmarrje dhe familje | I mesëm |

**Fusha 4 "Statistikat e mjedisit dhe multidomain"**

Statistikat e mjedisit dhe multidomain përfshijnë statistikat e mjedisit dhe statistikat rajonale, dhe gjeohapësinore.

Qëllimi kryesor i statistikave të mjedisit dhe multidomain është sigurimi i të dhënave në kohë dhe me cilësi i treguesve statistikorë të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave të përbashkëta mjedisore dhe socio-ekonomike, monitorimin dhe menaxhimin e këtyre fushave. Gjithashtu, në këtë fushë statistikore synohet dhe integrimi i informacionit statistikor dhe atij gjeohapësinor, me anë të të cilit synohet sigurimi i numrit më të madh të mundshëm të statistikave të gjeoreferuara në kohë dhe cilësi nga fusha të ndryshme të statistikave në një nivel territorial të detajuar.

Objektivi kryesor gjatë vitit 2025, për statistikat e mjedisit dhe multidomain është realizimi i të gjithë objektivave, sipas Programit të Statistikave Zyrtare 2022–2026, me fokus rritjen e cilësisë dhe plotshmërisë së serive kohore për treguesit me frekuencë vjetore, të lidhur në veçanti me statistikat e mbetjeve dhe statistikat e ujit, si dhe finalizimi i ngritjes së infrastrukturës së teknologjisë së informacionit për regjistrin statistikor të ndërtesave dhe banesave (RSNB/ASRBD).

Agjencia statistikore përgjegjëse: INSTAT-i

Tabela nr. 17 paraqet numrin e aktiviteteve të kësaj fushe, për kategoritë: periodiciteti/burimi i të dhënave/niveli minimal i publikimit/institucioni përgjegjës.

*Tabela nr. 17: Përmbledhje e numrit të aktiviteteve për fushën "Statistikat e mjedisit dhe multidomain"*

| 4. Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain | Nr. i aktiviteteve Statistikore (AS) | Nr. AS / Periodiciteti * | Nr. AS / Burimi i të dhënave** | Nr. AS / Niveli minimal i publikimit | Nr. AS / Institucioni përgjegjës |
|---|---|---|---|---|---|
| Mjedisi | 9 | 3-V<br>1- 2V | 8 BA<br>1 V | 9 Vendi | 9 INSTAT |
| Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS) për qëllime Statistikore | 4 | 4-Tjetër | 4-Tjetër | 4 NA | 4 INSTAT |
| **Gjithsej** | **13** | **8-V<br>1-2V<br>4-Tjetër** | **8 BA<br>1V<br>4-Tjetër** | **9 Vendi<br>4 NA** | **13 INSTAT** |

*M-mujor; T-tremujor; V-vjetor;
** VS-vrojtim statistikor; BA-burim administrativ; NA-nuk aplikohet.

**Tema 4.1 "Mjedisi"**

Statistikat e mjedisit parashikohet të prodhohen sipas këtyre nëntemave:

*4.1.1 "Llogaritë monetare mjedisore"*, sipas kësaj nënteme, INSTAT-i do të prodhojë statistika mbi llogaritë monetare mjedisore, me frekuencë vjetore, të siguruara nga burime administrative, duke shfrytëzuar të dhënat e disponueshme në INSTAT (kryesisht të dhënat e siguruara nga Drejtoria e Llogarive Kombëtare) dhe duke i shpërndarë këto të dhëna sipas kërkesave dhe metodologjisë evropiane.

*4.1.2 "Llogaritë fizike mjedisore"*, sipas së cilës INSTAT-i do të realizojë aktivitetin "Llogaritë fizike mjedisore" të gjeneruara nga burimi administrativ dhe duke përpunuar të dhënat statistikore të siguruara nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe INSTAT-i.

*4.1.3 "Statistikat mbi menaxhimin e mbetjeve"*, ku INSTAT-i do të kryejë prodhimin vjetor të statistikave mbi mbetjet, bazuar në aktivitetet "Statistikat mbi menaxhimin e mbetjeve", të siguruara nga burimi administrativ dhe "Statistikat mbi menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane", të siguruara nga bashkitë e vendit, me një sistem tashmë të konsoliduar të mbledhjes së të dhënave. Gjithashtu, brenda kësaj nënteme, INSTAT-i do të kryejë prodhimin vjetor të statistikave mbi mbetjet, bazuar në "Statistikat mbi menaxhimin e mbetjeve" të siguruara nga vrojtimi vjetor mbi mbetjet në industri.

*4.1.4 "Statistikat e ujit"* – Prodhimi vjetor i statistikave të ujit nga INSTAT-i, do të bazohet në aktivitetin statistikor "Statistikat e ujit", i cili prodhohet nga përpunimi i të dhënave administrative të siguruara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar.

*4.1.5 Statistikat e qytetit* – Për realizimin e kësaj nënteme do të prodhohen statistikat mbi cilësinë e ajrit, zhurmat dhe automjetet sipas vjetërsisë në përdorim. Këto statistika do të prodhohen nga INSTAT-i me frekuencë vjetore, duke u mbështetur në aktivitetin "Statistikat mbi cilësinë e ajrit dhe zhurmat", të cilat prodhohen nga përpunimi i të dhënave të siguruara nga INSTAT-i, si dhe i të dhënave administrative të siguruara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

*4.1.6 "Statistikat e biodiversitetit"* – Nga realizimi i kësaj teme statistikore do të vijojë punën për sigurimin e të dhënave të përgjithshme dhe specifike për zonat e mbrojtura, speciet e kërcënuara, florën dhe faunën. Të dhënat janë vjetore në nivel kombëtar dhe sigurohen nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.

**Treguesit kryesorë**: Tregues vjetorë mbi taksat në mjedis në total vendi; tregues vjetorë mbi shpenzimet për mbrojtjen e mjedisit dhe të ardhurat në total vendi; tregues vjetorë mbi të mirat dhe shërbimet në mjedis në total vendi; tregues vjetorë mbi llogaritë rrjedhëse fizike të energjisë në total vendi, burimet e brendshme natyrore (DE), përdorimin e brendshëm të materialeve mjedisore (DMC); tregues mbi menaxhimin e mbetjeve dhe substancave të rrezikshme në nivel vendi; tregues statistikorë mbi mbetjet e ngurta urbane, mbetjet e ngurta industriale; cilësinë e ujërave larës në detet Adriatik dhe Jon; tregues mbi ujin, cilësinë e ajrit dhe zhurmat në nivel vendi dhe në qytete kryesore, speciet e rrezikuara dhe ato të mbrojtura për florën

dhe faunën, si dhe tregues mbi numrin dhe sipërfaqen e zonave të mbrojtura.

**Përputhshmëria me *acquis*:** *Llogaritë monetare në mjedis* bazohen në rregulloren (KE) 691/2011, "Për llogaritë ekonomike evropiane mjedisore". *Llogaritë fizike mjedisore* bazohen në rregulloren (KE) 691/2011, "Për llogaritë ekonomike evropiane mjedisore". Përkufizimet e përdorura janë kryesisht në përputhje me këtë rregullore. *Llogaritë e flukseve të materialeve mjedisore* publikohen nga INSTAT-i me periodicitet vjetor dhe në përputhje me metodologjinë e BE-së. *Statistikat në fushën e mbetjeve të ngurta urbane* realizohen duke zbatuar metodologjitë dhe standardet e parashikuara në rregulloret si: rregullorja (KE) nr. 2150/2002, "Për statistikat e mbetjeve", direktiva e Këshillit të Evropës nr. B2008/98/EC "Për mbetjet dhe raportimin e detyrueshëm të statistikave për mbetjet", rregullorja (KE) nr. 782/2005, që përcakton formatin e detyrueshëm për transmetimin e rezultateve në statistikat e mbetjeve, rregullorja (KE) nr. 783/2005, shtojca II për rregulloren e mbetjeve, direktiva e Këshillit të Evropës nr. 2150/2002, "Për kriteret e duhura të vlerësimit të cilësisë dhe përmbajtjen e raporteve të cilësisë për statistikat e mbetjeve", rregullorja (KE) nr. 849/2010, "Për menaxhimin e mbetjeve urbane" dhe manuali i Eurostatit për statistikat e mbetjeve, i amenduar. *Statistikat në fushën e ujërave* realizohen duke zbatuar metodologjitë sipas standardeve evropiane bazuar në rregulloret dhe direktivat e BE-së, rregullorja (KE) 2017/1951, "Për programin e statistikave evropiane".

Statistikat e kësaj teme statistikore janë pjesërisht në përputhje me rregulloret përkatëse.

**Tema 4.2 "Multidomain"**

Kjo temë përbëhet nga 2 nëntema:

*4.2.1 Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS) për qëllime statistikore* – gjatë vitit 2025, INSTAT-i do të zbatojë aktivitetet që lidhen me sistemin e informacionit gjeografik bazuar dhe në PSZ-në 2022–2026, me fokus përditësimin e vazhdueshëm të të dhënave gjeohapësinore me informacionin e ardhur nga Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023, burime administrative, burime alternative dhe/ose verifikime në terren. Baza e të dhënave gjeohapësinore do të shërbejë edhe për përmirësimin e kampionit të vrojtimeve të tjera statistikore të INSTAT-it.

Si pjesë e aktiviteteve të gjeoinformacionit do të punohet edhe në integrimin e të dhënave gjeohapësinore me të dhënat statistikore në funksion të përgatitjes së materialit hartografik për publikimet e veçanta të INSTAT-it me anë të komponentit gjeografik. Në këtë kuadër të publikimit të të dhënave statistikore do të synohet në përditësimin dhe pasurimin e gjeoportalit të INSTAT-it me më shumë tregues rajonalë në nivele të ndryshme gjeografike për të qenë sa më pranë nevojave të përdoruesve.

Në zbatim të pikës 3/b, të nenit 8, të ligjit nr. 140/2020, "Për censin e popullsisë dhe banesave", lidhur me aktivitetin "Ndërtimin e Regjistrit Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave (RSBN)", gjatë vitit 2025 synohet të përfundohet ngritja e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit për regjistrin, që përfshin aplikacionin *web* të regjistrit, si dhe aplikacionin e mbledhjes së të dhënave në terren në kuadër të përditësimit dhe mirëmbajtjes së regjistrit. Gjatë vitit 2025, fokus do të jetë finalizimi i ndërtimit të të gjithë bazës GIS/IT së RSNB-së dhe përgatitja për ndërmarrjen e aktivitetit të parë të përditësimit në terren. Gjatë vitit 2025 është parashikuar të nisë dhe procesi i përditësimit të regjistrit me të dhënat e siguruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (Adresari) apo autoritete të tjera publike shqiptare, sipas variablave të përcaktuar në regjistër. Kjo fazë përfshin verifikimin në terren të informacionit dhe përditësimin e bazës së të dhënave të regjistrit. Në funksion të përditësimit dhe mirëmbajtjes së regjistrit do të vendosen apo rishikohen marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera publike.

Për sa i përket aktivitetit "Klasifikimi statistikor i njësive territoriale" INSTAT-i transmeton, sipas kërkesave të Eurostatit, rregullisht çdo vit listën e njësive administrative lokale (LAU) me klasifikimet që disponon, si: shkallën e urbanizimit (DEGURBA) dhe klasifikimin e zonave bregdetare (*Costal Areas*). INSTAT-i do të vijojë të transmetojë këtë listë sipas kërkesave të Eurostatit për vitin 2025. Gjithashtu, gjatë vitit të ardhshëm, INSTAT-i ka planifikuar harmonizimin e klasifikimit të nomenklaturave statistikore NUTS, në përputhje me rregulloret e KE-së, si dhe implementimin e tipologjive territoriale (TERCET), në përputhje me rregulloret e Komisionit Evropian, si dhe paraqitjen

hartografike të treguesve kryesorë të Censit në nivel rrjeti qelizor (*grid*) prej 1 km².

Në zbatim të rregulloreve të Komisionit Evropian mbi klasifikimet e nomenklaturës territoriale me mbështetjen nga programi i bashkëpunimit statistikor me shumë vende përfituese – IPA 2022 dhe bazuar në të dhënat e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, INSTAT-i do të synojë: a) përditësimin e klasifikimit të rajoneve NUTS; b) përditësimin e shkallës së urbanizimit "*degree of urbanization*" (DEGURBA) e aplikuar në nivel LAU mbi bazën e popullsisë në nivel rrjeti qelizash (*grid*); c) përcaktimin e listës së qyteteve (Cities) mbi bazën e metodologjisë evropiane; d) përcaktimin e "*Functional Urban Areas*" (FUAs) bazuar mbi bazën e popullsisë në nivel rrjeti qelizash (*grid*) dhe lëvizjeve vajtje-ardhje për në punë.

*4.2.2 Harmonizimi i temave "Demografia" dhe "Njësitë statistikore" sipas direktivës INSPIRE*

Në lidhje me Infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor (NSDI Kombëtare), INSTAT-i do të fokusohet në transformimin dhe harmonizimin e të dhënave gjeografike për dy temat që është përgjegjës në kuadrin e NSDI shqiptare (demografia dhe njësitë statistikore), sipas specifikimeve të direktivës INSPIRE. Me mbështetjen e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, INSTAT-i parashikon harmonizimin e të dhënave gjeohapësinore me të dhënat e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023.

*Tabela nr. 18: Lista e vrojtimeve për fushën "Statistikat e mjedisit dhe multidomain"*

| Vrojtimi | Burimi i financimit |
|---|---|
| Vrojtimi i përdorimit të ujit në industri | Buxhet shteti |

*Tabela nr. 19: Niveli i përputhshmërisë me acquis për fushën "Statistikat e mjedisit dhe multidomain"*

| Aktiviteti | Niveli i përputhshmërisë |
|---|---|
| Llogaritë Monetare Mjedisore | I ulët |
| Llogaritë Fizike Mjedisore | I mesëm |
| Statistikat mbi menaxhimin e mbetjeve | I mesëm |
| Statistikat e ujit | I mesëm |
| Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS) për qëllime Statistikore | I lartë |

**Botime përmbledhëse**

Botimet e INSTAT-it pasqyrojnë një gamë të gjerë të dhënash dhe analizash statistikore, duke ofruar një pamje gjithëpërfshirëse të zhvillimeve demografike, ekonomike, sociale e mjedisore në Shqipëri. Ato kanë fokus të veçantë, tregjet e punës, tregtinë e jashtme, transportin, kulturën dhe turizmin. Këto publikime u shërbejnë vendim-marrësve, kërkuesve shkencorë, akademikëve dhe publikut të gjerë për të kuptuar më mirë realitetin dhe dinamikën e vendit. Të përgatitura në përputhje me standardet ndërkombëtare, botimet e INSTAT-it janë një burim i domosdoshëm për ndjekjen e politikave dhe planifikimin strategjik, duke mbështetur vendimmarrjen e bazuar në shifra.

**Vjetari Statistikor Rajonal**

Vjetari Statistikor Rajonal është një publikim me frekuencë vjetore, i cili synon t'i japë përdoruesve një përmbledhje të treguesve dhe tendencave demografike, ekonomike, sociale dhe mjedisore më të rëndësishme dhe më të fundit në nivel rajonal, qarku dhe, ku është i disponueshëm, edhe në nivel lokal (si p.sh. nivel bashkie). Prioriteti i Vjetarit është paraqitja e treguesve statistikorë (normat, raportet, mesataret, koeficientët, indekset etj.) dhe jo vlerat absolute. Kjo mundëson krahasimin ndërmjet njësive territoriale, pavarësisht nga madhësia dhe vendndodhja e tyre. Ky publikim respekton Nomenklaturën Evropiane të Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS), ku dallon këto nivele: NUTS 1 (nivel vendi), NUTS 2 (rajonet statistikore bazë, në Shqipëri: Veri, Qendër, Jug), NUTS 3 (rajone të vogla statistikore, në Shqipëri: 12 prefekturat ose qarqet), LAU 1 (njësitë administrative vendore 1, në Shqipëri: 61 bashki).

**Regjistrat e biznesit**

Statistikat zyrtare bazuar në regjistrat e biznesit i shërbejnë të gjithë komunitetit të biznesit, politikëbërësve dhe akademikëve për të analizuar situatën ekonomike në vend, për të ndërmarrë

iniciativa dhe vendime të drejta për të përmirësuar klimën dhe zhvillimin e bizneseve.

**Shqipëria në shifra**

Shqipëria në shifra paraqet në mënyrë sintetike të dhëna statistikore për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë. Botimi përmban 36 kapituj: demografia, shëndetësia, kushtet sociale, arsimi, kultura, papunësia, punësimi, çmimet, tregtia e jashtme, transporti, turizmi, llogaritë kombëtare, regjistri i ndërmarrjeve, inovacioni etj.

**Burra dhe gra në Shqipëri**

Publikimi "Burra dhe Gra në Shqipëri" është një publikim me periodicitet vjetor, i cili paraqet të dhëna për fusha të ndryshme të jetës të ndara sipas gjinisë, si dhe paraqet matjen dhe monitorimin e jetës së grave dhe burrave në shoqëri. Kapitujt e përfshirë në këtë botim pasqyrojnë fusha të ndryshme të të dhënave me bazë gjinore, të cilat janë përpunuar dhe vendosur në kontekst nga stafi i INSTAT-it, duke i bërë ato më të lehta dhe të kuptueshme për publikun e gjerë.

**Tregtia e jashtme e mallrave dhe ndërmarrjet**

Botimi pasqyron disa nga kërkesat themelore dhe nevojat e disa grupeve të përdoruesve për të dhënat mbi tregtinë e mallrave dhe ndikimin e tyre në ekonominë shqiptare. Ky publikim i dedikuar paraqet me anë të shifrave realitetin ekonomik në vend, si dhe përgjigjet ndaj kërkesave në rritje për informacion statistikor të vendimmarrësve, kërkuesve shkencorë dhe akademikëve në Shqipëri.

**Tregu i punës**

Botimi mbi tregun e punës është një burim i rëndësishëm informacioni mbi situatën dhe tendencat e tregjeve kombëtare të punës. Ai ndihmon për të monitoruar politikat dhe strategjitë kryesore për punësimin dhe pagat, sipas gjinisë dhe strukturës gjinore, dhe moshore, shkallës arsimore, aktivitetit ekonomik dhe profesioneve. Botimi vjetor i tregut të punës përmban një analizë të zgjeruar të publikimeve tremujore bazuar në burime administrative dhe vrojtimin e forcave të punës.

**Turizmi në shifra**

Ky publikim i dedikuar paraqet me anë të shifrave të dhëna përmbledhëse mbi sektorin e turizmit për nevoja të hartuesve të politikave, vendimmarrësve, kërkuesve shkencorë dhe akademikëve në Shqipëri. Përgatitja e këtij materiali është mundësuar nga burime administrative dhe dy vrojtime: vrojtimi "Pushime dhe udhëtime" dhe "Vrojtimi i strukturave akomoduese".

**Statistikat e kostos së punës**

Publikimi "Statistikat e Kostos së Punës" siguron të dhëna cilësore, të hollësishme dhe të harmonizuara mbi kostot e punës së ndërmarrjeve për faktorin e prodhimit punë. Ky publikim përmban të dhëna mbi orët reale të punës, pagat dhe rrogat bruto në kesh dhe në natyrë, kontributet për sigurimet shoqërore që paguan punëdhënësi për punëmarrësin, kostot e trajnimit profesional, si dhe shpenzime të tjera, si: kostot e rekrutimit dhe shpenzimet për veshje, strehim apo taksat e punësimit etj.

**Statistika të kulturës**

INSTAT-i publikon statistika mbi kulturën, duke u përqendruar në pjesëmarrjen kulturore dhe në dimensionin ekonomik të kulturës. Këto statistika lidhen me pjesëmarrjen dhe trashëgiminë kulturore, edukimin dhe punësimin në kulturë. Gjithashtu, botimi është pasuruar me seksione të veçanta që i dedikohen edhe përdorimit të internetit për qëllime kulturore dhe shpenzimeve publike në kulturë.

**Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm**

Publikimi "Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, 2022" përmban disa indikatorë për secilin objektiv, paraqitur vizualisht, me një përshkrim të indikatorit, vlerën e tij, si dhe krahasimin me vitin përpara. Ky publikim parashikohet të realizohet një here në tri vite.

**Transporti në shifra**

Transporti është një sektor i rëndësishëm i ekonomisë dhe luan një rol jetik në shoqërinë e sotme të lëvizshme. Ky publikim i dedikuar paraqet me anë të shifrave situatën reale në vend, si dhe përgjigjet ndaj kërkesave në rritje për informacion statistikor të vendimmarrësve, kërkuesve shkencor dhe akademikëve në Shqipëri. Përgatitja e këtij botimi mundësohet nga burime administrative të treguesve statistikorë lidhur me transportin hekurudhor, rrugor, detar dhe ajror, lidhur me sasinë e mallrave dhe numrin e pasagjerëve që lëvizin çdo vit, mjetet e përdorura dhe treguesit e sigurisë në transport.

**Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta**

Statistikat në lidhje me ndërmarrjet private të huaja dhe të përbashkëta (shqiptare dhe të huaja) synojnë të tregojnë strukturën, të matin treguesit ekonomikë, format e organizimit, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. INSTAT-i, nëpërmjet këtij publikimi, plotëson disa prej kërkesave për informacion statistikor të vendimmarrësve,

kërkuesve shkencor, akademikëve etj., të cilat janë vazhdimisht në rritje.

CENSET

**A. Censi i Popullsisë dhe Banesave**

Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023 ka përfunduar në muajin nëntor të vitit 2023, duke pasur në fokus respektimin e udhëzuesit "Rekomandimet për Censet e Popullsisë dhe Banesave të vitit 2020" të Konferencës së Statistikave Evropiane në përputhje dhe me rishikimin e "Parimeve dhe rekomandimeve për Censet e Popullsisë dhe Banesave", të Kombeve të Bashkuara, për vitin 2020.

Të dhënat e këtij censi luajnë një rol thelbësor në përditësimin e të dhënave statistikore të nevojshme në nivel qendror dhe vendor. Ai, gjithashtu, ndihmon në kuptimin dhe ilustrimin e transformimeve që Shqipëria ka përjetuar në periudhat midis censeve. Censi ofron informacionin bazë statistikor mbi popullsinë, ndërtesat dhe banesat për të gjithë territorin e Shqipërisë, i cili është thelbësor për ndërtimin e institucioneve, zhvillimin e qëndrueshëm, demokracinë dhe qeverisjen e mirë në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Gjithashtu, këto të dhëna nxjerrin në pah ndryshimet demografike, ekonomike dhe shoqërore ndërmjet dy censeve sipas ndarjes territoriale.

Një komponent tjetër shumë i rëndësishëm i Censit është edhe ai gjeohapësinor në të cilin të dhënat e Censit do të shërbejnë për të përditësuar gjeodatabazën e INSTAT-it, për të populluar Regjistrin Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave, si dhe për ndërtimin e kornizës së re të kampionimit për vrojtimet e INSTAT-it.

Të dhënat do të bëhen të disponueshme në formë të agreguar, duke filluar nga zonat më të vogla gjeografike deri në nivel bashkiak dhe kombëtar, sipas kalendarit të publikimeve të Censit, si dhe përmes rrjetit të qelizave 1 km$^2$, për të lehtësuar zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e planeve dhe programeve të zhvillimit, përafrimin me metodologjitë evropiane, si dhe për qëllime të tjera dhe kërkime shkencore.

**Aktivitetet kryesore të Censit të Popullsisë dhe Banesave për vitin 2025**

Në kalendarin e publikimeve është parashikuar që gjatë vitit 2025 të realizohen:

- analizat të thelluara mbi tematika të ndryshme;
- të dhënat mikro në dispozicion për përdoruesit e jashtëm.

**B. Censi i bujqësisë**

INSTAT-i ka bërë progres në përgatitjen e Censit të Bujqësisë, duke zhvilluar një dokument strategjik, i cili përfshin planin e veprimit dhe buxhetin e nevojshëm për realizimin e tij. Miratimi zyrtar i Strategjisë së Censit të Bujqësisë do të kryhet pas miratimit të projektligjit për "Censin e bujqësisë". Projektligji, i cili po ndiqet nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, është përgatitur nga INSTAT-i në bashkëpunim me ekspertë nga vendi dhe ndërkombëtarë, dhe aktualisht është në proces diskutimi nga ministritë e linjës. Projektligji "Për censin e bujqësisë" është pjesë e PKIE 2025, nën kapitullin 18 "Statistikat".

Censi i Bujqësisë do t'i përmbahet zbatimit të rregullores (BE) nr. 2018/1091, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës, datë 18 korrik 2018, mbi Statistikat e Integruara të Fermave, si dhe rregullores zbatuese të Komisionit (BE) 2021/2286, datë 16 dhjetor 2021.

**Aktivitete të planifikuara për Censin e Bujqësisë**

Aktivitete të mëtejshme të planifikuara për Censin e Bujqësisë janë:

- Rishikimi i strategjisë, planit të aktiviteteve dhe buxhetit;
- Finalizimi i pyetësorit;
- Finalizimi i kornizës metodologjike;
- Ngritja e sistemit të teknologjisë së informacionit (TI) për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave.

Ky proces do të kontribuojë në mbledhjen e të dhënave të sakta dhe të besueshme për sektorin bujqësor, duke mundësuar zhvillimin e politikave të informuara dhe përmirësimin e statistikave të bujqësisë në përputhje me standardet dhe rregulloret ndërkombëtare.

**V. Sistemi i menaxhimit të cilësisë**

INSTAT-i synon të ofrojë produkte dhe shërbime statistikore që korrespondojnë me nevojat statistikore të informacionit të grupeve të ndryshme të përdoruesve. Përmirësimi i cilësisë së informacionit statistikor kryhet vazhdimisht duke kërkuar kostot më të ulëta të mundshme dhe duke zvogëluar barrën e përgjigjes. INSTAT-i është angazhuar të sigurojë cilësinë më të lartë në lidhje me përpilimin e statistikave. Në përputhje me legjislacionin për statistikat zyrtare, INSTAT-i përdor metoda dhe procese statistikore në linjë me parimet dhe standardet shkencore të njohura

ndërkombëtarisht, kryen analiza të vazhdueshme të statistikave, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe siguron që statistikat të jenë sa më të përditësuara. Në kryerjen e detyrave funksionale INSTAT-i ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë nga Kodi i Praktikës së Statistikave Evropiane.

Në kuadër të sigurimit të cilësisë statistikore, në përputhje me nenin 5, të ligjit nr. 17/2018, "Për statistikat zyrtare" dhe parimin nr. 4 "Cilësia statistikore" të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, INSTAT-i, gjatë vitit 2024, ka ndërmarrë iniciativat e mëposhtme:

- Rritjen e kapaciteteve profesionale dhe ndërgjegjësimit të punonjësve të sistemit statistikor për menaxhimin e cilësisë përmes zhvillimit të trajnimeve të vazhdueshme mbi këtë fushë;

- Menaxhimin e kujdesshëm të risqeve dhe planifikimin në kohë të masave përkatëse parandaluese, thelbësore për Programin e Statistikave Zyrtare;

- Auditin statistikor dhe vetëvlerësimi, përcaktuar si rruga konkrete për identifikimin e pikave të forta dhe mundësive për përmirësim e cilësisë së një procesi apo produkti statistikor. Ky është një proces sistematik, i programuar, i pavarur, i dokumentuar, me anë të të cilit bëhet një vlerësim objektiv i hapave të ndjekur gjatë një procesi statistikor. Me synimin për të rritur përmirësimin e cilësisë së proceseve statistikore, prej vitit 2019 INSTAT-i ka nisur zbatimin konkret të këtyre aktiviteteve;

- Implementimin e GSBPM-së si një model reference. Nëpërmjet këtij modeli monitorohen afatet kohore të të gjitha proceseve statistikore, dokumentimi i tyre dhe matja e kosto-efektivitetit për aktivitetet statistikore;

- Për të siguruar cilësinë e statistikave zyrtare dhe besueshmërinë e publikut në to, INSTAT-i ka ofruar raportet e cilësisë në nivelin e produkteve statistikore. Nëpërmjet tyre, përdoruesve u sigurohet informacion, si edhe metadatat referenciale/strukturore, me format standard në metodat dhe përkufizimet e aplikuara, dhe në cilësinë e rezultateve statistikore. Struktura e raporteve të cilësisë bazohet në konceptin e cilësisë së Sistemit Evropian të Statistikave (ESS-SIMS) dhe në parimet lidhur me cilësinë e produkteve statistikore sipas Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane;

- Orientimin ndaj përdoruesit – INSTAT-i përpiqet që të prodhojë statistika sa më afër nevojave të përdoruesve, përpiqet të njohë dhe të përmbushë pritshmëritë e tyre dhe në këtë mënyrë të sigurojë përmbushjen e plotë të nevojave për të dhëna statistikore zyrtare. Matja e pritshmërisë së përdorueseve realizohet nëpërmjet Vrojtimi të Kënaqësisë së Përdoruesve;

- Orientimin ndaj punonjësit – INSTAT-i kujdeset për kualifikimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve, me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe kompetencave të tyre, duke ndikuar kështu në rritjen e motivimit dhe kënaqësisë së punonjësve të cilët kontribuojnë efektivisht në proceset e punës nëpërmjet Vrojtimit të Kënaqësisë së Punonjësve.

**Gjatë vitit 2025,** INSTAT-i do të punojë në kuadër të menaxhimit të cilësisë, si vijon:

- Në përputhje me parimin nr. 1 "Koordinimi dhe bashkëpunimi", të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, INSTAT-i dhe Eurostati sigurojnë koordinimin e të gjitha aktiviteteve për zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave evropiane në nivel të Sistemit Kombëtar Statistikor dhe Sistemit Statistikor Evropian. Autoritetet statistikore bashkëpunojnë në mënyrë aktive, në kuadër të partneritetit të Sistemit Statistikor Evropian, në mënyrë që të sigurojnë zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave evropiane;

- Në përputhje me parimin nr. 4 "Cilësia statistikore", të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, INSTAT-i do të punojë në kuadër të përmirësimit të cilësisë statistikore. Puna do të fokusohet në: hartimin/përditësimin dhe publikimin e raporteve të cilësisë dhe metadatave referenciale për përdoruesit, dokumentimin e proceseve statistikore, rritjen e kapaciteteve profesionale dhe ndërgjegjësimit të punonjësve të SKS-së, auditin statistikor dhe vetëvlerësimin, orientimin ndaj përdoruesve dhe punonjësve;

- Në përputhje me parimin nr. 9 "Ngarkesa ndaj të intervistuarve" të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, INSTAT-i monitoron përmes dy treguesve bazë: numri i pyetësorëve që ndërmarrjet/familjet duhet të përgjigjen si dhe kohëzgjatja e intervistës;

- Në përputhje me parimin nr. 10 "Kosto dhe efektiviteti", të Kodit të Praktikave Evropiane dhe në përmbushje të rekomandimit nr. 19 të *Peer Review*, për krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës që mundëson vlerësimin e kostove të proceseve dhe

produkteve të aktiviteteve statistikore dhe për përdorimin e informacionit që rezulton për qëllime menaxhimi, duke përfshirë edhe krahasimin e efikasitetit dhe kosto-efektivitetit, INSTAT-i ka ndërtuar një sistem gjithëpërfshirës që mundëson vlerësimin e kostove të proceseve dhe produkteve të aktiviteteve statistikore;

- Implementimi i Modelit të Përgjithshëm të Aktivitetit për Organizatat Statistikore (GAMSO), i cili plotëson Modelin e Përgjithshëm të Procesit Statistikor të Biznesit (GSBPM) me aktivitete shtesë të nevojshme për të mbështetur prodhimin statistikor. INSTAT-i do të zëvendësojë kornizën aktuale të vlerësimit të performancës (PAF) me GAMSO në mbështetje të planifikimit të burimeve, zhvillimit dhe zbatimit të arkitekturave të biznesit, duke përfshirë përbërës, të tillë si arkitekturat e aftësive dhe sistemet e menaxhimit të riskut.

Tabelat më poshtë paraqesin informacion të detajuar mbi planin e vlerave të treguesve të performancës 2025 krahasuar me mesataren 2017–2021 për secilën fushë statistikore.

*Tabela nr. 20: Menaxhimi i cilësisë për fushën "Statistikat sociale dhe demografike"*

| | 2017-2021 | 2025 |
|---|---|---|
| Dokumentimi sipas standartit GSBPM | 15 | 17 |
| Matja e kostos së aktiviteteve statistikore | 0 | 17 |
| Auditi Statistikor | 0 | 1 |
| Pyetësori i vetëvlerësimit | 0 | 0 |
| Raportet e cilësisë/metadatat sipas fushave | 14 | 21 |
| Raportet e cilësisë/metadatat sipas fushave të reja | 1 | 3 |

*Tabela nr. 21: Menaxhimi i cilësisë për fushën "Statistikat ekonomike"*

| | 2017-2021 | 2025 |
|---|---|---|
| Dokumentimi sipas standartit GSBPM | 13 | 17 |
| Matja e kostos së aktiviteteve statistikore | 0 | 17 |
| Auditi Statistikor | 1 | 1 |
| Pyetësori i vetëvlerësimit | 0 | 0 |
| Raportet e cilësisë/metadatat sipas fushave | 16 | 17 |
| Raportet e cilësisë/metadatat sipas fushave të reja | 1 | 0 |

*Tabela nr. 22: Menaxhimi i cilësisë për fushën "Statistikat sektoriale"*

| | 2017-2021 | 2025 |
|---|---|---|
| Dokumentimi sipas standartit GSBPM | 9 | 24 |
| Matja e kostos së aktiviteteve statistikore | 0 | 24 |
| Auditi Statistikor | 0 | 0 |
| Pyetësori i vetëvlerësimit | 1 | 2 |
| Raportet e cilësisë/metadatat sipas fushave | 11 | 18 |
| Raportet e cilësisë/metadatat sipas fushave të reja | 1 | 0 |

*Tabela nr. 23: Menaxhimi i cilësisë për fushën "Statistikat e mjedisit dhe multidomain"*

| | 2017-2021 | 2025 |
|---|---|---|
| Dokumentimi sipas standartit GSBPM | 9 | 4 |
| Matja e kostos së aktiviteteve statistikore | 0 | 4 |
| Auditi Statistikor | 0 | 0 |
| Pyetësori i vetëvleresimit | 1 | 0 |
| Raportet e cilësisë/metadatat sipas fushave | 8 | 7 |
| Raportet e cilësisë/metadatat sipas fushave të reja | 1 | 3 |

*Tabela nr. 24: Tregues të përgjithshëm*

| Indikatorët | 2017-2021 | 2025 |
|---|---|---|
| Niveli i kënaqësisë së përdoruesve të statistikave të prodhuara nga INSTAT | 0.26 | 4.1/82.0% |
| Përqindja e përdoruesve që shprehin besim/besueshmëri në statistikat kombëtare (në një Vrojtim) | 0.96 | 4.0/80% |
| Ngarkesa e të intervistuarve pranë familjeve | Po | Po |
| Ngarkesa e të intervistuarve pranë ndërmarrjeve | Po | Po |
| Kohëzgjatja e intervistës mesatare në minuta | 32.9 | 32.00 |

**VI. Integrimi evropian dhe bashkëpunimet ndërkombëtare**

**Integrimi Evropian**

Instituti i Statistikave ka punuar vazhdimisht dhe me prioritet për harmonizimin e statistikave zyrtare me standardet evropiane. Rekomandimet e progres-raporteve ndër vite për kapitullin 18, rekomandimet e nënkomiteteve të ndryshme të Komisionit Evropian dhe të vlerësimeve të ndryshme nga Eurostati për statistikat zyrtare, janë pjesë e planeve të punës të INSTAT-it, të cilat monitorohen dhe zbatohen rigorozisht. INSTAT-i si koordinator i Sistemit Kombëtar Statistikor dhe institucion përgjegjës për kapitullin 18 "Statistikat", bashkërendon punën për ndjekjen dhe zbatimin e rregulloreve evropiane në prodhimin e statistikave zyrtare.

Në vitin 2024, INSTAT-i punoi për përafrimin e disa akteve ligjore, si projektligjit "Për Censin e bujqësisë" dhe projektudhëzimit "Për zbatimin e vrojtimit të të ardhurave dhe nivelit të jetesës – për krijimin e një kornize të përbashkët për statistikat evropiane në lidhje me personat dhe familjet, bazuar në të dhënat në nivel individual të mbledhura nga kampioni".

Në kuadër të detyrimeve pas takimit dypalësh, INSTAT-i me mbështetjen e projektit "Mbështetje për procesin e integrimit në BE të Shqipërisë", SEI ka dorëzuar pranë zyrës së kryenegociatorit pozicionin negociues të kapitullit 18 "Statistikat". Gjithashtu, në kuadër të detyrimeve që sjell zbatimi i agjendës së integrimit Evropian, INSTAT-i ka përgatitur raportimet dhe kontributet si vijon:

- PKIE 2025–2027 – Planifikimi, monitorimi dhe zbatimi i Planit Kombëtar të Integrimit Evropian;
- Programin Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian PKABE 2024–2030;
- Progres Raporti për kapitullin 18 "Statistikat";
- Kontributi në nënkomitete të ndryshme ku INSTAT-i kontribuon si:
- Nënkomiteti për Ekonominë, Çështjet Ekonomike, Financiare dhe Statistikat – ECOFIN;
- Nënkomiteti për Bujqësinë dhe Peshkimin – AGRIFISH;
- Nënkomiteti për Tregtinë, industrinë, doganat dhe tatimet;
- Nënkomiteti "Drejtësia, liria dhe siguria";
- Nënkomiteti "Inovacioni, shoqëria e informacionit dhe politikat sociale".

**Gjatë vitit 2025,** Sistemi Kombëtar Statistikor dhe INSTAT-i do të fokusohen në veprimtaritë për përafrim të *acquis communitaire,* në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe agjendën e integrimit evropian për kapitullin 18 "Statistikat". Ky proces do të kërkojë një planifikim dhe përfshirje në Planin Kombëtar të Integrimit Evropian të burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare.

Në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 94, datë 20.5.2019, "Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian (GNPIE)", si drejtues dhe negociator i kapitullit 18, INSTAT-i do të vijojë organizimin e takimeve periodike të GNPIE-së për këtë kapitull sipas metodologjisë përkatëse, duke përdorur edhe instrumente si platforma *online* e integrimit evropian PIEA, e cila do të furnizohet nga kontributi i anëtarëve të GNPIE-së si pasqyrë zyrtare e zhvillimeve të kapitullit 18 "Statistikat".

Mbështetur në VKM-në nr. 749, datë 19.12.2018, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse, për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian" dhe në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 113, datë 30.8.2019, "Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të platformës së partneritetit për integrimin evropian", INSTAT-i do të vijojë takimet në kuadër të procesit të integrimit evropian me përfaqësues të shoqërisë civile, botës akademike dhe shoqatave të biznesit.

Nga ana tjetër, gjatë vitit 2025, INSTAT-i do të vijojë kontributin në takimet e nivelit të lartë të organizuar nga Eurostati me vendet e Ballkanit Perëndimor, të Evropës Lindore, si dhe Sistemit Statistikor Evropian. INSTAT-i përfaqëson Shqipërinë në Grupin e Nivelit të Lartë për Partneritet, Koordinim dhe Zhvillim e Kapacitete, të Kombeve të Bashkuara, dhe merr pjesë duke kontribuar në forume botërore të organizuara nga Kombet e Bashkuara, si dhe jep kontribut si në Byronë e Konferencës së Statisticienëve Evropianë të UNECE, për vitet 2023–2025, si anëtar.

**Bashkëpunimet ndërkombëtare**

Prodhuesit e statistikave zyrtare në vend kanë bashkëpunim të ngushtë me institucionet homologe të vendeve të zhvilluara dhe janë të përfshirë në aktivitetet që zhvillojnë organizatat ndërkombëtare, si Eurostati dhe Kombet e Bashkuara, për modernizimin e prodhimit statistikor.

Bashkëpunimi statistikor me Eurostatin synon jo vetëm forcimin e Sistemit Kombëtar Statistikor, duke përshtatur metodologjitë dhe praktikat më të mira të prodhimit statistikor, por edhe në drejtim të forcimit të kuadrit ligjor në përputhje me *acquis*, si dhe rritjes së kapaciteteve profesionale të statisticienëve.

Nëpërmjet projekteve mbështetëse të financuara nga fondet e Bashkimit Evropian përmes instrumenteve të tilla, si IPA kombëtare dhe me shumëpërfitues, është arritur të ndërtohen metodologji dhe nivele komunikimi të cilat kanë mundësuar prodhimin e statistikave moderne dhe të krahasueshme. Gjithashtu, vende të ndryshme evropiane kontribuojnë me programet e tyre qeveritare për vendin tonë në fushën e përmirësimit të statistikave të nivelit vendor, infrastrukturën teknologjisë së informacionit, ndërtimit të regjistrave etj.

**“Programi i bashkëpunimit statistikor me instrumentin shumëpërfitues – IPA 2022”**

Në muajin janar të vitit 2024 filloi zbatimi i programit IPA shumëpërfitues 2022, i cili do të vijojë deri në muajin dhjetor të vitit 2027. Mbështetja fokusohet në 15 fusha statistikore, në një prej të cilave përfitues është Banka e Shqipërisë. Mbështetja do të ofrohet përkatësisht për statistikat e financiare të qeverisë dhe defiçitit të tejkaluar, indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumatorit (HICP) dhe indeksi i çmimeve të banesave (HPI); barazitë e fuqisë blerëse (PPP), statistikat afatshkurtra të biznesit, statistikat e transportit, statistikat strukturore të biznesit, vrojtimin e forcës së punës, vrojtimin e të ardhurave dhe nivelit të jetesës, sistemi i integruar evropian për mbrojtjen sociale, llogaritë ekonomike në mjedis, statistikat e ujit, menaxhimi i cilësisë, zhvillimi i qëndrueshëm, statistikat e qytetit/informacioni gjeografik, si dhe investimet e huaja direkte (përfitues i të cilës është Banka e Shqipërisë). Mbështetja fokusohet në cilësinë e prodhimit të statistikave dhe transmetimit të të dhënave, sigurimin e ekspertizës, si rritje të kapaciteteve të stafit të INSTAT-it të përfshirë në projektet statistikore.

**“Financimi i drejtpërdrejtë për mbështetjen e INSTAT-it në kryerjen e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2022” SIDA (Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar):**

Nëpërmjet kontributit të Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar, për vitin 2025 synohet mbështetje për realizimin e analizave të thelluara bazuar në rezultatet e Censit, si dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës *backup* të Censit. Projekti parashikohet të përfundojë brenda muajit qershor të vitit 2025.

**“Statistika të forta vendore shqiptare” – SALSTAT II**

Zyra e Bashkëpunimit Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në bashkëpunim me Zyrën Federale të Statistikave (FSO) mbështet prej vitesh INSTAT-in nëpërmjet projektit SALSTAT, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve të stafit të bashkive mbi njohuritë në statistikat zyrtare dhe të Sistemit Kombëtar Statistikor. Ky projekt ka kontribuar, gjithashtu, në sigurimin e një pjesë të pajisjeve kompjuterike për Censin. Projekti është në fazën e dytë të zbatimit për periudhën 2022–2026 dhe ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve për stafin e bashkive, zyrave rajonale dhe të përfaqësuesve të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore me qëllim krijimin e njësive statistikore në nivel bashkie. Gjithashtu, nëpërmjet këtij projekti synohet krijimi i një regjistri statistikor të ndërtesave dhe banesave, dhe të një regjistri statistikor të popullsisë rezidente, i cili do të jetë burimi i statistikave vjetore të popullsisë dhe banesave në të ardhmen.

**“Asistencë teknike për realizimin e Censit të Bujqësisë” – Fondi për lehtësimin e integrimit në BE – IPA 2014-2020**

Bashkimi Evropian përmes përdorimit të fondit për lehtësimin e integrimit në BE, IPA II, ka ofruar mbështetje për zbatimin e disa aktiviteteve operacionale të Censit të Bujqësisë përmes asistencës teknike në komponentët e metodologjisë të Censit dhe infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, për një periudhë 18-mujore, e cila përfshin dhe gjysmën e parë të vitit 2025.

Gjatë vitit 2025, INSTAT-i synon të fillojë procesin e anëtarësimit në platformën **SDDS (*Special Data Dissemination Standard*)**, të Fondit Monetar Ndërkombëtar. Kalimi i Shqipërisë nga *Enhanced General Data Dissemination System* (e-GDDS) në standardin e shpërndarjes së të dhënave (SDDS), është një dëshmi e fortë e angazhimit të Sistemit Kombëtar Statistikor, për transparencën e të dhënave.

Anëtarësimi në SDDS pritet të përmirësojë përpilimin dhe shpërndarjen e të dhënave, të lehtësojë procesin e krijimit të politikave

makroekonomike, të ndihmojë në rritjen e besimit të investitorëve në kapacitetin institucional të vendit dhe të kontribuojë në stabilitetin ekonomik dhe financiar.

**VII. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG)**

INSTAT-i, prej disa vitesh ka tashmë në planin e punës, zbatimin e Agjendës 2030 për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, pasi statistikat janë instrumenti i zgjedhur për të vendosur bazën për monitorimin e zbatimit të këtyre qëllimeve në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Në sesionin e dyzet e gjashtë, të Komisionit Statistikor të Kombeve të Bashkuara, u dakordësua krijimi i grupit të nivelit të lartë për partneritetin, koordinimin dhe ngritjen e kapaciteteve për Agjendën e vitit 2030 (HLG-PCCB), i përbërë nga kryestatisticienë nga 22 zyra statistikore kombëtare që përfaqësojnë vendet e tjera në rajonet e tyre përkatëse. Ky grup kishte për detyrë të nxiste nacionalizimin e sistemit të monitorimit të Agjendës 2030 dhe nxitjen e ngritjes së kapaciteteve statistikore, partneritete dhe koordinim, ku theksohej se zyra statistikore duhet të koordinojnë zbatimin e agjendës në nivel vendi. Për të siguruar këtë gjë HLG-PCCB ka përgatitur këtë plan veprimi, Plani Global i Veprimit i *Cape Town* (CTGAP) i cili tashmë po rishikohet nga ky grup në të cilin anëtar dhe bashkëdrejtues është INSTAT-i.

INSTAT-i deri më tani ka prodhuar 66 indikatorë statistikorë, të cilët përditësohen në platformën për OZHQ-të, në faqen zyrtare të INSTAT-it: http://instat.gov.al/al/sdgs/. Viti 2025, do të jetë viti i prodhimit të numrit më të lartë të indikatorëve bazuar në të dhënat e Censit të Popullsisë dhe Banesave, dhe vrojtimeve të tjera të kryera gjatë vitit 2024.

Gjithashtu, INSTAT-i, gjatë periudhës 2024–2027, ka në zbatim një projekt statistikor për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), pjesë e programit IPA 2022 shumëpërfitues, i cili do të ketë në fokus përmirësimin e dashbordit për OZHQ-të, paraqitjen në mënyrë sa më të kuptueshme të indikatorëve dhe komunikimin e tyre te përdoruesit.

**VIII. Burimet financiare dhe njerëzore**

Për zbatimin e Planit Vjetor 2025 është parashikuar buxheti i INSTAT-it dhe stafi shtesë i nevojshëm për realizimin apo përmirësimin e aktiviteteve statistikore. Sipas udhëzimit plotësues nr. 9, datë 10.7.2024, *"Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025–2027"* është bërë shpërndarja e tavaneve buxhetore për institucionet, ku për Institutin e Statistikave, tavani buxhetor për vitin 2025 rezulton të jetë si në tabelën e mëposhtme:

*Tabela nr. 25: Parashikimi i buxhetit të INSTAT-it për çdo fushë statistikore, si dhe për zëra të tjerë*

| Produkti | | Viti 2025 000/lekë |
|---|---|---|
| 1 | Njësi statistikore për tu vrojtuar | 364,328 |
| a. | Statistikat Sociale dhe Demografike | 190,254 |
| b. | Statistikat Ekonomike | 86,356 |
| c. | Statistikat Sektoriale | 39,330 |
| d. | Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain | 3,085 |
| e. | Shërbime për të tretë (B.SH) | 45,303 |
| 2 | Personel i trajnuar | 491,372 |
| 3 | Blerje paisje, sisteme, makineri të ndryshme | 6,400 |
| 4 | Financim i huaj | 100,000 |
| | **Gjithsej** | **962,100** |

*Shënim. Buxheti sipas tavaneve buxhetore faza II (PBA 2025–2027)

Paraqitja e zërave financiarë sipas përqindjes që zënë në buxhetin total rezulton të jetë si në grafikun e mëposhtëm:




Për sa i përket burimeve njerëzore, stafi i angazhuar për realizimin e Planit të PSZ 2025 është stafi i INSTAT-it, 20 punonjës nga Banka e Shqipërisë, 19 punonjës nga Ministria e Financave, 4 punonjës nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

Sipas parashikimeve të Programit të Statistikave Zyrtare 2022–2026, referuar tabelës nr. 17, "Nevojat për staf shtesë 2022–2026", shtesa e parashikuar për vitin 2025 është 12 punonjës për INSTAT-in dhe 2 punonjës për Bankën e Shqipërisë. Gjithashtu, që prej vitit 2023 referuar këtij programi, INSTAT-i ka identifikuar nevojën për 18 punonjës shtesë për INSTAT-in, të cilët janë përfshirë në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) të viteve 2023–2025, 2024–2026, por që nuk janë miratuar në asnjë nga të dy PBA-të. Si pasojë, numri shtesë prej 18 punonjësish është paraqitur edhe në kërkesat shtesë të PBA 2025–2027, por që ende nuk kemi një përgjigje për miratim ose jo.

Për vitin 2025, INSTAT-i kërkon që të adresohet ky numër, i cili është në përputhje me programin e miratuar të statistikave zyrtare, duke përfshirë jo vetëm kërkesën për 12 punonjës të rinj për vitin 2025 sipas këtij plani, por edhe numrin e pozicioneve të parashikuara më herët prej 18 punonjësish. Në total, sipas parashikimeve në Programin e Statistikave Zyrtare, si dhe për të mbuluar kërkesat në rritje për të dhëna, numri i kërkuar i punonjësve për vitin 2025 është 30 punonjës.

Kjo kërkesë për punonjës është thelbësore për të përballuar ngarkesën e punës dhe për të përmirësuar kapacitetet e prodhimit të statistikave, duke përfshirë zhvillimin e metodologjive dhe teknologjive të reja statistikore.

Për ngritjen e kapaciteteve dhe nivelit profesional të stafit të agjencive statistikore, gjatë vitit 2025 INSTAT-i planifikon të zhvillojë një sërë trajnimesh dedikuar prodhimit statistikor, cilësisë statistikore, metodave dhe sistemeve IT për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave, komunikimit dhe shpërndarjes së informacionit etj. Njohuritë e marra në këto trajnime do t'i shërbejnë rritjes së vazhdueshme të performancës në procesin e prodhimit statistikor në funksion të prodhimit në kohë dhe me cilësi të statistikave zyrtare.

**IX. Analiza SWOT**

Analiza *SWOT* (pikat e forta, të dobëta, mundësitë dhe kërcënimet) është një kornizë e përdorur për të vlerësuar pozicionin e institucioneve prodhuese të statistikave zyrtare dhe për të zhvilluar programin nga ana strategjike. Analiza vlerëson faktorët e brendshëm dhe të jashtëm, si dhe potencialin aktual dhe të ardhshëm. Ky instrument është krijuar për të lehtësuar vështrimin realist, të bazuar në fakte, të drejtuar nga të dhënat në pikat e forta dhe të dobëta të Sistemit Kombëtar Statistikor dhe institucioneve mbështetëse.

Analiza SWOT përfshin klimën në të cilën funksionon Sistemi Kombëtar Statistikor, duke vënë në qendër INSTAT-in, si institucioni përgjegjës për

koordinimin dhe monitorimin e ecurisë dhe performancës së këtij sistemi. Duke marrë parasysh kuadrin ligjor, ambientin dhe kulturën statistikore të institucioneve prodhuese dhe atyre furnizuese me të dhëna administrative, INSTAT-i ka vlerësuar kapacitetin, mekanizmat dhe burimet e nevojshme për të garantuar zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve të parashikuara në program.

Një ndihmë të madhe për analizën kanë dhënë dhe japin raportet periodike të vlerësimit, të hartuara nga ekspertët e Eurostatit (*Peer Reviews*), përfshirja e statisticienëve në forumet ndërkombëtare dhe asistenca e huaj për aktivitete të veçanta statistikore.

Në këtë këndvështrim, analiza SWOT hartohet si vijon:

PIKAT E FORTA

- **Legjislacion i përafruar**. Ligji nr. 17/2018, "Për statistikat zyrtare" është përafruar me rregulloren (BE) 223/2009, "Për statistikat Evropiane", e ndryshuar, në interes të formalizimit të Sistemit Kombëtar Statistikor, rolit aktiv të përdoruesve dhe ndërtimit të instrumenteve monitoruese/raportuese. Kjo kornizë mundëson zbatimin e parimeve themelore të statistikave zyrtare, duke garantuar besueshmërinë dhe konfidencialitetin statistikor.

- **Mandat i konsoliduar për aksesin në të dhëna.** Legjislacioni për statistikat zyrtare ngarkon çdo institucion publik, mbajtës i të dhënave administrative, të furnizojë prodhuesit e statistikave zyrtare me informacionin e duhur vetëm për qëllime statistikore.

- **Komunikim i formalizuar me aktorët.** Gjatë vitit të fundit, INSTAT-i ka intensifikuar format e komunikimit me institucionet që furnizojnë prodhuesit statistikorë me të dhëna administrative. Gjithashtu, marrëdhënia ndërmjet prodhuesve të statistikave zyrtare është formalizuar nëpërmjet krijimit të Komitetit të Prodhuesve Statistikorë, instrument i cili siguron një koordinim më të mirë në aspektin e planifikimit dhe shpërndarjes.

- **Punonjës të kualifikuar, të njohur për profesionalizmin dhe eksperiencën.** Personeli i sistemit statistikor, veçanërisht i INSTAT-it, gëzon kapacitetet profesionale jo vetëm në fushat statistikore, por edhe në ato mbështetëse, si teknologji informacioni dhe administrative.

- **Infrastrukturë trajnimi.** Qendra e Trajnimit Statistikor, sipas kërkesave të ligjit për statistikat zyrtare, ka mundësuar përgatitjen e trajnerëve dhe moduleve më të rëndësishme për të rritur kapacitetet profesionale të statisticienëve. Trajnimet ofrojnë njohuri mbi harmonizimin dhe standardet e akteve ndërkombëtare, njohuri teknike për disa fusha statistikore dhe njohuri themelore në aspektin menaxherial/lidership.

- **Mbështetje ndërkombëtare.** Sistemi Kombëtar Statistikor mbështetet nga programet e Bashkimit Evropian dhe të disa vendeve anëtare për kryerjen e suksesshme të aktiviteteve statistikore, si dhe modernizimin e fazave të ndryshme të procesimit. Njëkohësisht, mbështetja ka ndihmuar në proceset e vlerësimit të performancës për të evidentuar pikat që kanë nevojë për ndërhyrje përmirësuese në të ardhmen.

- **Marrëdhënie ndërkombëtare.** Prodhuesit e statistikave zyrtare janë në gjendje të bashkëpunojnë me partnerët e huaj për projekte të ndryshme rajonale dhe më gjerë, si dhe të kontribuojnë në nxjerrjen e udhëzimeve përmirësuese për prodhim statistikor. Nga ana tjetër, bashkëpunimet kanë ndikuar në rritjen e njohurive nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave.

- **Infrastrukturë moderne e teknologjisë së informacionit.** Me mbështetjen e donatorëve dhe partnerëve është mundësuar ndërtimi i sistemeve IT në përputhje me kërkesat e kohës, si dhe rritja e kapaciteteve profesionale të stafit IT. Aftësia e stafit IT dhe monitorimi i vazhdueshëm i përparimeve teknologjike mundësojnë vendosjen në të njëjtin nivel me më të përparuarit.

- **Konfidencialiteti i të dhënave.** Për të rritur besueshmërinë e individëve, INSTAT-i dhe prodhuesit e tjerë të statistikave zyrtare kanë ndërtuar infrastrukturën e duhur ligjore dhe teknike për të garantuar trajtimin e të dhënave të tyre si konfidenciale dhe në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

- **Cilësia statistikore.** Përdorimi i instrumenteve GSBPM, Metadata, SIMS dhe raportet e cilësisë, shërbejnë jo vetëm për përmirësimin e cilësisë së aktiviteteve statistikore, por edhe për rritjen e transparencës së prodhuesve në lidhje me publikun.

- **Plani i vazhdimësisë.** Për arsye të eksperiencës negative të shkaktuar nga shkaqet madhore, tërmetet dhe pandemia, INSTAT-i ka hartuar Planin e Vazhdimësisë për reagimin e institucionit në rast të ndeshjes së pengesave të tilla në të ardhmen.

- **Këshilli i Statistikave si zëri i përdoruesve.** Përdoruesit e statistikave zyrtare janë klienti i produkteve statistikore. Këshilli i Statistikave përbëhet nga përfaqësues të përdoruesve kryesorë në vend. Zëri i tyre ndihmon në proceset e planifikimit statistikor dhe monitorimit të performancës së sistemit.

-**Mbështetje e qeverisë mbi besueshmërinë në të dhënat statistikore zyrtare.** Këshilli i Ministrave, nëpërmjet VKM-së nr. 650, datë 10.11.2017, ka shprehur angazhimin e tij për të respektuar kërkesat e standardeve evropiane dhe parimet statistikore, ka garantuar ruajtjen e pavarësisë profesionale të INSTAT-it dhe alokimin e burimeve të nevojshme financiare dhe njerëzore për kryerjen e aktiviteteve statistikore të programit.

PIKAT E DOBËTA

- **Burime të pamjaftueshme.** Burime të pamjaftueshme njerëzore nuk mundësojnë përmbushjen e kërkesave në rritje për statistika zyrtare.

- **Auditi statistikor.** INSTAT-i, nën cilësinë e institucionit përgjegjës për të garantuar zbatueshmërinë e parimeve statistikore, nuk zotëron kontroll të mjaftueshëm mbi cilësinë e të dhënave të ofruara nga institucionet publike dhe prodhuesit e tjerë të statistikave zyrtare, kryesisht mbi saktësinë, përpikmërinë, afatin kohor etj.

- **Edukimi statistikor.** Mangësitë në njohuritë statistikore ndikojnë negativisht në interpretimin e drejtë të treguesve statistikorë nga grupet e interesit, siç janë përdoruesit dhe media. Për këtë, trajnimi i vazhdueshëm i përdoruesve për fusha të ndryshme të statistikës do të ndikonte në rritjen e shkallës së interpretimit dhe analizave të informacionit statistikor.

- **Shpërndarja e informacionit statistikor.** Shpërndarja e informacionit statistikor, në kohë dhe formate të aksesueshme për përdoruesit duhet të jetë prioritet i INSTAT-it, duke përafruar të dhënat e publikuara në kalendar me ato të standardeve ndërkombëtare.

MUNDËSITË

- **Integrimi evropian.** Hapja e negociatave për anëtarësim në BE rrit nevojën për më shumë statistika reale dhe të besueshme. Partneriteti midis INSTAT-it dhe Eurostatit në këtë drejtim, krijon dhe premton mundësi për shkëmbime frytdhënëse të eksperiencave më të mira. Procesi i integrimit ndihmon, gjithashtu, personelin të rrisë shkallën e ndërgjegjësimit drejt standardeve evropiane. Nga ana tjetër, përafrimi me *acquis communautaire* ndikon në forcimin e legjislacionit të statistikave zyrtare dhe konsolidimin e Sistemit Kombëtar Statistikor.

- **Modernizimi i teknologjisë.** Përparimet në teknologjitë e informacionit sjellin përmirësime në sistemet e komunikimit midis INSTAT-it, furnizuesve me të dhëna administrative dhe përdoruesit.

- **Procesi zhvillimor për cilësinë statistikore**. Përmirësimet në aspektin e cilësisë së statistikave që prodhon sistemi, ndikojnë në zbatimin e parimeve statistikore, si dhe transparencën e besueshmërinë e publikut në to.

- **Përmbushje e kërkesave.** Statistikat zyrtare të prodhuara do të mbështesin politikbërësit për hartimin e dokumenteve strategjike, politikave makroekonomike dhe sociale si në nivel kombëtar ashtu edhe rajonal.

- **Rritja e pagave.** Rritja e pagave ndikon në rritjen e kënaqësisë së punonjësve, duke sjellë rritje të motivimit dhe performancës në punë. Gjithashtu, në nivel institucional ky instrument krijon mundësi që të reduktohen largimet duke sjellë si pasojë stabilitet në lëvizjet e punonjësve.

KËRCËNIMET

- **Moszbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga ky program** nga të gjithë aktorët, si: mosrespektimi i afateve kohore për dërgimin e të dhënave dhe informacioni jo i plotë nga njësitë statistikore dhe siguruesit e të dhënave administrative, do të sillte vonesë në zbatimin e aktiviteteve statistikore sipas afateve të parashikuara dhe mangësi në sasinë dhe cilësinë e treguesve.

- **Mungesa e strukturave statistikore,** si dhe rishikimi i herëpashershëm i strukturës organizative në ministritë e linjës dhe institucionet e tjera që sigurojnë të dhënat administrative, rrezikon zbatimin cilësor të këtij programi.

- **Mungesa e burimeve financiare dhe njerëzore** mund të rrezikojë moskryerjen e vrojtimeve të parashikuara në këtë program.

- **Mospërdorimi i klasifikimeve të njëjta në të gjitha institucionet**. Nëse nuk do të arrihet përdorimi i klasifikimeve të parashikuara të implementohen gjatë zbatimit të këtij programi, atëherë kjo do të sillte mospërputhshmërinë e të dhënave për të njëjtët tregues.

- **Sulmet kibernetike:** Siguria e të dhënave në kohën e sotme nuk është një detyrë e lehtë, në një

mjedis ku sistemet e TI-së janë subjekt ndaj sulmeve kibernetike, hakerimeve dhe shumë kërcënimeve të tjera që mjediset e informacionit të digjitalizuar i ekspozohen, pavarësisht vendndodhjes apo mënyrës së lidhjes të përdorur.

- **Mospërafrimi i akteve me *acquis communitaire*** cenon mosrealizimin e programit sipas standardeve evropiane, duke penguar/vonuar procesin e integrimit në fushën e statistikave.

- **Forcat madhore.** Nga eksperienca e viteve të fundit, fenomene të tilla si tërmetet dhe pandemitë mund të ndikojnë drejtpërdrejtë në vazhdueshmërinë e proceseve statistikore, si dhe të kenë impakt në nivelet buxhetore.

**X. Analiza e risqeve dhe problemet e pritshme për kryerjen e aktiviteteve**

Secili aktivitet statistikor i parashikuar në Programin Vjetor 2025 dhe pasqyruar në aneksin e këtij plani, shoqërohet edhe me problematikat dhe nivelin e risqeve të mundshme që mund të ndikojnë në performancën e aktiviteteve. Në vështrimin e përgjithshëm të aneksit, konstatohet se ka një ngjashmëri në tematikat e risqeve të aktiviteteve, pavarësisht fushës apo temës në të cilën ata parashikohen kryesisht në vonesat në sigurimin e të dhënave, mospërmbushjen e kritereve të cilësisë, si: saktësia, përpikmëria dhe krahasueshmëria, për të dhënat administrative/vrojtimet statistikore, transmetimin e të dhënave, nivelin profesional, burimet financiare dhe njerëzore për kryerjen e aktiviteteve dhe lëvizjet e stafit.

Ndër risqet e analizuara është dhe pezullimi/vonesa e mbledhjes, prodhimit dhe shpërndarjes së statistikave zyrtare si pasojë e fatkeqësive natyrore, pandemive globale apo sulmeve kibernetike, të cilat paraqesin kërcënime të mëdha për sigurinë e sistemeve të TI-së. Në një mjedis ku sistemet digjitale janë gjithnjë e më të ekspozuara ndaj hakerimeve dhe sulmeve të tjera të sofistikuara, ruajtja e sigurisë së të dhënave bëhet një risk i vazhdueshëm, pavarësisht vendndodhjes apo mënyrës së lidhjes së përdorur.

*Tabela nr. 26: Risqet dhe nivelet e tyre për secilën fushë statistikore*

| Fusha statistikore | Risku | Niveli i riskut: 1-3 i ulët,4-6 i mesëm, 7-9 i lartë |
|---|---|---|
| 1 "Statistikat Demografike dhe Sociale" | Pezullimi/vonesa e mbledhjes, prodhimit dhe shpërndarjes të statistikave zyrtare si pasojë e Fatkeqësive natyrore/ Pandemi Globale | 6 |
| | Vonesa në procesin e grumbullimit të të dhënave nga burimet administrative si dhe nga Vrojtimin e Forcave të Punës për vlerësimin e migracionit | 3 |
| | Mospërmbushja e kritereve të cilësisë si: saktësia, përpikmëria dhe krahasueshmëria, për të dhënat administrative/vrojtimet statistikore | 6 |
| 2 "Statistikat Ekonomike" | Pezullimi/vonesa e mbledhjes, prodhimit dhe shpërndarjes të statistikave zyrtare si pasojë e Fatkeqësive natyrore / Pandemi Globale | 6 |
| | Pezullimi/vonesa e prodhimit dhe shpërndarjes të statistikave zyrtare si pasojë e largimit të stafit | 6 |
| | Ndryshim i bazës ligjore të burimit administrativ | 5 |
| | Procesimi elektronik jo i saktë nga SIFQ për konsolidimin e të dhënave dhe gjenerimin e raporteve financiare | 9 |
| 3 "Statistikat Sektoriale" | Pezullimi/vonesa e mbledhjes, prodhimit dhe shpërndarjes të statistikave zyrtare si pasojë e Fatkeqësive natyrore / Pandemi Globale | 4 |
| | Vonesa të tjera në procesin e grumbullimit, kontrollit dhe hedhjes së të dhënave | 4 |
| | Mospërmbushja e kritereve të cilësisë si: saktësia, përpikmëria dhe krahasueshmëria, për vrojtimet statistikore dhe për të dhënat administrative | 4 |
| | Gabime të bëra nga stafi ekspert gjatë përpunimit dhe nxjerrjes së rezultateve. | 3 |
| | Mospajisja e sistemeve të mbledhjes së të dhënave me gjithe funksionet e nevojshme | 3 |
| | Probleme me sistemin CAPI gjatë mbledhjes së të dhënave | 4 |
| | Mungesa e stafit përgjegjës në agjencitë e tjera statistikore | 3 |
| 4 "Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain | Pezullimi/vonesa e mbledhjes, prodhimit dhe shpërndarjes të statistikave zyrtare si pasojë e Fatkeqësive natyrore / Pandemi Globale | 4 |
| | Vonesa të tjera në procesin e grumbullimit, kontrrollit dhe hedhjes së të dhënave | 4 |
| | Mospërmbushja e kritereve të cilësisë si: saktësia, përpikmëria dhe krahasueshmëria, për vrojtimet statistikore | 4 |
| Te tjera | Sulmet kibernetike | 7 |
| | Lëvizja e stafit | 5 |

Për reduktimin e risqeve, INSTAT-i ka ndërmarrë një sërë iniciativash, të cilat kanë të bëjnë me formalizimin e veprimtarive të planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe raportimit të aktiviteteve statistikore. Për të përmirësuar sigurinë ndaj sulmeve kibernetike, INSTAT-i ka implementuar masa specifike mbrojtëse, duke përfshirë ngritjen e infrastrukturave të avancuara të sigurisë kibernetike, përditësimin e vazhdueshëm të protokolleve të sigurisë, zbatimin e sistemeve të monitorimit për zbulimin e hershëm të kërcënimeve dhe trajnimin periodik të stafit për mbrojtjen e të dhënave.

Gjithashtu, për të reduktuar vonesat në transmetimin e informacionit, si dhe për të përmirësuar cilësinë e të dhënave administrative që sigurohen nga institucionet prodhuese, gjatë vitit 2025, INSTAT-i ka negociuar me institucionet publike marrëveshje mirëkuptimi, duke përcaktuar detyra dhe përgjegjësi të qarta ndërinstitucionale, ngritje grupesh pune dhe përcaktimin e formave dhe afateve të transmetimit të të dhënave të nevojshme. Ndikim të drejtpërdrejtë në reduktimin e risqeve kanë edhe aktivitetet zbatuese për arritjen e objektivave strategjikë të zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor, të reflektuara në seksionin II të këtij dokumenti.

**XI. Notë shpjeguese për përdorimin e aneksit**

Aneksi i Planit Vjetor 2025 është hartuar sipas klasifikimit të përcaktuar në shtojcën 1, të ligjit të statistikave zyrtare (fushë/temë/nëntemë) duke ndjekur përmbajtjen e Programit të Statistikave Zyrtare 2022–2026 për çdo modul. Përputhja e moduleve me temën është në linjë me klasifikimin statistikor të Kompendium 2024 të Eurostatit. Çdo aktivitet statistikor i parashikuar për një temë të caktuar, shoqërohet me kolona të cilat tregojnë:

- Kodi i aktivitetit;
- Emërtimi i aktivitetit;
- Lloji i aktivitetit.

Përqindja e të dhënave nga burimi administrativ/vrojtimi:

- Periodiciteti;
- Treguesit statistikorë;
- Afati i grumbullimit të të dhënave;
- Afati i përpunimit të të dhënave
- Afati i publikimit të rezultateve;
- Institucionet përgjegjëse për furnizimin me të dhëna;
- Institucioni përgjegjës për aktivitetin;
- Risku i pritshëm;
- Niveli i riskut;
- Burimi financiar për mbulimin e aktivitetit.

Shkurtimet “D”, “M”, “T” dhe “V” kanë kuptimin përkatësisht:

*D* – ditë;

*M* – muaj;

*T* – tremujor;

*V* – vit.

*Periudhë reference* do të thotë periudha së cilës i referohen të dhënat e grumbulluara apo rezultatet e publikuara.

**Shembull I: 1.1.1.1 Statistikat e popullsisë**

Në kolonën “Afati i grumbullimit të të dhënave” rezulton “V+90 D”. Kjo do të thotë se grumbullimi i të dhënave mbyllet 92 ditë pas përfundimit të vitit referencë.

P.sh. Për vitin referencë 2024, afati i grumbullimit të të dhënave është data 1 prill 2025.

Në kolonën “Afati i përpunimit të të dhënave” rezulton “V+136 D”. Kjo do të thotë që të dhënat përpunohen brenda datës 16 maj 2025.

Në kolonën “Afati i publikimit të rezultateve” rezulton “V+152 D”. Kjo do të thotë se rezultatet do të publikohen 152 ditë pas mbylljes së vitit referencë. Nëse viti referencë është 2024, atëherë publikimi i rezultateve do të jetë brenda datës 2 maj 2025.

**Shembull III: 1.4.2.1 Statistikat e shëndetit dhe sigurisë në punë**

Në kolonën “Afati i grumbullimit” rezulton “Dita e 180 e V”. Kjo do të thotë që të dhënat grumbullohen brenda vitit referencë, përkatësisht në ditën e 180 të tij, brenda datës 30 qershor të vitit referencë.

**XII. Aneksi**

Aktivitetet statistikore për vitin 2025

<table>
<tr><th>Kodi i fushës statistikore</th><th>Fusha statistikore</th><th>Kodi i temës</th><th>Tema</th><th>Kodi i nëntemës</th><th>Nëntema</th><th>Kodi i aktivitetit statistikor</th><th>Aktiviteti</th><th>Lloji i aktivitetit</th><th>% nga burimi administrativ</th><th>% nga vrojtimi</th><th>Tipi i aktivitetit</th><th>Periodiciteti i aktivitetit</th><th>Treguesit statistikorë</th><th>Institucioni përgjegjës për furnizimin me të dhëna</th><th>Institucioni përgjegjës për prodhimin e të dhënave</th><th>Afati i grumbullimit të dhënave</th><th>Afati i përpunimit të të dhënave</th><th>Afati i publikimit të të dhënave</th><th>Risku dhe nivelet</th><th>Burimet financiare</th></tr>
<tr><td>1</td><td colspan="20">Statistikat sociale dhe demografike</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td>1.1</td><td colspan="18">Popullsia me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri dhe jashtë saj</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td></td><td>1.1.1</td><td colspan="16">Demografi, migracion dhe projeksione</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td>1.1.1.1</td><td>Statistikat e POPULLSISË</td><td>Kombinim i burimeve administrative dhe vrojtimeve</td><td>60%</td><td>40%</td><td>I vazhdueshëm</td><td>Vjetor</td><td>1. Dendësia e popullsisë sipas qarkut.<br>2. Fëmijë, adoleshentë dhe të rinj në raport me popullsinë e përgjithshme.<br>3. Koeficienti i rritjes së popullsisë sipas qarkut.<br>4. Mosha mediane e popullsisë sipas qarkut dhe gjinisë.<br>5. Piramida e popullsisë më 1 janar sipas grup-moshës dhe gjinisë.<br>6. Popullsia me 1 janar sipas grup-moshës dhe gjinisë.<br>7. Popullsia më 1 janar sipas grup-moshës, rajonit, qarkut dhe gjinisë.<br>8. Popullsia më 1 janar sipas moshës dhe gjinisë.<br>9. Popullsia më 1 janar sipas moshës, rajonit dhe gjinisë.<br>10. Popullsia më 1 janar sipas qarkut dhe gjinisë.<br>11. Popullsia mesatare sipas grup-moshës dhe gjinisë.<br>12. Popullsia mesatare sipas qarkut dhe gjinisë.<br>13. Raporti gjinor i popullsisë.<br>14. Raporti i varësisë gjithsej.<br>15. Raporti i varësisë së të moshuarve.<br>16. Raporti i varësisë së të rinjve.</td><td>Instituti i Statistikave; Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile</td><td>INSTAT-i</td><td>V + 90 D</td><td>V + 136 D</td><td>V + 152 D</td><td>1. Vonesa në procesin e grumbullimit të të dhënave nga burimet administrative, si dhe nga AFP-ja për vlerësimin e migracionit -|- 6<br>2. Mospërmbushja e kritereve të cilësisë, si: saktësia, përpikmëria dhe krahasueshmëria, për të dhënat administrative/vrojtimet statistikore -|- 6<br>3. Pezullimi/vonesa e mbledhjes, prodhimit dhe shpërndarjes së statistikave zyrtare si pasojë e fatkeqësive natyrore/ pandemi globale -|- 6</td><td>Buxhet shteti</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td>1.1.1.2</td><td>Projeksionet e popullsisë</td><td>Burim administrativ</td><td>100%</td><td></td><td>I vazhdueshëm</td><td>Çdo 5 vjet</td><td>1. Popullsia në seri kohore.<br>2. Popullsia sipas gjinisë.<br>3. Popullsia sipas moshës.<br>4. Popullsia sipas qarkut.<br>5. Piramida e popullsisë.<br>6. Koeficienti i varësisë.<br>7. Popullsia mbi moshën e punës.<br>8. Popullsia në moshë pune.<br>9. Popullsia nën moshën e punës.<br>10. Mosha mediane e popullsisë.<br>11. Projeksionet e popullsisë sipas skenarëve.</td><td>Instituti i Statistikave</td><td>INSTAT-i</td><td>V+180 D</td><td>V + 244 D</td><td>V + 305 D</td><td>1. Vonesa në procesin e grumbullimit dhe analizimit të të dhënave -|- 6<br>2. Mospërmbushja e kritereve të cilësisë, si: saktësia, përpikmëria dhe krahasueshmëria e të dhënave -|- 6</td><td>Buxhet shteti</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td>1.1.1.3</td><td>Statistikat e migracionit ndërkombëtar dhe lëvizjet e brendshme</td><td>Kombinim i burimeve administrative dhe vrojtimeve (derivuar nga LFS)</td><td>40%</td><td>60%</td><td>I vazhdueshëm</td><td>Vjetor</td><td>1. Arsyet e emigrimit.<br>2. Emigracioni sipas gjinisë dhe moshës.<br>3. Koeficienti bruto i emigrantëve.<br>4. Koeficienti bruto i imigrantëve.<br>5. Koeficienti bruto i migracionit të brendshëm neto sipas qarkut.<br>6. Lëvizjet e brendshme të popullsisë sipas qarkut.<br>7. Migracioni i brendshëm sipas grup-moshës dhe gjinisë.<br>8. Migracioni neto.<br>9. Numri i emigrantëve.<br>10. Numri i imigrantëve.<br>11. Piramida e lëvizjeve të brendshme sipas grup-moshës dhe gjinisë.</td><td>Instituti i Statistikave Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile</td><td>INSTAT-i</td><td>V + 90 D</td><td>V + 136 D</td><td>V + 152 D</td><td>1. Vonesa në procesin e grumbullimit të të dhënave nga AFP-ja për vlerësimin e migracionit -|- 6<br>2. Mospërmbushja e kritereve të cilësisë, si: saktësia, përpikmëria dhe krahasueshmëria, për vrojtimet statistikore -|- 6</td><td>Buxhet shteti</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td>1.1.1.4</td><td>Statistikat e diasporës shqiptare</td><td>Kombinim i burimeve administrative dhe vrojtimeve</td><td>50%</td><td>50%</td><td>I vazhdueshëm</td><td>Çdo 5 vjet</td><td>1. Diaspora 1 janar.<br>2. Piramida e popullsisë banuese dhe popullsia e shtetasve shqiptar.<br>3. Piramida e diasporës.<br>4. Diaspora sipas shteteve të destinacionit.<br>5. Norma e rritjes vjetore të emigrantëve shqiptarë sipas destinacioneve kryesore.<br>6. Shqiptarët në Evropë.<br>7. Karakteristikat social-demografike.</td><td>Instituti i Statistikave</td><td>INSTAT-i</td><td>V + 212 D</td><td>V + 304 D</td><td>V + 335 D</td><td>1. Vonesa në procesin e grumbullimit dhe analizimit të të dhënave -|- 6<br>2. Mospërmbushja e kritereve të cilësisë, si: saktësia, përpikmëria dhe krahasueshmëria e të dhënave -|- 6</td><td>Buxhet shteti</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td>1.1.1.5</td><td>Statistikat e ngjarjeve jetësore</td><td>Burim administrativ</td><td>100%</td><td></td><td>I vazhdueshëm</td><td>Tremujor</td><td>1. Abortet e ndërprera ligjërisht sipas grup-moshës së nënës.<br>2. Divorcet gjithsej.<br>3. Divorcet me kërkesën e bashkëshortes/bashkëshortit.<br>4. Indeksi sintetik i fekonditetit sipas qarkut.<br>5. Jetëgjatësia e pritur në moshën 55 vjeç.<br>6. Jetëgjatësia e pritur në moshën 80 vjeç.<br>7. Jetëgjatësia në lindje sipas qarkut dhe gjinisë.<br>8. Jetëgjatësia në moshën 60 vjeç.<br>9. Jetëgjatësia sipas grup-moshës dhe gjinisë.<br>10. Koeficientët specifikë të fekonditetit sipas grup-moshës.<br>11. Koeficienti bruto i divorceve.<br>12. Koeficienti bruto i lindjeve sipas qarkut.<br>13. Koeficienti bruto i martesës sipas qarkut.<br>14. Koeficienti bruto i riprodhimit.</td><td>Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile</td><td>INSTAT-i</td><td>T + 15 D</td><td>T + 35 D</td><td>T + 45D</td><td>1. Vonesa në procesin e grumbullimit të të dhënave nga burimet administrative -|- 3<br>2. Mospërmbushja e kritereve të cilësisë, si: saktësia, përpikmëria dhe krahasueshmëria, për të dhënat administrative -|- 3<br>3. Pezullimi/vonesa e mbledhjes, prodhimit dhe shpërndarjes së statistikave zyrtare si pasojë e fatkeqësive natyrore/ pandemi globale -|- 3</td><td>Buxhet shteti</td></tr>
</table>

| | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | 15. Koeficienti bruto i vdekjeve sipas qarkut.<br>16. Koeficienti i divorceve për 100 martesa.<br>17. Koeficienti i lindshmërisë tek adoleshentët.<br>18. Koeficienti i shtesës natyrore.<br>19. Koeficienti neto i riprodhimit.<br>20. Lindjet e asistuara.<br>21. Lindjet e gjalla sipas muajit.<br>22. Lindjet e gjalla sipas peshës së lindjes dhe gjinisë.<br>23. Lindjet e gjalla sipas qarkut.<br>24. Lindjet e gjalla sipas qarkut, tregues tremujor.<br>25. Lindjet në adoleshencë.<br>26. Lindjet sipas bashkisë.<br>27. Lindjet sipas gjinisë.<br>28. Lindjet sipas grup-moshës së nënës.<br>29. Lindjet sipas grup-moshës së nënës, qarkut dhe rajonit.<br>30. Lindjet sipas llojit (binjak, trinjak etj.).<br>31. Lindjet sipas moshës së babait.<br>32. Lindjet sipas moshës së nënës, vitit të lindjes së nënës dhe gjinisë.<br>33. Lindjet sipas moshës së nënës, vitit të lindjes së nënës dhe radhës në lindje.<br>34. Lindjet sipas moshës së nënës, vitit të lindjes së nënës dhe rajonit të rezidencës së nënës.<br>35. Lindjet sipas radhës së lindjes së fëmijës dhe gjinisë.<br>36. Lindjet sipas viteve të martesës së nënës.<br>37. Martesat sipas bashkisë.<br>38. Martesat sipas gjinisë dhe grup-moshës.<br>39. Martesat sipas muajit.<br>40. Martesat sipas qarkut.<br>41. Martesat sipas shtetësisë së bashkëshortëve.<br>42. Mosha mesatare e martesës sipas qarkut dhe gjinisë.<br>43. Mosha mesatare e nënës në lindje sipas qarkut.<br>44. Raporti gjinor në lindje sipas qarkut.<br>45. Shtesa natyrore e popullsisë sipas qarkut dhe sipas bashkisë.<br>46. Tabelat e jetës.<br>47. Vdekjet e grupuara në ditë, nën 1 vjeç, sipas gjinisë.<br>48. Vdekjet fetale.<br>49. Vdekjet mbi 1 vjeç sipas qarkut dhe gjinisë.<br>50. Vdekjet nën 1 vjeç sipas qarkut dhe gjinisë.<br>51. Vdekjet sipas bashkisë.<br>52. Vdekjet sipas gjinisë.<br>53. Vdekjet sipas gjinisë, moshës, vitit të lindjes dhe shtetësisë.<br>54. Vdekjet sipas gjinisë, moshës, vitit të lindjes dhe statusit ligjor martesor.<br>55. Vdekjet sipas gjinisë, rajonit, moshës.<br>56. Vdekjet sipas gjinisë, rajonit, qarkut dhe grup-moshës.<br>57. Vdekjet sipas grup-moshës dhe gjinisë.<br>58. Vdekjet sipas muajit.<br>59. Vdekjet sipas qarkut.<br>60. Vdekjet sipas qarkut, tregues tremujor.<br>61. Vdekshmëria foshnjore.<br>62. Vdekshmëria nën 5 vjeç.<br>63. Vdekshmëria neonatale. | | | | | | | |
| 1.1.1.6 | Vrojtimi i Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë (MICS) | Vrojtim | | 100% | Tjetër | Aktiviteti nuk ka një periodicitet fiks. | *MICS - Temat bazë*<br>1. Tregues të përgjithshëm.<br>2. Vdekshmëria.<br>3. Lindshmëria dhe kujdesi i nënës.<br>4. Imunizimi, ushqyerja e fëmijëve dhe shëndeti i tyre.<br>5. Arsimi/edukimi.<br>6. Dhuna, fëmijët që punojnë, martesat e hershme.<br>7. Furnizimi me ujë dhe kanalizimet.<br><br>*MICS - Temat plotësuese:*<br>1. Pirja e duhanit, pasiguria për ushqimin, emergjenca.<br>2. Riprodhimi dhe planifikimi familjar.<br>3. Shëndeti, ushqyerja dhe zhvillimi i fëmijëve.<br>4. Mësimi dhe fitimi i aftësive për të ardhmen.<br>5. Mbrojtja nga dhuna dhe shfrytëzimi.<br>6. Mundësi të barabarta për jetën. | Instituti i Statistikave | INSTAT-i | I papërcaktuar | I papërcaktuar | I papërcaktuar | 1. Risku i realizmit ose jo të anketës në kohë;<br>2. Vonesa në procesin e grumbullimit dhe analizimit të të dhënave;<br>3. Mospërmbushja e kritereve të cilësisë, si: saktësia, përpikmëria dhe krahasueshmëria e të dhënave. | Buxhet shteti dhe donatorë |

| | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.1.2 | Censi i popullsisë dhe banesave, azilkërkuesit dhe të huajt | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | 1.1.2.1 | Aktivitetet në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave:<br>- Analizat tematike mbi fusha të ndryshme<br>- Mikrodata në dispozicion për përdoruesit e jashtëm | Vrojtim | | 100% | Tjetër | Çdo 10 vite | 1. Banesat e zakonshme/jo të zakonshme për banim (ose pjesërisht për banim) ose kolektive, sipas llojit dhe pronësisë.<br>2. Banesat sipas llojit të furnizimit me ujë, energji elektrik, ngrohje.<br>3. Banesat sipas sipërfaqes së përdorur për banimi.<br>4. Banesat sipas statusit të banuar/të pabanuar.<br>5. Llojet e pajisjeve shtëpiake të përdorura nga NjEF-të.<br>6. Ndërtesat për banim (ose pjesërisht për banim) sipas viti/periudhës së ndërtimit, materialit të ndërtimit.<br>7. NjEF-të private dhe kolektive sipas madhësisë (numri të anëtarëve për NjEF).<br>8. Numri i anëtarëve të mëparshëm të NjEF-ve (emigrantët) sipas llojit të NjEF-së, vitit dhe arsyes së largimit.<br>9. Numri i nënave sipas numrit të fëmijëve që kanë lindur gjallë, si dhe numri i fëmijëve që jetojnë.<br>10. Numri i NjEF-ve sipas llojit të tokës bujqësore që kanë në përdorim dhe sipërfaqet respektive.<br>11. Numri i NjEF-ve sipas numrit të blegtorisë/ shpendëve/koshereve të bletëve që disponojnë.<br>12. Popullsia banuese që ka jetuar ndonjëherë jashtë shtetit dhe është kthyer, sipas arsyes së kthimit.<br>13. Popullsia e personave të pastrehë.<br>14. Popullsia në nivel kombëtar, qarku, bashkie dhe njësie administrative, sipas gjinisë dhe moshës/grup-moshës.<br>15. Popullsia sipas identitetit etnik, besimit fetar, gjuhës.<br>16. Popullsia sipas nivelit arsimor zyrtar që ndjekin dhe/ose që kanë përfunduar.<br>17. Popullsia sipas shkallës ë vështirësive për aftësitë e kufizuara.<br>18. Popullsia sipas statusit të martesës dhe/ose bashkëjetesës.<br>19. Popullsia sipas statusit të punësimit, profesionit, orëve të punës, industrisë ku punojnë, vendndodhjes së punës, kohës së vajtjes në punë, llojit të transportit për të shkuar në punë.<br>20. Popullsia sipas vendbanimit të zakonshëm të NjEF-ve private në banesa të zakonshme ose jo të zakonshme, si dhe të NjEF-ve kolektive në banesa kolektive.<br>21. Popullsia sipas vendlindjes, shtetësisë dhe vendbanimit të zakonshëm. | Instituti i Statistikave | INSTAT-i | | Nëntor 2025 | 31 Dhjetor 2025 | 1. Sulmet kibernetike-\|- 7<br>2. Lëvizja e stafit -\|- 5 | Kombinuar (buxhet shteti + donatorët) |
| | | 1.1.2.2 | Statistikat e azilit dhe të huajve | | | | | | | | | | | | | |
| | | 3.7.1.2 | Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit | Vrojtim (Anketa e Çmimeve të Konsumit) | | 100% | I vazhdueshëm | Mujor | 1. Indeksi mujor i çmimeve të harmonizuar të konsumit.<br>2. Indeksi mesatar vjetor i çmimeve të harmonizuar të konsumit.<br>3. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të harmonizuar të konsumit.<br>4. Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të harmonizuar të konsumit.<br>5. Ndryshimi mesatar vjetor i Indeksit të çmimeve të harmonizuar të konsumit. | Instituti i Statistikave | INSTAT-i | Dita e 24-rt e M | M + 16D | M + 21D | 1. Mospërmbushja e kritereve të cilësisë, si: saktësia, përpikmëria dhe krahasueshmëria, për të dhënat administrative -\|- 1<br>2. Mospërmbushja e kritereve të cilësisë, si: saktësia, përpikmëria dhe krahasueshmëria, për vrojtimet statistikore -\|- 1<br>3. Pezullimi/vonesa e mbledhjes, prodhimit dhe shpërndarjes së statistikave zyrtare si pasojë e fatkeqësive natyrore/ pandemive globale -\|- 1 | Buxhet shteti |
| | | 3.7.1.3 | Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) me taksa konstante | Vrojtim (Anketa e Çmimeve të Konsumit) | | 100% | I vazhdueshëm | Mujor | 1. Indeksi mujor i çmimeve të harmonizuar të konsumit – me taksa konstante.<br>2. Indeksi mesatar vjetor i çmimeve të harmonizuar të konsumit me taksa konstante.<br>3. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të harmonizuar të konsumit me taksa konstante.<br>4. Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të harmonizuar të konsumit me taksa konstante.<br>5. Ndryshimi mesatar vjetor i indeksit të çmimeve të harmonizuar të konsumit me taksa konstante. | Instituti i Statistikave | INSTAT-i | Dita e 24 e M | M + 16D | M + 20D | 1. Mospërmbushja e kritereve të cilësisë, si: saktësia, përpikmëria dhe krahasueshmëria, për të dhënat administrative -\|- 1<br>2. Mospërmbushja e kritereve të cilësisë, si: saktësia, përpikmëria dhe krahasueshmëria, për vrojtimet statistikore -\|- 1<br>3. Pezullimi/vonesa e mbledhjes, prodhimit dhe shpërndarjes së statistikave zyrtare si pasojë e fatkeqësive natyrore/ pandemive globale -\|- 1 | Buxhet shteti |
| | 3.7.2 | Indeksi i Nivelit të Çmimeve, PBB për frymë në MFB | | | | | | | | | | | | | | |
| | | 3.7.2.1 | Vrojtimet e Matjes së Fuqisë Blerëse | Vrojtim | | 100% | I vazhdueshëm | Vjetor | 1. Indeksi i nivelit të çmimeve të konsumit.<br>2. Produkti i brendshëm bruto për frymë në PFB. | Instituti i Statistikave | INSTAT-i | Dita e 160 e V | Dita e 330 e V | | 1. Mospërmbushja e kritereve të cilësisë, si: saktësia, përpikmëria dhe krahasueshmëria, për vrojtimet statistikore -\|- 1<br>2. Pezullimi/vonesa e mbledhjes, prodhimit dhe shpërndarjes së statistikave zyrtare si pasojë e fatkeqësive natyrore/ pandemive globale -\|- 1 | Donatorët |
| | 3.7.3 | Indeksi i Çmimeve të Banesave | | | | | | | | | | | | | | |
| | | 3.7.3.1 | Statistikat mbi Çmimet e Banesave (SÇB) | Burim administrativ | 100% | | Studim | Tremujor | | Agjencia Shtetërore e Kadastrës | INSTAT-i | T | T | | 1. Pezullimi/vonesa e mbledhjes, prodhimit dhe shpërndarjes së statistikave zyrtare si pasojë e fatkeqësive natyrore/ pandemive globale -\|- 9 | Buxhet shteti |
| 3.8 | Shkenca, Teknologjia dhe Inovacioni | | | | | | | | | | | | | | | |
| | 3.8.1 | Statistikat e shkencës | | | | | | | | | | | | | | |
| | | 3.8.1.1 | Statistikat e shkencës | Kombinim i burimeve administrative dhe vrojtimeve | 80% | 20% | I vazhdueshëm | Vjetor - Statistikat GBARD<br>Çdo 2 vite - Statistikat mbi shpenzimet dhe personelin | 1. Personeli i angazhuar në kërkim-zhvillim.<br>2. Përqindja e shpenzimeve të kërkim-zhvillimit ndaj GDP-së.<br>3. Statistikat mbi GBARD. | Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Banka e Shqipërisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti i Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Instituti i Shëndetit Publik, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Instituti i Gjeoshkencave, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Spitalet Universitetet | INSTAT-i | V + 125D | V+ 156D | | 1. Mospublikimin në kohë i rezultateve të vrojtimit -\|- 2<br>2. Mospërmbushja e kritereve të cilësisë, si: saktësia, përpikmëria dhe krahasueshmëria, për Statistikat e Inovacionit dhe i rezultateve të vrojtimit. -\|- 6<br>3. Mosevidentimi dhe realizimi i detyrave të përditshme të specialistit përgjegjës të anketës -\|- 1<br>4. Moszbatimi në kohë i kalendarit të publikimeve statistikore dhe përditësimit të materialeve në *web* -\|- 3<br>5. Gabime në përllogaritje e treguesve nga specialistët përgjegjës të anketës -\|- 3<br>6. Lëvizja e stafit me eksperiencë nga sektori -\|- 8<br>7. Mosfunksionimi i metodave të automatizimit dhe mospasja e suportit për automatizimin e proceseve të prodhimit statistikor -\|- 6 | Buxhet shteti |

| | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | | | | | 8. Moszhvillimi i sistemeve të informacionit dhe *web-services*. -\|- 6 | |
| 3.8.2 | Statistikat e inovacionit | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | 3.8.2.1 | Statistika mbi inovacionin në ndërmarrje | Vrojtim | | 100% | I vazhdueshëm | Çdo 2 vite | 1. Përqindja e ndërmarrjeve aktive në inovacion.<br>2. Shitjet neto të ndërmarrjeve aktive në inovacion.<br>3. Të punësuarit në ndërmarrjet aktive në inovacion.<br>4. Përqindja e ndërmarrjeve që kanë të paktën një inovacion procesi biznesi.<br>5. Ndërmarrje që kanë inovacion produkti dhe inovacion procesi biznesi.<br>6. Ndërmarrje me të paktën një inovacion produkti që nuk ishte i ofruar më parë në treg.<br>7. Ndërmarrje aktive në inovacion që kanë bashkëpunuar.<br>8. Ndërmarrje që kanë blerë teknologji të re që nuk ishte përdorur më parë në ndërmarrje.<br>9. Ndërmarrje që morën mbështetje financiare nga autoritetet publike.<br>10. Ndërmarrje aktive në inovacion sipas madhësisë së ndërmarrjes.<br>11. Ndërmarrje joaktive në Inovacion sipas madhësisë së ndërmarrjes.<br>12. Ndërmarrje aktive në inovacion që kanë bashkëpunuar sipas madhësisë së ndërmarrjes.<br>13. Ndërmarrje që kanë të paktën një inovacion produkti sipas madhësisë së ndërmarrjes.<br>14. Ndërmarrje që kanë të paktën një inovacion procesi biznesi sipas madhësisë së ndërmarrjes.<br>15. Përqindja e ndërmarrjeve aktive në Inovacion sipas sektorëve ekonomik.<br>16. Ndërmarrje joaktive në Inovacion sipas sektorëve ekonomik.<br>17. Ndërmarrje aktive në inovacion që kanë bashkëpunuar sipas sektorëve ekonomik.<br>18. Ndërmarrje që kanë të paktën një inovacion produkti sipas sektorëve ekonomik.<br>19. Ndërmarrje që kanë të paktën një inovacion procesi biznesi sipas sektorëve ekonomik.<br>20. Ndërmarrje që kanë vetëm inovacion produkti dhe procesi biznesi sipas sektorëve ekonomik.<br>21. Ndërmarrje me të paktën një inovacion produkti që ishte i ngjashëm ose identik me produkte në treg sipas sektorëve ekonomik.<br>22. Ndërmarrje me të paktën një inovacion produkti që nuk ishte i ofruar më parë në treg sipas sektorëve ekonomik.<br>23. Përqindja e ndërmarrjeve që kanë të paktën një inovacion produkti. | | INSTAT-i | V + 4D | V + 159D | V + 173D | 1. Mospërmbushja e kritereve të cilësisë, si: saktësia, përpikmëria dhe krahasueshmëria, për vrojtimin e TIK-ut në ndërmarrje -\|- 6<br>2. Mosevidentimi dhe realizimi i detyrave të përditshme të specialistit përgjegjës -\|- 5<br>3. Moszbatimi në kohë i kalendarit të publikimit dhe përditësimit të materialeve në *web* -\|- 4<br>4. Gabime në përllogaritje e treguesve nga specialistët -\|- 4<br>5. Mosfunksionimi i metodave të reja të IT për mbledhjen e të dhënave të vrojtimit -\|- 6<br>6. Lëvizja e stafit me eksperiencë nga sektori -\|- 6<br>7. Mosfunksionimi i metodave të automatizimit dhe mos pasja e suportit për automatizimin e proceseve të prodhimit të statistikave -\|- 6<br>8. Moszhvillimi i sistemeve të informacionit dhe *web-services* -\|- 6<br>9. Mospublikimi në kohë i rezultateve të vrojtimit -\|- 3 | Buxhet shteti |
| 3.8.3 | Statistikat e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | 3.8.3.1 | Statistikat e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në ndërmarrje | Vrojtim | | 100% | I vazhdueshëm | Vjetor | 1.. Ndërmarrje që kanë akses në internet.<br>2. Ndërmarrje që shesin produkte/shërbime *online*.<br>3. Shpejtësia maksimale për shkarkim dokumentesh e specifikuar në kontratën me ofruesin e shërbimit të internetit.<br>4. Përqindja e ndërmarrjeve që përdorin një nga llojet e medias sociale. Përqindja e ndërmarrjeve që përdorin *website* ose një *homepage*. Përqindja e ndërmarrjeve që përdorin shërbimet *cloud*.<br>5. Përqindja e ndërmarrjeve që përdorin ndarjen automatike të informacionit brenda ndërmarrjes.<br>6. Përqindja e ndërmarrjeve që përdorin *software*-in për menaxhimin e marrëdhënieve me klientët (CRM).<br>7. Përqindja e ndërmarrjeve që përdorin informacionin elektronik për zinxhirët e informacionit.<br>8. Ndërmarrje që përdorin kompjuter sipas madhësisë së ndërmarrjes.<br>9. Punonjës që përdorin kompjuter në ndërmarrje sipas madhësisë së ndërmarrjes.<br>10. Ndërmarrje që kanë akses në internet sipas madhësisë së ndërmarrjes.<br>11. Ndërmarrje që shesin produkte/shërbime *online* sipas madhësisë | | INSTAT-i | V + 93D | V + -230D | V + 260D | 1. Mospërmbushja e kritereve të cilësisë, si: saktësia, përpikmëria dhe krahasueshmëria, për vrojtimin e TIK në Ndërmarrje -\|- 5<br>2. Mosevidentimi dhe realizimi i detyrave të përditshme të specialistit përgjegjës -\|- 2<br>3. Moszbatimi në kohë i kalendarit të publikimit dhe përditësimit të materialeve në *web* -\|- 4<br>4. Gabime në përllogaritje e treguesve nga specialistët -\|- 4<br>5. Mosfunksionimi i metodave të reja të IT për mbledhjen e të dhënave të vrojtimit -\|- 6<br>6. Lëvizja e stafit me eksperiencë nga sektori -\|- 6<br>7. Mosfunksionimi i metodave të automatizimit dhe mos pasja e suportit për automatizimin e proceseve të prodhimit të statistikave -\|- 6<br>8. Moszhvillimi i sistemeve | Buxhet shteti |

| | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | së ndërmarrjes.<br>12. Përqindja e ndërmarrjeve të cilat kanë specialist të fushës së TIK-ut.<br>13. Përqindja e ndërmarrjeve që përdorin kompjuter sipas aktivitetit ekonomik.<br>14. Përqindja e punonjësve që përdorin kompjuter në ndërmarrje sipas aktivitetit ekonomik.<br>15. Përqindja e ndërmarrjeve që kanë akses në internet sipas aktivitetit ekonomik.<br>16. Përqindja e ndërmarrjeve që shesin produkte/shërbime *online* sipas aktivitetit ekonomik.<br>17. Përqindja e ndërmarrjeve të cilat kanë ndikim mjedisor.<br>18. Përqindja e ndërmarrjeve të cilat kanë përdorur teknologjinë AI në ndërmarrjet e tyre. | | | | | | të informacionit dhe *web-services* -\|- 5<br>9. Mospublikimi në kohë i rezultateve të vrojtimit -\|- 3 | |
| 3.8.3.2 | Statistikat nga anketa e TIK-ut në familje | Vrojtim | | 100% | I vazhdueshëm | Vjetor | 1. Përqindja e NjEF-ve që kanë akses interneti në shtëpi.<br>2. Përqindja e NjEF-ve që përdorin linjë interneti *broadband*.<br>3. Përqindja e individëve që e përdorin rregullisht internetin: gjithsej.<br>4. Përqindja e individëve që e përdorin rregullisht internetin: meshkuj (si % e të gjithë meshkujve).<br>5. Përqindja e individëve që e përdorin rregullisht internetin: femra (si % e të gjitha femrave).<br>6. Përqindja e individëve që e përdorin rregullisht internetin: grup-mosha 16–24 vjeç (si % e të gjithë individëve 16–24 vjeç).<br>7. Përqindja e individëve që e përdorin rregullisht internetin: grup-mosha 25–34 vjeç (si % e të gjithë individëve 25–34 vjeç).<br>8. Përqindja e individëve që e përdorin rregullisht internetin: grup-mosha 35–44 vjeç (si % e të gjithë individëve 35–44 vjeç).<br>9. Përqindja e individëve që e përdorin rregullisht internetin: grup-mosha 45–54 vjeç (si % e të gjithë individëve 45–54 vjeç).<br>10. Përqindja e individëve që e përdorin rregullisht internetin: grup-mosha 55–64 vjeç (si % e të gjithë individëve 55–64 vjeç).<br>11. Përqindja e individëve që e përdorin rregullisht internetin: grup-mosha 65–74 vjeç (si % e të gjithë individëve 65–74 vjeç).<br>12. Përdorimi i *e-qeverisjes*: Përqindja e individëve që kanë dërguar elektronikisht formularë të plotësuar në 12 muajt e fundit.<br>13. Përdorimi i *e-blerje* (blerje *online*): Përqindja e individëve që kanë porositur *online* të mira materiale ose shërbime për përdorim personal nga interneti në 12 muajt e fundit.<br>14. Pajisjet kryesore të përdorura për të hyrë në internet.<br>15. Shpërndarja e individëve për blerjet *online* sipas produkteve/shërbimeve.<br>16. Shpërndarja e individëve sipas aftësive të TIK-ut.<br>17. Shpërndarja e përdorimit të TIK-ut sipas grup-moshës<br>18. Shpërndarja e shpeshtësisë së përdorimit të TIK-ut sipas grup-moshave.<br>19. Shpërndarja e individëve që kryejnë thirrje/video thirrje, sipas grup-moshave.<br>20. Shpërndarja e përdorimit të TIK-ut sipas gjinisë.<br>21. Shpërndarja e shpeshtësisë së përdorimit të TIK-ut sipas gjinisë.<br>22. Llojet e blerjeve *online* sipas gjinisë. | Instituti i Statistikave | INSTAT-i | V | V + 151D | V + 164D | Përgatitja në kohë e programit të mbledhjes së të dhënave për vitin referues -\|- 3 | Buxhet shteti |
| 4 | Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain | | | | | | | | | | | | | |
| 4.1 | Mjedisi | | | | | | | | | | | | | |
| 4.1.1 | Llogaritë Monetare Mjedisore | | | | | | | | | | | | | |
| 4.1.1.1 | Statistikat mbi taksat mjedisore sipas industrive | Burim administrativ | 100% | | I vazhdueshëm | Vjetor | 1. Taksat mjedisore të ndara sipas kategorive.<br>2. Taksat mjedisore të ndara sipas industrive (Nace 64).<br>3. Taksat e mjedisit (te ardhurat sipas llojit të taksave që kanë ndikim mbi mjedisin.<br>4. Klasifikimi sipas ESA 2010, shpenzimet totale të qeverisë, PBB me çmime korrente). | Instituti i Statistikave | INSTAT-i | V + 451D | V + 475D | V + 482D | 1. Pezullimi ose vonesa e mbledhjes, prodhimit dhe shpërndarjes të statistikave zyrtare si pasojë e Fatkeqësive -\|- 5<br>2. Mbledhja me vonesë dhe jocilësore së të dhënave administrative për llogaritë monetare dhe fizike në mjedis, çka mund të sjellë | Buxhet shteti |

| | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | | | | | vonesa në llogaritjen dhe shpërndarjen e statistikave të llogarive mjedisore -\|- 5<br>3. Gabimet e bëra nga stafi ekspert gjatë përpunimit dhe nxjerrjes së rezultateve duke sjellë ndikim në cilësinë e produktit statistikor -\|- 5 | |
| 4.1.2 | Llogarite Fizike Mjedisore | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | 4.1.2.1 | Llogaritë e flukseve të materialeve mjedisore | Burim administrativ | 100% | | I vazhdueshëm | Vjetor | 1. Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore në raport me popullsinë.<br>2. Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore.<br>3. Varësia nga importi i materialeve.<br>4. Bilanci fizik tregtar.<br>5. Eksportet e materialeve mjedisore.<br>6. Importet e materialeve mjedisore.<br>7. Burimet e brendshme natyrore. | Instituti i Statistikave, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore | INSTAT-i | V + 436D | V + 473D | V + 480D | 1. Pezullimi/vonesa e mbledhjes, prodhimit dhe shpërndarjes të statistikave zyrtare si pasojë e fatkeqësive -\|- 5<br>2. Gabimet e bëra nga stafi ekspert gjatë përpunimit dhe nxjerrjes së rezultateve duke sjellë ndikim në cilësinë e produktit statistikor -\|- 5<br>3. Mbledhja me vonesë dhe jocilësore së të dhënave administrative për llogaritë monetare dhe fizike në mjedis, çka mund të sjellë vonesa në llogaritjen dhe shpërndarjen e statistikave të llogarive mjedisore -\|- 5 | Buxhet shteti |
| | | 4.1.2.2 | Llogaritë e emetimeve në ajër | Burim administrativ | 100% | | I vazhdueshëm | Vjetor | 1. Emetimet në ajër sipas industrive.<br>2. Emetimet në ajër sipas njësive ekonomike familjare. | Instituti i Statistikave | INSTAT-i | V + 436D | V + 473D | | 1. Pezullimi ose vonesa e mbledhjes, prodhimit dhe shpërndarjes të statistikave zyrtare si pasojë e fatkeqësive -\|- 5<br>2. Mbledhja me vonesë dhe jocilësore së të dhënave administrative për llogaritë monetare dhe fizike në mjedis, çka mund të sjellë vonesa në llogaritjen dhe shpërndarjen e statistikave të llogarive mjedisore -\|- 5<br>3. Gabimet e bëra nga stafi ekspert gjatë përpunimit dhe nxjerrjes së rezultateve duke sjellë ndikim në cilësinë e produktit statistikor -\|- 5 | Buxhet shteti |
| | | 4.1.2.3 | Llogaritë e flukseve fizike të energjisë | Burim administrativ | 100% | | I vazhdueshëm | Vjetor | 1. Inputet e energjisë Natyrore.<br>2. Produktet e energjisë.<br>3. Mbetjet e energjisë. | Instituti i Statistikave | INSTAT-i | V + 436D | V + 473D | | 1. Pezullimi ose vonesa e mbledhjes, prodhimit dhe shpërndarjes të statistikave zyrtare si pasojë e Fatkeqësive -\|- 5<br>2. Mbledhja me vonesë dhe jocilësore së të dhënave administrative për llogaritë monetare dhe fizike në mjedis, çka mund të sjellë vonesa në llogaritjen dhe shpërndarjen e statistikave të llogarive mjedisore -\|- 5<br>3. Gabimet e bëra nga stafi ekspert gjatë përpunimit dhe nxjerrjes së rezultateve duke sjellë ndikim në cilësinë e produktit statistikor -\|- 5 | Buxhet shteti |
| 4.1.3 | Statistikat mbi menaxhimin e mbetjeve dhe substancave të rrezikshme | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | 4.1.3.1 | Statistikat mbi menaxhimin të mbetjeve të ngurta urbane | Burim administrativ | 100% | | I vazhdueshëm | Vjetor | 1. Gjenerimi i mbetjeve sipas burimeve kryesore gjeneruese (NACE).<br>2. Trajtimi i mbetjeve sipas mënyrave bazë të trajtimit.<br>3. Përbërja merceologjike e mbetjeve të ngurta urbane.<br>4. Stacionet kryesore për mbledhjen dhe përpunimin e mbetjeve të ngurta urbane.<br>5. Raport cilësie mbi menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane në Shqipëri.<br>6. Mbetjet inerte në përbërje të mbetjeve urbane.<br>7. Mbetje të rrezikshme në përbërje të mbetjeve urbane<br>Import - eksport i mbetjeve.<br>8. Gjenerimi i mbetjeve urbane raportuar për banor rezident.<br>9. Mbetje të ricikluara nga mbetjet urbane.<br>10. Mbetje të trajtuara ndarë sipas mënyrave standarde të trajtimit.<br>11. Mbetje të patrajtuara nga mbetjet urbane totale të generuara në Shqipëri. | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit<br>Bashkitë | INSTAT | V + 155D | V + 253D | V + 267D | 1. Mosrealizimi i vrojtimit vjetor i mbetjeve urbane sipas objektivave, duke sjellë mospublikimin e statistikave mbi menaxhimin e mbetjeve dhe moshartimin e raporteve periodike të kërkuara nga Eurostat -\|- 4 | Buxhet shteti |
| 4.1.4 | Statistikat e ujit | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | 4.1.4.1 | Statistikat e ujit-administrative | Burim administrativ | 100% | | I vazhdueshëm | Vjetor | 1. Cilësia e ujërave larës në plazhet detare të Shqipërisë.<br>2. Statistikat mbi furnizimin e popullsisë me ujë dhe menaxhimi i ujërave të | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, | INSTAT-i | V + 125D | V + 291D | V + 300D | 1. Mosarritja e realizimit të aktivitetit të statistikave të ujit, dhe e rritjes së indikatorëve sipas | Buxhet shteti |

| | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | ndotura.<br>3. Statistikat mbi cilësitë fiziko kimike të ujërave në lumenj dhe liqene natyrale.<br>4. Portata e ujërave të brendshëm sipas burimeve natyrore.<br>5. Statistikat të pjesshme nga bilanci i përgjithshëm i ujërave në Republikën e Shqipërisë.<br>6. Statistika mbi rajonet e baseneve të lumenjve, RBD.<br>7. Reshjet mesatare vjetore në Shqipëri.<br>8. Përdorimi i ujërave nga burimet sipërfaqësore.<br>9. Përdorimi i ujërave nga rezervat nëntokësore, aquiferet.<br>10. Hyrje dalja e ujërave sipërfaqësore me vendet. ndërkufitare me Shqipërinë<br>11. Përdorimi i ujërave sipas degëve kryesore të ekonomisë, Nace - Rev2.<br>12. Trajtimi i ujërave të përdorura dhe shkarkimi i tyre.<br>13. Mbetjet nga trajtimi i ujërave të ndotura dhe trajtimi i llumrave.<br>14. Prurjet mesatare vjetore të ujit sipas baseneve lumore.<br>15. Sipërfaqet efektive dhe reale të baseneve kryesore ujëmbledhëse të brendshme dhe ndërkufitare.<br>16. Shkarkimet e ujërave në dete sipas baseneve lumore. | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar,<br>Agjencia Kombëtare e Mjedisit,<br>Instituti i Gjeoshkencave,<br>Ujësjellës-Kanalizime Tiranë | | | | | objektivave për pasojë, duke sjellë pamundësinë e hartimit të bilancit të përgjithshëm vjetor mbi ujërat në territorin e Shqipërisë, si dhe për rrjedhojë mungesën e kontributit të Shqipërisë në hartimin e bilancit global të ujërave nga Eurostat -\|- 4<br>2. Avari/dëmtime /shkëputje në infrastrukturën e IT servera duke sjellë pezullim/vonesa të mbledhjes prodhimit dhe shpërndarjes të statistikave zyrtare -\|- 4 | |
| | | 4.1.4.2 | Vrojtimi i përdorimit të ujit në industri | Vrojtim | | 100% | I vazhdueshëm | Çdo 2 vite | 1. Furnizimi me ujë sipas NACE.<br>2. Përdorimi i ujit sipas NACE.<br>3. Shkarkimi ujërave të përdorura sipas NACE. | INSTAT | INSTAT-i | V + 216 D | V + 326 D | Nuk publikohen | 1. Ardhja e pyetësorëve me vonesë në INSTAT -\| - 4<br>2. Vonesa dhe gabime të tjera në procesin e kontrollit dhe hedhjes së të dhënave -\|- 4<br>3. Mospërmbushja e kritereve të cilësisë (saktësia, përpikmëria dhe krahasueshmëria) në vrojtimin e përdorimit të lëndës drusore në industri, e cila sjell si pasojë mosshpërndarjen në kohë dhe me cilësi të rezultateve të vrojtimit -\|- 5<br>4. Avari/dëmtime /shkëputje në infrastrukturën e IT servera duke sjellë pezullim/vonesa të mbledhjes prodhimit dhe shpërndarjes të statistikave zyrtare -\|- 4 | Buxhet shteti |
| 4.1.5 | Statistikat e qytetit | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | 4.1.5.1 | Statistikat mbi cilësinë e ajrit, zhurmat dhe mbi automjetet sipas vjetërsisë në përdorim | Burim administrativ | 100% | | I vazhdueshëm | Vjetor | 1. Cilësia e ajrit në qytetet kryesore të Shqipërisë.<br>2. Niveli i ndotjes akustike në ambientet publike sipas kohës dhe intensitetit të zhurmave.<br>3. Statistikat mbi mjetet e transportit rrugor sipas vjetërsisë në përdorim.<br>4. Automjetet rrugore në përdorim sipas burimeve energjetike që përdorin. | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë,<br>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit,<br>Agjencia Kombëtare e Mjedisit | INSTAT-i | V + 152D | V + 292D | V + 302D | 1. Mosmbledhja e të dhënave administrative për mjedisin nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe agjencive të tyre, mund të sjellë vonesa dhe pasaktësi në publikimin e disa treguesve administrativ lidhur me cilësinë e ajrit dhe klimën kryesisht -\|- 4 | Buxhet shteti |
| 4.1.6 | Statistikat e biodiversitetit | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | 4.1.6.1 | Statistikat e biodiversitetit | Burim administrativ | 100% | | I vazhdueshëm | Vjetor | 1. Rrjeti i zonave të mbrojtura në Shqipëri.<br>2. Llojet e faunës së egër në Shqipëri.<br>3. Statusi kombëtar i ruajtjes së shpendëve.<br>4. Lista e florës dhe faunës së egër sipas statusit të kërcënimit.<br>5. Llojet e faunës së egër objekt gjuetie në Shqipëri. | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit,<br>Agjencia Kombëtare e Mjedisit,<br>Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura | INSTAT-i | V + 151D | V + 244D | V + 251D | 1. Mosmarrja e të dhënave administrative nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për pyjet, kullotat dhe biodiversitetin, si pasojë e riorganizimit të sistemit administrativ që mbulon fushën përkatëse duke sjell pamundësi të realizimit të treguesve që lidhen kryesisht me kadastrën pyjore -\|- 4 | Buxhet shteti |
| 4.2 | Informacioni statistikor rajonal dhe gjeohapësinor | | | | | | | | | | | | | | | |
| 4.2.1 | Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS) për qëllime statistikore | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | 4.2.1.1 | Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS) për qëllime Statistikore | Tjetër | | | I vazhdueshëm | Tjetër | 1. Përditësimi i të dhënave gjeohapësinore me informacionin e ardhur nga Censi i Popullsisë dhe Banesave.<br>2. Integrimi i të dhënave gjeohapësinore me të dhënat statistikore.<br>3. Publikimi i rezultateve të Censit nëpërmjet hartave tematike.<br>4. Përmirësimi i gjeoportalit të INSTAT-it dhe pasurimi me indikatorë të tjerë socio-ekonomikë. | Instituti i Statistikave | INSTAT-i | V+ 364D | V+ 546D | V+ 548D | 1. Mungesa e burimeve financiare dhe asistencës teknike në kohë. -\|- 4 Cilësia e të dhënave të mbledhura në terren. -\|- 4 | Buxhet shteti |
| | | 4.2.1.2 | Ndërtimi i regjistrit statistikor të ndërtesave dhe banesave të Shqipërisë | Tjetër | | | I vazhdueshëm | Tjetër | 1. Ndërtimi i infrastrukturës TI të Regjistrit Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave.<br>2. Ndërtimi i databazës së Regjistrit Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave. | Instituti i Statistikave,<br>Ministria e Brendshme,<br>Autoriteti i Zhvillimit të Territorit, | INSTAT-i | V+ 364D | V+ 364D | V + 1462D | 1. Mosmarrja e të dhënave administrative për krahasueshmërinë me të dhënat statistikore -\|- 4 | Kombinuar (buxhet shteti + donatorët) |

| | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | 3. Formalizimi i bashkëpunimit me institucionet që do të kontribuojnë në përditësimin e RSNB.<br>4. Përditësimi i databazës së Regjistrit Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave me të dhëna nga institucionet e tjera që disponojnë informacion mbi ndërtesat dhe banesat. | Agjencia Shtetërore e Kadastrës<br>Bashkitë | | | | | | |
| | | 4.2.1.3 | Klasifikimi statistikor i njësive territoriale | Tjetër | | | I vazhdueshëm | Tjetër | 1. Transmetimi i listës së njësive territoriale lokale (LAU) në EUROSTAT<br>2. Harmonizimi i klasifikimit të nomenklaturave statistikore NUTS, në përputhje me rregulloret e KE-së.<br>3. Implementimi i tipologjive territoriale (TERCET) në përputhje me rregulloret e Komisionit Evropian.<br>4. Paraqitja hartografike e të dhënave të popullsisë në nivel grid 1km². | Instituti i Statistikave | INSTAT | V+ 364D | V+ 732D | V + 732D | 1. Mungesa e të dhënave të detajuara për përllogaritjen e klasifikimeve territoriale -\|- 4 | Buxhet shteti |
| 4.2.2 | Harmonizimi i temave “Demografia” dhe “Njësitë statistikore” sipas direktivës INSPIRE | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | 4.2.2.1 | Harmonizimi i temave “Demografia” dhe “Njësitë statistikore” sipas direktivës INSPIRE | Tjetër | | | I vazhdueshëm | Tjetër | Transformimi i të dhënave gjeografike të INSTAT -it bazuar në Infrastrukturën Kombëtare të të Dhënave Hapësinore në Shqipëri, duke ndjekur rekomandimet e direktivës INSPIRE për dy tema: shpërndarja e popullsisë dhe njësitë statistikore. | Instituti i Statistikave | INSTAT-i | V + 364D | V + 732D | V + 1462D | 1. Ndryshime, shtyrje afatesh nga institucioni koordinues (Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor) -\|- 4 | Buxhet i shtetit |

**VENDIM**
**Nr. 00-2024-2161 (167), datë 4.7.2024**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët:

| | |
|---|---|
| Ilir Panda | kryesues; |
| Medi Bici | anëtar; |
| Sokol Binaj | anëtar; |
| Albana Boksi | anëtare; |
| Sandër Simoni | anëtar, |

Sot në datë 4.7.2024, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, çështjen penale që i përket:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër

I MITUR NË KONFLIKT ME LIGJIN: Roland Matranxhi

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese", parashikuar nga neni 79, shkronja "a" i Kodit Penal.

TRASHËGIMTARË TË VIKTIMËS: Nesim Metallari, Filxharie Metallari

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtares Albana Boksi; prokurorin pranë Prokurorisë së Përgjithshme Arqilea Koça, i cili kërkoi "Lënien në fuqi të vendimit nr. 188, datë 9.5.2019 të Gjykatës së Apelit Shkodër"; mbrojtësin e zgjedhur, avokat Anton Kosteri, i cili kërkoi: "Ndryshimin e vendimit nr. 151 (360), datë 28.1.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe vendimit nr. 188, datë 9.5.2019 të Gjykatës së Apelit Shkodër; Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, uljen me 1/3 të masës së dënimit për të pandehurin Roland Matranxhi dhe dënimin e tij përfundimisht me 6 (gjashtë) vite e 8 (tetë) muaj burgim"; dhe si e diskutoi çështjen në tërësi, në përfundim;

VËREN:

**I. Rrethanat e çështjes**

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër në datë 11.11.2017 ka regjistruar procedimin penal të regjistruar për veprat penale të parashikuara në nenet 76 dhe 279 të Kodit Penal (në vijim "KP"). Më datë 8.2.2018, ka paraqitur kërkesën për dërgimin e kësaj çështje në gjyq, duke akuzuar të miturin në konflikt me ligjin Roland Matranxhi për kryerjen e veprës penale "Vrasja me dashje" parashikuar nga neni 76 i KP-së Më datë 6.3.2018, prokuroria ka marrë vendim për ndryshimin e akuzës për veprën penale "Vrasja me dashje" parashikuar nga neni 76 i KP-së për të miturin në konflikt me ligjin Roland Matranxhi, duke i komunikuar akuzën për veprën penale "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese" parashikuar nga neni 79/a i KP-së (për shkak se ka rezultuar që viktima është i mitur).

2. Në seancë paraprake në datë 13.3.2018, mbrojtësi i zgjedhur dhe i mituri në konflikt me ligjin (i pranishëm), kanë parashtruar kërkimin për të vijuar gjykimin sipas procedurës së gjykimit të shkurtuar, pasi sipas tyre gjykata mund të japë një vendim të drejtë me këto prova. Mbrojtësi dhe i mituri në konflikt me ligjin nuk kanë paraqitur kërkesë për pavlefshmërinë e akteve të hetimeve paraprake, papërdorshmërinë e provave, nevojën për marrjen e provave të tjera. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër (gjyqtari i seancës paraprake) me vendimin nr. 437 (1175), datë 13.3.2018 ka vendosur dërgimin e çështjes në gjyq për të miturin në konflikt me ligjin Roland Matranxhi, i akuzuar për kryerjen e veprës penale "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese" parashikuar nga neni 79/a i KP-së.

3. Para gjykatës së shqyrtimit të çështjes në themel, në seancën gjyqësore të datës 27.6.2018 mbrojtësi i zgjedhur nga i mituri në konflikt me ligjin ka deklaruar se i qëndron kërkesës për gjykim të shkurtuar të paraqitur në seancë paraprake. Gjykata e shkallës së parë (gjykata e shqyrtimit të çështjes në themel) bazuar në parashikimet e nenit 403 pika 2 i Kodit të Procedurës Penale (në vijim "KPP"), ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, që parashikon "*Nuk lejohet kërkesa për gjykim të shkurtuar për veprat penale, për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm*", ka vendosur të rrëzojë kërkesën e të miturit Roland Matranxhi në konflikt me ligjin, për gjykim të shkurtuar, duke vijuar gjykimin e kësaj çështje penale me gjykim të zakonshëm. Gjykata ka arsyetuar se në kushtet kur vepra penale për të cilën akuzohet i mituri në konflikt me ligjin Roland Matranxhi, sipas nenit 79, shkronja "a" i KP-së parashikon dënim me burgim të përjetshëm dhe përbën një kriter ndalues për pranimin e gjykimit të shkurtuar, në përputhje me parashikimet e nenit 403, pika 2 e KPP-së, kërkesa për gjykim të shkurtuar duhet të rrëzohet.

4. Gjykatat në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, të zhvilluar sipas rregullave të gjykimit të zakonshëm kanë pranuar të vërtetuar faktin se, i mituri në konflikt me ligjin Roland Matranxhi në datë 10.11.2017, rreth orës 18:00 ka goditur me thikë për motive të dobëta shtetasin e mitur Alkis Metallari, i cili më pas ka ndërruar jetë në Spitalin Rajonal Kukës. Shkak për ngjarjen është bërë fakti se sipas viktimës dhe shtetasit Ismen Matmuja, i mituri në konflikt me ligjin Roland Matranxhi kishte ngacmuar motrën e Ismenit, shtetasen Zime Matmuja. Ditën që ka ndodhur ngjarja, i mituri në konflikt me ligjin Roland Matranxhi është takuar dhe ka shkëmbyer fjalë me shtetasin Ismen Matmuja, lidhur me faktin se i mituri në konflikt me ligjin kishte ngacmuar motrën e shtetasit Ismen Matmuja, shtetasen Zime Matmuja. Takimin në këtë vend palët e kanë lënë pas një komunikimi të mëparshëm mes të miturit në konflikt me ligjin dhe viktimës, bashkë me të cilin ka qenë në vendngjarje dhe shtetasi Ismen Matmuja. Ditën e ngjarjes, i mituri në konflikt me ligjin Roland Matranxhi me thikë me vete, pasi është njoftuar në *Instagram* nga shtetasi Alkis Metallari, i cili i ka lënë takim me qëllim për të sqaruar disa keqkuptime midis tyre. Pasi janë takuar, të tre janë spostuar në një pozicion që nuk dukeshin nga persona të tjerë, ku janë konfliktuar me njëri-tjetrin, kohë gjatë së cilës, pasi i mituri në konflikt me ligjin është goditur nga viktima Alkis Metallari me grusht, e ka goditur me mjetin thikë, të cilën e kishte marrë me vete, duke i shkaktuar vdekjen.

**5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr. 151 (360), datë 28.1.2019,** ka vendosur: "*Deklarimin fajtor të pandehurit Roland Sami Matranxhi, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese", parashikuar nga neni 79, shkronja "a" e Kodit Penal dhe dënimin e tij me 10 (dhjetë) vite burgim. Vuajtja e dënimit fillon nga data e arrestimit në flagrancë, datë 10.11.2017 dhe të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme.* (…)"

6. Gjykata e shkallës së parë, ndër të tjera, ka arsyetuar se, ... nga ana e mbrojtëses së të miturit në konflikt me ligjin[2] u pretendua se duhet ndryshuar cilësimi ligjor i veprës penale, sipas nenit 83 të KP-së "Vrasja e kryer në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme". Nga provat e administruara gjatë gjykimit, edhe pse rezultoi që viktima, ka goditur të miturin në konflikt me ligjin Roland Matranxhi, nuk provohet fakti se i mituri në konflikt me ligjin ka vepruar në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme. Këtë fakt e deklaron vetëm i mituri në konflikt me ligjin dhe nuk mbështetet me asnjë provë tjetër të administruar gjatë gjykimit. I vetmi fakt që rezultoi gjatë gjykimit, është fakti se i mituri në konflikt me ligjin Roland Matranxhi është goditur me grusht nga viktima Alkis Metallari, fakt i deklaruar nga i mituri në konflikt me ligjin, por edhe nga deklarimet e shtetasit Ismen Matmuja, deklarime të dhëna përpara oficerit të policisë gjyqësore ditën e ngjarjes, datë 10.11.2017. Gjithashtu, nga këqyrja e të miturit në konflikt me ligjin Roland Matranxhi rezultoi se te ai është konstatuar një dëmtim në pjesën e fytyrës, ënjtje në mollëzën e syrit të djathtë, ndërsa në pjesë të tjera të trupit nuk janë konstatuar dëmtime. Nuk rezulton i provuar fakti, që i mituri në konflikt me ligjin Roland Matranxhi të ketë goditur shtetasin Alkis Metallari, gjatë kohës që ky i fundit ka qenë duke e sulmuar apo pas përfundimit të tij. Gjithashtu nuk rezultoi që viktima ditën e ngjarjes, të ketë pasur ndonjë mjet me vete, i cili të përbënte rrezik për jetën apo shëndetin e të miturit në konflikt me ligjin. Nga ana tjetër nuk rezultoi që shtetasi Ismen Matmuja, i cili ka qenë në vendin e ngjarjes, të ketë pasur ndonjë mjet, nëpërmjet të cilit të ketë goditur të miturin në konflikt me ligjin Roland Matranxhi, sikurse deklarohet prej tij. Fakti që ky shtetas ka pasur një shkop me vete deklarohet vetëm nga shtetasi Armand Shehu, shok i të miturit në konflikt me ligjin, i cili nuk ka qenë i pranishëm në vendin ku ka ndodhur ngjarja, por deklaron se ka parë një djalë me një shkop duke ndjekur të miturin në konflikt me ligjin Roland Matranxhi. I mituri në konflikt me ligjin Roland Matranxhi, që në momentin që është njoftuar për t'u takuar nga viktima nëpërmjet rrjetit social *Instagram*, ka pranuar takimin, duke marrë edhe mjetin prerës thikë me vete, pavarësisht se ky mjet sipas aktit të ekspertimit teknik, nuk i ka plotësuar kriteret për t'u konsideruar armë e ftohtë. Nëpërmjet këtij mjeti ka goditur viktimën Alkis Metallari, i cili si pasojë ka ndërruar jetë në Spitalin Rajonal Kukës.

[2] Termi i përdorur nga gjykata "i pandehur" është zëvendësuar me termin e parashikuar për këtë subjekt në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur "i mitur në konflikt me ligjin".

6.1 Në aktin e ekspertimit mjekoligjor nr. 560, datë 10.11.2017 është pasqyruar konkluzioni si vijon: “1. Te kufoma e shtetasit Alkis Metallari u konstatua një plagë prerëse me karakteristikat dhe lokalizimet e lartpërmendura, shoqëruar me dëmtim të murit të përparmë të gjoksit nga ana e majtë, rupturë të mushkërisë së majtë. 2. Këto dëmtime janë shkaktuar me mjet të fortë me teh dhe majë të mprehtë siç mund të jetë edhe thika. 3. Shkaku i vdekjes së shtetasit Alkis Metallari ka qenë shoku i rëndë traumatik hemorragjik”. Është administruar edhe certifikata e vdekjes së shtetasit Alkis Metallari, lëshuar nga zyra e gjendjes civile Kukës, datë 22.2.2018, nga e cila ka rezultuar se viktima ka qenë i mitur, i datëlindjes 11.5.2001, 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjeç, në kohën e kryerjes së veprës penale. Për këtë arsye në seancën paraprake, prokurori me vendimin “Për ndryshimin e akuzës”, ka ndryshuar akuzën në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin Roland Matranxhi, nga “Vrasja me dashje”, sipas nenit 76 të KP-së, në “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, e parashikuar nga neni 79, shkronja “a” e KP-së.

6.2 I mituri në konflikt me ligjin Roland Matranxhi ka konsumuar nga ana objektive figurën e veprës penale “Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese” parashikuar nga neni 79 shkronja “a” i KP-së. Kjo për arsye se i mituri në konflikt me ligjin Roland Matranxhi, pasi është konfliktuar me viktimën ka nxjerrë mjetin thikë, të cilën e kishte marrë me vete, me të cilën e ka goditur, si pasojë e të cilës ka gjetur vdekjen. Pavarësisht faktit se i mituri në konflikt me ligjin Roland Matranxhi pretendoi se nuk ka pasur dijeni nga ana subjektive se viktima ka qenë e mitur, nën moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç, fakti që objektivisht viktima është e mitur, passjell përgjegjësi penale sipas nenit 79, shkronja “a” e KP-së. Neni 79 i KP-së ka marrë në mbrojtje të posaçme një kategori të veçantë subjektesh, duke përfshirë edhe të miturit, duke përcaktuar se kur vrasja drejtohet ndaj këtyre personave, pikërisht për shkak të këtyre cilësive, parashikohen edhe marzhe më të larta dënimi në minimum deri në burgim të përjetshëm. Pra ligjvënësi këtë dispozitë e lidh në mënyrë të veçantë me cilësitë e viktimës së veprës penale, pavarësisht cilësive të veçanta që mund të gëzojë subjekti aktiv që kryen veprën penale, sikurse në rastin konkret, ku rezultoi se edhe i mituri në konflikt me ligjin Roland Matranxhi, në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i mitur, nën moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç.

Vepra penale “Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese” është një vepër penale materiale, që do të thotë se konsiderohet e konsumuar plotësisht, kur vjen pasoja e vrasjes. Në rastin konkret ka ardhur pasoja e kërkuar nga shkronja “a” e nenit 79 të KP-së, vdekja e shtetasit Alkis Metallari, i mitur. Figura e veprës penale të “Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese”, parashikuar nga neni 79 i KP-së shkronja “a” kërkon si formë faji dashjen e drejtpërdrejtë, duke u përjashtuar dashja indirekte. Në lidhje me subjektin e veprës penale, në rastin konkret plotësohet ky element, duke pasur parasysh nenin 12 të KP-së. Në rastin konkret, i mituri në konflikt me ligjin në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë mbi 14 vjeç, dhe rrjedhimisht në vështrim të nenit 12/1 të KP-së, në drejtim të moshës i mituri në konflikt me ligjin Roland Matranxhi, ka qenë madhor e i përgjegjshëm penalisht në datën e kryerjes së veprës penale, objekt gjykimi dhe si tillë ai ka pasur moshën për përgjegjësi penale. Sa më sipër u arsyetua, i mituri në konflikt me ligjin Roland Matranxhi duhet deklaruar fajtor për veprën penale të “Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese” parashikuar nga neni 79 shkronja “a” i KP-së.

7. Kundër vendimit nr. 151 (360), datë 28.1.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, **ka paraqitur ankim i mituri në konflikt me ligjin Roland Matranxhi,** duke kërkuar: “*Ndryshimin e vendimit nr. 151 (360) datë 28.1.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke vendosur deklarimin fajtor të të miturit në konflikt me ligjin Roland Matranxhi, për veprën penale të “Vrasje e kryer në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme”, parashikuar nga neni 83 i Kodit Penal dhe dënimin e tij në minimumin e parashikuar*.”.

**8. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 188, datë 9.5.2019,** ka vendosur: “*Lënien në fuqi të vendimit nr. 151 (360) datë 28.1.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Kundër vendimit lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë*.”.

8.1 Gjykata e apelit ka arsyetuar se, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është i bazuar në ligjin material penal dhe atë procedural penal si dhe në prova, ndaj si i tillë ai duhet të lihet në fuqi. Mbi pretendimet për shkelje procedurale të procesit, mbrojtësi i të miturit në konflikt me ligjin Roland Matranxhi gjatë gjykimit në apel përveç pretendimeve të ngritura në ankim lidhur me kualifikimin ligjor dhe masën e dënimit, ka

pretenduar dhe pavlefshmërinë e vendimit për shkak të shkeljeve procedurale të realizuara gjatë hetimit dhe gjykimit në shkallë të parë që kanë të bëjnë përkatësisht me: mospranimin e gjykimit të shkurtuar, cilësimin e gabuar të veprës, mosmarrjen parasysh të faktit që i pandehuri është i mitur, si dhe shkelje procedurale që kanë të bëjnë me pyetjen e të miturit gjatë hetimeve paraprake pa praninë e prindit apo të të afërmve dhe konkretisht të Roland Matranxhi dhe Armand Shehut.

8.2 Gjykata e apelit pasi i mori në shqyrtim këto kërkesa i konsideron ato si të pabazuara si në ligj dhe në prova, të cilat nuk përbëjnë elemente të pavlefshmërisë absolute të vendimit që mund të pasjellin në kuptim të nenit 128/a dhe 428/ç të KPP-së prishjen e vendimit dhe kthimin e tij për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Në analizë dhe të nenit 128/a të KPP-së asnjë nga shkaqet e ngritura nga avokati nuk përbëjnë element të pavlefshmërisë absolute të vendimit gjyqësor të cilat do të detyronin gjykatën të prishte vendimin dhe të kthente çështjen për rigjykim. Kështu, nuk ka asnjë shkak të lidhur me formimin e trupit gjykues, pjesëmarrjen e prokurorit, njoftimin e të pandehurit i cili ka qenë i rregullt, apo me të drejtën e tij për mbrojtje e cila është respektuar gjatë gjithë gjykimit nëpërmjet mbrojtësve të zgjedhur prej të miturit në konflikt me ligjin, të cilët kanë marrë pjesë gjatë gjithë gjykimit dhe ju janë garantuar të gjitha të drejtat procedurale për realizimin e një mbrojtje efektive.

8.3 Lidhur me gjykimin e shkurtuar, gjykata e apelit konstaton se mospranimi i saj nga gjykata e shkallës së parë është i ligjshëm dhe i drejtë, dhe i argumentuar në mënyrë të plotë nga kjo gjykatë. Është pikërisht neni 403, pika 2 e KPP-së, pas ndryshimeve të viti 2017, i cili nuk e lejon gjykimin e shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet një dënim me burgim të përjetshëm. Për sa kohë neni 79, shkronja "a" e KP-së (...) me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vendosur të rrëzojë kërkesën për gjykim të shkurtuar, pasi nuk mund të dalë tej apo në kundërshtim me parashikimet e ligjit procedural penal.

8.4 Lidhur me pretendimet e avokatit për pavlefshmërinë e deklarimeve të dy të miturve të dhëna para policisë gjyqësore pa prezencën e prindit, lidhur me shtetasit Roland Matranxhi dhe Armand Shehu, gjykata e apelit verifikoi dy procesverbalet e deklarimeve të tyre të datave 10.11.2017 për personin nën hetim Roland Matranxhi dhe për personin që ka dijeni për veprën penale Armand Shehu. Nga analiza e tyre konstatohet se shtetasi Roland Matranxhi është pyetur në përputhje me parashikimet ligjore në prezencë të avokates dhe psikologes së tij, ndërsa personi nën hetim Armand Shehu është pyetur pa prezencën e psikologut. Lidhur me deklarimet e dëshmitarit Armand Shehu të bëra gjatë hetimeve paraprake, konstaton se vërtet policia gjyqësore në shkelje të nenit 18 të KPP-së ka realizuar pyetjen e tij pa prezencën e psikologut, por kjo shkelje së pari nuk përbën një nga rastet e pavlefshmërisë absolute të akteve (aq më tepër që nuk është i mitur në konflikt me ligjin apo viktimë dhe se për dy ditë nga pyetja mbushte moshën 18 vjeç), por si një rast i pavlefshmërisë relative të akteve nuk është ngritur dhe pretenduar nga avokatët e zgjedhur të të pandehurit në momentet e duhura procedurale dhe konkretisht në seancë paraprake apo në seancë gjyqësore para së të fillojë shqyrtimi gjyqësor, sanksionuar kjo në nenin 129, pika 3 të KPP-së. Këto pretendime nuk janë ngritur nga mbrojtësit e të miturit në konflikt me ligjin dhe si të tilla nuk mund të merren në shqyrtim gjatë gjykimit në apel të çështjes së themelit në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin Roland Matranxhi.

8.5 Në lidhje me themelin e çështjes, deklarimin fajtor të të miturit në konflikt me ligjin Roland Matranxhi në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, është provuar plotësisht se i mituri në konflikt me ligjin ka konsumuar elementet e veprave penale për të cilën është akuzuar, atë të "Vrasjes në rrethana cilësuese" parashikuar nga neni 79 shkronja "a" të KP-së. Mbi ankimin e të miturit në konflikt me ligjin Roland Matranxhi lidhur me cilësimin ligjor të veprës penale; Nga provat e nënshtruara shqyrtimit gjyqësor provohet se ditën e ngjarjes, i mituri në konflikt me ligjin Roland Matranxhi me thikë me vete, pasi është njoftuar në *Instagram* nga shtetasi Alkis Metallari, i cili i ka lënë takim me qëllim për të sqaruar disa keqkuptime midis tyre. Pasi janë takuar të tre janë spostuar në një pozicion që nuk dukeshin nga persona të tjerë, ku janë konfliktuar me njëri-tjetrin, kohë gjatë së cilës, pasi i mituri në konflikt me ligjin është goditur nga viktima Alkis Metallari me grusht, e ka goditur me mjetin thikë, të cilën e kishte marrë me vete, duke i shkaktuar vdekjen. Sa më sipër krijon bindjen se i mituri në konflikt me ligjin Roland Matranxhi nuk ka qenë në kushtet e

mbrojtjes së nevojshme dhe as në kapërcim të saj, ai ka shkuar për t'u konfliktuar me viktimën dhe shtetasin Alkis Metallari duke marrë dhe thikë me vete, duke mos qenë në këto kushte nën një sulm të vërtetë, të padrejtë dhe të çastit nga viktima dhe kushëriri i tij, por në një grindje dhe gjuajtje reciproke ka shkaktuar vdekjen e viktimës. Pretendimet e tij se është gjetur nën një sulm të çastit dhe të padrejtë ndaj tij si dhe të rrezikshëm për jetën nuk qëndrojnë, pasi rrjedha e gjithë ngjarjes tregon se ai ka paramenduar sulmin, është përgatitur për të duke marrë thikën me vete, nuk provohet ekzistenca e shkopit dhe gjuajtjeve me të, si dhe shkalla e dëmtimeve në trupin e tij nuk i mbështet pretendimet e tij në asnjë moment. Kështu nga akti i ekspertimit mjekoligjor rezulton se ai ka dëmtim në pjesën e fytyrës, ënjtje në mollëzën e syrit të djathtë, ndërsa në pjesë të tjera të trupit nuk janë konstatuar dëmtime, dhe në asnjë moment ndonjë dëmtim tjetër të shkaktuar nga ndonjë shkop apo mjet tjetër i fortë i pretenduar prej tij. Me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se nuk rezulton e provuar fakti që viktima ditën e ngjarjes, të ketë pasur ndonjë mjet me vete, i cili të përbënte rrezik për jetën apo shëndetin e të miturit në konflikt me ligjin, dhe nuk rezultoi që shtetasi Ismen Matmuja, i cili ka qenë në vendin e ngjarjes, të ketë pasur ndonjë mjet, nëpërmjet të cilit të ketë goditur të miturin në konflikt me ligjin Roland Matranxhi, sikurse deklarohet prej tij. Fakti që ky shtetas ka pasur një shkop me vete deklarohet vetëm nga shtetasi Armand Shehu, shok i të miturit në konflikt me ligjin, i cili nuk ka qenë i pranishëm në vendin ku ka ndodhur ngjarja, por deklaron se ka parë një djalë me një shkop duke ndjekur të miturin në konflikt me ligjin Roland Matranxhi.

Sa më lart, nga shqyrtimi gjyqësor i akteve të ndodhura në fashikullin gjyqësor rezulton se, i mituri në konflikt me ligjin Roland Matranxhi ka konsumuar plotësisht elementet e veprës penale të "Vrasjes në rrethana cilësuese", të shtetasit Alkil Metallari, të parashikuara respektivisht nga neni 79 shkronja "a" të KP-së dhe me të drejtë është deklaruar fajtor dhe dënuar nga gjykata e shkallës së parë. Lidhur me masën e dënimit, ajo është e drejtë duke ju referuar nenit 47 të KP-së, rrethanave lehtësuese dhe rënduese në ngarkim të tij si dhe Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit. Gjithashtu pavarësisht nga fakti se kjo masë dënimi është në minimumin e parashikuar nga dispozita, në kushtet e mungesës së një ankimi nga organi i akuzës, nuk mund të rëndojë në këtë gjykim pozitën e të miturit në konflikt me ligjin Roland Matranxhi.

9. Kundër vendimit nr. 188, datë 9.5.2019, të Gjykatës së Apelit Shkodër, **ka paraqitur rekurs, më datë 10.6.2019 i mituri në konflikt me ligjin Roland Matranxhi,** me të cilin ka kërkuar: "*Prishjen e vendimit nr. 188, datë 9.5.2019 të Gjykatës së Apelit Shkodër, duke vendosur kthimin e çështjes për rishqyrtim*". Në rekurs, ndër të tjera në lidhje me disponimin për refuzimin e gjykimit të shkurtuar dhe faktin penal të atribuuar, mbrojtja e të miturit në konflikt me ligjin ka parashtruar këto shkaqe:

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër i kishte të gjitha kushtet për të pranuar kërkesën për gjykim të shkurtuar duke parë këtu faktin që nuk kishte asnjë provë të re.
- Gjykatat e kanë rrëzuar këtë kërkesë për gjykim të shkurtuar, kur aktet ishin të plota dhe çështja mund të zgjidhej në gjendjen e ishin aktet, pasi si në deklarimet e dëshmitarëve dhe në aktet e dosjes provohet fare mire që nuk kemi të bëjmë me veprën penale për të cilën është dënuar kërkuesi.
- Konstatimi i gjykatave se vepra penale nuk lejon natyrën e gjykimit të shkurtuar, jo vetëm ishte i gabuar dhe në shkelje të dispozitave procedurale. Gjykatat kanë gabuar duke rrëzuar këtë kërkesë, ndaj është bërë pjesë e rekursit edhe mospranimi i kësaj kërkese, pasi janë shkelur të drejtat e kërkuesit.
- Analiza në vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe gjykatën e apelit për rrëzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar mungon totalisht, siç dhe nuk faktohen arsyet e mospranimit.
- Në praktikën gjyqësore është arsyetuar se gjykimi i shkurtuar nuk shërben vetëm për ekonomi gjyqësore, por i sjell të pandehurit edhe përfitimin e uljes së 1/3 së dënimit, e drejtë e ligjshme kjo e cila nuk mundet t'i mohohet në mënyrë të gabuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër si dhe nga Gjykata e Apelit Shkodër.
- Disponimi i gjykatave për kërkesën për gjykim të shkurtuar është një vendim i ndërmjetëm që si gjithë vendimet e tjera mundet t'i nënshtrohet shqyrtimit në gjykatën më të lartë dhe nëse ky disponim mund të jetë i gabuar, atëherë rrjedhimisht gjykata me e lartë duhet që të rregullojë pasojat e krijuara nga kjo vendimmarrje e gabuar. *(vendimi nr. 4 datë 10.2.2012 i Gjykatës Kushtetuese)*.
- Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe i Gjykatës së Apelit Shkodër për

mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar bie në kundërshtim dhe me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur (në vijim "KDPM").

- Nëse Gjykata e Apelit Shkodër vendosi rrëzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, atëherë në momentin që është kërkuar ripyetja e dëshmitarëve, kjo gjykatë nuk ka marrë "mundimin" të bëjë thirrjen e tyre ose shoqërimin e detyrueshëm të tyre, aspekt logjik ky që mund të justifikonte dhe mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar.

- Referuar rrethanave të faktit provohet se kërkuesi Roland Matranxhi, ka konsumuar elementet e veprës penale "Vrasja e kryer në kapërcim të kufijve të mbrojtjes se nevojshme" dhe kurrsesi "Vrasje në rrethana të tjera cilësuese", e parashikuar nga neni 79 i KP-së.

- Gjykata e Rrethit Shkodër, nuk ka bërë një hetim serioz të ngjarjes dhe deklarimeve të dëshmitarëve duke treguar njëanësi në marrjen e vendimit; kjo gjykatë në asnjë moment nuk kërkoi shoqërimin e detyrueshëm të dëshmitarëve prezent në vendngjarje, ripyetje e cila do të sillte për pasojë një panoramë më të gjerë të ngjarjes, duke provuar pretendimet e kërkuesit.

- Vendimet janë të pavlefshme pasi janë marrë mbi akte të pavlefshme. Dëshmitarët Ismen Matmuja dhe Armand Shehu në datë 10.11.2017, pavarësisht se kanë qenë nën moshën 18 vjeç, janë pyetur pa praninë e psikologut apo kujdestarit.

- Nga ana e mbrojtjes në gjykatën e apelit u ngrit pretendimi për pavlefshmëri dhe u trajtuan aktet e papërdorshme dhe të pavlefshme. Gjykata e Apelit Shkodër në shkelje flagrante të ligjit, pasi ndërpreu seancën gjyqësore për t'u shprehur në lidhje me këto kërkime të mbrojtjes, shpalli dhe vendimin përfundimtar. Gjykata nuk i dha mundësinë të pandehurit për të parashtruar mbrojtjen para gjykatës, e drejtë kjo thelbësore e të pandehurit në procesin penal.

- Në rastin konkret, Roland Matranxhi ka qenë i detyruar të mbrojë jetën pasi është sulmuar nga dy persona, nga ku njëri mbante me vetë një shkop rreth gjysmë metri të gjatë, ndërkohë që jo vetëm po sulmohej, por të llogarisësh këtu që ishte një sulm për diçka që kërkuesi nuk kishte asnjë lidhje, kujtojmë këtu se vetë shtetasja Zime Matmuja ka pranuar faktin se ajo ka parë personin që e ka ngacmuar, por dhe rrethanat e ngjarjes që vetë shtetasi Ismet Matmuja një nga personat që së bashku me viktimën kanë sulmuar të pandehurin kur thotë që "Alkisi e qëlloi disa herë…", por dhe nga këqyrja që i është bërë të pandehurit ditën e ndalimit të tij ku shihen qartë dëmtimet që ka në fytyrë dhe trup, tregojnë se ankuesi jo vetëm nuk ka pasur lidhje me ngacmimin e Zime Matmuja, por dhe që sulmi ndaj tij ishte i padrejtë, një sulm që i rrezikonte shëndetin, të drejtat e interesat e tij etj., të gjithë këta "elemente" që janë pjesë përbërëse e veprës penale, të parashikuara nga neni 83 i KP-së dhe që nuk u morën parasysh nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër në vendimin e saj.

- Në rastin konkret ka pasur një sulm të padrejtë, të vërtetë dhe të çastit. Rezulton nga aktet e ndodhura në dosjen penale se ankuesi përveçse është sharë e fyer me të padrejtë, por edhe është sulmuar me të padrejtë. Ankuesi nuk mund të përjashtohet nga përgjegjësia penale në bazë të nenit 19 të KP-së, pasi karakteri i mbrojtjes nuk ka qenë në proporcion me rrezikshmërinë e sulmit, por nga ana e perceptimit të situatës ku ndodhej kërkuesi, duke u goditur nga dy persona, nga ku njëri nxori nga xhupi një dru të gjatë gjysmë metri, ky i fundit ka menduar se nxjerrja e thikës do të bënte të mundur zmbrapsjen e sulmit. Për shkak se sulmi ka qenë i befasishëm dhe për shkak të tronditjes që ka pësuar ka qenë e pamundur për të menduar me gjakftohtësi se si të zmbrapste këtë sulm dhe në të njëjtën kohë të mos kapërcente kufijtë e mbrojtjes së nevojshme.

- Vendimi objekt ankimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, gjithashtu është në kundërshtim dhe me KP-në dhe doktrinën nga ku jepet një përkufizim i saktë se kur kapërcehen kufijtë e mbrojtjes së nevojshme si dhe mospërputhja haptazi midis tyre, d.m.th., karakterit të mbrojtjes së nevojshme dhe sulmit.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër duke bërë një krahasim të thjeshtë midis veprës penale të "Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese" parashikuar nga neni 79 i KP-së dhe "Vrasja e kryer në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme", parashikuar nga neni 83 i KP-së do të vërente se vrasja me dashje parashikuar nga neni 79, kryhet ndaj një personi që për shkak të moshës së zhvillimit fizik e psikik të tij, nuk është në gjendje të mbrohet nga veprimet kriminale. Që të jemi para kësaj vepre duhet të plotësohen tre kushte thelbësore: Viktima të ketë qenë objektivisht nën moshën 18 vjeç; subjekti i krimit të ketë ditur se po vret një të mitur; vrasja të jetë kryer me dashje.

- Për këtë fakt gjithmonë në funksion të përgjegjësisë penale dhe elementeve të veprës që gjykata duhet të ketë parasysh për kualifikim të kësaj vepre vendimin nr. 04/2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

- Në rastin konkret mungon qëllimi si pjesë e anës subjektive e veprës, me të gjitha elementet e saj përbërëse.

- Duke parë dhe analizuar tërësinë e kushteve konkrete të ngjarjes, nga vetë provat e analizuara faktohet se ankuesi ka qenë duke u goditur nga dy persona me pa të drejtë për një ngjarje që nuk kishte kurrfarë lidhje. Fakti që viktima Alkis Metallari dhe shtetasi Ismet Matmuja e kanë marrë në celular dhe i kanë kërkuar që në fillim të takoheshin në kafe "Berlin" e më pas e kanë drejtuar kërkuesin për tu sqaruar në një vend që nuk kishte persona të pranishëm dhe pasja me vete e një shkopi të gjatë gjysmë metri tregon qartë se qëllimi i tyre ka qenë goditja e kërkuesit Roland Matranxhi dhe jo sqarimi siç këto i kishin kërkuar.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka dhënë një vendim jo të mbështetur në ligj e prova, pasi nuk ka asnjë provë komprometuese që t'i shërbente për vërtetimin e vrasjes në rrethana të tjera cilësuese, pasi edhe ato pak dëshmi tregojnë se ankuesi ka qenë nën goditjen e disa personave të cilët as nuk i njihte e as nuk i kishin treguar pse po e sulmonin, por janë mjaftuar vetëm me pyetjen: A e njeh shtetasen Zime Matmuja? dhe e kanë goditur.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ashtu dhe Gjykata e Apelit nuk kanë pasur parasysh as urdhëresat e nenit 12 dhe 13 të KDPM-së.

**II. Procedura në Gjykatën e Lartë dhe nevoja për njësim të praktikës gjyqësore**

10. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim "Kolegji"), i përbërë nga një trup gjykues prej tre gjyqtarësh, ka marrë në shqyrtim këtë çështje në dhomë këshillimi në datën 25.4.2024. Kolegji konstatoi se rekursi është paraqitur në formën e kërkuar nga ligji dhe brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 435 të Kodit të Procedurës Penale (në vijim "KPP"). Prokuroria është njoftuar për rekursin. Në këto kushte, rekursi plotëson kushtet formale të parashikuara nga neni 435/1 i KPP-së. Gjatë shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, Kolegji vlerësoi se në rekursin e paraqitur nga i gjykuari, ngrihen çështje ligjore me rëndësi për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, në vështrim të kërkesave të nenit 432, pika 1, shkronja "a" të KPP-së. Gjatë shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, Kolegji vlerësoi të njësojë praktikën gjyqësore pasi konstatoi praktika të ndryshme të Kolegjit Penal në drejtim të zbatimit të nenit 403/2 të KPP-së, për veprat penale që parashikojnë dënim me burgim të përjetshëm kur të akuzuar janë persona ndaj të cilëve ligji ndalon dhënien e një dënimi të tillë. Pas një hulumtimi mbi praktikën gjyqësore, pas ndryshimeve të nenit 403/2 të KPP-së me ligjin nr. 35/2017 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (në vijim "ligji nr. 35/2017"), ndryshime këto që kanë hyrë në fuqi në datë 1.8.2017, Kolegji ka evidentuar se çështja zbatimit apo jo të kësaj dispozite për veprat penale që parashikojnë dënim me burgim të përjetshëm kur të akuzuar janë persona ndaj të cilëve ligji ndalon dhënien e një dënimi të tillë (gra dhe të mitur), ka qenë e diskutueshme dhe ka sjellë qëndrime të ndryshme jo vetëm midis Kolegjeve të Gjykatës së Lartë, por edhe në praktikën e gjykatave më të ulëta.

11. Në kuadër të ndryshimeve të bërë me paketën e ligjeve të reformës në drejtësi, gjatë ndryshimeve që ka pësuar KPP-ja me ligjin nr. 35/2017, janë prekur dhe dy nenet 403 dhe 406, ku ndryshimi më i rëndësishëm lidhet me paragrafin e dytë të nenit 403 të KPP-së, që ndalon kërkesën për gjykim të shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm. Aktualisht, neni 403 i këtij Kodi është formuluar në këtë mënyrë: "*1. Kërkesa për gjykimin e shkurtuar paraqitet nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij me autorizim të posaçëm në seancën paraprake ose në seancë gjyqësore kur procedohet sipas nenit 400 dhe paragrafit 3, të nenit 406/ç, të këtij Kodi, me pasojë mospranimi. 2. Nuk lejohet kërkesa për gjykim të shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm*".

12. Në praktikën e Kolegjit Penal ku është marrë në analizë dhe interpretuar neni 403/2 i KPP-së, pas ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017 është mbajtur qëndrimi se ky ndalim gjen zbatim edhe kur të akuzuar për një vepër penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm është një i mitur në konflikt me ligjin (*shih vendimin nr. 00-2022-1595, datë 6.12.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*). Sipas këtij qëndrimi, neni 403, paragrafi i dytë i KPP-së ndalon aplikimin e këtij riti procedural kur gjykohen vepra penale (kur akuza i konteston të pandehurit vepra penale të kësaj natyre) për të cilat parashikohet

(si sanksion) lloji i dënimit me burgim të përjetshëm, duke mos e lidhur këtë parashikim (ndalim) me statusin "moshën e të pandehurit" të gjykuar, në kuptimin e pamundësisë së ndikimit të privilegjeve të toleruara prej legjislatorit në trajtimin seleksionues të subjekteve "të mitur në konflikt me ligjin" (të cilat evitojnë aplikimin e llojit të dënimit "burgim të përjetshëm", për këto lloj subjektesh), në funksion të aksesit të pakufizuar të tyre, për shkak të këtij "statusi", edhe në këtë "zonë të konsideruar të padepërtueshme", por duke e reduktuar vetëm në llojin e veprës penale të atribuuar të pandehurit, sipas akuzës. Në terma të tjerë, sipas këtij qëndrimi, trajtimi sanksionues i privilegjuar, i toleruar prej legjislatorit për të miturit në konflikt me ligjin, që presupozon pamundësinë e aplikimit ndaj tyre të llojit të dënimit me "burgim të përjetshëm", si dhe të një dënimi më të lartë se 12 vjet burgim, nuk paraqet asnjë lloj ndikimi në drejtim të evitimit të ndalimit të përgjithshëm, të përcaktuar në nenin 403/2 të KPP-së, prekludues apriori i së drejtës për të pasur akses në ritin procedural të "gjykimit të shkurtuar", të subjekteve të gjykuara për veprat penale të kontestuara prej akuzës, që parashikojnë si titull sanksionues, llojin e dënimit me "burgim të përjetshëm".

13. Ndërsa në një rast tjetër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrim të ndryshëm, duke konkluduar se ndalimi i parashikuar në nenin 403/2 të KPP-së nuk gjen zbatim kur i akuzuar për këto kategori veprash penale është një i mitur në konflikt me ligjin (*shih vendimin nr. 00-2023-928 (169), datë 1.6.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*). Sipas këtij qëndrimi qëllimi i ligjvënësit, në lidhje me parashikimin e këtij ndalimi, lidhet me faktin e krijimit të pamundësisë ligjore, ndaj atyre subjekteve që kryejnë vepra penale/krime shumë të rënda, për të përfituar mundësinë që shmang burgimin e përjetshëm. Thënë ndryshe, kjo ndalesë ligjore, si rregull i përgjithshëm, ka si qëllim që subjektet e veprave penale për të cilat ligji parashikon dhe mundëson dënimin me burgim të përjetshëm, të mos kenë mundësi t'i shmangen këtij dënimi maksimal, nëse kryejnë vepra penale për të cilat parashikohet dënueshmëria maksimale. Kolegji më tej ka vlerësuar se në kushtet e ekzistencës së parashikimeve/mbrojtjes së posaçme ligjore të parashikuar për subjektin "i mituri në konflikt me ligjin", zbatueshmëria e përcaktimit – rregullit të parashikuar në nenin 403/2 të KPP-së është e kufizuar, për sa kohë ajo rëndon pozitën e tij (të miturit në konflikt me ligjin), pasi zbatimi i kësaj dispozite ligjore, vjen në kundërshtim me vetë qëllimin e ligjvënësit (që është shmangia e të miturit nga aplikimi i dënimit me burgim të përjetshëm) dhe nuk është në përputhje me frymën e drejtësisë penale për të miturit, me rëndësinë dhe qëllimin e dënimit penal, kur autorë janë të miturit, për sa kohë që vetë ligji e ka përjashtuar në mënyrë të shprehur, taksative, aplikimin e këtij dënimi maksimal për këtë kategori subjektesh të veprës penale. Për shkak të mbrojtjes ligjore të posaçme që i është dhënë këtij subjekti "të miturit në konflikt me ligjin", ndalesa e parashikuar në nenin 403/2 të KPP-së (si pamundësi ligjore për të aplikuar gjykimin sipas ritit të gjykimit të shkurtuar, për subjektet e proceduara për veprat penale për të cilët parashikohet dënimi më burgim të përjetshëm), nuk gjen zbatim, përderisa dënueshmëria maksimale (burgimi i përjetshëm) për të miturin ndalohet nga vetë ligji, (neni 31 dhe 51 i KP-së dhe neni 97 i KDPM-së). Rregulli i përgjithshëm i parashikuar në nenin 403/2 i KPP-së, nuk gjen zbatim në rastin e të miturit në konflikt me ligjin, pasi KP-ja (nenet 31 dhe 51) dhe KDPM-ja përmbajnë rregullime më të favorshme, jo vetëm duke e përjashtuar atë nga dënimi me burgim të përjetshëm, por duke përcaktuar se dënimi me burgim për të miturin nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikohet për veprën penale të kryer, por jo më shumë se 12 vjet (neni 97/2, KDPM). Në këtë kuptim, Kolegji ka vlerësuar se pika 2 e nenit 403 të KPP-së, në rastin kur të miturit janë autorë të veprës penale, nuk mund të interpretohet si dispozitë e vetme (e izoluar) në legjislacionin penal shqiptar, por në bazë të interpretimit sistematik, duhet analizuar dhe interpretuar në raport harmonik me parashikimet e dispozitave të tjera materiale të KP-së dhe KDPM-së.

14. Kolegji konstaton se ekzistenca e dy vendimeve të mësipërme të Gjykatës së Lartë, ku ajo është shprehur në mënyrë të ndryshme për zbatimin e gjykimit të shkurtuar në rastet e të miturve në konflikt me ligjin të akuzuar për vepër penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm, është evidentuar edhe nga Gjykata Kushtetuese. Kjo gjykatë me vendimin nr. 4, datë 31.1.2024, ka vlerësuar se në kushtet kur nuk ka një vendim unifikues ose njësues të Gjykatës së Lartë në drejtim të zbatimit të gjykimit të shkurtuar për të miturit në

konflikt me ligjin për veprat penale që parashikojnë dënimin me burgim të përjetshëm, pritshmëritë e kërkuesit për pranimin e kërkesës për zbatimin e gjykimit të shkurtuar nga Gjykata e Lartë janë të pabazuara dhe për këtë arsye pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar.

15. Krahas vendimeve të sipërcituara, pas ndryshimit të nenit 403/2 të KPP-së me ligjin nr. 35/2017, nga hulumtimi janë evidentuar edhe vendimmarrje të gjykatave të faktit, të cilat reflektojnë qëndrime të ndryshme në drejtim të zbatimit apo jo të këtij ndalimi, jo vetëm kur të akuzuar për një vepër penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm janë "të miturit në konflikt me ligjin", por edhe kur subjekt i kësaj kategorie veprash penale është një grua. Në thelb të qëndrimeve lejuese të pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar për subjektet "të mitur në konflikt me ligjin" dhe "gra" që akuzohen për një vepër penale që parashikon dënimin me burgim të përjetshëm është pamundësia *de jure* dhe *de facto* i caktimit të këtij dënimi ndaj këtyre subjekteve. Ndërsa, në thelb të qëndrimit të ndryshëm të praktikës gjyqësore është se ligjvënësi pengesën për mospranimin e gjykimit të shkurtuar nuk e lidh me masën e dënimit të dhënë, por e lidh me veprën penale.

16. Duke pasur parasysh qëndrimet e ndryshme të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë si edhe të gjykatave të faktit lidhur me interpretimin e ligjit procedural penal (nenit 403/2 të KPP-së), kur të akuzuar për një vepër penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm janë persona ndaj të cilëve ligji e ndalon dhënien e një dënimi të tillë, por edhe për zgjidhjen e problematikave të tjera ligjore që mund të hasen në praktikën gjyqësore lidhur me zbatimin e këtij ndalimi ligjor të përgjithshëm, Kolegji ka evidentuar nevojën për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore. Ndonëse evidentohen vetëm dy vendimmarrje me qëndrime të kundërta të Gjykatës së Lartë, qëndrimet e ndryshme të praktikës gjyqësore (edhe ato të gjykatave më të ulëta) për një periudhë të gjatë kohe nga hyrja në fuqi e ndryshimit të nenit 403 të KPP-së me ligjin nr. 35/2017, Kolegji çmoi se kjo situatë është e papajtueshme me parimin e sigurisë juridike. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim "GJEDNJ") në disa vendimmarrje të saj, ka vlerësuar uniformitetin dhe njëtrajtshmërinë në zbatimin e ligjit nga gjykatat, si një nga kërkesat dhe garancitë e lidhura me procesin e rregullt ligjor (neni 6 i KEDNJ-së). Sipas GJEDNJ-së, kur evidentohen zgjidhje të ndryshme gjyqësore të njëjta, në parim, ato duhet të ndiqen nga unifikimi dhe harmonizimi i praktikës, nëpërmjet mekanizmave të ngritura për këtë qëllim, kryesisht nga Gjykata e Lartë (*shih Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë, aplikimi nr. 13279/05, datë 20.10.2011, §§ 61, 80*). Gjykata e Lartë, nëpërmjet ushtrimit të funksionit kontrollues të karakterit ligjor dhe nomofilatik, ka për detyrë të sigurojë një raport të ngushtë midis uniformitetit dhe konsistencës së praktikës gjyqësore dhe së drejtës së individit për një gjykim të drejtë.

17. Sa më sipër, në referim të nenit 438 të KPP-së, Kolegji ka disponuar me vendim të ndërmjetëm se shqyrtimi i kësaj çështjeje duhet të kalojë në seancë gjyqësore (me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë), me qëllim njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore në lidhje me çështjet:

1. A zbatohet neni 403, pika 2 i Kodit të Procedurës Penale për personat e akuzuar për një krim që KP-ja parashikon dënim me burgim të përjetshëm, por ndaj të cilëve ligji ndalon dhënien e një dënimi të tillë?

1.1 A zbatohet procedura e gjykimit të shkurtuar kur akuza është për një vepër penale që përmban dënimin me burgim të përjetshëm, por është cilësuar e mbetur në tentativë?

1.2 Si do të veprohet në rastin kur akuza është ngritur për një vepër penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm dhe gjyqtari i seancës paraprake e dërgon në gjyq për këtë akuzë, por gjykatat në përfundim të gjykimit të zakonshëm i japin faktit një cilësim tjetër juridik, që nuk parashikon dënimin me burgim të përjetshëm?

18. Në seancë gjyqësore, Prokuroria e Përgjithshme, në lidhje me pyetjet e shtruara për njësim mbajti këto qëndrime (parashtruar më poshtë në mënyrë të përmbledhur):

- Ndalimi ligjor i aplikimit/pranueshmërisë së gjykimit të shkurtuar kur vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri parashikon në normën e saj dënimin me burgim të përjetshëm, parashikuar në nenin 403, pika 2 të KPP-së, duhet të konsiderohet/interpretohet si ndalim kategorik pavarësisht subjektit të veprës penale.
- Fakti që vepra penale ka mbetur në tentativë nuk përbën shkak për cenimin e rregullimit ligjor të përcaktuar në nenin 403/2 të KPP-së, pra nuk

mund të përbëjë kriter për zbatimin e gjykimit të shkurtuar për veprat penale që parashikojnë dënimin me burgim të përjetshëm.

- Rrëzimi i kërkesës për gjykimin e shkurtuar vetëm me arsyetimin e ndalimit ligjor të parashikuar në nenin 403/2 të KPP-së nuk mund të shoqërohet me mohimin e përfitimit që do të kishte i pandehuri në rastin e gjykimit të shkurtuar.

- Ndërsa cilësimi ligjor i veprës me të cilën është dërguar për gjykim i pandehuri, mund të përcaktojë ritin e gjykimit, cilësimi përfundimtar i tij jo domosdoshmërisht përjashton përfitimin që ai do të kishte pasur në kushtet e gjykimit të shkurtuar.

- Që i pandehuri të përfitojë "bonusin" e ofruar nga ligji do të duhet që në mënyrë komplementare të përmbushen këto elemente: Të jetë bërë kërkesë për gjykimin e shkurtuar nga i pandehuri; Të konkludohet në seancë paraprake se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet duke adoptuar qasjen si në rastet e veprave penale që nuk hyjnë në ndalimin e parashikuar nga neni 403/2 i KPP-së dhe se rrëzimi i kërkesës bazohet vetëm në këtë të fundit. Në gjykimin në themel, i pandehuri të mos ndikojë në mënyrë rënduese në ekonominë gjyqësore duke pasur qasjen e përshkruar në nenin 405/7 të KPP-së; Cilësimi ligjor përfundimtar i veprës penale të ketë ndryshuar nga një vepër penale që parashikon burgim të përjetshëm në një vepër penale që nuk e parashikon këtë dënim.

19. Mbrojtësi i zgjedhur nga i mituri në konflikt me ligjin, në lidhje me çështjet e shtruara për njësim, mbajti qëndrimin se (parashtruar më poshtë në mënyrë të përmbledhur):

- Neni 403/2 i KPP-së duhet të interpretuar në harmoni me parimet themelore të së drejtës penale në përgjithësi dhe parimeve të caktimit të dënimi në veçanti.

- Kjo dispozitë duhet të interpretohet në mënyrë të zgjeruar në përputhje me frymën e përgjithshme të KP-së dhe KDPM-së. Interpretimi i kësaj dispozite në mënyrë sipërfaqësore dhe të ngushtë është në shkelje të rëndë të parimeve të caktimit të dënimit dhe qëllimit të dënimit në vetvete.

- Nenet 31 dhe 51 të KP-së dhe dispozitat e KDPM-së janë norma të veçanta që janë përjashtimore pasi ndalojnë aplikimin e dënimit me burgim të përjetshëm për një kategori të veçantë personash. Neni 403 i KPP-së i ndryshuar synon ndalimin e përfitimit vetëm ndaj personave që janë subjekte të dënimit penal "burgim i përjetshëm" pasi pavarësisht se vepra parashikon dënimin me burgim të përjetshëm përsëri të miturit në konflikt me ligjin dhe gratë nuk janë subjekte të dënimit me burgim të përjetshëm.

- E drejta e detyrueshme sipas nenit 5, 17, 116, 122 dhe 123 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcakton midis të tjerash mbrojtjen më të lartë të interesit të fëmijës dhe detyrimin që legjislacioni i brendshëm të mos cenojë angazhimet e marra përsipër nga Shqipëria në raport me fëmijët.

- Duke qenë se Italia është ndër të paktat shtete që aplikon gjykimin e shkurtuar, vlerësojmë që qëndrimet e jurisprudencës italiane, mund të merren në konsideratë (shih vendimin nr. 207/2022 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Italisë që trajton një rast të ngjashëm).

- Në rastet e gjykimit të personave, akuzuar për një krim që KP-ja parashikon dënim me burgim të përjetshëm, por ndaj të cilëve ligji ndalon dhënien e një dënimi të tillë, nuk duhet të zbatohet neni 403, pika 2 i KPP-së.

- Në rast se ndaj një personi është ngritur akuzë për një vepër penale që përmban dënimin me burgim të përjetshëm, por është cilësuar e mbetur në tentativë, duke pasur parasysh të gjitha parimet e caktimit të dënimit penal, gjykata nuk duhet të aplikojë nenin 403/2 të KPP-së, por mund të pranojë kërkesën për gjykim të shkurtuar.

- Kur akuza e ngritur nga prokuroria është për një vepër penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm dhe gjyqtari i seancës paraprake e dërgon në gjyq për këtë akuzë, por gjykatat në përfundim të gjykimit të zakonshëm i japin faktit një cilësim tjetër juridik, që nuk parashikon dënimin me burgim të përjetshëm, gjykata, në rast se i pandehuri ka kërkuar në seancë paraprake aplikimin e gjykimit të shkurtuar, duhet që në momentin e caktimit të dënimit, të zbresë 1/3 e masës së dënimit.

**III. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë**

20. Kolegji, sjell në vëmendje se gjykimi i shkurtuar, i cilësuar nga legjislacioni procedural penal si një gjykim i posaçëm, është parashikuar për herë të parë në KPP të vitit 1995, të miratuar me ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995. Instituti i "gjykimit të shkurtuar" parashikohet nga nenet 403–406 të KPP-së dhe jo në pak raste ka qenë objekt trajtimi në jurisprudencën shqiptare. Sillet në vëmendje këtu vendimi njësues nr. 2, datë 29.1.2003, në të cilin Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë

shprehur se gjykimi i shkurtuar ka vlerë për ekonomi gjyqësore, sepse thjeshton dhe shkurton procedurat, rrit shpejtësinë dhe efektivitetin e gjykimit dhe sjell përfitim në uljen e 1/3 të masës së dënimit. Por, ky përfitim nuk duhet kurrsesi të shkojë në dëm të dhënies së drejtësisë dhe gjykata e pranon atë, vetëm kur bindet se çështja mund të përfundojë në gjendjen që janë aktet. Edhe Gjykata Kushtetuese ka trajtuar gjykimin e shkurtuar si një gjykim të posaçëm, që konsiston në heqjen dorë në mënyrë të vullnetshme nga disa aspekte themelore të së drejtës për një proces të rregullt, të tilla si parimi i barazisë së armëve dhe i formimit të provës në kontradiktoritet, për të përfituar ulje dënimi *(shih vendimet nr. 4/2012; nr. 14/2012 të Gjykatës Kushtetuese).* Nga ana tjetër, zgjedhja e gjykimit të shkurtuar, si rit procesual, influencon mbi përllogaritjen/përcaktimin e dënimit, i cili ulet me 1/3 nëse procedohet me gjykim të shkurtuar. Pra, sipas Gjykatës Kushtetuese kemi të bëjmë me një aspekt të së drejtës materiale që gërshetohet me të drejtën procesuale *(shih vendimin nr. 14, datë 26.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese).* Sipas Gjykatës Kushtetuese në vlerësimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, gjyqtari nuk duhet të udhëhiqet vetëm nga parimi i ekonomisë gjyqësore, por edhe nga parimi i drejtësisë efektive *(shih vendimin nr. 24/2012 të Gjykatës Kushtetuese).*

21. Nga përmbajtja e neneve 403-406 të KPP-së rezulton se ky lloj i posaçëm gjykimi ndryshon nga gjykimi i zakonshëm, për shkak se aplikohet vetëm mbi kërkesën e të pandehurit, kërkesë e cila duhet të paraqitet në afatin procedural ligjor me pasojë mospranimi[3]. Neni 403/1 i KPP-së, në versionin e tij fillestar (të pandryshuar), parashikonte se "*1. I pandehuri ose përfaqësuesi i tij i posaçëm mund të kërkojnë që çështja të përfundohet derisa të mos jetë filluar shqyrtimi gjyqësor*.". Ndërsa, neni 406/1 parashikonte, se "*1. Kur pranohet fajësia, gjykata e ul dënimin me burgim me një të tretën. Dënimi me burgim të përjetshëm zëvendësohet me njëzet e pesë vjet burgim*."[4]. Kjo dispozitë duke parashikuar shprehimisht zëvendësimin e dënimit me "burgim të përjetshëm", si rezultat i gjykimit të shkurtuar, me atë "njëzet e pesë vjet burgim"[5] pranonte në këtë mënyrë lejimin e këtij lloj gjykimi edhe për veprat penale që parashikojnë një dënim të tillë. Me ligjin nr. 145/2013 për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", si pasojë e rritjes së masës maksimale të dënimit me burgim (neni 32/1 i KP-së[6]), neni 406/1 u ndryshua, duke u parashikuar zëvendësimi i "burgimit të përjetshëm", si pasojë e gjykimit të shkurtuar, me "tridhjetë e pesë vjet burgim".

22. Ndërkohë, në kuadër të ndryshimeve të bëra me paketën e ligjeve të reformës në drejtësi (viti 2016), gjatë ndryshimeve që ka pësuar KPP-ja me ligjin nr. 35/2017, janë prekur dhe dy nenet 403 dhe 406, ku ndryshimi më i rëndësishëm lidhet me paragrafin e dytë të nenit 403 të këtij Kodi, objekt i çështjeve të shtruara për njësim, që ndalon kërkesën për gjykim të shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm. Konkretisht, neni 403/2 i KPP-së, i ndryshuar, shprehimisht parashikon se "*2. Nuk lejohet kërkesa për gjykim të shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm*.". Paralelisht me këtë ndryshim, u shfuqizua fjalia e dytë e pikës 1 të nenit 406 të KPP-së që parashikonte zëvendësimin e dënimit me "burgim të përjetshëm" me atë "tridhjetë e pesë vjet burgim.". Në praktikën e gjykatave më të ulëta, pas ndryshimit të nenit 403/2 të KPP-së me ligjin nr. 35/2017, reflektohen qasje të ndryshme në drejtim të kuptimit, interpretimit dhe zbatimit të këtij parashikimi ligjor. Sipas njërit qëndrim, mjafton që vepra penale objekt akuze ta parashikojë dënimin me burgim të përjetshëm dhe automatikisht zbatohet pika 2 e nenit 403 të KPP-së që përjashton kategorikisht zbatimin e gjykimit të shkurtuar; në thelb të këtij qëndrimi është se ligjvënësi pengesën për mospranimin e gjykimit të shkurtuar nuk e lidh me masën e dënimit të dhënë,

[3] Gjykata e Lartë vazhdimisht ka theksuar kushtin që kërkesa për gjykim të shkurtuar duhet të paraqitet në afatin procedural të parashikuar në ligj *(shih vendimet nr. 161, datë 22.2.2010; nr. 459, datë 12.5.2010; nr. 85, datë 15.6.2011; nr. 123, datë 10.4.2013; nr. 206, datë 30.10.2014; nr. 43, datë 18.3.2015; nr. 103, datë 10.6.2015; nr. 139, datë 16.9.2015; nr. 5, datë 13.1.2016; nr. 222, datë 7.12.2016 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).*

[4] Me ligjin nr. 8813, datë 13.6.2002 për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", neni 406/1 është ndryshuar si vijon: *"1. Kur jep vendim dënimi, gjykata e ul dënimin me burgim ose gjobë me një të tretën. Dënimi me burgim të përjetshëm zëvendësohet me njëzet e pesë vjet burgim."*, duke parashikuar uljen me 1/3 edhe të dënimit me gjobë.

[5] Neni 32/1 i Kodit Penal "Dënimi me burgim për krimet jepet për një kohë nga pesë ditë deri në njëzet e pesë vjet".

[6] Neni 32/1 i Kodit Penal, ndryshuar me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013 "Dënimi me burgim për krimet jepet për një kohë nga pesë ditë deri në tridhjetë e pesë vjet".

por e lidh me veprën penale. Sipas qëndrimit tjetër, pamundësia *de jure* dhe *de facto* e zbatimit të dënimit me burgim të përjetshëm për dy kategori subjektesh "të mitur në konflikt me ligjin" dhe "gra" i përjashton këto subjekte nga ndalimi i parashikuar në nenin 403/2 të KPP-së; kjo do të thotë që këto subjekte edhe kur akuzohen për një vepër penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm, nuk mund të privohen nga e drejta për të kërkuar gjykim të shkurtuar vetëm dhe për shkak të ndalimit ligjor të parashikuar në këtë dispozitë.

23. Parashikimi ligjor në nenin 403/2 të KPP-së është marrë në analizë dhe interpretuar edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili në vendimin nr. 00-2022-1595, datë 6.12.2022 ka mbajtur qëndrimin se ky ndalim ligjor gjen zbatim edhe kur i akuzuar për një vepër penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm është një "i mitur në konflikt me ligjin", pasi dispozita këtë parashikim (ndalim) nuk e lidh me statusin "moshën e të pandehurit" të gjykuar dhe "privilegjeve" që ligjvënësi u ka dhënë këtyre subjekteve (të cilat evitojnë aplikimin e llojit të dënimit "burgim të përjetshëm", për këto lloj subjektesh), por vetëm me llojin e veprës penale të atribuuar të pandehurit, sipas akuzës. Ndërsa, në vendimin nr. 00-2023-928 (169), datë 1.6.2023 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrimin se ky ndalim ligjor nuk gjen zbatim për subjektin "i mitur në konflikt me ligjin" përderisa dënueshmëria maksimale (burgimi i përjetshëm) për të miturin ndalohet nga vetë ligji dhe se KP-ja (nenet 31 dhe 51) dhe KDPM-ja, përmbajnë rregullime më të favorshme, jo vetëm duke e përjashtuar atë nga dënimi me burgim të përjetshëm, por duke përcaktuar se dënimi me burgim për të miturin nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikohet për veprën penale të kryer, por jo më shumë se 12 vjet (neni 97/2, KDPM).

24. Aktualisht një nga arsyet që parashikon ligji procedural penal (në fuqi) për mospranimin e gjykimit të shkurtuar është kur i pandehuri akuzohet për një vepër penale për të cilën parashikohet dënim me burgim të përjetshëm (neni 403/2 i KPP-së). Në Kodin Penal janë parashikuar në mënyrë ezauruese veprat penale për të cilat ligji parashikon dënim me burgim të përjetshëm (23 vepra penale). Duke i individualizuar nga pjesa e posaçme e këtij Kodi rezulton se këto vepra penale janë si vijon: "Genocidi" (neni 73), "Krime kundër njerëzimit" (neni 74), "Krimet e luftës" (Neni 75), "Vrasja me paramendim" e kryer për interes apo hakmarrje (neni 78/2), "Vrasja për gjakmarrje" (neni 78/a), "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese"(neni 79), "Vrasja e funksionarëve publikë"(neni 79/a), "Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit"(neni 79/b), "Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare" (neni 79/c), "Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur" kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së mitur (neni 100/3), "Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit" e të miturit nën moshën 14 vjeç, i paraprirë ose i shoqëruar me tortura fizike ose psikike, kur është kryer kundër disa personave ose më shumë se një herë (neni 109/3), "Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë" kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen (neni 109/b), "Zhdukja me forcë" (kur kjo vepër ka sjellë si pasojë vdekjen (neni 109/c), "Trafikimi i personave të rritur" kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e personit (110/a), "Trafikimi i të miturve" kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit (neni 128/b), "Vjedhja me pasojë vdekjen" (neni 140), "Dorëzimi i territorit" (neni 208), "Dorëzimi i forcave të armatosura" (neni 209), "Atentati" (neni 219), "Kryengritja" (neni 221/2), "Vepra me qëllime terroriste" (neni 230), "Financimi i terrorizmit" (neni 230/a), "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve" kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit (neni 298/3). Ndërsa, në Kodin Penal Ushtarak parashikohet dënimi me burgim të përjetshëm për tetë veprat penale si vijon: "Dorëzimi i forcave ushtarake dhe i mjeteve të luftimit armikut" (neni 25), "Dhënia e informatave sekrete" kryer në gjendje lufte ose në gjendje të jashtëzakonshme (neni 26/3), "Dhënia e ndihmës armikut" (neni 30), "Dezertimi i kuadrit komandues" (neni 34/2), "Moszbatimi i urdhrit nga kuadri komandues" (neni 47), "Shtrëngimi për të shkelur detyrat" (neni 50/3), "Vjedhja" (neni 34), "Vrasja me dashje" (neni 77).

25. Referuar parashikimit ligjor të pikës 2 të nenit 403 të KPP-së, në të gjitha rastet kur akuza përfshin qoftë njërën nga veprat penale të sipërpërmendura, gjykata vendos mospranimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar dhe vazhdon procedurën e gjykimit të zakonshëm. Kundër vendimit të mospranimit nuk lejohet ankim i veçantë, por ky disponim mund të

ankimohet së bashku me vendimin përfundimtar[7]. Kolegji vë në dukje se ndryshimet e KPP-së në lidhje me këtë gjykim të posaçëm, gjykimi i shkurtuar, janë pasojë e vendimeve unifikuese dhe ato të Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me këtë institut të së drejtës procedurale. Në këtë drejtim, Kolegji gjen me vend të vërë në dukje se në dispozitat kalimtare të ligjit nr. 35/2017, nuk gjen rregullim ligjor të posaçëm rasti kur vepra penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm është kryer para hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve të KPP-së në raport me kërkesën për gjykim të shkurtuar, kur kjo kërkesë është paraqitur në seancë paraprake pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore. Edhe ky ometim ka krijuar paqartësi, duke passjellë praktika të ndryshme gjyqësore të gjykatave më të ulëta në lidhje me faktin nëse për këto raste do të zbatohet ligji procedural penal që ka qenë në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës prej të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, sipas parimit latin "*tempus regit actum*" apo ligji procedural penal që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale sipas parimit të zbatimit të "ligjit penal favorizues".

26. Ky konstatim ndonëse nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me pyetjet e shtruara për njësim, theksohet nga Kolegji Penal në vështrim të zhvillimit të praktikës gjyqësore, për zbatimin e drejtë të ligjit procedural penal në raport me kërkimin e të pandehurve për t'u gjykuar sipas procedurës së gjykimit të shkurtuar. Në këtë drejtim, Kolegji Penal ka mbajtur qëndrimin se, nëse një dispozitë e cilësuar si procedurale për faktin se parashikohet në ligjin procedural, ka një ndikim në ashpërsinë e masës së dënimit që duhet të jepet nga gjykata, atëherë ajo është një dispozitë penale materiale, ndaj të cilës ka vend për t'u zbatuar parimi i sanksionuar në nenin 29, pika 2 të Kushtetutës[8], si dhe nenin 3, pika 3[9] të KP-së. Një konkluzion i tillë gjen mbështetje edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila ka vlerësuar në situata të ngjashme se, një dispozitë e tillë procedurale që ndikon në dënimin e caktuar, duhet të cilësohet si një dispozitë penale materiale, ndaj të cilës ka vend për t'u zbatuar nenin 7 paragrafi i parë i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim "KEDNJ")[10]. GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj ka pohuar se neni 7 i KEDNJ-së, jo vetëm që garanton parimin e mosretroaktivitetit të ligjeve penale më të rrepta, por imponon edhe zbatimin nga gjykata të ligjit penal dispozitat e të cilit janë më të favorshëm për të akuzuarin, pasi në të kundërt kemi dhunim të parimit të ligjshmërisë, duke aplikuar një ligj të pafavorshëm për të akuzuarin. Kolegji thekson se, gjykatat në raste të tilla, mes zbatimit të parimit "*tempus regit actum*" dhe zbatimit të ligjit penal më të favorshëm, duhet ti japë përparësi të drejtave dhe garancive kushtetuese të pandehurit. Kolegji edhe më parë ka vënë në dukje se mospranimi i ankimit të pandehurit për riparimin e pasojave të gjykimit të shkurtuar nga gjykata e apelit nuk mund të ketë si shkak ndryshimet ligjore të pikës 2 të nenit 403 të KPP-së, kur fakti penal ka ndodhur përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2017 *(shih vendimin nr. 00-2024-427 (62), datë 7.3.2024; vendimin nr. 00-2024-1242 (176), datë 9.7.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).*

27. Në një vështrim krahasues, rezulton se edhe Kodi i Procedurës Penale të Italisë (në vijim "KPP italian"), nga i cili është huazuar ky lloj gjykimi i posaçëm në ligjin procedural penal shqiptar, parashikon gjykimin e shkurtuar në librin e gjashtë, titulli I, nenet 438-443. Në versionin e tij fillestar, neni 442, pika 2 i KPP-së italian parashikonte shprehimisht zëvendësimin e dënimit me burgim të përjetshëm, si rezultat i gjykimit të shkurtuar, me atë "tridhjetë vjet burgim"; duke lejuar kështu pranimin e gjykimit të shkurtuar edhe për veprat penale që parashikojnë dënim me burgim të përjetshëm. Me vendimin nr. 176/1991, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Italisë deklaroi antikushtetues nenin 441, pika 2 të KPP italian, në pjesën që parashikonte që "dënimi me burgim të përjetshëm zëvendësohet me tridhjetë vjet burgim" për shkelje të nenit 76 të Kushtetutës, nisur nga fakti që ligji delegues parashikonte për gjykimin e shkurtuar vetëm kriterin e uljes me 1/3 të dënimit, dukshëm i pazbatueshëm për veprat penale që dënohen me burgim të përjetshëm. Duke zgjidhur paqartësitë interpretuese që u shfaqën në praktikë pas këtij vendimi, Seksionet

[7] Neni 405/6 i KPP-së, ndryshuar me ligjin nr. 35/2017.

[8] Neni 29/2 i Kushtetutës: *"2. Nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale".*

[9] Neni 3, pika 3 e Kodit Penal *"Kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale".*

[10] Çështja Scoppola kundër Italisë/ kërkesa nr. 10249/03, vendimi i datës 17.9.2009.

e Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit të Italisë deklaruan se papranueshmëria e gjykimit të shkurtuar pas shpalljes së antikushtetutshmërisë së normës duhet të zbatohet në çdo rast në të cilin akuza e paraqitur në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq kishte të bënte me një krim "të dënueshëm" me burgim të përjetshëm, edhe kur gjyqtari besonte se për shkak të ekzistencës së rrethanave lehtësuese duhej caktuar një dënim tjetër (vendim nr. 2977, datë 6.3.1992 i Seksioneve të Bashkuara Penale të Gjykatës së Kasacionit Itali). Pak më vonë, me vendimin nr. 163 të vitit 1992, Gjykata Kushtetuese e Italisë ka mbajtur qëndrim se nuk mund të konsiderohet *apriori* e papajtueshme me Kushtetutën parashikimi ligjor për përjashtimin nga e drejta për të kërkuar gjykimin e shkurtuar për veprat penale që dënohen me burgim të përjetshëm qoftë edhe mbi bazën e llojit të veprës penale, pasi parashikime të tilla ligjore justifikohen nga rëndësia e madhe që kanë këto vepra penale. Neni 30 i ligjit nr. 479, datë 16.12.1999, riktheu, mundësinë e aksesit në këtë lloj gjykimi të posaçëm për veprat penale që dënohen me burgim të përjetshëm, nëpërmjet shtimit të pikës 2 në nenin 442 të KPP-së italian, me të cilin vendoste versionin fillestar të Kodit, duke parashikuar se, "dënimi me burgim të përjetshëm zëvendësohet me tridhjetë vjet burgim". Me ligjin nr. 33, datë 12.4.2019 në KPP italian u parashikua sërish ndalimi i gjykimit të shkurtuar për veprat penale të dënueshme me burgim të përjetshëm, në mënyrë identike me nenin 403/2 të Kodit tonë. Konkretisht, KPP italian në nenin 438, paragrafi. 1-bis i tij, parashikon se "*nuk lejohet gjykimi i shkurtuar për krimet e dënueshme me burgim të përjetshëm*". Më tej ky ligj, paralelisht ka shfuqizuar edhe pikat e nenit 442/2 të KPP italian që parashikonin zbatimin e dënimeve të përfituara si rezultat i gjykimit të shkurtuar.

28. Ndalimi i gjykimit të shkurtuar për veprat penale që parashikojnë dënim me burgim të përjetshëm jo pak herë është bërë objekt kontrolli kushtetues incidental në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Italisë, e cila vazhdimisht ka mbajtur qëndrim se nuk mund të konsiderohet *apriori* e papajtueshme me Kushtetutën parashikimi ligjor për përjashtimin nga e drejta për të kërkuar gjykimin e shkurtuar për të dënuarit me burgim të përjetshëm qoftë edhe mbi bazën e llojit të veprës penale, pasi parashikime të tilla ligjore justifikohen nga rëndësia e madhe që kanë këto vepra penale. *(vendim nr. 163/1992 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Italisë).* Këto çështje futen në diskrecionin e ligjvënësit *(vendim 117/2011 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Italisë).* Me vendimin nr. 260/2020, Gjykata Kushtetuese e Italisë shprehet se kufizimi ligjor procedural nuk mund të konsiderohet as arbitrar dhe as i paarsyeshëm. Sipas Gjykatës Kushtetuese diskrecioni i pushtetit legjislativ është ushtruar brenda kufijve të lejuara nga Kushtetuta dhe se lejimi apo jo i gjykimit të shkurtuar janë çështje ligjore në të cilat legjislatori gëzon diskrecion përzgjedhjeje sipas Kushtetutës. Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar edhe se akuza e ngritur është objekt vlerësimi jo vetëm nga ana e prokurorit, por edhe nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake, gjë që nënkupton një kontroll gjyqësor paraprak në formulimin e akuzës së prokurorit dhe mundësi e njëkohësisht garanci për të pandehurin që të mos privohet në mënyrë të padrejtë për të kërkuar gjykimin e shkurtuar. Gjithashtu, në vendimin nr. 208/2021 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Italisë nuk ka gjetur papajtueshmëri të dispozitës së mësipërme me Kushtetutën për përjashtimin nga gjykimi i shkurtuar të personave të padënueshëm për shkak të paaftësisë totale mendore dhe që akuzohen për vepër penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm. Për vepra penale të një rëndësie të tillë të veçantë, Gjykata Kushtetuese shprehet se është i nevojshëm zhvillimi i një procesi publik me pjesëmarrjen e popullit për administrimin e drejtësisë, me të gjitha garancitë si për të pandehurin, ashtu edhe për viktimat, për pjesëmarrje në zbardhjen e të vërtetës (*vendim nr. 208/2021 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Italisë*). Sipas jurisprudencës së konsoliduar kushtetuese, ndonëse është e vërtetë që e drejta për të kërkuar gjykimet e posaçme (alternative) kur njihet, përbën një nga modalitetet më domethënëse dhe vendimtare të ushtrimit të së drejtës së mbrojtjes është po aq e vërtetë që mohimi ligjor i një mundësie të tillë për një kategori të caktuar veprash penale nuk e cenon thelbin e kësaj të drejte *(vendimet nr. 260/2020, nr. 95/2015, 273/2014, 237/2012, 333/2009, 2019/2004, 148/2004 të Gjykatës Kushtetuese të Italisë).*

29. Gjykata Kushtetuese e Italisë në vendimin nr. 140/2010, duke bërë një analizë mbi *ration* (qëllimin) e këtij gjykimi është shprehur se, vlerësimet e të pandehurit për dobinë e gjykimeve të posaçme varen në radhë të parë nga mënyra se si është përcaktuar procesi dhe vepra penale nga prokurori.

Me pasojën që kur, për "raste patologjike", si gabimet ose mosveprimet e prokurorit për përcaktimin e faktit ose të veprës penale, akuza pëson një ndryshim substancial, i pandehuri duhet të rivendoset në afat për të bërë vlerësimet e duhura, me rrjedhojë, përndryshe, cenimin e së drejtës së mbrojtjes si dhe të parimit të barazisë së armëve, duke qenë se do të kishim një diskriminim sipas "ekzaktësisë ose plotësisë më të madhe ose më të vogël të vlerësimit diskrecional të rezultateve të hetimeve paraprake nga ana e prokurorit. *(shih edhe vendimet nr. 333/2009 dhe nr. 265/1994 të Gjykatës Kushtetuese të Italisë).* Po në vendimin e lartpërmendur, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se, *me kërkesën për gjykim të shkurtuar i pandehuri pranon të gjykohet me gjykimin e posaçëm në raport me akuzat e formuluara nga prokurori, e vetëm ndaj tyre ai shpreh vlerësimin e dobisë së këtij gjykimi; kështu që nuk do të ishte kushtetutshmërisht e pranueshme që ai të gjendej i detyruar nga zgjedhja e tij edhe ndaj veprave penale të reja (të ndryshme) që mund t'i ngarkoheshin.* Gjykata Kushtetuese e Italisë, në vendimin nr. 313/1990 është shprehur se përcaktimi i dënimit nuk mund t'i shmanget kontrollit juridiksional. Po kjo gjykatë, në vendimin nr. 23/1992 ka theksuar se mungesa e kontrollit mbi vendimin e gjyqtarit për mospranim të ritit të posaçëm sjell pasoja në planin e dënimit, në dëm të të pandehurit. Ndërsa Gjykata e Kasacionit të Italisë është shprehur se, në rast se është vazhduar me ritin e zakonshëm procedural, nuk ka dyshim se vendimi mund të apelohet për një motiv specifik, që është dhënia e një dënimi "të paligjshëm". I pandehuri ka të drejtë të pretendojë në apel se për shkak të refuzimit të ritit të posaçëm në mënyrë të pajustifikuar ose të gabuar, nuk ka mundur të përfitojë nga reduktimi i dënimit, edhe pse ai i ka përmbushur të gjitha detyrimet procedurale në ngarkim të tij. Përcaktimi konkret i dënimit është i rivlerësueshëm nga gjyqtari i apelit, të cilit ky pretendim i kërkohet në mënyrë specifike nga i pandehuri. *(shih vendimin nr. 44711, datë 27 tetor–18 nëntor 2004, të Gjykatës së Kasacionit të Italisë).*

30. Veçoritë e institutit të gjykimit të shkurtuar janë trajtuar edhe nga GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj. GJEDNJ-ja duke analizuar institutin në fjalë, ka theksuar se kjo procedurë paraqet avantazhe të padiskutueshme për të pandehurin: në rast dënimi, ky i fundit gëzon një ulje të dënimit *(Hermi kundër Italisë, nr. 18114/02, datë 18.10.2006 dhe Hany kundër Italisë, nr. 17543/05, datë 6.11.2007).* Kjo procedurë gjithsesi është e shoqëruar me një lehtësim të garancive procedurale të ofruara nga e drejta e brendshme, në veçanti për sa i përket publicitetit të diskutimit si dhe mundësisë që të kërkohet paraqitja e provave dhe thirrja e dëshmitarëve (*Kwiatkowska kundër Italisë, nr. 52868/99, datë 30.11.2000*). Këto garanci përbëjnë aspekte themelore të së drejtës për një proces të rregullt ligjor të sanksionuar nga neni 6 i KEDNJ-së. Gjithsesi, as teksti dhe as fryma e kësaj dispozite nuk ndalojnë që një person të heqë dorë në mënyrë spontane dhe të shprehur nga kjo e drejtë. Por, që të merret në konsideratë nën këndvështrimin e Konventës, kjo heqje dorë duhet të jetë e shprehur në mënyrë eksplicite dhe duhet të jetë e shoqëruar me një minimum garancish. Në vijim GJEDNJ-ja ka çmuar se, duke kërkuar procedimin me gjykim të shkurtuar, aplikanti ka hequr dorë në mënyrë eksplicite nga të drejtat e tij për një seancë publike, të thërrasë dëshmitarët e tij në gjykim, të paraqesë prova, në këmbim të një sërë avantazheve që atij i garantohen nga legjislacioni i brendshëm *(Scoppola kundër Italisë, nr. 10249/03).*

31. Po në këtë aspekt, GJEDNJ-ja ka çmuar gjithashtu se, një i pandehur duhet të presë që shteti të veprojë në mirëbesim dhe të ketë marrë mirë parasysh zgjedhjet procedurale të mbrojtjes, duke përdorur mundësitë e ofruara nga ligji. Është kundër parimeve të sigurisë juridike dhe të mbrojtjes të besimit legjitim të personave që janë në gjykim që shteti mund, në mënyrë të njëanshme, të ulë avantazhet që rrjedhin nga heqja dorë e disa të drejtave që kanë të bëjnë me nocionin e procesit të rregullt. Nëse kjo heqje dorë bëhet në këmbim të avantazheve të lartpërmendura, nuk mund të konsiderohet e drejtë që, pasi autoritetet e brendshme kanë pranuar të procedojnë me gjykim të thjeshtuar, një element themelor i marrëveshjes ndërmjet shtetit dhe të pandehurit mund të modifikohet në disavantazh të këtij të fundit, pa konsensusin e tij. Në këtë drejtim, gjykata vëren se, nëse është e vërtetë që shtetet kontraktuese nuk janë të detyruar nga Konventa të parashikojnë procedura të thjeshtuara, qëndron gjithsesi fakti se, kur këto procedura ekzistojnë dhe aplikohen, parimet e procesit të rregullt ligjor imponojnë që të mos privohet në mënyrë arbitrare i pandehuri nga avantazhet që me atë procedurë lidhen (*Scoppola kundër Italisë, kërkesa nr. 10249/03*).

32. Po ashtu, në lidhje me institutin në shqyrtim, GJEDNJ-ja është shprehur se "dispozitat e

paragrafit 3 të nenit 6 sanksionojnë nevojën që t'i jepet një kujdes i veçantë njoftimit të "akuzës" të interesuarit. Duke qenë se aktakuza ka një rol të rëndësishëm në procedimin penal, neni 6, paragrafi 3 i njeh të pandehurit të drejtën që të informohet jo vetëm me motivin e akuzës, pra me faktet materiale që i atribuohen dhe mbi të cilat bazohet akuza, por edhe, dhe në mënyrë të detajuar, me kualifikimin juridik të dhënë këtyre fakteve (*Pélissier dhe Sassi kundër Francës, nr. 25444/94, § 51*) dhe se, ... një informacion i saktë dhe i plotë i akuzave në ngarkim të një të pandehuri pra dhe i kualifikimit juridik të veprës penale që autoritetet mund të konsiderojnë në ngarkim të tij, është një kusht i rëndësishëm për procesin e rregullt ligjor (*Drassich kundër Italisë, kërkesa nr. 25575/04*). Gjithashtu, GJEDNJ-ja institutin në fjalë e ka shqyrtuar në funksion të garantimit të së drejtës së mbrojtjes të të akuzuarit. Ajo ka theksuar se, e drejta të informohesh për natyrën dhe motivet e akuzës duhet të konsiderohet në këndvështrimin e së drejtës të të pandehurit të përgatisë mbrojtjen e tij. Nëse gjyqtarët e themelit disponojnë, kur kjo e drejtë i është njohur në të drejtën e brendshme, mundësinë për të rikualifikuar faktet, ata duhet të sigurohen që të pandehurit kanë pasur mundësinë të ushtrojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes në mënyrë korrekte dhe efektive. Kjo do të thotë që të pandehurit duhet të informohen në kohë të përshtatshme jo vetëm me motivet e akuzës, pra me faktet materiale që i atribuohen dhe mbi të cilat bazohet akuza, por edhe, dhe në mënyrë të detajuar, me kualifikimin juridik të dhënë këtyre fakteve. *(Drassich kundër Italisë, kërkesa nr. 25575/04).*

33. Kolegji sjell në vëmendje se KEDNJ-ja nuk krijon detyrime për shtetet kontraktuese që të parashikojnë në ligjin e tyre procedura të thjeshtëzuara, ku përfshihet edhe gjykimi i shkurtuar. Por kur këto procedura ekzistojnë, sikurse na kujton GJEDNJ-ja, parimet e procesit të rregullt ligjor kërkojnë që i pandehuri të mos privohet arbitrarisht nga mundësia e përfitimit prej tyre. Në këtë këndvështrim, Kolegji vlerëson se mospranimi i kërkesës së të pandehurit për gjykim të shkurtuar duhet të jetë i arsyetuar dhe i mbështetur në ligj. Ligji procedural shqiptar i parashikon në mënyrë taksative rastet kur kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk duhet të pranohet. Një nga arsyet që parashikon ligji për mospranimin e gjykimit të shkurtuar është kur i pandehuri akuzohet për një vepër penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm, parashikim që ndonëse i qartë në përmbajtjen e dispozitës është reflektuar në interpretime të ndryshme në praktikën gjyqësore, duke passjell nevojën që të shtrohen për njësim pyetjet që do të trajtohen në vijim.

**i. Në lidhje me çështjen e parë të shtruar për njësim**: "*A zbatohet neni 403, pika 2 i Kodit të Procedurës Penale për personat e akuzuar për një krim që Kodi Penal parashikon dënim me burgim të përjetshëm, por ndaj të cilëve ligji ndalon dhënien e një dënimi të tillë?*"

34. Neni 403, pika 2 i KPP-së, parashikon: "*2. Nuk lejohet kërkesa për gjykim të shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm.*". Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se ligjvënësi e ka kufizuar fushën e zbatimit të gjykimit të shkurtuar për një kategori veprash penale, konkretisht për ato vepra penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm. Nisur nga interpretimet e ndryshme të praktikës gjyqësore, për t'i dhënë përgjigje pyetjes së shtruar për njësim, çështja që duhet ndarë është nëse ky ndalim ligjor i referohet vetëm llojit të veprës penale nisur nga rrezikshmëria e saj shoqërore të reflektuar në objektin që cenon apo gjen përjashtim në varësi të subjektit përfitues nga ky rit gjykimi: i pandehur "burrë"; e pandehur "grua" (dënimi maksimal 35 vjet burgim); i mitur në konflikt me ligjin (dënimi maksimal 12 vjet burgim). Për të arritur në një përfundim është e nevojshme fillimisht të sqarohet arsyeja e ligjvënësit në parashikimin e këtij ndalimi, për të konkluduar më pas nëse ka vend për ta aplikuar këtë institut në varësi të subjektit të akuzuar për një krim për të cilin parashikohet dënim me burgim të përjetshëm.

35. Kolegji çmon të sjellë në vëmendje se ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre (neni 1, paragrafi 1 i KP-së). Me këtë formulim KP-ja i referohet ligjit penal për përcaktimin e veprës penale dhe kësisoj vë në plan të parë si element të saj kundërligjshmërinë e veprimit ose mosveprimit. Praktika gjyqësore dhe doktrina pranon se baza juridike për përcaktimin e veprës penale është kundërligjshmëria e saj. Kundërligjshmëria e veprimit ose mosveprimit është shprehje e rrezikshmërisë shoqërore të veprës. Një vepër e kundërligjshme mund të quhet penale kur parashikohet si e tillë në ligjin penal. Ndërsa rrezikshmëria shoqërore është tipari social dhe elementi thelbësor material i veprës penale. Ajo

është kategori objektive që do të thotë se përcaktimi i saj bëhet në bazë të kushteve objektive të shoqërisë, se cilat vepra janë shoqërisht të rrezikshme. Rrezikshmëria është vlerësimi negativ që i bëhet një vepre (veprim ose mosveprim) në një shoqëri të caktuar dhe në një periudhë kohe të caktuar, nga ligjvënësi. Kriteri që ka pasur parasysh ligjvënësi në vlerësimin e një vepre, është sjellja e njeriut që paraqet rrezik për shoqërinë dhe individin. Ky vlerësim apo çmim që i bëhet rrezikshmërisë shoqërore ka karakter objektiv dhe jo subjektiv. Në këtë rast merret për bazë objekti që është dëmtuar ose kundër të cilit drejtohet vepra penale. Sa më i rëndësishëm të jetë ky objekt, pra marrëdhëniet juridike të vendosura e të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal, aq më e rrezikshme është vepra dhe sa më pak i rëndësishëm të jetë objekti, aq më pak e rrezikshme për shoqërinë është vepra. Rrezikshmëria shoqërore e veprës penale është e shkallëzuar; disa vepra penale janë më të rënda, d.m.th., paraqesin rrezikshmëri shoqërore më të madhe. Pra, konkludohet se shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale përcaktohet në radhë të parë nga rëndësia e objektit të prekur ose të vënë në rrezik. Në përshtatje me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale në KP janë parashikuar edhe sanksionet penale. Për ato vepra penale që janë të rënda edhe dënimet penale janë të ashpra; ndërsa për ato që janë më pak të rënda edhe dënimet parashikohen më të lehta. Në vijim të kësaj që u tha kuptohet se veprat penale për të cilat parashikohet dënimi maksimal me burgim të përjetshëm, janë veprat penale më të rënda në rendin shoqëror, të cilat paraqesin shkallën më të lartë të rrezikshmërisë shoqërore për shkak të rëndësisë së objektit që cenojnë, në përshtatje të të cilës ligjvënësi ka parashikuar edhe sanksionin penal. Kjo është e qartë edhe nga parashikimi i nenit 31/1 të KP-së, sipas të cilit: "*Dënimi me burgim të përjetshëm jepet me vendim të gjykatës për kryerjen e një krimi të rëndë.*".

36. Ndërkohë, sikurse u evidentua më lart, gjykimi i shkurtuar si gjykim i posaçëm është parashikuar për herë të parë në KPP-në e vitit 1995, duke gjetur zbatim mbi kërkesën e të pandehurit, me kushtin e vetëm që çështja të mund të zgjidhej në gjendjen që janë aktet. Ndalimi ligjor i parashikuar në pikën 2 të nenit 403 të KPP-së u parashikua për herë të parë në ligjin procedural penal, me ligjin nr. 35/2017, të miratuar në kuadër të reformës në drejtësi. Në relacionin shoqërues të projektligjit që ka ndryshuar këtë dispozitë, thuhet se, "*Në nenin 406 është diskutuar ulja e përfitimit nga gjykimi i shkurtuar në ose parashikimi për aplikimin e këtij riti gjykimi vetëm për një kategori të caktuar veprash penale, duke u përjashtuar veprat e rënda, për të cilat është i nevojshëm zhvillimi i një gjykimi të zakonshëm, veçanërisht kjo në situatën aktuale dhe besimin e ulët të publikut te drejtësia. Kjo çështje i është lënë për vendimmarrje Komisionit të Ligjeve për sa kohë ka qëndrime të ndryshme.*"[11]. Nga përmbajtja e këtij relacioni shoqërues të projektligjit rezulton se në kuadër të ndryshimeve ligjore është diskutuar mes uljes së masës së përfitimit të gjykimit të shkurtuar (nga ajo 1/3) ose përjashtimit në aplikimin e këtij riti gjykimi, për një kategori veprash penale, konkretisht veprat e rënda. Ndërsa, ligjvënësi me ligjin nr. 35/2017, nëpërmjet parashikimit ligjor në paragrafin e dytë të nenit 403 të KPP-së zgjodhi të kufizojë gjykimin e shkurtuar për një kategori veprash penale, duke përjashtuar veprat penale që parashikojnë dënim me burgim të përjetshëm. Sikurse, u evidentua më lart, veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm, për shkak të objektit që cenojnë paraqesin shkallën më të lartë të rrezikshmërisë shoqërore dhe për këtë arsye kategorizohen në veprat penale më të rënda, vepra këto të cilat ligjvënësi shprehimisht i ka përjashtuar nga aksesi në ritet e posaçme të gjykimit me efekt "premial", sikurse është gjykimi i shkurtuar. Në këtë rast ligjvënësi, duke përjashtuar nga ky lloj i posaçëm gjykimi vetëm një kategori të veprave penale, konkretisht veprat penale më të rënda (të tilla konsiderohen ato për të cilat parashikohet dënimi maksimal) ka marrë për bazë objektin që është dëmtuar ose kundër të cilit drejtohet vepra penale. Arrihet në këtë përfundim pasi rrezikshmëria shoqërore ka karakter objektiv dhe jo subjektiv dhe për rrjedhojë, merret për bazë objekti që është dëmtuar ose kundër të cilit drejtohet vepra penale. Ndalimi i përgjithshëm i materializuar në pikën 2 të nenit 403 të KPP-së, objekt diskutimi në çështjen për njësim ka një arsye të fortë: ligjvënësi e kushtëzon zgjedhjen e zbatimit ose moszbatimit të

[11] Shih relacionin e Projektligjit nr. 35/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale", faqe 33.

një instituti të caktuar, në rastin konkret, gjykimin e shkurtuar, me parashikimin abstrakt të veprave penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm (veprat penale më të rënda), duke shprehur në këtë mënyrë vlerësimin e tij "negativ" dukshëm më të lartë ndaj kësaj kategorie veprash penale me rrezikshmëri të theksuar shoqërore në raport me veprat e tjera për të cilat nuk parashikohet një dënim i tillë, si dhe duke ia nënshtruar gjykimin e tyre një trajtimi më "rigoroz".

37. Ligjvënësi me këtë parashikim ligjor kërkon të garantojë realizimin e drejtësisë penale në mënyrë efektive si për të pandehurin ashtu edhe për viktimën e veprës penale. Në këtë kontekst, Kolegji vlerëson se për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm, ndalimi i gjykimit të shkurtuar ka një qëllim domethënës: për krime të kësaj rëndësie, ligjvënësi ka parapëlqyer (zgjedhur) debatin gjyqësor, si rruga më e sigurt për të shmangur gabimin gjyqësor, si dhe për të garantuar maksimalisht të drejtat e të pandehurit, por edhe të viktimës së veprës penale nëpërmjet pjesëmarrjes në një gjyq oral dhe kontradiktor për sqarimin e të vërtetës *(qëllim që rezulton edhe nga relacioni shoqërues i projektligjit që ka ndryshuar këtë dispozitë)*. Në këtë vështrim nuk mundet kurrsesi që këto garanci të mos garantohen në mënyrë të barabartë për të gjithë personat e akuzuar për një vepër penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm. Nuk ka asnjë kuptim që të pandehurve "burra madhorë" të akuzuar për këto vepra penale t'u garantohet standard më i lartë i procesit ligjor se sa "të miturve në konflikt me ligjin" dhe "grave" të akuzuar po për të njëjtat krime. Këtu duhet theksuar se, debati gjyqësor efektiv dhe oral mbi çdo provë dhe shqyrtimi i provave sipas rregullave të gjykimit të zakonshëm ku provat merren, formësohen, debatohen dhe shqyrtohen drejtpërdrejt para gjykatës, rrit garancitë për dhënien e drejtësisë efektive përmes procesit të rregullt ligjor, garanci që duhen ofruar në mënyrë të barabartë për të gjithë të akuzuarit për këto krime të rënda.

38. Ndonëse GJEDNJ-ja nuk gjen shkelje në vullnetin e lirë dhe të qartë të të pandehurit për të hequr dorë nga e drejta e debatit gjyqësor për provat, kjo e drejtë për vepra penale të një rëndësie të tillë (sikurse ato për të cilat parashikohet dënim burgim të përjetshëm) nuk prevalon mbi nevojën e shmangies së gabimit gjyqësor dhe sqarimin sa më të padyshimtë të të vërtetës në një gjykim kontradiktor dhe me të gjitha garancitë e një procesi të rregullt ligjor, në kuadër të dhënies së një vendimi të ligjshëm dhe të drejtë. Është e vërtetë që e drejta për të kërkuar zbatimin e një riti alternativ gjykimi, kur njihet një e drejtë e tillë, përbën një nga mënyrat më të rëndësishme në të cilën gjen shprehje e drejta e mbrojtjes, por është po aq e vërtetë që mohimi ligjor i një mundësie të tillë për një kategori veprash penale (sikurse krimet më të rënda të rendit shoqëror) nuk e cenon thelbin e kësaj të drejte. Aksesi në ritet e posaçme të gjykimit është pjesë përbërëse e së drejtës së mbrojtjes sipas ligjit procedural penal dhe Kushtetutës (neni 31) vetëm me përmbushjen e disa kushteve që ligjvënësi ka parashikuar si kriter për zbatimin e tyre (riteve të posaçme). Vetëm me përmbushjen e këtyre kushteve, sikurse do të trajtohet në vijim, një e drejtë e tillë duhet të garantohet ose të paktën duhet garantuar ndreqja e pasojave nëpërmjet dhënies së shpërblimit (uljes së dënimit me 1/3) që aksesi në kohë në këtë lloj riti do të kishte lejuar, sa herë që gjykimi i shkurtuar është mohuar padrejtësisht për shkak të një gabimi të prokurorit në ngritjen e akuzës penale, vlerësimit të gabuar të gjykatës apo edhe si pasojë e ndryshimit të akuzës gjatë procesit gjyqësor. Por nga përmbajtja e ligjit procedural penal dhe Kushtetutës, nuk mund të nxirret si përfundim e drejta e çdo të pandehuri për të aksesuar në të gjitha ritet e posaçme të gjykimit të parashikuar nga ligji procedural penal. Në këtë kuptim, mundësia për të kërkuar zbatimin e një riti procedural që ndikon në masën e dënimit përfundimtar, qartazi nuk mund të konsiderohet një kusht *sine qua non* për një mbrojtje efikase të pozitës juridike të të pandehurit, për sa kohë ajo përjashtohet për të gjitha ato vepra për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm.

39. Për sa më sipër, nisur nga një interpretim literal dhe logjik, Kolegji vlerëson se parashikimi ndalues i bërë në nenin 403/2 të KPP-së, i referohet objektit të veprës penale që mbron norma e posaçme e KP-së, pra rëndësisë së marrëdhënies juridike që kjo normë mbron dhe jo elementeve të tjerë të figurës së veprës penale. Nëpërmjet këtij parashikimi ligjor, ligjvënësi mbi bazën e një politike penale ka synuar të identifikojë një kategori veprash penale që duhet t'i nënshtrohen një trajtimi më "rigoroz", për shkak të "alarmit social" (ndjeshmërisë së publikut) të gjeneruar nga këto lloj krimesh, i cili jo domosdoshmërisht është i lidhur me masën e dënimit përfundimtar. Nëse ligjvënësi

do të dëshironte të kundërtën ai mund t'i referohej dënimit përfundimtar dhe një teknikë e tillë ligjore është prezente në legjislacionin material penal sikurse shfaqet me rastin e institutit të pezullimit të dënimit[12], parashkrimin e ekzekutimit të dënimit[13], rehabilitimin[14], caktimin e masave të sigurimit personal[15], apo duke e lidhur me subjektin e proceduar, sikurse parashikohet në ligjin procedural penal në rastin e caktimit të masës së sigurimit arrest në burg.[16] Vlen të evidentohet se ligjvënësi, për arsye të politikës penale, edhe në raste të tjera, aplikimin apo jo të një instituti procedural e lidh me rëndësinë e veprës dhe jo (ose vetëm) me masën e dënimit përfundimtar sikurse në gjykimin e posaçëm me marrëveshje[17], përgjimet[18], caktimin e masës së sigurimit personal arrest në burg ndaj një kategorie të privilegjuar subjektesh[19].

40. Nga ana tjetër me këtë parashikim ligjor, ligjvënësi ka hequr mundësinë ligjore që subjektet e proceduara për veprat më të rënda penale, të përfitojnë ulje dënimi ose t'i shmangen mundësisë së dënimit me burgim të përjetshëm. Kjo do të thotë se ligjvënësi ka zgjedhur që të mos përfitojnë shpërblim (ulje) në masën e dënimit përfundimtar autorët e veprave penale më të rënda që u përmendën në mënyrë ezauruese më lart. Qartazi, dispozita, paragrafi i dytë, i nenit 403 të KPP-së, ndalon aplikimin e këtij riti procedural, me pasojë pamundësinë e aplikimit, për këtë shkak, të zbritjes, uljes së dënimit në masën e 1/3 të tij (përcaktimi i nenit 406/1 të KPP-së) kur gjykohen vepra penale (kur akuza i atribuon të pandehurit vepra penale të kësaj natyre) për të cilat parashikohet (si sanksion) lloji i dënimit me "burgim të përjetshëm", duke mos e lidhur këtë parashikim (ndalim) me statusin "moshën e të pandehurit" apo "gjininë e të pandehurit", të gjykuar, në kuptimin e pamundësisë së ndikimit të privilegjeve të toleruara prej legjislatorit në trajtimin sanksionues të subjekteve "të mitur në konflikt me ligjin" apo "gra" (të cilat evitojnë aplikimin e llojit të dënimit "burgim i përjetshëm" për këto lloje subjektesh), në funksion të aksesit, të pakufizuar, të tyre, për shkak të këtij "statusi" apo "gjinie" edhe në këtë "zonë të konsideruar të padepërtueshme", por duke e reduktuar vetëm në llojin e veprës penale të atribuuar të pandehurit, sipas akuzës. Nëse ligjvënësi do të dëshironte të kundërtën ai mund të parashikonte kufizime në aplikimin e këtij ndalimi të përgjithshëm ligjor për një kategori subjektesh ndonëse të akuzuar për këto vepra penale, sikurse ka zgjedhur ta bëjë në rite të tjera të posaçme gjykimi, siç është gjykimi me marrëveshje *(Në këtë lloj gjykimi arritja e marrëveshjes lejohet për veprat penale, për të cilat ligji parashikon një dënim në maksimum jo më shumë se 7 vjet burgim. Ky kufizim nuk gjen zbatim në rastin e bashkëpunëtorit të drejtësisë – neni 406/d, pika 2 të KPP-së).*

41. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji vlerëson se lejimi apo jo i gjykimit të shkurtuar për vepra penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm është çështje që përfshihet në diskrecionin e ligjvënësit. Kolegji çmon se nuk është në kundërshtim me Kushtetutën ky ndalim ligjor, i bazuar në titullin abstrakt të veprës penale, të cilën ligjvënësi e ka vendosur kundrejt aksesit në gjykimet e posaçme me efekt shpërblyes. Individualizimi i veprave penale që do t'i nënshtrohen një trajtimi më "rigoroz", mbi bazën e një politike penale të lidhur në mënyrë të veçantë me ndjeshmërinë e publikut të gjeneruar nga secila prej këtyre veprave penale, e cila jo domosdoshmërisht lidhet me masën përfundimtare të dënimit, përfshihet në sferën e diskrecionit të ligjvënësit, diskrecion ky që për nga qëllimet që ndjek nuk rezulton as arbitrar dhe as i paarsyeshëm edhe në një interpretim në aspektin kushtetues. Sikurse u evidentua më lart, sistemi juridik penal parashikon një gamë të gjerë rastesh në të cilat, për arsye të politikës penale, ligjvënësi e lidh me llojin e veprës penale dhe jo (ose vetëm) me masën e dënimit përfundimtar zbatimin e një trajtimi substancial ose procedural më rigoroz. Në këtë vështrim, trajtimi i ndryshëm i personave ndaj të cilëve ligji ndalon dhënien e një dënimi me burgim të përjetshëm, por ndërkohë të akuzuar për një krim për të cilin parashikohet një dënim i tillë, me personat e akuzuar për vepra penale të tjera, për të cilat ligji penal nuk parashikon dënim me burgim të përjetshëm, nuk përbën cenim të parimit të barazisë ligjore (në kuptim të nenit 18 të Kushtetutës dhe 14 të KEDNJ-së). Kjo për arsye se vetëm të parët janë faktikisht të akuzuar për kryerjen e një krimi që ka

[12] Nenet 59, 63 tëë Kodit Penal.
[13] Neni 68 i Kodit Penal.
[14] Neni 69 i Kodit Penal.
[15] Neni 229/2 i KPP-së.
[16] Neni 230/2 i KPP-së.
[17] Neni 406/d i KPP-së.
[18] Neni 221/1/a i KPP-së.
[19] Neni 230/1 i KPP-së.

një rrezikshmëri të theksuar shoqërore që ligjvënësi në mënyrë abstrakte e konsideron të papajtueshëm me gjykimin e shkurtuar.

42. Nuk ka dyshim se me këtë ndalim ligjor, ligjvënësi ka eliminuar mundësinë ligjore të zbritjes, uljes së dënimit në masën e 1/3 të tij (përcaktimi i nenit 406/1 të KPP-së) kur gjykohen vepra penale (kur akuza i atribuon të pandehurit vepra penale të kësaj natyre) për të cilat parashikohet (si sanksion) lloji i dënimit me "burgim të përjetshëm". Relacioni shoqërues i projektligjit nr. 35/2017, përmend si qëllim nevojën që subjektet e akuzuar për veprat penale të rënda të gjykohen nëpërmjet procedurës së zakonshme të gjykimit, gjykim ky që jo vetëm forcon garancitë procedurale të të pandehurit, por edhe parandalon gabimin gjyqësor në këto gjykime të një rëndësie të veçantë, duke siguruar pjesëmarrjen me të gjitha garancitë ligjore si për të pandehurin edhe për viktimën e veprës penale, në zbardhjen e të vërtetës. Në këtë pikë duhet thënë se nuk mund të ketë trajtim të ndryshëm procedural kundrejt subjekteve të akuzuar për të njëjtat vepra penale për të cilat vepron ndalimi i parashikuar në nenin 403/2 të KPP-së. Kjo për arsye se garancitë më të mëdha që ofron shqyrtimi i çështjes me procedurë të zakonshme gjykimi, kurrsesi nuk mund të kufizohen ndaj personave të akuzuar për vepra penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm, por ligji e ndalon dhënien e një dënimit të tillë (të miturit në konflikt me ligjin dhe gratë).

43. Nga ana tjetër, Kolegji çmon se në parashikimin e ndalimit ligjor me nenin 403/2 të KPP-së, as qëllimet e synuara dhe as mjeti i përdorur nga ligjvënësi në arritjen e tyre nuk janë të papajtueshme me Kushtetutën. Përkundrazi, duhet thënë se një zgjedhje e tillë e ligjvënësit për t'i gjykuar veprat penale më të rënda të parashikuara me ligj, nëpërmjet një gjykimi kontradiktor dhe oral para trupës gjyqësore kolegjiale, me të gjitha garancitë që ofron gjykimi me procedurë të zakonshme, përfshihet në sferën e zgjedhjes diskrecionale të ligjvënësit, kundrejt të cilës nuk mund të mbivendoset një vlerësim i pavarur i këtij Kolegji të Gjykatës së Lartë. Ky Kolegj i kësaj gjykate vlerëson se edhe përballë një situate në të cilën i pandehuri kërkon gjykim mbi aktet (madje pohon fajësinë e tij), nuk është e paarsyeshme zgjedhja e ligjvënësit në parashikimin e zhvillimit të një gjykimi oral dhe kontradiktor, në të cilin gjen shprehje në mënyrën më të mirë garancia e "së drejtës për tu mbrojtur duke provuar" për vërtetimin e fakteve dhe nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse, në interes të të gjithë shoqërisë dhe viktimave të veprës penale.

44. Në lidhje me "viktimën e veprës penale" sipas Direktivës 2012/29/BE të Parlamentit dhe Komisionit Evropian datë 25.10.2012 "*Për përcaktimin e standardeve minimum për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimës së veprave penale dhe zëvendësimin e Vendimit Kuadër të Komisionit 2001/220/JHA*" (Direktiva 2012/29/BE), në të cilën është bazuar ndryshimi i bërë në KPP me ligjin nr. 35/2017, duhet të kuptohet jo vetëm individi që ka pësuar një dëm (fizik, mendor, emocional, apo ekonomik) të shkaktuar drejtpërdrejt nga vepra penale, por edhe anëtari i familjes së personit, vdekja e të cilit është shkaktuar nga një vepër penale dhe i cili ka pësuar një dëm si rezultat i vdekjes së personit. Viktimës së veprës penale neni 58/1 i KPP-së i garanton të drejtën të thirret në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore, si dhe të dëgjohet nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar. Në këtë kontekst, gjykimi i veprave penale më të rënda, nëpërmjet procedurës së gjykimit të zakonshëm i jep mundësi edhe këtij subjekti që të marrë pjesë në gjykim dhe të ushtrojë të drejtat që i njeh KPP-ja, duke garantuar të drejtën për t'u dëgjuar veçanërisht për këto lloje krimesh të rënda që duhet theksuar cenojnë thelbin (bërthamën) e lirive dhe të drejtave të viktimave.

45. Në lidhje me sa më sipër, sillet në vëmendje që Gjykata Kushtetuese ka theksuar se ligjvënësi është përgjegjës për hartimin e politikave penale, pra për marrjen e tërësisë së masave me karakter penal, që synojnë të parandalojnë kriminalitetin në një vend dhe një kohë të caktuar, si dhe për përcaktimin e strategjisë së përgjithshme të luftës kundër kriminalitetit në vend dhe në këtë drejtim ligjvënësit i njihen hapësira për zgjidhje diskrecionale që i rezervohen vetëm atij. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit ligjvënësi, lidhur me vlerësimin e mjetit të zgjedhur për ndëshkimin e shkelësve të ligjit dhe qëllimin që kërkohet të arrihet, ka një hapësirë të lirë dhe të gjerë veprimi, e cila mund të shqyrtohet në shkallë të kufizuar nga kjo gjykatë (*shih vendimin nr. 1, datë 12.1.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërkohë, i përket Gjykatës Kushtetuese të analizojë proporcionalitetin e kësaj mase në raport me gjendjen dhe me shkeljet për të cilat është parashikuar dhënia e tyre (*shih vendimin nr. 12, datë*

*14.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata Kushtetuese ka theksuar se proporcionalitetin e një kufizimi ajo e vlerëson rast pas rasti dhe duke pasur parasysh disa aspekte, si balancën mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik ose mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar atë, të drejtën e cenuar dhe synimin që kërkon të arrijë ligjvënësi, aspekte që nuk duhet të analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëra tjetrën. Vendosja me ligj e llojit të dënimeve është përgjithësisht diskrecion i pushtetit legjislativ, i cili, në përputhje me kërkesat dhe me nevojat në ndryshim të shoqërisë, bën rregullimin ligjor përkatës, por gjykata analizon proporcionalitetin e kësaj mase në raport me gjendjen dhe me shkeljet për të cilat është parashikuar dhënia e tyre (*shih vendimin nr. 12, datë 14.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Me ndryshimet që pësoi paragrafi 2 i nenit 403 të KPP-së, gjykimi i shkurtuar nuk do të pranohet në rastet kur akuza e ngritur ndaj të pandehurit parashikon dënim me burgim të përjetshëm. Para ndryshimeve një ndalim i tillë nuk ekzistonte: në rast se i pandehuri deklarohej fajtor, masa e dënimit përfundimtar ulej me 1/3 ose dënimi me burgim të përjetshëm zëvendësohej me masën maksimale të dënimit me burgim që parashikonte KP-ja. Arsyeja kryesore e ligjvënësit për miratimin e këtij ndryshimi referuar relacionit shoqërues të projektligjit nr. 35/2017, rezulton se mbështetet në nevojën e forcimit të garancive dhe kufizimin e mundësive të gabimit gjyqësor, në rastet e akuzave veçanërisht të rënda. Në këndvështrimin e ligjvënësit, për raste të kësaj natyre, garancitë e procesit kontradiktor fitojnë përparësi kundrejt nevojës për të përfituar në planin e ekonomisë gjyqësore dhe të efektivitetit të ndjekjes penale. Në këtë vështrim, masat e miratuara nga ligjvënësi në parashikimin e rasteve të përjashtimit objektiv për veprat penale me rrezikshmëri të veçantë shoqërore (pikërisht për shkak të objektit që cenojnë) nga shqyrtimi i tyre mbi bazën e akteve të hetimit paraprak (gjykimi i shkurtuar) dhe si rrjedhojë edhe nga përfitimi premial (ulja në 1/3 të masës së dënimit dhe mosaplikimi i burgimit të përjetshëm) paraqesin një zgjidhje "balancuese", sigurisht në diskrecionin e ligjvënësit, të cilit i përket e drejta e zgjedhjes për të zgjeruar perimetrin e "drejtësisë së negociuar".

47. Në lidhje me argumentet se me parashikimin e këtij ndalimi ligjor ligjvënësi ka synuar që të rrisë numrin e dënimeve me burgim të përjetshëm për autorët e këtyre veprave, Kolegji vlerëson se duhet mbajtur në konsideratë nga ana tjetër se jo domosdoshmërisht në përfundim të gjykimit, konkludohet në dhënien e një dënimi të tillë; kjo për arsye se për subjektet "i mitur në konflikt me ligjin" dhe "gra", dhënia e dënimit me burgim të përjetshëm është i ndaluar me ligj (neni 31 i KP-së), ndërsa për subjektet e tjera (të pandehur "burra" madhorë) gjykata ka gjithmonë mundësinë që në prani të disa rrethanave lehtësuese (nenet 48, 49 të KP-së) të caktojë një dënim me burgim (jo të përjetshëm). Pra, gjykimi nuk përfundon në çdo rast me dhënien e një dënimi përfundimtar me burgim të përjetshëm, pasi edhe personat që akuzohen për këtë kategori krimesh në përfundim të gjykimit kur gjenden fajtor mund të marrin një dënim më të lehtë se ai maksimal. Por edhe në këtë rast, ndalimi i përgjithshëm ligjor i parashikuar me nenin 403/2 të KPP-së heq mundësinë ligjore për të përfituar shpërblim (ulje) në masën e dënimit përfundimtar (me 1/3). Pra, përjashtimi nga përfitimi që rrjedh nga aplikimi i gjykimit të shkurtuar gjen zbatim për shkak të llojit të veprës dhe pavarësisht masës së dënimit përfundimtar.

48. Në vijim, Kolegji çmon të sjellë në vëmendje se neni 31/2 i KP-së parashikon se *"Dënimi me burgim të përjetshëm nuk jepet ndaj personave që në kohën e kryerjes së krimit nuk kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, si dhe për gratë."*. Neni 51 "Dënimi për të miturit", parashikon se *"Për të miturit, që në kohën e kryerjes së veprës penale nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç, dënimi nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikon ligji për veprën penale të kryer. Rregullat për caktimin e dënimit për të miturin parashikohen në KDPM."*. Neni 5 i KDPM-së parashikon se *"Dispozitat e Kodit Penal, të Kodit të Procedurës Penale dhe të ligjeve të tjera, zbatohen në procesin e drejtësisë penale për të mitur vetëm për çështje që nuk janë të rregulluara nga ky Kod ose nëse përmbajnë rregullime më të favorshme për të miturit."*. Ndërsa, neni 97, parashikon se, *"1. Burgimi ndaj një të mituri mund të zbatohet në rast se ai ka kryer një vepër penale për të cilën minimumi i dënimit të parashikuar është 7 vjet dhe kur ky dënim është i nevojshëm për shkak të natyrës, rrezikshmërisë së lartë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së fajësisë. 2. Për të miturin dënimi me burgim nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikohet për veprën penale të kryer, por jo më shumë se 12 vjet. 3. Për përcaktimin e masës së dënimit për të miturin, gjykata merr parasysh dhe i kushton vëmendje të veçantë të gjitha rrethanave që lidhen me shkallën*

*e pjekurisë së të miturit dhe kohën që nevojitet për edukimin dhe formimin profesional. Megjithatë, në varësi të shkallës së fajësisë, dënimi mund të jetë më i shkurtër, kur vlerësohet se është i mjaftueshëm për të arritur qëllimin e tij.”.*

49. Referuar kuadrit të mësipërm ligjor, Kolegji nuk ka se si të mos ndajë të njëjtin qëndrim ligjor se në rastet kur i mituri është autor i veprës penale, nga gjykata është i pamundur caktimi i dënimit me burgim të përjetshëm (apo më i lartë se 12 vjet), pikërisht për shkak se këtë e ndalon vetë ligji. KDPM-ja parashikon të drejta të posaçme për të miturin në konflikt me ligjin, duke garantuar mbrojtjen e të miturit dhe interesin e tij më të lartë, në përputhje me Kushtetutën dhe standardet ndërkombëtare, duke vënë theksin në forcimin e sistemit të drejtësisë restauruese dhe mbrojtjen efektive të të drejtave procedurale të fëmijëve. KDPM-ja është një akt ligjor i veçantë pasi në përmbajtjen e tij materiale dhe procedurale, ka të përfshirë të gjitha dispozitat për të miturit nga KP-ja, KPP-ja, ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ligji “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, gjithashtu rezulton që është hartuar në përputhje të plotë edhe me *Konventën mbi të drejtat e fëmijës*, jo vetëm në kontekstin e të drejtave dhe të ngritjes së një sistemi mbrojtjeje për të miturit, por edhe për realizimin efektiv të tyre. Është e qartë se, legjislatori me miratimin e KDPM-së ka pasur si synim që për rastet kur autor i veprave penale është i mituri t’i ofrojë një mbrojtje të posaçme kësaj kategorie duke përcaktuar norma të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin (neni 1/1 i KDPM-së). Madje ky Kod përmban rregullime edhe për të rinjtë nga grup-mosha 18 deri në 21 vjeç, sipas parashikimeve në nene të veçanta të tij. Në këtë aspekt, si dhe referuar nenit 5 të KDPM-së, Kolegji thekson se ky Kod është ligj i mëvonshëm (*lex posteriori*) ndaj KPP-së dhe KP-së, ashtu edhe ligj i posaçëm (*lex speciali*), në raport me këto Kode.

50. Mirëpo, Kolegji çmon të sjellë në vëmendje se gjykimi i shkurtuar është një rit procedural që normohet në KPP, ndërsa dispozitat e KDPM-së nuk kanë ndonjë parashikim ligjor lidhur me gjykimet e posaçme, e aq më tepër ndonjë parashikim të ndryshëm dhe më të favorshëm që do të kishte përparësi për tu zbatuar gjatë gjykimit për të miturit në konflikt me ligjin. Për këtë arsye, nuk mund të pranohet zbatimi i parimit të specialitetit si argument për përjashtimin e të miturit në konflikt me ligjin nga ndalimi ligjor i parashikuar në nenin 403/2 të KPP-së, pasi ky parim gjen zbatim vetëm kur dy norma ligjore rregullojnë të njëjtën lëndë, me pasojën që zbatohet norma e posaçme, e cila ka përparësi dhe shmang normën e përgjithshme *(lex specialis derogat legi generali)*. Raporti i specialitetit ekziston kur elementet përbërëse të një norme penale (të përgjithshme) janë të gjithë të pranishëm edhe në një normë tjetër (e posaçme), e cila përveç tyre, përmban edhe disa elemente më specifike që e cilësojnë normën e dytë, të posaçme në raport me normën e parë (*vendimi njësues nr. 3, datë 2.11.2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*). Gjithashtu, Kolegji çmon se as parimi i subsidiaritetit nuk gjen zbatim në zgjidhjen e çështjes të shtruar për njësim, pasi ky parim ndërhyn për të mbuluar një hapësirë të lënë nga normë tjetër, apo kur dy a më shumë norma mbrojnë në shkallë të ndryshme marrëdhënien juridike. Sipas këtij parimi, zbatimi i njërës normë në të njëjtën kohë për të njëjtin fakt, përjashton zbatimin e normës penale tjetër, në rastin e mbrojtjes së marrëdhënieve juridike që mbrohen në mënyrë progresive dhe të përshkallëzuar nga një nivel më i ulët drejt një niveli më të lartë.

51. Rast i tillë për shembull mund të jetë instituti i pezullimit të dënimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik parashikuar në nenin 63 të KP-së. Kjo alternativë e dënimit me burgim edhe me ndryshimet ligjore[20] nuk parashikoi kushte më të favorshme për zbatimin ndaj të miturve. Ndërkohë, ndryshime më të favorshme në këtë drejtim paraqet KDPM-ja, neni 101, i të cilit parashikon rregullime të detajuara në lidhje me kryerjen e një pune me interes publik për të miturin[21] dhe që në këtë rast përbën normë të posaçme dhe subsidiare, duke shmangur rregullimet e

[20] Ndryshuar me ligjin nr. 10023, datë 27.11.2008 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.

[21] Neni 101/6 i KDPM-së parashikon se, *“6. Puna me interes publik, si një vendim plotësues, mund të zbatohet ndaj një të mituri edhe në rastet kur neni përkatës i Kodit Penal nuk e parashikon atë si një lloj dënimi”.*

përgjithshme të nenit 63 të KP-së. Gjithashtu, në ndryshim me rregullimet e përgjithshme të KP-së, në përputhje me parimin e zbatimit të dënimit me burgim si mjeti i fundit i mundshëm, KDPM-ja ka sjellë rregullime më të favorshme edhe në lidhje me kohëzgjatjen dhe kriteret e zbatimit të dënimit me burgim për të miturin (neni 97/2 i KDPM-së), të cilat përbëjnë normë të posaçme dhe zbatohen në raport me ato të KP-së. Në këtë kontekst, nuk mund të bëhet referim në parimet e mësipërme, pasi asnjë dispozitë e KDPM-së nuk ka ndonjë parashikim në lëndën e gjykimit të shkurtuar aq më tepër ndonjë parashikim më të favorshëm për të miturin në konflikt me ligjin me qëllim që të ketë bazë ligjore përjashtimi nga ndalimi ligjor i parashikuar në nenin 403/2 të KPP-së.

52. Pavarësisht parimit të mbrojtjes më të lartë të të miturit, Kolegji vlerëson se ky parim nuk do të thotë moszbatueshmërinë e instituteve të KPP-së apo Kodit Penal, sikurse i ka parashikuar ligjvënësi. Në mungesë të rregullimeve të posaçme ligjore në KDPM lidhur me një institut të parashikuar në KP apo KPP, nuk mund të konkludohet në përjashtimin e zbatimit të institutit në fjalë për të miturin në konflikt me ligjin, pasi kjo mënyrë do të çonte në krijimin e një norme të re të së drejtës penale të posaçme, duke hyrë kështu në juridiksionin ligjbërës. Duke ndarë të njëjtin qëndrim me përfaqësuesin e Prokurorisë së Përgjithshme, Kolegji çmon se pavarësisht interpretimeve të ndryshme që mund të bëhen në kuadër të karakterit human të së drejtës apo parimit të interesit më të lartë të të miturit, interpretimet që do të rezultonin në krijimin e një norme të re, e kapërcejnë juridiksionin lëndor të kësaj gjykate. Në këtë kontekst vlen të theksohet se ekzistojnë një sërë dispozitash në KP dhe KPP që reflektojnë parimet e humanizmit apo diskriminimit pozitiv të këtyre kategorive të subjekteve të veprave penale dhe kësisoj, Kolegji çmon se nuk mund të bëhen interpretime për një diskriminim të mëtejshëm pozitiv të tyre në mungesë të një parashikimi ligjor (diskrecion i ligjvënësit).

53. Zbatimi i nenit 403/2 të KPP-së duhet të bëhet nga gjykatat nisur nga parashikimi abstrakt i llojit të veprës penale për të cilën është ngritur akuza nga prokurori dhe jo nga masa përfundimtare e dënimit. Sipas Gjykatës Kushtetuese, dënimi penal është rezultat i vlerësimit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, nga njëra anë, dhe shkallës së fajit të autorit të saj, nga ana tjetër. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se përcaktimi i veprave penale dhe llojeve të dënimeve është në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e cila duke shqyrtuar të gjitha elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënimit për autorët e veprave penale *(shih vendimet nr. 47 datë 26.7.2012; nr. 12 datë 19.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese)*. Për sa më sipër, të gjitha rregullimet e posaçme që sanksionojnë parime të dënimit për të miturit në konflikt do të merren në shqyrtim dhe do të gjejnë zbatim në momentin e individualizimit të dënimit, duke i dhënë të gjitha garancitë dhe mbrojtjen e veçantë kësaj kategorie të posaçme të subjekteve të procesit penal, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor kur fajësia është vërtetuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Madje, në përputhje me parimin që masa e dënimit me burgim të jetë masa e fundit që mund të jepet, mund të gjejë zbatim edhe neni 52 i KP-së që ka parashikuar mundësinë e përjashtimit të të miturit nga dënimi, si një dispozitë më e favorshme dhe në interesin më të lartë të të miturit në konflikt me ligjin.

54. Edhe në një interpretim historik të parashikimeve ligjore, Kolegji konstaton se si ndryshimet e KPP-së me ligjin nr. 35/2017 dhe KDPM-ja janë pjesë e kuadrit ligjor të reformës në drejtësi, pra i takojnë të njëjtës kohë e për rrjedhojë të njëjtës qasje të ligjvënësit ndaj zhvillimeve shoqërore. Nëse ligjvënësi do të kishte si synim qasjen e kundërt të praktikës gjyqësore, kjo do të evidentohej në harmonizimin në këtë drejtim të këtyre dy ligjeve. Ritheksohet se dispozitat e KDPM-së nuk kanë ndonjë parashikim ligjor lidhur me gjykimet e posaçme e aq më tepër ndonjë parashikim të ndryshëm që do të kishte përparësi për t'u aplikuar gjatë gjykimit për të miturin në konflikt me ligjin. Ndërkohë, neni 5 i KDPM-së parashikon se për ato çështje që nuk janë të rregulluara nga ky Kod zbatohen dispozitat e KPP-së. Ndërsa kur për të njëjtën çështje ka parashikime si nga KP-ja, KPP-ja dhe nga KDPM-ja, atëherë do të gjejnë zbatim ato rregullime më të favorshme për të miturit,

pavarësisht se në cilin Kod parashikohen.[22] Për shembull kryerja e një pune me interes publik[23], referuar KDPM-së mund të caktohet si një dënim plotësues ose si një dënim alternativ. KDPM-ja nuk ka parashikuar shprehimisht mundësinë që gjykata të mund të mjaftohet vetëm me dënimin plotësues. Megjithatë, në këtë rast mund të gjejnë zbatim rregullimet e KP-së që në raste të caktuara mundëson caktimin e vetëm dënimit plotësues.[24] Gjithashtu, përmbushja e detyrimeve të caktuara sipas nenit 102 të KDPM-së, duke mos qenë një listë shteruese, mund të bëhet duke caktuar gjykata edhe detyrime të tjera të parashikuara në nenin 60 të KP-së ose detyrime që çmon se janë në interesin më të mirë të të miturit. Shembujt e mësipërm, sillen në vëmendje për të kuptuar se vetëm në rast se ka parashikime për të njëjtën lëndë (për të njëjtin institut të së drejtës) në KP, KPP ashtu edhe në KDPM, do të gjejnë zbatim ato rregullime më të favorshme dhe që përmbushin interesin më të lartë të të miturit në konflikt me ligjin në kuptim të nenit 5 të KDPM-së. Përndryshe institutet ligjore në mungesë të një përcaktimi tjetër ligjor, do të zbatohen ashtu sikurse janë parashikuar nga ligjvënësi në njërin prej ligjeve procedural apo material penal. Ky përfundim bazohet edhe në nenin 2/1 të KPP-së me titull "Respektimi i normave procedurale" që përcakton se *"2. Dispozitat procedurale penale janë të zbatueshme edhe për të pandehurit e mitur për aq sa nuk parashikohet ndryshe në ligjin e posaçëm në fuqi."*.

55. Për sa më lart mund të sintetizohet se trajtimi sanksionues i privilegjuar, i toleruar prej legjislatorit për "të miturit në konflikt me ligjin" dhe "gratë", që presupozon pamundësinë e aplikimit ndaj tyre të llojit të dënimit me "burgim të përjetshëm", si dhe të një dënimi më të lartë se 12 vjet burgim (për të miturit në konflikt me ligjin), nuk paraqet asnjë lloj ndikimi në drejtim të evitimit të ndalimit të përgjithshëm, të përcaktuar në nenin 403/2 të KPP-së, përjashtues apriori, i së drejtës për të pasur akses në ritin procedural të "gjykimit të shkurtuar", të subjekteve të gjykuara për veprat penale të atribuuara prej akuzës, që parashikojnë si titull sanksionues, llojin e dënimit me "burgim të përjetshëm".

56. Në përfundim të kësaj analize, në lidhje me çështjen e shtruar për njësim, Kolegji mban këtë qëndrim njësues: **"Ndalimi i parashikuar nga neni 403, pika 2 i Kodit të Procedurës Penale, zbatohet edhe për subjektet ndaj të cilëve ligji penal ndalon dhënien e dënimit me burgim të përjetshëm".**

**ii. Në lidhje me nënçështjen e parë të shtruar për njësim**: "*A zbatohet procedura e gjykimit të shkurtuar kur akuza është për një vepër penale që përmban dënimin me burgim të përjetshëm, por është cilësuar e mbetur në tentativë?*"

57. Në dhënien përgjigje pyetjes së mëparshme, Kolegji arriti në përfundimin se paragrafi i dytë, i nenit 403 të KPP-së, ndalon aplikimin e këtij riti procedural kur gjykohen vepra penale për të cilat parashikohet (si sanksion) lloji i dënimit me "burgim të përjetshëm", duke e lidhur këtë ndalim vetëm me llojin e veprës penale të atribuuar të pandehurit, sipas akuzës. Duke pasur parasysh këtë përfundim, Kolegji vlerëson se argumentet në lidhje me çështjen e parë marrin vlerë dhe për këtë çështje të shtruar për njësim/zhvillim. Sikurse është argumentuar më lart, ligjvënësi në parashikimin e këtij ndalimi ligjor ka shprehur vlerësimin e tij negativ për veprat e rënda për të cilat parashikohet si sanksion lloji i dënimit me burgim të përjetshëm, duke iu referuar në mënyrë abstrakte vetëm objektit të veprës penale që është cenuar apo vënë në rrezik dhe jo fazave të kryerjes së saj.

58. Kodi Penal shqiptar (në fuqi), tentativën e ka rregulluar në dy nene që janë nenet 22 dhe 23 të tij. Sipas nenit 22 vepra penale quhet e mbetur në tentativë kur, megjithëse personi ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për ta kryer atë, vepra ndërpritet e nuk përfundohet për rrethana të pavarura nga vullneti i tij. Nisur nga kuptimi që ligji penal i jep tentativës, si dhe doktrinës së të drejtës penale, ky institut përbëhet nga disa elemente. *Elementi i parë* i rëndësishëm i tentativës është ndërmarrja nga personi i veprimeve të drejtpërdrejta në kryerjen e veprës penale. Kjo do të thotë që vepra penale ka filluar të kryhet dhe personi me veprimet e tij ka cenuar ose ka rrezikuar të mirat juridike që mbrohen nga legjislacioni penal. Për të përcaktuar nëse personi ka ndërmarrë veprime të drejtpërdrejta për realizimin e veprës penale një rëndësi të madhe,

[22] Neni 5 "Raporti me ligjet e tjera": *"Dispozitat e Kodit Penal, të Kodit të Procedurës Penale dhe të ligjeve të tjera, zbatohen në procesin e drejtësisë penale për të mitur vetëm për çështje që nuk janë të rregulluara nga ky Kod ose nëse përmbajnë rregullime më të favorshme për të miturit".*

[23] Neni 101 i KDPM-së.

[24] Neni 30/2 i KP-së.

përveç anës objektive ose tërësisë së veprimeve të jashtme që kryen ai për realizimin e veprës penale, paraqet edhe ana subjektive e personit ose qëndrimi psikik që ai mban ndaj veprimeve të kryera dhe pasojave që vijnë prej tyre. Për të arritur në një përfundim të drejtë në këtë rast, nuk ekziston një rregull i përgjithshëm që mund të zbatohet gjithmonë në raste të ngjashme, por kjo zgjidhet rast pas rasti, nga gjykatat, duke u bazuar në të gjitha rrethanat, si dhe aktet dhe provat e çdo çështje konkrete. *Element tjetër* i tentativës është se veprimet për realizimin e veprës penale kryhen nga personi me dashje. Veprimi i personit me dashje për realizimin e veprës penale në rastet e tentativës do të thotë që, ai parashikon karakterin e kundërligjshëm të veprimeve të tij, si dhe parashikon pasojat e mundshme të veprës penale dhe realizon veprime të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale, por vepra ndërpritet dhe nuk përfundohet për shkaqe që nuk varen nga vullneti i tij. *Element tjetër* i tentativës është që veprimi i synuar nga personi të ndërpritet, të mos përfundohet. Vepra penale do të konsiderohet se është ndërprerë dhe nuk është përfunduar kur personi ka filluar kryerjen e saj, ai ka ndërmarrë veprime të drejtpërdrejta për realizimin e veprës, por nuk ka arritur që të realizojë qëllimin e tij kriminal. *Elementi i fundit* i tentativës është që vepra penale të jetë ndërprerë dhe të mos jetë përfunduar, për shkaqe që nuk varen nga vullneti i personit. Në qoftë se vepra penale është ndërprerë për shkaqe që lidhen me vullnetin e lirë të personit, vepra nuk do të konsiderohet si e mbetur në tentativë edhe pse personi ka ndërmarrë veprime të drejtpërdrejta për realizimin e saj. Në këto raste do të ndodhemi para heqjes dorë, me vullnetin e lirë të personit nga kryerja e veprës penale, e cila nëse është përfundimtare, e përjashton atë nga përgjegjësia penale për veprën që ka tentuar të kryejë.

59. Vepra penale do të konsiderohet që është ndërprerë dhe nuk është përfunduar për shkaqe që nuk varen nga vullneti i personit, kur ndërprerja e saj ka ndodhur për rrethana objektive, për shkaqe të jashtme që nuk mund të parashikohen dhe as të ndikohen nga personi. KP-ja përmban një dispozitë të përgjithshme që parashikon se personi që tenton të kryejë një krim mban përgjegjësi penale. Kështu, ky Kod në nenin 23 parashikon se "*Personi që tenton të kryejë një krim përgjigjet për të*". Që personi të përgjigjet për tentativën e kryerjes së një krimi gjykata në përfundim të shqyrtimit gjyqësor duhet të analizojë mbi të gjitha rrethanat e provat elementet e sipërpërmendur për të arritur në përfundimin që këto elemente përmbushen kumulativisht dhe personi që ka tentuar kryerjen e krimit do të përgjigjet për të. Në këtë rast, personi që ka tentuar të kryejë një krim do të mbajë përgjegjësi penale njëlloj sikurse personi që e ka konsumuar plotësisht veprën penale. Kësisoj, parashikimi nga legjislatori në nenin 23 të KP-së për personat që tentojnë të kryejnë një krim, mundësinë e zbutjes së dënimit, uljes apo caktimit të një dënimi më të butë nga ai i parashikuar në ligj, nuk paraqet asnjë lloj ndikimi në drejtim të evitimit të ndalimit të përgjithshëm, të përcaktuar në nenin 403/2 të KPP-së, përjashtues apriori i së drejtës për të pasur akses në ritin procedural të "gjykimit të shkurtuar", të personave të gjykuar për veprat penale të atribuuara prej akuzës, që parashikojnë si titull sanksionues, llojin e dënimit me "burgim të përjetshëm".

60. Në lidhje me llojin dhe masën e dënimit, Kolegji në një vështrim krahasues, vëren se ka legjislacione penale të shteteve të ndryshme, ku përfshihet për shembull Italia, që për individualizimin e dënimit për personin që tenton të kryejë një krim parashikon shprehimisht uljen konkrete të dënimit, krahasuar me dënimin që parashikon dispozita penale konkrete për veprën e kryer, në varësi të masës së dënimit që parashikohet nga dispozita e posaçme që parashikon krimin që ka tentuar të kryejë personi. Në disa legjislacione penale të tjera sikurse Kodi Penal i Francës (nenet 225-4-7), në rastet e parashikuara shprehimisht nga ligji penal për figura të caktuara të veprave penale me rrezikshmëri të lartë, si për shembull trafikimi i qenieve njerëzore apo dhe krimet seksuale ndaj të miturve, tentativa për kryerjen e një krimi specifik ndëshkohet njëlloj si krimi i konsumuar. Pra, fakti që vepra penale ka mbetur në tentativë nuk shërben si rrethanë lehtësuese për zbutjen e dënimit, por përkundrazi rëndësia e së drejtës, marrëdhënies shoqërore të mbrojtur nga ligji penal apo subjekteve specifikë, merr përparësi absolute në vlerësimin e rrezikshmërisë së faktit penal. Një parashikim i tillë është tregues i qëllimit parandalues, frenues e ndëshkues të politikës penale që ndjek një legjislacion penal për të garantuar maksimalisht paprekshmërinë e marrëdhënieve juridike/së drejtës/objektit të rrezikuar, çka e bën të qartë se nuk diskutohet lehtësim/zbutje dënimi për autorin as në rastin e pranisë së tentativës. Legjislacione të

tjera për caktimin e dënimit ndaj personit që tenton të kryejë një krim, kanë zgjedhur që të parashikojnë një rregull të përgjithshëm sipas të cilit ai mban të njëjtën përgjegjësi penale si për veprën e kryer, por mund të dënohet më butë ose mund të dënohet me një lloj dhe masë dënimi më të lehtë se personi që e ka kryer veprën penale plotësisht (Kosova, Maqedonia e Veriut etj.).

61. Në këtë drejtim, Kolegji vë në dukje se legjislacioni ynë penal ka parashikime të ndryshme ligjore në periudha të ndryshme kohore. Kështu, KP-ja e vitit 1927 i përcaktonte masat konkrete të dënimit që mund të caktoheshin ndaj personit që tentonte të kryente një krim, në varësi të masës së dënimit që parashikonte dispozita penale për veprën e kryer, si dhe në varësi të llojit të tentativës. Kodet Penale të viteve 1952 dhe 1977, në ndryshim nga KP-ja i vitit 1927, parashikonin rregullin e përgjithshëm që personi që tentonte të kryente një krim, kishte përgjegjësi të njëjtë si personi që e kishte kryer veprën penale, por gjykata mund ta ulte dënimin që do të caktohej ndaj tij duke parashikuar edhe rrethanat që duhet të mbante parasysh gjykata në uljen e dënimit. Sipas KP-së në fuqi, "*Gjykata, në varësi të shkallës së afërsisë së pasojës, si dhe të shkaqeve për të cilat krimi mbeti në tentativë, zbut dënimin dhe mund ta ulë atë nën minimumin e parashikuar nga ligji ose të caktojë një lloj dënimi më të butë nga ai i parashikuar në ligj.*"[25]. Nga përmbajtja e kësaj dispozitë rezulton se gjykatat duhet të vlerësojnë disa kriteret në individualizimin e dënimit në rastet e veprave penale që kanë mbetur në tentativë, e konkretisht duhet analizuar shkalla e afërsisë së ardhjes së pasojës, si dhe shkaqet për të cilat krimi mbeti në tentativë.

62. Në lidhje me të gjithë elementet e sipërpërmendur, sikurse me të drejtë parashtrohet edhe nga Prokuroria e Përgjithshme, Kolegji vlerëson se në rastin kur vepra penale objekt akuze është cilësuar e mbetur në tentativë, gjykata në individualizimin e përgjegjësisë penale dhe dënimit ndaj autorit të veprës, është e kushtëzuar në vendimmarrjen e saj nga një hetim gjyqësor i plotë, i detajuar i gjithë rrethanave të çështjes, nga një analizë e plotë e shkaqeve për të cilat krimi mbeti në tentativë, nga një trajtim argumentues dhe vlerësim i rëndësisë së veprës penale apo intensitetit të rrezikshmërisë së saj, duke përcaktuar shkallën e afërsisë së pasojës në raport me veprimtarinë e autorit, si dhe nëse verifikohen faktorë të jashtëm ndikues apo një analizë e shkaqeve konkrete që shkaktuan tentativën (pra moskonsumimin e plotë të veprës penale). Kolegji thekson se shkaqet për të cilat krimi ka mbetur në tentativë dhe shkalla e afërsisë së pasojës, ndikon në përcaktimin dhe analizën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe të autorit të saj, pasi në rastet e tentativës së plotë autori ka kryer të gjitha veprimet duke synuar ardhjen e pasojës së dëshiruar prej tij, por kjo nuk është realizuar për rrethana që nuk varen nga vullneti i tij. Në parim, dënimi që parashikohet për këto vepra është ai që përcaktohet për veprën penale në dispozitën e posaçme të KP-së. Tentativa përcaktohet si një element/rrethanë që mund të çojë në zbutjen e dënimit, por jo domosdoshmërisht gjykatat mund të arrijnë në një konkluzion të tillë. Praktika gjyqësore në Shqipëri, por dhe teoria, nuk e ka interpretuar asnjëherë si domosdoshmëri / detyrim zbutjen e masës së dënimit në rastet kur vepra ka mbetur në tentativë. Gjithashtu, përcaktimi i rrethanave apo shkaqeve për të cilat vepra penale ka mbetur në tentativë dhe sa kjo ndikon në masën e uljes së dënimit, kërkon një analizë të thelluar në raport me rrethanat e faktit penal, shkallën e fajit si dhe verifikimin e rrethanave lehtësuese apo rënduese. Kësisoj, edhe në këtë këndvështrim për sa kohë nuk ka ndonjë parashikim ligjor që përcakton masë konkrete dënimi për veprën penale të mbetur në tentativë apo përjashtimin e saj nga një lloj i caktuar dënimi, Kolegji konkludon se është i paevitueshëm, zbatimi i ndalimit të përgjithshëm të parashikuar në nenin 403/2 të KPP-së.

63. Në përfundim të kësaj analize, në lidhje me nënçështjen e parë të shtruar për njësim/zhvillim, Kolegji mban këtë qëndrim njësues: **"Kur akuza është për një vepër penale që përmban dënimin me burgim të përjetshëm, por është cilësuar e mbetur në tentativë, nuk zbatohet procedura e gjykimit të shkurtuar.".**

**iii. Në lidhje me nënçështjen e dytë të shtruar për njësim**: "*Si do të veprohet në rastin kur akuza është ngritur për një vepër penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm dhe gjyqtari i seancës paraprake e dërgon në gjyq për këtë akuzë, por gjykatat në përfundim të gjykimit të zakonshëm i japin faktit një cilësim tjetër juridik, që nuk parashikon dënimin me burgim të përjetshëm?*"

[25] Neni 23, fjalia e dytë e Kodit Penal.

64. Në lidhje me çështjen e fundit të shtruar për njësim, Kolegji fillimisht çmon të ritheksojë rëndësinë që ka atribuimi i akuzës nga prokuroria dhe garantimi i së drejtës së mbrojtjes për të pandehurin. Në këtë drejtim, Kolegji risjell në vëmendje se edhe në raste të tjera ka marrë në analizë kuptimin e termave "fakt penal", "akuzë", "vepër penale" dhe "cilësim juridik". GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj ka theksuar se, 'akuza' është njoftimi zyrtar nga ana e autoritetit kompetent, i faktit që lidhet me kryerjen e një vepre penale. 'Natyra e akuzës' është cilësimi juridik që u bëhet fakteve në aktakuzë. 'Shkaku i akuzës' janë faktet materiale për të cilat akuzohet i pandehuri (*shih vendimet e GJEDNJ-së, Kamasinski kundër Austrisë, datë 19.12.1989; Pelissier e Sassi kundër Francës; Drassich kundër Italisë etj.*). Në referim të jurisprudencës së GJEDNJ-së, me rëndësi në funksion të garantimit të të drejtave kushtetuese dhe procedurale të pandehurit është komunikimi i akuzës, me të gjitha elementet e saj të renditura më lart.

65. Edhe Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj, në lidhje me atribuimin e akuzës dhe ndryshimin e cilësimit juridik, (*shih vendimin nr. 24/2012*), mes të tjerave ka argumentuar: "*E drejta e individit për t'u vënë në dijeni menjëherë dhe në mënyrë të hollësishme mbi natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij, është sanksionuar nga neni 31/a i Kushtetutës dhe nga neni 6/3/a i KEDNJ-së. Ky parim kushtetues është trajtuar nga jurisprudenca shqiptare dhe ajo e GJEDNJ-së, në funksion të realizimit të së drejtës së mbrojtjes të të akuzuarit si dhe të garantimit të parimit të barazisë së armëve ndërmjet palës akuzuese dhe mbrojtjes. Gjykata vëren se qëllimi i këtyre dispozitave është të krijojnë mundësinë për të akuzuarin të njihet paraprakisht me materialet, provat dhe rezultatet e hetimit, në mënyrë që të ushtrojë të drejtën e tij për të përgatitur një mbrojtje efektive, pra për të paraqitur argumentet në favor të tij dhe për të kundërshtuar akuzën e ngritur (shih vendimin nr. 4, datë 10.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese)...*".

66. Kolegji çmon se neni 34 i KPP-së, titulluar "marrja e cilësisë se të pandehurit", është një dispozitë e përgjithshme që tregon rëndësinë që ka njohja e të pandehurit me akuzën, të dhënat ku ajo bazohet, burimet e provave si dhe çdo të dhënë, fakt apo rrethanë që është e nevojshme për realizimin e një mbrojtje efektive. Kjo dispozitë nuk parashikon asnjë pasojë në lidhje me aktin e njoftimit të akuzës, ndaj duhet vlerësuar ngushtësisht me të drejtën e prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale dhe "thirrjen e të pandehurit në gjykim"/*vocatio in ius*. KPP-ja, në tërësinë e dispozitave të tij, garanton edhe të drejtat procedurale të pandehurit, i cili duhet të njoftohet në mënyrë efektive për akuzën ndaj tij, aktet/provat (burimet e provave) ku ajo bazohet dhe çdo element tjetër thelbësor që ndikon në mbrojtjen e tij. Në lidhje me të drejtën e mbrojtjes, Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj të konsoliduar, ka theksuar se ajo duhet të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve *(shih vendimet nr. 37, datë 19.9.2011; nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 5, datë 17.2.2003 dhe nr. 33, datë 24.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese)*. Po në këtë drejtim, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, qëllimi i së drejtës për t'u informuar për akuzën, i sanksionuar nga neni 6/3/a i KEDNJ-së, është që informacioni i kërkuar t'i jepet të akuzuarit në momentin e ngritjes se akuzës, ose në momentin e fillimit të procesit gjyqësor dhe është thelbësor fakti që vepra penale për të cilën dënohet një person, është ajo për të cilën ai është akuzuar (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Pélissier dhe Sassi kundër Francës, 25 mars 1989)*.

67. Kolegji thekson se ligji procedural penal i jep mundësi prokurorit si gjatë hetimit paraprak, ashtu edhe në gjykim, të ndryshojë akuzën e atribuuar të pandehurit. Çdo ndryshim i akuzës apo i rrethanave cilësuese/rënduese duhet ti njoftohet të pandehurit, pikërisht për të garantuar të drejtat e tij të mbrojtjes. Gjatë hetimeve paraprake sipas afateve të parashikuar në ligj prokurori ka të gjithë hapësirën e nevojshme për të realizuar një hetim të plotë, duke respektuar normat procedurale dhe parimet që udhëheqin procesin penal. Ligji procedural penal parashikon se cilësia e të pandehurit ruhet më pas në çdo gjendje dhe shkallë të procesit derisa të ketë marrë formë të prerë vendimi i pushimit, i pafajësisë ose i dënimit. Në përfundim të hetimeve paraprake, nëse prokurori vlerëson se provat e grumbulluara gjatë hetimeve janë të mjaftueshme për të provuar se fakti penal ka ndodhur dhe se ai është kryer nga i pandehuri, paraqet para gjykatës kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq *(nenet 327/6, shkronja b dhe 331 të KPP-së)*. Ky moment konkretizon ushtrimin e ndjekjes penale dhe nënkupton detyrimin e prokurorit që në përfundim të hetimeve të procedojë me një nga mënyrat e parashikuara në

ligj„ në zbatim të nenit 327 pika 6 të KPP-së. Ky akt përmban të dhënat e kërkuara nga neni 34, si dhe pika 3 e nenit 331 të KPP-së: a) gjeneralitetet e të pandehurit dhe të viktimës, kur është e mundur, si dhe çdo element tjetër që shërben për identifikimin e tyre; b) parashtrimin e faktit penal dhe cilësimin juridik të veprës penale; c) burimet e provës dhe faktet që ato u referohen; ç) kërkimin që gjyqtari i seancës paraprake të vendosë dërgimin e çështjes në gjyq; d) datën dhe nënshkrimin e prokurorit. Nga ana tjetër, Kolegji thekson se pika 2 e nenit 331 parashikon pavlefshmërinë e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, kur nuk është respektuar ndër të tjera edhe parashikimi i pikës 3 të nenit 327 të KPP-së, që përmban: përshkrimin e përmbledhur të faktit penal për të cilin i pandehuri është proceduar, kohën dhe vendin e kryerjes, cilësimin juridik të këtij fakti penal, lajmërimin për depozitimin e akteve në sekretari dhe të drejtën për tu njohur me akte dhe për të marrë kopje të tyre.

68. Me ndryshimet kushtetuese me ligjin nr. 76/2016, reflektuar dhe në KPP (me ligjin nr. 35/2017), kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq e paraqitur nga prokurori në përfundim të hetimeve paraprake (përmbajtja e të cilës pasqyron në thelb akuzën e kontestuar prej këtij të fundit të hetuarit, i cili prej këtij momenti "fiton" statusin e të pandehurit, duke u akuzuar për një akuzë të caktuar), i nënshtrohet kontrollit dhe verifikimit nga gjyqtari i seancës paraprake. Konstituimi i seancës paraprake është një moment kyç në funksion të verifikimit të qëndrueshmërisë së akuzës të atribuuar të pandehurit, si për sa i përket aspektit të kompletueshmërisë së hetimeve të zhvilluara, ashtu edhe në drejtim të kualifikimit të saktë juridik të faktit penal të atribuuar nëpërmjet akuzës të pandehurit *(shih vendimin njësues nr. 62, datë 1.11.2021 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë)*. Një nga detyrat e gjyqtarit të seancës paraprake është edhe verifikimi për bazueshmërinë/qëndrueshmërinë e akuzës në gjykimin e themelit. Në këtë seancë të pandehurit i njihet për herë të parë mundësia për të kundërshtuar akuzën që prokurori i ka njoftuar atij përpara se çështja penale të dërgohet për gjykim në themel. Në funksion të verifikimit të bazueshmërisë / qëndrueshmërisë së akuzës, gjyqtari i seancës paraprake mund të disponojë për korrigjimin ose saktësimin e akuzës, sipas nenit 332/d të KPP-së. Nga përmbajtja e kësaj dispozite, kur gjatë seancës paraprake del se cilësimi juridik i faktit është i gabuar, ose kur akuza nuk është formuluar në mënyrë të qartë dhe të saktë, gjykata fton prokurorin që të bëjë korrigjimet ose saktësimet e nevojshme. Në rast se prokurori nuk vepron, gjykata vendos t'i kthejë aktet, duke njoftuar dhe drejtuesin e prokurorisë.

69. Përfshirja e seancës paraprake si një nga fazat e procedimit penal, paraqet rëndësi në funksion të forcimit të institutit të mbrojtjes, nëpërmjet kontrollit (filtrimit) të akuzave të nxituara dhe të pambështetura, të paraqitura prej prokurorit, fryt i një veprimtarie hetimore të pakompletuar/të paplotë, përfshirë sidomos rastet kur prokurori anashkalon apo nuk tregon vëmendjen e duhur në lidhje me integrimin e kontributit të mbrojtjes në funksion të kompletueshmërisë. Parashikimi i figurës së gjyqtarit të seancës paraprake synon jo thjesht ushtrimin e një "kontrolli" mbi veprimtarinë procedurale të prokurorit gjatë hetimit paraprak, por mbi të gjitha, garantimin e të drejtave të mbrojtjes, duke synuar edhe efektivitetin e gjykimit të çështjes penale në themel. Duke qenë tipar i një kontrolli gjyqësor që realizohet nëpërmjet debatit dhe në zbatim të kontradiktoritetit mes të palëve të thirrura në seancë gjyqësore, nënkuptohet që kur gjyqtari i seancës paraprake vendos sipas nenit 332/dh të KPP-së, ai ushtron funksione juridiksionale në një gjykim të kufizuar, por pa marrë atributet e gjyqtarit që shqyrton themelin e çështjes, në lidhje me vlerësimin e fakteve, provave dhe fajësisë së pandehurit. Kjo kompetencë e gjyqtarit të seancës paraprake, që në thelb lidhet me verifikimin e kushteve të gjykueshmërisë së çështjes, ka diferenca me funksionin e gjyqtarit të gjykimit të çështjes (akuzës) në themel, i cili duhet të verifikojë bazueshmërinë e akuzës në funksion të fajësisë së të pandehurit *(shih vendimin njësues nr. 62, datë 1.11.2021 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë)*.

70. Kolegji Penal ka një jurisprudencë të konsoliduar se, në seancë paraprake nuk zbatohet standardi provues "përtej çdo dyshimi të arsyeshëm", standard ky që i përket fazës së gjykimit të çështjes në themel dhe formësohet mbi bazën e provave të marra në gjykim në prezencë të kontradiktoritetit të palëve para një gjykate natyrale

dhe neutrale.[26] Gjyqtari i seancës paraprake nuk mund të hyjë në çështje të të vlerësuarit të provave e çmuarjes së tyre në kuptim të të provuarit, vlerësim që bëhet në kontradiktoritet e debat gjyqësor, që është karakteristikë e gjykimit në themel të çështjes.[27] Detyra e gjyqtarit të seancës paraprake është që, në prani të burimit të provave që i paraqiten, të verifikojë nëse në situatën në të cilën ndodhen aktet, mund të kalohet çështja në gjyq, pa bërë vlerësime thelbësore që i takojnë fazës së gjykimit në themel të çështjes *(shih vendimin njësues nr. 00-2023-2241 (312), datë 16.11.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).*

71. Në këtë pikë, Kolegji sjell në vëmendje se një ndër disponimet e gjyqtarit të seancës paraprake është edhe në lidhje me kërkesën e të pandehurit për të proceduar me gjykim të shkurtuar. Kur shqyrton kërkimin e të pandehurit për të proceduar me gjykim të shkurtuar, gjyqtari i seancës paraprake, përveç dispozitave tipike që lidhen me rolin dhe funksionin e kësaj faze të procedimit penal, duhet të zbatojë edhe parashikimet konkrete të ligjit procedural penal për këtë lloj të posaçëm gjykimi. Gjykimi i shkurtuar është një gjykim i posaçëm i cili konsiston në heqjen dorë në mënyrë të vullnetshme nga i pandehuri nga disa aspekte themelore të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të tilla si parimi i barazisë së armëve dhe i formimit të provës në kontradiktoritet, për të përfituar një ulje dënimi. Për këtë arsye legjislatori për këtë lloj gjykimi ka parashikuar rregulla të veçanta në kreun IV të titullit VII të KPP-së (nenet 403-406), të cilave gjyqtarët duhen t'i përmbahen gjatë zbatimit të këtij gjykimi të posaçëm (*vendim nr. 4, datë 10.2.2012 i Gjykatës Kushtetuese).*

72. Ndryshimet e KPP-së (me ligjin nr. 35/2017) normuan disa kufizime lidhur me mënyrën dhe kohën e paraqitjes së kërkesës për gjykim të shkurtuar. Nga përmbajtja e nenit 403, pika 1 të KPP-së, rezulton se gjyqtari i seancës paraprake ka për detyrë të verifikojë pikë së pari nëse kërkesa për gjykim të shkurtuar është paraqitur nga një subjekt i legjitimuar. Duke qenë se i pandehuri heq dorë nga disa të drejta themelore të procesit të rregullt ligjor, e drejta për të kërkuar gjykim të shkurtuar është një e drejtë vetjake e tij, që do të thotë se kjo kërkesë duhet paraqitur vetëm prej tij ose mbrojtësit të pajisur me autorizim të posaçëm.[28] Një element tjetër formal që duhet verifikuar është koha e depozitimit të kësaj kërkese, në seancë paraprake. Në lidhje me këtë element, Kolegji rithekson qëndrimin se paraqitja e kërkesë për gjykim të shkurtuar në seancë paraprake, nuk do të thotë se qëllimi i ligjvënësit ka qenë të kufizojë të drejtën e gjyqtarit që është caktuar për të gjykuar çështjen në themel, të rivlerësojë këtë kërkim. Kolegji vlerëson se gjyqtari i caktuar për shqyrtimin e çështjen në themel, nuk ka asnjë pengesë ligjore të vlerësojë këtë kërkim të refuzuar nga gjyqtari i seancës paraprake. Në mbështetje të këtij qëndrimi është edhe parashikimi ligjor i pikës 3 të nenit 332/dh të KPP-së, ku është theksuar se, "*Procedura e shqyrtimin në seancë paraprake nuk zëvendëson gjykimin e çështjes në themel dhe as paragjykon vendimin përfundimtar të saj*".[29]

73. Kolegji sjell në vëmendje se ligjvënësi në funksion të dhënies së drejtësisë, e ka kushtëzuar pranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar me verifikimin e gjendjes së akteve nga gjykata. Pra, kërkesën e të pandehurit dhe të mbrojtësit të posaçëm të tij, gjykata e pranon vetëm atëherë kur çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen e akteve të fashikullit të hetimeve.[30] Në këtë aspekt, Kolegji vlerëson se gjykata që shqyrton këtë kërkim, duhet të mbajë në konsideratë pikën "7" të nenit 405 të KPP-së [31], që rregullon rastet apo parashikon arsyet përse kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk mund të pranohet. Ky parashikim ka lidhje të drejtpërdrejtë me aktet dhe provat e grumbulluara gjatë hetimit paraprak, ndaj Kolegji vlerëson se "gjendja e akteve" që referohet në pikën 6 të kësaj dispozite, duhet vlerësuar e lidhur me sa parashikon pika 7 e saj (pra pikat 6 e 7 të nenit 405 të KPP-së duhen interpretuar e zbatuar në unison me njëra – tjetrën).[32] Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk pranohet kur i pandehuri ose mbrojtësi i tij paraqesin pretendime

[26] Vendim nr. 183, datë 24.6.2022 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

[27] Vendim nr. 169, datë 14.6.2022 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

[28] Neni 403/1 i KPP-së *"1. Kërkesa për gjykimin e shkurtuar paraqitet nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij me autorizim të posaçëm në seancën paraprake ose në seancë gjyqësore kur procedohet sipas nenit 400 dhe paragrafit 3, të nenit 406/ç, të këtij Kodi, me pasojë mospranimi".*

[29] Vendim nr. 00-2023-723, datë 27.4.2023 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

[30] Neni 405/6 i KPP-së.

[31] Neni 405 pika 7 i KPP-së.

[32] Vendim nr. 00-2023-723, datë 27.4.2023 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

për pavlefshmërinë e akteve apo papërdorshmërinë e provave. Në këtë rast gjykata nuk e zgjidh dot çështjen "në gjendjen që janë aktet", pasi gjykata duhet të vlerësojë llojin e pavlefshmërisë së pretenduar dhe të diskutojë provat që pretendohet se janë marrë në kundërshtim me ligjin, vlerësim ky që kuptohet nuk mund të bëhet jashtë debatit gjyqësor. Kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk do të pranohet edhe kur i pandehuri dhe mbrojtësi kërkojnë që të merren prova të tjera, pasi provat e reja që kërkohen dhe mënyra e marrjes së tyre duhet të debatohen në seancë gjyqësore. Gjithashtu, kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk pranohet kur gjykata konstaton kryesisht akte absolutisht të pavlefshme apo prova të papërdorshme. Kolegji vlerëson se është detyrë e gjykatës që t'i konstatojë dhe t'i deklarojë ato me vendim edhe kur nuk ngrihen nga pala e interesuar. Në këtë rast është e qartë se gjykimi i shkurtuar nuk mund të pranohet, pasi çështja nuk mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet. Nga ana tjetër, ritheksohet edhe arsyeja e fundit që parashikon ligji për mospranimin e gjykimit të shkurtuar, që është kur i pandehuri akuzohet për një vepër penale për të cilën ligji penal parashikon llojin e sanksionit "me burgim të përjetshëm".[33]

74. Në të gjitha rastet e sipërpërmendura, gjykata vendos mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar dhe vazhdon me procedurën e gjykimit të zakonshëm. Kundër vendimit të mospranimit nuk lejohet ankim i veçantë, por ai mund të ankimohet bashkë me vendimin përfundimtar. Kolegji vlerëson se mospranimi i kërkesës së të pandehurit për gjykim të shkurtuar duhet të jetë i arsyetuar dhe i mbështetur në ligj. Kjo do të thotë që si në rastin kur kërkesa pranohet ashtu edhe kur vendoset mospranimi i saj, gjyqtari i seancës paraprake duhet të analizojë dhe arsyetojë jo vetëm nëse përmbushen kushtet formale/procedurale të parashikuara në nenin 403 të KPP-së, por edhe nëse çështja "mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet" (kushti substancial), sipas pikave 6 dhe 7 të nenit 405 të KPP-së. Arsyeja qëndron në faktin se, vendimi i mospranimit ankimohet bashkë me vendimin përfundimtar dhe kësisoj kontrollohet nga një gjykatë më e lartë, sipas procedurave përkatëse. Dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjidhje ndërmjet dy mundësive. Pra, gjyqtari duhet të argumentojë në rast se përmbushen secili prej kushteve të parashikuara në ligj (formale dhe substanciale), pavarësisht se arsyeja e refuzimit mund të lidhet vetëm me njërin prej tyre. Edhe sipas Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 14/2012 "*...për të garantuar një të drejtë ankimi efektive ndaj vendimit të mospranimit të gjykimit të shkurtuar, gjykata e apelit duhet të jetë në gjendje që të shqyrtojë e kontrollojë në mënyrë efikase ligjshmërinë e ushtrimit të diskrecionit nga ana e gjykatës së shkallës së parë në marrjen e vendimit, si nga pikëpamja procedurale ashtu edhe substanciale.*".

75. Duke u rikthyer në çështjen e shtruar për njësim, Kolegji thekson se verifikimi i akuzës së atribuuar të gjykuarit ka rëndësi në raport me shqyrtimin e pretendimeve të pandehurit për bazueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e kësaj akuze, si dhe vlefshmërinë apo përdorshmërinë e provave ku ajo mbështetet. Sikurse është thënë në këtë vendim, një nga arsyet kur nuk pranohet kërkesa për gjykim të shkurtuar është situata ligjore kur i pandehuri akuzohet për një vepër penale për të cilën ligji penal parashikon dënim me burgim të përjetshëm. Verifikimi i kësaj situate, vendos detyrim për gjyqtarin e seancës paraprake që të analizojë pretendimet e të pandehurit për ndryshimin e cilësimit juridik të fakti penal që i është atribuuar në raport me gjendjen e akteve të fashikullit të hetimeve. Të drejtën për të kundërshtuar akuzën për të gjitha elementet përbërës të saj, i pandehuri mund ta ushtrojë jo vetëm në seancë paraprake, por edhe gjatë gjykimit në themel të çështjes së tij penale në ngarkim të tij. Edhe në gjykim, në funksion të garantimit të një mbrojtje efektive i pandehuri mund të kundërshtojë akuzën e ngritur ndaj tij si për sa i përket shkakut ashtu dhe në lidhje me natyrën (cilësimin juridik) e akuzës. Detyra e gjyqtarit që gjykon çështjen në themel është ta zgjidh drejt çështjen dhe të zbatojë ligjin. Në këtë vështrim me qëllim që të garantohet dhënia e drejtësisë dhe zbatimi i ligjit, si dhe të garantohet e drejta e të pandehurit për mbrojtje dhe kontradiktoritet, KPP-ja, në nenin 375, ka parashikuar mundësinë e gjykatës që shqyrton çështjen në themel të saktësojë edhe cilësimin juridik të faktit penal që akuza i konteston të pandehurit. Sipas Gjykatës Kushtetuese, kuptimi në këtë mënyrë i përmbajtjes

[33] Neni 403/2 i KPP-së.

së nenit 375 të KPP-së i shërben dhënies së drejtësisë, sepse në të kundërtën ajo do të vepronte në kundërshtim me provat dhe me ligjin. Në rast se gjykata nuk do të bënte një cilësim të drejtë të veprës penale, vendimi i saj do të prishej nga gjykata më e lartë për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit. Pra, edhe në këtë aspekt, gjykata është e detyruar të bëjë vetë ndryshimin e cilësimit të veprës kur ky është i ndryshëm nga ai i prokurorit *(shih vendimin nr. 50, datë 30.7.1999 të Gjykatës Kushtetuese).*

76. Kolegji ritheksson qëndrimin se në këtë rast, gjykata mund të rikualifikojë të njëjtin fakt që është përshkruar në akuzë apo në kërkesën për gjykim dhe jo një fakt të ri, i cili përmban elemente apo rrethana të reja që nuk i janë njoftuar të pandehurit apo për të cilat prokuroria nuk ka ushtruar ndjekjen penale. Kolegji vë në dukje se, me "fakt që rezulton ndryshe" duhet të kuptojmë një fakt që paraqitet ndryshe në mënyrë tërësore, nga ai i parashtruar në kërkesën për gjykim. E thënë ndryshe, gjykata në emër të dhënies së drejtësisë, nuk legjitimohet të vlerësojë ato veprime apo mosveprime të të pandehurit, të cilat ndonëse rezultojnë gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk i janë atribuuar të pandehurit me aktin e njoftimit të akuzës apo në kërkesën për gjykim. Nëse do të ndodhte kjo gjë, cenohet e drejta e të pandehurit për proces të rregullt ligjor, si: e drejta e tij për t'u mbrojtur, e drejta për t'u dëgjuar, e drejta për akses në gjykatë etj. Gjykata ushtron të drejtën e saj për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, vetëm në lidhje me faktin e përshkruar në kërkesën për gjykim, që i është njoftuar/komunikuar të pandehurit dhe për të cilin prokuroria ka ushtruar ndjekjen penale, duke i atribuuar një akuzë konkrete. Pra, në zbatimin e nenit 375 të KPP-së, fakti nuk ndryshon, por cilësimi juridik i tij (natyra e akuzës) rivlerësohet nga gjykata në përputhje me parimin *jura novit curia* (gjykata e njeh ligjin). Fakti i njëjtë do të thotë "i njëjti fakt objektiv" i cili karakterizohet nga të njëjtat veprime, subjekte dhe objekt material. Pra, "fakti i njëjtë" do të thotë që fakti jo vetëm në tërësinë e tij të jetë i njëjtë, por edhe se asnjë element i tij përbërës nuk duhet të rezultojë të jetë i ndryshëm nga ajo që është përcaktuar në akuzën e paraqitur nga prokurori (*shih vendimin nr. 00-2024-1166 (150), datë 27.6.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

77. Në mungesë të një përkufizimi në ligjin penal shqiptar, Kolegji në jurisprudencën e tij për termin "fakt i njëjtë apo i ndryshëm", ka referuar jurisprudencën e GJEDNJ-së. Në çështjen Sergey Zolotukhin kundër Rusisë[34], GJEDNJ-ja ka analizuar nenin 4 Protokolli nr. 7 të Konventës, që ndalon procedimin apo gjykimin e një personi për një "vepër" të dytë, përderisa në origjinë të saj qëndrojnë fakte identike ose në thelb të njëjta me ato të së parës. Duke interpretuar "faktin e njëjtë", GJEDNJ-ja në këtë vendim konkludon se janë faktet që përbëjnë një tërësi rrethanash faktike konkrete që implikojnë të njëjtin person dhe që lidhen midis tyre në mënyrë të pazgjidhshme në kohë dhe në hapësirë. Në rastin Zolotukhin kundër Rusisë, GJEDNJ-ja ka analizuar edhe ndryshimet që ekzistojnë mes termave "të njëjta akte apo fakte" nga njëra anë dhe nocionit "e njëjta shkelje apo vepër" nga ana tjetër. Në interpretimin e këtyre nocioneve, GJEDNJ-ja është mbështetur edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (në vijim "GJED"), si dhe të Gjykatës Interamerikane të të Drejtave të Njeriut, të cilët janë bazuar në identitetin e aktit/veprimit material të kryer dhe kanë hedhur poshtë kualifikimin ligjor të këtij akti/veprimi, si të parëndësishëm. GJEDNJ-ja ka theksuar se ndalimi i procedimit apo i gjykimit dy herë të një individi, lidhet me të njëjtat fakte kriminale dhe jo me cilësimin ligjor të shkeljes së kryer. Nga ana tjetër, edhe GJED ka interpretuar kuptimin e 'faktit të njëjtë kriminal' në raport me zbatimin e parimit *ne bis in idem* pavarësisht nga cilësimet juridike që mund të ketë për një fakt kriminal, në legjislacionet e ndryshme të vendeve anëtare. Edhe GJED-ja ka theksuar se kur ligji përdor termin të "njëjtën ngjarje/fakt", referon tek aktet e kryera faktikisht nga një person dhe jo tek i njëjti krim apo vepër penale. GJED-ja ka vlerësuar se, në mungesë të një harmonizimi të legjislacioneve penale mes shteteve anëtare të hapësirës Schengen, është normale që cilësimet juridike të ndryshojnë nga një shtet tek tjetri. Kjo është edhe arsyeja pse duhet marrë në konsideratë vetëm identiteti i veprimit material, që nga GJED-ja është përkufizuar si, "ekzistenca e një tërësie rrethanash konkrete të

[34] Vendim i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 10.2.2009. Në këtë vendim, GJEDNJ-ja ka analizuar zbatimin e parimit *ne bis in idem*, duke ju referuar edhe kuptimit të termit "fakt i njëjtë".

lidhura mes tyre në mënyrë të pandashme”.[35]

78. Në këtë kontekst, Kolegji thekson se është kompetencë ekskluzive e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të bëjnë ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale - për rastin konkret - edhe për një vepër penale që nuk e parashikon llojin e dënimit me burgim të përjetshëm. Në këtë rast vihet në diskutim se çfarë pasojash ka ky ndryshim në lidhje me kërkesën për gjykim të shkurtuar të paraqitur në seancë paraprake, nga i pandehuri i akuzuar dhe dërguar në gjykim për një vepër penale për të cilën parashikohet dënim me burgim të përjetshëm. Lidhur me sa më sipër, Kolegji sjell në vëmendje se Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 14/2012 është shprehur: “*Nëse gjykata e apelit, që shqyrton ankimin ndaj vendimit të mospranimit të gjykimit të shkurtuar, konstaton se çështja mund të vendosej në gjendjen e akteve dhe kërkesa e të pandehurit për gjykim të shkurtuar është refuzuar pa të drejtë, ajo ka kompetenca të ndryshojë vendimin në lidhje me masën e dënimit, duke aplikuar nenin 406/1 të KPP-së. Kjo bëhet me qëllim që të vihet në vend një e drejtë e mohuar dhe i pandehuri të përfitojë reduktimin e dënimit. Ndërsa për sa i përket ritit procesual të gjykimit të shkurtuar, ky i fundit është i parikuperueshëm në apel*”. Po në këtë aspekt, GJEDNJ-ja ka çmuar gjithashtu se, nëse është e vërtetë që shtetet kontraktuese nuk janë të detyruar nga Konventa të parashikojnë procedura të thjeshtuara, qëndron gjithsesi fakti se, kur këto procedura ekzistojnë dhe aplikohen, parimet e procesit të rregullt ligjor imponojnë që të mos privohet në mënyrë arbitrare i pandehuri nga avantazhet që me atë procedurë lidhen (*Scoppola kundër Italisë, kërkesa nr. 10249/03*).

79. Edhe Gjykata Kushtetuese italiane, në vendimin nr. 313/1990 është shprehur se *përcaktimi i dënimit nuk mund t’i shmanget kontrollit juridiksional*. Po kjo gjykatë, në vendimin nr. 140/2010 duke bërë një analizë mbi *ratio* e këtij gjykimi, është shprehur se, vlerësimet e të pandehurit për dobinë e gjykimeve të posaçme varen në radhë të parë ‘nga mënyra se si është përcaktuar procesi dhe vepra penale nga prokurori’. Me pasojën që kur, për ‘raste patologjike’, si gabimet ose mosveprimet e prokurorit për përcaktimin e faktit ose të veprës penale, akuza pëson një ndryshim substancial, i pandehuri duhet të rivendoset në afat për të bërë vlerësimet e duhura, me rrjedhojë, përndryshe, cenimin e së drejtës së mbrojtjes si dhe të parimit të barazisë së armëve, duke qenë se do të kishim një diskriminim sipas “ekzaktësisë ose plotësisë më të madhe ose më të vogël të vlerësimit diskrecional të rezultateve të hetimeve paraprake nga ana e prokurorit (*shih edhe vendimet nr. 333/2009 dhe nr. 265/1994 të Gjykatës Kushtetuese Italiane*). Po kjo Gjykatë, në vendimin nr. 23/1992 ka theksuar se, *mungesa e kontrollit mbi vendimin e gjyqtarit për mospranim të ritit të posaçëm sjell pasoja në planin e dënimit, në dëm të të pandehurit.* Ndërsa, Gjykata e Kasacionit të Italisë është shprehur se, në rast se është vazhduar me ritin e zakonshëm procesual, nuk ka dyshim se, vendimi mund të apelohet për një motiv specifik, që është dhënia e një dënimi “të paligjshëm”. (...) I pandehuri ka të drejtë të pretendojë në apel se, për shkak të refuzimit të ritit të posaçëm, në mënyrë të pajustifikueshme ose të gabuar, nuk ka mundur të përfitojë nga reduktimi i dënimit, edhe pse ai i ka përmbushur të gjitha detyrimet procesuale në ngarkim të tij. (...) Përcaktimi konkret i dënimit është i rivlerësueshëm nga gjyqtari i apelit, të cilit ky pretendim i kërkohet në mënyrë specifike nga i pandehuri (*shih vendimin nr. 44711, datë 27 tetor-18 nëntor 2004, të Gjykatës italiane të Kasacionit*).

80. Në vijim të analizës së mësipërme, për pyetjen e shtruar për njësim, Kolegji, duke u bazuar në vlerësimet e lartpërmendura, çmon se në rastin kur në përfundim të shqyrtimit gjyqësor nuk rezulton i provuar fakti ashtu sikurse është kontestuar nga prokurori, por gjykata që gjykon çështjen e ndryshon cilësimin juridik të veprës penale në një vepër penale për të cilën nuk parashikohet dënim me burgim të përjetshëm, duhet të riparojë pasojat e një vendimi të marrë në kundërshtim me ligjin, duke aplikuar nenin 406/1 të KPP-së, pavarësisht se kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk është pranuar (nga gjyqtari i seancës paraprake). Ky parim vlen jo vetëm për gjykatën e shkallës së parë, por edhe për gjykatën e cila kontrollon vendimin përfundimtar (gjykatën e apelit), sigurisht brenda kufijve të shkaqeve të ankimit. Kjo për arsye se, gjykimi në apel ka si qëllim, nga njëra anë t’i respektohet e drejta e ankimit personit të dënuar, në mënyrë që ai të ketë mundësinë të dëgjohet nga një trup tjetër gjyqësore. Nga ana tjetër, gjykimi në apel ka si qëllim që të korrigjojë edhe ato gabime që mund të jenë bërë

[35] GJED, vendimi i datës 9 mars 2006/çështja VanEsbroeck.

gjatë gjykimit në shkallën e parë në lidhje me zbatimin e ligjit, vlerësimin e provave, moskryerjen e një hetimi të plotë e të gjithanshëm të çështjes, si dhe në lidhje me ligjshmërinë e refuzimit të gjykimit të shkurtuar. Kontrolli i ushtruar nga gjykata e apelit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë nuk është kontroll konstatues, por me synim që të plotësohen mangësitë e të korrigjohen gabimet.

81. Nga ana tjetër, Kolegji thekson se në këtë rast, riparimi i pasojave të mospranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, duhet të jetë i kushtëzuar me verifikimin e përmbushjes edhe të kushteve të tjera të përmendura më lart. Konkretisht: (i) kërkesa për gjykim të shkurtuar nga i pandehuri duhet të jetë paraqitur në përputhje me parashikimet e paragrafit të parë të nenit 403 të KPP-së; (ii) ky kërkim duhet të jetë shoqëruar edhe me analizën apo pretendimin e tij për ndryshimin e cilësimit juridik të faktit penal (për një vepër penale që nuk parashikon dënim me burgim të përjetshëm); (iii) verifikimi nga gjykata nëse çështja mund të zgjidhej në gjendjen që janë aktet, duke mbajtur në konsideratë edhe pikën 7 të nenit 405 të KPP-së. Lidhur me verifikimin e faktit nëse çështja mund të zgjidhej në gjendjen që janë aktet, Kolegji vlerëson se ky verifikim tashmë do të kryhet jo mbi bazën e një vlerësimi paraprak të akteve të hetimit, por duke u bazuar edhe tek ecuria e procesit gjyqësor në raport me provat e marra e të verifikuara në gjykim, e lidhur kjo me faktin nëse ka qenë e nevojshme marrja e provave të tjera për të dhënë një vendim të drejtë. Në rast se gjatë gjykimit janë marrë prova të reja (si pasojë e pavlefshmërive absolute/papërdorshmërisë) dhe shqyrtimi i tyre ka qenë i rëndësishëm/vendimtar për cilësimin ligjor të fakteve dhe zgjidhjen e çështjes, gjykata ka të drejtën e refuzimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar. Ndërsa, në rast se shqyrtimi i provave nuk i ka sjellë ndonjë të re procesit, por vetëm humbjen e së drejtës për të përfituar uljen e 1/3 të dënimit në rast se do të ishte pranuar kërkesa për gjykim të shkurtuar, gjykatat duhet të aplikojnë nenin 406/1 të KPP-së, pavarësisht se kërkesa për gjykim të shkurtuar në seancë paraprake apo në shkallë të parë është refuzuar, duke ndrequr kështu pasojat e një vendimi të marrë në kundërshtim me ligjin. Në këtë rast çështja mund të zgjidhej "në gjendjen që janë aktet" dhe kësisoj do të bëhet ndreqja e pasojave, duke aplikuar uljen e dënimit me 1/3 sipas nenit 406/1 të KPP-së.

82. Në përfundim të kësaj analize, në lidhje me nënçështjen e dytë të shtruar për njësim/zhvillim, Kolegji mban këtë qëndrim njësues: ***Nëse gjykatat në përfundim të gjykimit të zakonshëm, i japin faktit një cilësim tjetër juridik për një vepër penale që nuk parashikon dënimin me burgim të përjetshëm, duhet të zbatojnë nenin 406/1 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me masën e dënimit edhe nëse akuza është ngritur për një vepër penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm dhe gjyqtari i seancës paraprake e ka dërguar në gjyq për këtë akuzë. Ky përfundim zbatohet, me kusht që të plotësohen elementet e mëposhtme:***

***a) Të jetë paraqitur kërkesë për gjykim të shkurtuar nga i pandehuri në përputhje me parashikimet e paragrafit të parë të nenit 403 të Kodit të Procedurës Penale, e shoqëruar me kërkimin e tij për ndryshimin e cilësimit juridik të faktit, për një vepër penale që nuk parashikon dënim me burgim të përjetshëm.***

***b) Të çmohet që çështja mund të zgjidhej në gjendjen që janë aktet, duke mbajtur në konsideratë edhe pikën 7 të nenit 405 të Kodit të Procedurës Penale.".***

**IV. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete**

83. Në lidhje me zgjidhjen e rastit konkret, Kolegji sjell në vëmendje se shkaqet e rekursit në Gjykatën e Lartë parashikohen nga neni 432 i KPP-së. Kjo dispozitë, në pikën 1 të saj parashikon se, rekursi në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të gjykatës së apelit mund të bëhet për këto shkaqe: *a) për mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; b) për mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; c) kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë".* Kolegji Penal ka evidentuar se Gjykata e Lartë është një gjykatë ligji, të cilës palët mund t'i drejtohen vetëm për shkaqet e përcaktuara në nenin 432 të KPP-së. Pretendimet në lidhje me vlerësimin e gabuar të fakteve dhe provave, nuk merren në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, pasi kjo është një çështje që del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të saj. Pavarësisht se Gjykata e Lartë nuk i hyn vlerësimit të provave është në kompetencën e saj që të shqyrtojë nëse nga gjykatat më të ulëta është zbatuar drejt ligji dhe nëse

vendimmarrja e tyre është në standardet e një vendimmarrje të arsyetuar, duke marrë për bazë edhe qëndrimin e mbajtur nga Gjykata Kushtetuese, GJEDNJ-ja dhe Gjykata e Lartë.

84. Referuar akteve të dosjes, vendimmarrjes së gjykatave dhe shkaqeve të ngritura në rekurs, Kolegji vlerëson se vendimmarrja e Gjykatës së Apelit Shkodër nuk ka vend për tu cenuar dhe si e tillë duhet të lihet në fuqi. Pretendimet e mbrojtjes së ankuesit lidhur me pavlefshmërinë e akteve dhe papërdorshmërinë e provave janë të pabazuara dhe kanë marrë përgjigje të argumentuar nga gjykata e apelit. Pretendimet lidhur me cilësimin e gabuar të faktit penal lidhur me vrasjen e viktimës së mitur Alkis Metallari, fakt i cili sipas mbrojtjes duhet të cilësohet jo si "Vrasje në rrethana të tjera cilësuese", por si "Vrasje e kryer në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme" parashikuar nga neni 83 i KP-së, lidhen me pretendime të karakterit faktual dhe si të tilla, dalin jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Lidhur me këtë pretendim (të pretenduar që në shkallën e parë të gjykimit) Kolegji vlerëson se vendimmarrja e të dyja gjykatave është e arsyetuar dhe në respektim të neneve 152 dhe 383 të KPP-së.

85. I mituri në konflikt me ligjin gjatë gjykimit në fakt ka pretenduar se ka qenë në kapërcim të mbrojtjes së nevojshme për shkak të sulmit të padrejtë, të vërtetë dhe të çastit nga viktima dhe personi tjetër prezent. Legjislacioni penal shqiptar lejon që një nga mënyrat për mbrojtjen e interesave të shtetit e të qytetarëve nga veprat penale është mbrojtja e nevojshme, që nënkupton kryerjen e veprimeve për sprapsjen e një sulmi kriminal brenda kufijve të lejuar nga ligji, duke dëmtuar sulmin dhe megjithëse dëmi i shkaktuar ka elementet e një vepre penale, autori nuk ka përgjegjësi penale. Për të nxjerre konkluzione nëse ndodhemi para mbrojtjes së nevojshme, duhen pasur parasysh elementet që përcakton neni 19 i KP-së, ku të gjitha këto elemente zgjidhen në mbështetje të rrethanave të ngjarjes. Neni 19 i KP-së përcakton tiparet që duhet të karakterizojnë sulmin dhe kriterin bazë që duhet të respektojë mbrojtja për të pranuar ekzistencën e mbrojtjes së nevojshme. Prandaj për të cilësuar veprën penale të konsumuar në kushtet e kapërcimit të kufijve të mbrojtjes së nevojshme, duhen analizuar kriteret ligjore të kësaj dispozite. Sipas kësaj dispozite sulmi duhet të plotësojë disa kushte: 1. Të jete veprim i njeriut. 2. Të jetë i padrejtë, çka nënkupton ndërmarrjen e veprimeve në kundërshtim me ligjin që cenojnë jetën, shëndetin, të drejtat dhe interesat e personit të cilit i drejtohen; 3. Të jetë i atëçastshëm pra të ketë filluar, të zgjasë dhe ende të mos ketë përfunduar ose të pritet në mënyrë të dukshme e me siguri që do të fillojë aty për aty; 4. Të jetë real (i vërtetë), pra të provohet ekzistenca e tij dhe të mos ekzistojë në imagjinatën e subjektit që po sulmohet; Për sa i takon mbrojtjes, duhet që ajo të drejtohet kundër sulmuesit si dhe karakteri i mbrojtjes të jetë në përpjesëtim me rrezikshmërinë e sulmit. Këtu kemi parasysh se intensiteti i sulmit përcaktohet nga objekti që preket ose vihet në rrezik nga sulmuesi, mjetet e përdorura dhe në rrethanat konkrete në të cilat bëhet sulmi. Në pajtim me këtë duhet të jetë edhe karakteri i mbrojtjes. Mospërmbushja e kritereve të mësipërme ligjore mes sulmit dhe mbrojtjes, e cilëson veprën penale të kryer nga personi i sulmuar në kushtet e kapërcimit të kufijve të mbrojtjes së nevojshme. Por gjatë mbrojtjes personi nuk është i detyruar të përdorë të njëjtat mjete me ato të sulmuesit *(shih vendimin nr. 00-2012-1695 (336), datë 12.12.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).*

86. Në rastin konkret, pretendimet e mbrojtjes se i mituri në konflikt me ligjin është gjetur në sulm të çastit dhe të padrejtë, si dhe të rrezikshëm për jetën janë gjetur të pabazuara nga të dyja gjykatat e faktit. Në mënyrën si janë pranuar rrethanat në të cilat ka ndodhur vepra penale, fakti që i mituri në konflikt me ligjin është përgatitur për sulmin duke marrë thikën me vete, fakti që nuk është provuar ekzistenca e shkopit dhe gjuajtjeve me të, fakti që këto pretendime nuk gjejnë mbështetje në shkallën e dëmtimeve të konstatuara në trupin e tij, do të thotë që i mituri në konflikt me ligjin nuk ka qenë në kushtet e sprapsjes së një sulmi kriminal (të padrejtë, real, të çastit) e për rrjedhojë me të drejtë është arritur në përfundimin e saktë nga të dyja gjykatat se ai (i mituri në konflikt me ligjin) nuk ka qenë në kushtet e mbrojtjes së nevojshme apo në kapërcim të saj. Gjykata e Lartë duke qenë një gjykatë ligji nuk mund të bëjë një vlerësim të ndryshëm të rrethanave të faktit, e po ashtu rekursi nuk mund të bazohet në shkaqe të tilla sikurse janë "vlerësim i gabuar i faktit dhe provave". Gjykata e Lartë shqyrton pretendimet e palëve lidhur me cilësimin juridik të faktit penal, por duke bazuar në të (faktin) sikurse pranohet i vërtetuar nga gjykatat më të ulëta (gjykata fakti).

87. Ky Kolegj ka një praktikë të konsoliduar se shqyrtimi i faktit dhe i provave/akteve, del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Por, ky vlerësim nuk mund të merret i shkëputur në rastet kur Gjykata e Lartë, identifikon me cilësinë e shkeljeve (dhe të ometimeve të zbatimit, në të njëjtën kohë) të ligjit që lidhen me moszbatim apo mosvlerësim të drejtë të kritereve dhe të kushteve ligjore, të parashikuara në nenet 152 dhe 383 dhe, në mënyrë të veçantë, në nenin 112/3 të KPP-së. Kolegji ka vlerësuar se, kufizimi në këtë rast është i lidhur me pamundësinë e Gjykatës së Lartë, për të ndryshuar vlerësimin e ekzistencës së veprës penale, qoftë në favor apo kundër të të gjykuarit, pa i hyrë vlerësimit të provave. Ky konkluzion mbështetet në faktin se çmuarja e provave/indicieve, përputhja e tyre me njëra-tjetrën të përfshira në fashikull, janë elemente të domosdoshëm për të arritur në fuqinë provuese të tyre, por që dalin jashtë kompetencës së Gjykatës së Lartë, si gjykatë ligji. *(shih vendimin nr. 00-2022-1055 (219), datë 13.9.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).*

88. Në rastin konkret, ndryshe nga sa pretendohet në rekurs, Kolegji vlerëson se cilësimi juridik i veprës penale "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese", parashikuar nga neni 79, shkronja "a" i KP-së është në interpretim të drejtë të ligjit material penal. Pretendimi i mbrojtjes së ankuesit në lidhje me ndryshimin e cilësimit të faktit penal nga vepra penale për të cilën është akuzuar në veprën penale "Vrasje e kryer në kapërcim të mbrojtjes së nevojshme" parashikuar nga neni 83 i KP-së është i pabazuar (në konsideratë të rrethanave të faktit të pranuara nga të dyja gjykatat) dhe ka marrë përgjigje të argumentuar nga të dyja gjykatat. Kolegji vlerëson se vendimmarrja e gjykatave është e arsyetuar në përputhje me nenin 152 dhe 383 të KPP-së, duke i dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve të ankuesit, si dhe në respektim të standardit provues "përtej çdo dyshimi të arsyeshëm". Nga mbrojtja nuk është paraqitur asnjë fakt, rrethanë apo provë që të krijojë dyshim për akuzën, e cila të çmohej në favor të të miturit në konflikt me ligjin.

89. Neni 79/a i KP-së, për të cilin është akuzuar dhe dënuar i mituri në konflikt me ligjin Roland Matranxhi parashikon dënim me burgim të përjetshëm. Neni 403/2 i KPP-së ndalon gjykimin e shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm. Bazuar në këto parashikime ligjore, të dyja gjykatat kanë arritur në përfundim të drejtë për mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar. Për sa më sipër, bazuar në nenin 441, pika 1, shkronja "e" të KPP-së, Kolegji vlerëson se vendimmarrja objekt rekursi duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenet 441, pika 1, shkronja "e" dhe 438 të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 188, datë 9.5.2019, të Gjykatës së Apelit Shkodër.
2. Ky vendim është njësues dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

**Tiranë, më 4.7.2024**

**Kryesues pjesërisht kundër:** Ilir Panda
**Anëtar:** Sokol Binaj, Medi Bici, Sandër Simoni
**Anëtar pjesërisht kundër:** Albana Boksi

MENDIM KUNDËR

***"Për motivet e kundërshtimit të vendimit të Kolegjit Penal, për çështjen nr. 52105-00631-00-2019 akti"***

1. Kolegji Penal pranë Gjykatës së Lartë (në vijim "Kolegji") ka marrë në shqyrtim rekursin e paraqitur nga i mituri në konflikt me ligjin Roland Matranxhi, ndaj vendimit nr. 188, datë 9.5.2019 të Gjykatës së Apelit Shkodër. Mbrojtësi i zgjedhur nga i mituri në konflikt me ligjin ka kërkuar: "Prishjen e vendimit nr. 188, datë 9.5.2019 të Gjykatës së Apelit Shkodër, duke vendosur kthimin e çështjes për rishqyrtim". Në thelb, në rekurs janë parashtruar pretendime në lidhje me disponimin e gjykatave të faktit për refuzimin e gjykimit të shkurtuar, si dhe në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal të atribuuar të gjykuarit.

2. Në rastin objekt gjykimi, nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes gjyqësore konstatohet se, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr. 151 (360), datë 28.1.2019, ka vendosur: "*Deklarimin fajtor të pandehurit Roland Sami Matranxhi, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese", parashikuar nga neni 79, shkronja "a" e*

*Kodit Penal dhe dënimin e tij me 10 (dhjetë) vite burgim. Vuajtja e dënimit fillon nga data e arrestimit në flagrancë, datë 10.11.2017 dhe të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme.* (…)" Gjykata e Apelit Shkodër, mbi ankimin e paraqitur nga mbrojtësi i të miturit në konflikt me ligjin me vendimin nr. 188, datë 9.5.2019 ka vendosur: "Lënien në fuqi të vendimit penal nr. 151 (360), datë 28.1.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër...". Kolegji Penal bazuar në nenin 441, pika 1, shkronja "e" të Kodit të Procedurës Penale (në vijim "KPP"), pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore, në përfundim disponoi për: "Lënien në fuqi të vendimit nr. 188, datë 9.5.2019 të Gjykatës së Apelit Shkodër".

3. Në këtë vendim, Kolegji Penal në lidhje me çështjet e shtruara për njësimin e praktikës gjyqësore, mbajti këto qëndrime njësuese:

- <u>Në lidhje me çështjen e shtruar për njësim</u>: A zbatohet neni 403, pika 2 i Kodit të Procedurës Penale për personat e akuzuar për një krim që Kodi Penal parashikon dënim me burgim të përjetshëm, por ndaj të cilëve ligji ndalon dhënien e një dënimi të tillë? Kolegji arrin në përfundimin njësues se "*Ndalimi i parashikuar nga neni 403, pika 2 i Kodit të Procedurës Penale, zbatohet edhe për subjektet ndaj të cilëve ligji penal ndalon dhënien e dënimit me burgim të përjetshëm.*".

- <u>Në lidhje me nënçështjen e parë</u>: A zbatohet procedura e gjykimit të shkurtuar kur akuza është për një vepër penale që përmban dënimin me burgim të përjetshëm, por është cilësuar e mbetur në tentativë? Kolegji arrin në përfundimin njësues se: "*Kur akuza është për një vepër penale që përmban dënimin me burgim të përjetshëm, por është cilësuar e mbetur në tentativë, nuk zbatohet procedura e gjykimit të shkurtuar*".

- <u>Në lidhje me nënçështjen e dytë</u>: Si do të veprohet në rastin kur akuza është ngritur për një vepër penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm dhe gjyqtari i seancës paraprake e dërgon në gjyq për këtë akuzë, por gjykatat në përfundim të gjykimit të zakonshëm i japin faktit një cilësim tjetër juridik, që nuk parashikon dënimin me burgim të përjetshëm? Kolegji arrin në përfundimin njësues se "*Nëse gjykatat, në përfundim të gjykimit të zakonshëm, i japin faktit një cilësim tjetër juridik për një vepër penale që nuk parashikon dënimin me burgim të përjetshëm, duhet të zbatojnë nenin 406/1 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me masën e dënimit edhe nëse akuza është ngritur për një vepër penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm dhe gjyqtari i seancës paraprake e ka dërguar në gjyq për këtë akuzë*".

*Ky përfundim zbatohet, me kusht që të plotësohen elementet e mëposhtme:*

*a) Të jetë paraqitur kërkesë për gjykim të shkurtuar nga i pandehuri në përputhje me parashikimet e paragrafit të parë të nenit 403 të Kodit të Procedurës Penale, e shoqëruar me kërkimin e tij për ndryshimin e cilësimit juridik të faktit, për një vepër penale që nuk parashikon dënim me burgim të përjetshëm.*

*b) Të çmohet që çështja mund të zgjidhej në gjendjen që janë aktet, duke mbajtur në konsideratë edhe pikën 7 të nenit 405 të Kodit të Procedurës Penale.*

4. Me këtë vendim të shumicës së anëtarëve të Kolegjit, **ne gjyqtarët Ilir Panda dhe_Albana Boksi, jemi pjesërisht kundër**. Gjyqtarët në pakicë kanë mbajtur qëndrimin se, "*Ndalimi i parashikuar nga neni 403, pika 2 i KPP-së, **nuk zbatohet** për subjektet ndaj të cilëve ligji penal ndalon dhënien e dënimit me burgim të përjetshëm*" (ndaj të miturit në konflikt me ligjin dhe grave). Natyrisht, ky qëndrim gjen zbatim edhe në rastin kur akuza që i është atribuuar të miturit në konflikt me ligjin apo gruas, cilësohet si e mbetur në tentativë. Në lidhje me dy qëndrimet të tjera njësuese në raport me zbatimin e institutit të gjykimit të shkurtuar, jemi dakord me konkluzionet njësuese (duke saktësuar se për nënçështjen e dytë, cilësimi i veprës penale si e mbetur në tentativë, jemi dakord me konkluzionet e shumicës, kur i gjykuari nuk është një mitur në konflikt me ligjin apo grua). Në lidhje me këtë qëndrim argumentojmë sa me poshtë vijon:

5. Gjyqtarët në pakicë pajtohen me argumentimin e shumicës së Kolegjit Penal se gjykimi i shkurtuar si një nga llojet e gjykimeve të posaçme, thjeshton dhe shkurton procedurat, rrit shpejtësinë dhe efektivitetin e gjykimit dhe sjell përfitim në uljen e 1/3 të masës së dënimit për të pandehurin. Gjykata, kur i pandehuri ka bërë kërkesë që të procedohet me këtë lloj gjykimi, paraprakisht çmon nëse çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, duke analizuar me kujdes faktin penal që i është atribuuar të pandehurit dhe cilësimin juridik, qëndrueshmërinë e akuzës dhe bazueshmërinë e saj në prova, duke vlerësuar nëse ka prova të pavlefshme apo të papërdorshme. Ligji parashikon që në aplikimin e gjykimit të shkurtuar çështja zgjidhet në gjendjen që janë aktet e fashikullit të hetimit, çka nënkupton pranimin e tyre nga palët ashtu sikurse janë. Është detyrim i gjykatës të

vlerësojë nëse në atë gjendje që janë aktet mund të japë vendim pa cenuar drejtësinë dhe interesat e ligjshme të të pandehurit. Me pranimin e kërkesës, gjykimi vazhdon me paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare, të cilat i referohen akteve të pranuara nga palët sikurse parashikon neni 405 i KPP-së dhe gjykata jep vendim bazuar në to.

6. Me të drejtë nga Kolegji është theksuar edhe fakti se në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë, kuadri ligjor penal ka pësuar një sërë ndryshimesh, që kanë afektuar edhe KPP-në, të cilit, me ligjin nr. 35/2017 datë 30.3.2017, hyrë në fuqi me datë 1.8.2017, *(ligji nr. 35/2017 datë 30.3.2017),* i janë prekur një sërë dispozitash, ndër të cilat edhe dispozitat që normojnë ritin e posaçëm të gjykimit të shkurtuar, të parashikuara nga nenet 403–406 të KPP-së. Nga këto ndryshime, neni 403 i këtij Kodi është formuluar në këtë mënyrë: "*1. Kërkesa për gjykimin e shkurtuar paraqitet nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij me autorizim të posaçëm në seancën paraprake ose në seancë gjyqësore kur procedohet sipas nenit 400 dhe paragrafit 3, të nenit 406/ç, të këtij Kodi, me pasojë mospranimi. 2. Nuk lejohet kërkesa për gjykim të shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm.*". Në kuptim të pikës 2 të nenit 403 të KPP-së, është pranuar nga Kolegji Penal se qëllimi i ligjvënësit, me parashikimin e kësaj ndalese ligjore, është ashpërsimi i drejtësisë penale për veprat e rënda, për të cilat parashikohet sanksioni me burgim të përjetshëm. Në këtë mënyrë, ligjvënësi ka synuar që të mos krijohet dhe lejohet mundësia ligjore që autorët e veprave më të rënda penale t'i shmangen dënimit me burgim të përjetshëm.

7. Në interpretimin literal të parashikimit ligjor të pikës 2 të nenit 403 të KPP-së, jemi dakord me vlerësimin e Kolegjit Penal se për të gjitha kërkesat e miratuara për dërgimin e çështjes në gjyq, kur objekt akuze është një nga veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm, gjykata nuk mund të procedojë sipas ritit të gjykimit të shkurtuar dhe apriori rregulli i përgjithshëm është që për të gjitha këto vepra penale duhet të zbatohen rregullat e gjykimit me procedurën e zakonshme. Nga ana tjetër, vetë ligjvënësi, duke mbajtur në vëmendje mbrojtjen e veçantë ligjore që u atribuohet kategorive të veçanta të subjekteve të veprës penale, i ka përjashtuar nga dënimi maksimal *(dënimi me burgim të përjetshëm),* pavarësisht nga lloji i veprës penale të kryer prej tyre dhe sanksioni maksimal i parashikuar nga dispozita konkrete e Kodit Penal (në vijim "KP"). Kështu, në nenin 31, paragrafi 2 të KP-së, përcaktohet: "*Dënimi me burgim të përjetshëm nuk jepet ndaj personave që në kohën e kryerjes së krimit nuk kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, si dhe për gratë.*". Ndërsa, neni 51 i këtij Kodi, "Dënimi për të miturit", parashikon: "*Për të miturit, që në kohën e kryerjes së veprës penale nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç, dënimi nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikon ligji për veprën penale të kryer. Rregullat për caktimin e dënimit për të miturin parashikohen në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.*".

8. Gjithashtu, në lidhje me të miturit, ligjvënësi ka miratuar edhe ligjin nr. 37/2017, datë 30.3.2017, "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur" (në vijim "KDPM"), i cili ka hyrë në fuqi më datë 1.1.2018. KDPM-ja parashikon të drejta të posaçme për të miturin në konflikt me ligjin, duke garantuar mbrojtjen e të miturit dhe interesin e tij më të lartë, në përputhje me Kushtetutën dhe standardet ndërkombëtare, duke vënë theksin në forcimin e sistemit të drejtësisë restauruese dhe mbrojtjen efektive të të drejtave procedurale të fëmijëve. Ky Kod është një akt ligjor i veçantë pasi në përmbajtjen e tij materiale dhe procedurale, ka të përfshirë të gjitha dispozitat për të miturit nga KP-ja, KPP-ja, ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", ligjin "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve". Ligji nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" gjithashtu rezulton që është hartuar në përputhje të plotë edhe me "Konventën mbi të drejtat e fëmijës", jo vetëm në kontekstin e të drejtave dhe të ngritjes së një sistemi mbrojtjeje për të miturit, por edhe për realizimin efektiv të tyre.

9. KDPM-ja, përmban norma të posaçme ligjore lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, dënimin penal, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale, si dhe rregulla për të rinjtë nga grup-mosha 18 deri në 21 vjeç. Ky ligj përbën një risi dhe zhvillon standardet e legjislacionit shqiptar në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në tërësi dhe të të miturve në konflikt me ligjin, në veçanti. Qëllimi i miratimit të këtij Kodi ka qenë grupimi i dispozitave të posaçme për të miturit në KDPM dhe dhënia përparësi në mënyrën e trajtimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, për mbështetjen e fëmijëve

viktimë apo të akuzuar në procesin penal, si dhe në trajtimin dhe mbrojtjen e të miturve në lidhje me garantimin e respektit dhe efektshmërinë në zbatimin e të drejtave të fëmijëve nëpërmjet drejtësisë miqësore, por edhe në përcaktimin e masave restauruese të përshtatshme për të miturit në konflikt me ligjin si dhe për rehabilitimin e tyre.

10. Në nenin 5 të KDPM-së, "Raporti me ligjet e tjera", përcaktohet se *dispozitat e Kodit Penal, të Kodit të Procedurës Penale dhe të ligjeve të tjera, zbatohen në procesin e drejtësisë penale për të mitur vetëm për çështje që nuk janë të rregulluara nga ky Kod ose nëse përmbajnë rregullime më të favorshme për të miturit.* Pra, sipas këtij neni, KDPM-ja është ligj i mëvonshëm (*lex posteriori*) ndaj KPP-së dhe KP-së, ashtu edhe ligj i posaçëm (*lex speciali)*, në raport me këto Kode. Ndërsa neni 97 i KDPM-së, përcakton: "*1. Burgimi ndaj një të mituri mund të zbatohet në rast se ai ka kryer një vepër penale për të cilën minimumi i dënimit të parashikuar është 7 vjet dhe kur ky dënim është i nevojshëm për shkak të natyrës, rrezikshmërisë së lartë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së fajësisë. 2. Për të miturin dënimi me burgim nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikohet për veprën penale të kryer, por jo më shumë se 12 vjet. 3 .Për përcaktimin e masës së dënimit për të miturin, gjykata merr parasysh dhe kushton vëmendje të veçantë të gjitha rrethanave që lidhen me shkallën e pjekurisë së të miturit dhe kohën që nevojitet për edukimin dhe formimin profesional. Megjithatë, në varësi të shkallës së fajësisë, dënimi mund të jetë më i shkurtër, kur vlerësohet se është i mjaftueshëm për të arritur qëllimin e tij*.". Qëllimi i kësaj dispozite është të pamundësojë dhënien e një mase dënimi më të lartë se 12 vjet burgim ndaj të miturit në konflikt me ligjin, pavarësisht sanksionit të parashikuar në veprën penale konkrete për të cilën ai procedohet. Në këto kushte, mbrojtja e posaçme që ligjvënësi i ka dhënë subjektit – të miturit në konflikt me ligjin, e përjashton atë nga çdo ndalesë apo parashikim ligjor i aplikueshëm apo i parashikuar nga dispozitat e ligjeve të tjera përtej KDPM-së, nga të cilat, *de jure* apo *de facto,* ekziston mundësia e rëndimit të situatës së këtij subjekti – të miturit në konflikt me ligjin.

11. Gjyqtarët në pakicë theksojnë se KDPM-ja është një kuadër ligjor i posaçëm (*lex specialis)* mbi drejtësinë penale për të miturit, i krijuar për të mbrojtur të miturit dhe interesin më të lartë të fëmijës. Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të dhëna qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ofron mbrojtje të veçantë për të miturit dhe ka për qëllim të tregojë edhe një status, një kujdes më të madh për fëmijët, i cili duhet të reflektohet jo vetëm në legjislacion, por edhe në të gjithë veprimtarinë e organeve shtetërore dhe subjekteve që trajtojnë të miturit. Lidhur me parimin e specialitetit të normave, me vendimin nr. 3, datë 2.11.2015, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ndër të tjera kanë arsyetuar se, *për të zgjidhur çështjen e zbatimit të saktë të normës ligjore, në rastin kur, në pamje të parë (prima facie), në të njëjtën kohë duket sikur vepron më shumë se një dispozitë penale, si kritere logjike dhe juridike për analizimin e kësaj çështjeje, nga doktrina janë elaboruar këto parime, i) parimi i specialitetit (lex specialis derogat legi generali), ii) parimi i subsidiaritetit (lex primaria derogat legi subsidiariae)... Në bazë të parimit të specialitetit, kur dy norma ligjore rregullojnë të njëjtën lëndë, zbatohet norma e posaçme, e cila ka përparësi dhe shmang normën e përgjithshme, kjo në përputhje me kriterin e përgjithshëm juridik për zgjidhjen e kundërshtive lex specialis derogat legi generali. Raporti i specialitetit ekziston kur elementet përbërëse të një norme penale (të përgjithshme) janë të gjithë të pranishëm edhe në një normë tjetër (e posaçme), e cila përveç tyre, përmban edhe disa elemente më specifike që e cilësojnë normën e dytë, të posaçme në raport me normën e parë. Norma e përgjithshme përmbahet krejtësisht në normën e posaçme, kjo e fundit ka një përmbajtje më të gjerë dhe e përfshin të parën (marrëdhënie lloj dhe specie), prandaj shkelja e normës së posaçme (si normë me madhe) logjikisht përfshin edhe shkeljen e normës së përgjithshme (norma më e vogël), ndaj vetëm norma e posaçme do të zbatohet. Sa më e madhe të jetë prania e elementeve specifikues përbërës të një norme penale inkriminuese, aq më e ngushtë është fusha e veprimit dhe e zbatimit të saj, në raport me normën e përgjithshme, duke pasur kjo e fundit më pak elemente rrethanorë që e kufizojnë fushëzbatimin e normës së përgjithshme, e cila rrjedhimisht gjen një zbatim më të gjerë. ... Parimi i subsidiaritetit, bazohet në praninë e një raporti funksional midis dy normave penale lidhur me mbrojtjen e një marrëdhënieje juridike që mbrohet në nivele të ndryshme cenimi apo formash të cenimit. Sipas këtij parimi, zbatimi i njërës normë në të njëjtën kohë për të njëjtin fakt, përjashton zbatimin e normës penale tjetër, në rastin e mbrojtjes së marrëdhënieve juridike që mbrohen në mënyrë progresive dhe të përshkallëzuar nga një nivel më i ulet drejt një niveli me të lartë, ... Parimi i subsidiaritetit ndërhyn për të mbuluar një hapësirë të lënë nga normë tjetër, apo kur dy a më shumë norma mbrojnë në shkallë të ndryshme marrëdhënien juridike...*

12. Në referim të analizës dhe të përcaktimeve ligjore të sipërcituara, gjyqtarët në pakicë vlerësojnë se në kushtet e ekzistencës së mbrojtjes së posaçme ligjore të parashikuar për të miturin në konflikt me ligjin, zbatimi i rregullit të parashikuar në nenin 403/2 të KPP-së, është i kufizuar. Qëllimi i ligjvënësit nuk është dënimi i të miturit, por rishoqërizimi, riintegrimi, rehabilitimi dhe parandalimi i rikryerjes së veprës penale ose një vepër tjetër penale. Ndër parimet e drejtësisë penale për të mitur është edhe gjykimi i drejtë, i shpejtë dhe me përparësi i të miturit në konflikt me ligjin (nenet 17 dhe 88 të KDPM-së). Sa më sipër trajtuar, gjyqtarët në pakicë vlerësojnë se rregulli i përgjithshëm i parashikuar në nenin 403/2 i KPP-së, nuk gjen zbatim në rastin e të miturit në konflikt me ligjin, pasi KP-ja (nenet 31 dhe 51*)* dhe KDPM-ja, përmbajnë rregullime më të favorshme, jo vetëm duke e përjashtuar atë nga dënimi me burgim të përjetshëm, por duke përcaktuar se dënimi me burgim për të miturin nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikohet për veprën penale të kryer, por jo më shumë se 12 vjet, (neni 97/2, KDPM). Në këtë kuptim, vlerësohet se pika 2 e nenit 403 të KPP-së, në rastin kur të miturit janë autorë të veprës penale, nuk mund të interpretohet si dispozitë e vetme (e izoluar) në legjislacionin penal shqiptar, por, në bazë të interpretimit sistematik, duhet analizuar dhe interpretuar në raport harmonik me parashikimet e dispozitave të tjera materiale të KP-së dhe KDPM-së.

13. Gjyqtarët në pakicë vlerësojnë se i njëjti qëndrim duhet mbajtur edhe në rastin kur akuza i atribuohet një gruaje, për të cilën ligjvënësi ka përjashtuar dhënien e një dënimi me burgim të përjetshëm. Ky qëndrim mund të parashtrojë diskutime në drejtim të diskriminimit për shkak të përkatësisë gjinore, në raport me zbatimin e ndalimit të parashikuar në pikën 2 të nenit 403 të KPP-së, kur i pandehuri është burrë. Në lidhje me këtë pretendim, në çështjen *Khmamtoku e Aksenchik v. Rusisë, datë 24.1.2017,* Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim "GJEDNJ") ka arritur në konkluzionin se nuk ka shkelje të nenit 14 "Ndalimi i diskriminimit" dhe nenit 5 "E drejta për lirinë dhe sigurinë" të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim "KEDNJ"), për sa i përket ndryshimit në trajtim mbështetur në moshë dhe në gjini sipas nenit 57 paragrafi 2 "Burgimi i përjetshëm" të KP rus. GJEDNJ-ja në këtë vendim ka vënë në dukje se është krejt të natyrshme që autoritetet kombëtare, detyra e të cilave është gjithashtu të marrin në konsideratë brenda kufijve të juridiksionit të tyre interesat e shoqërisë në tërësi, duhet të gëzojnë diskrecion të gjerë kur atyre u kërkohet të marrin vendime për çështje të ndjeshme siç është politika penale. Sipas GJEDNJ-së, trajtimi ndryshe për shkelëset gra të moshës madhore duke u përjashtuar nga burgimi i përjetshëm për shkak të gjinisë së tyre, bazohet edhe në instrumentet e ndryshme evropiane dhe ndërkombëtare që adresojnë nevojat e grave për mbrojtje nga mjedisi seksual, abuzimi me bazë gjinore, si dhe nevoja për mbrojtjen e shtatzënisë dhe amësisë. (*shih paragrafët 27 deri 30, 77-88 të vendimit të referuar më lart*). Edhe ligjvënësi shqiptar ka parashikuar në kuptim të nenit 31/2 të KP-së se në rastin kur gjykata vendos në përfundim të procesit gjyqësor deklarimin fajtore të një gruaje të pandehur që akuzohet për një vepër penale që parashikon dënimin me burgim të përjetshëm, ndaj saj nuk mund të aplikohet ky dënim. Ky është një ndalim kategorik i parashikuar nga legjislatori, lidhur me një kategori të posaçme të subjekteve të veprës penale, specifikisht gratë dhe të miturit. Në këtë vështrim, në mënyrë abstrakte, për të miturit në konflikt me ligjin dhe gratë, kur akuzohen për vepra penale për të cilat KP-ja ka parashikuar në maksimum dënimin me burgim të përjetshëm (vetëm për këto dy kategori subjektesh), dënimi në maksimum do të jetë: për të miturit deri në 12 vite burgim; për gratë deri në 35 vite burgim.

14. Gjyqtarët në pakicë vlerësojnë se edhe në rastin e grave ndalimi i parashikuar në nenin 403 pika 2 të KPP-së, nuk mund të zbatohet. Natyrisht, vlerësimi nëse plotësohen kriteret formale dhe substanciale të kërkesës për të proceduar me gjykim të shkurtuar, nëse çështja konkrete mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, nëse ka akte të pavlefshme apo prova të papërdorshme, i takon gjykatës (gjyqtarit të seancës paraprake ose gjyqtarit të themelit). Për këtë arsye gjyqtarët në pakicë çmojnë se nuk mund të konkludohet se pika 2 e nenit 403 të KPP-së ka si fushë zbatimi edhe veprat penale për të cilat dënimi me burgim të përjetshëm, ligjërisht është i pamundur të zbatohet, qoftë *de jure* dhe qoftë *de facto.* Ky interpretim sistematik dhe i harmonizuar i pikës 2 të nenit 403 të KPP-së me nenin 31 dhe 51 të KP-së, si dhe me nenet 5 e 97 të KDPM-së, vlerësohet se është në përputhje me nenin 18 të Kushtetutës dhe me nenin 14 të KEDNJ-së, duke

garantuar njëlloj të drejtat procedurale penale për të gjykuarat gra ose të mitur në konflikt me ligjin.

15. Gjyqtarët në pakicë vënë në dukje se GJEDNJ-ja, në jurisprudencën e saj ka argumentuar se i pandehuri në procesin penal, sipas nenit 6 të KEDNJ-së, mund të heqë dorë nga garancitë e mbrojtjes dhe të drejtat procedurale, me vullnetin e tij të lirë e të pavesuar. Gjykatat duhet të tregojnë kujdesin e duhur për të verifikuar se i pandehuri i ka kuptuar pasojat që vijnë nga heqja dorë e garancive procedurale të një gjykimi në kontradiktoritet dhe të verifikojë se kjo heqje dorë është pasojë e vullnetit të tij *(shih çështjen Sejdovic kundër Italisë, aplikimi nr. 56581/00*, vendim i Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së, datë 1.3.2006; çështjen *Scoppola kundër Italisë (nr. 2),* aplikimi nr. 10249/03, vendim i Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së datë 17.9.2009).

16. Në ndryshim nga sa ka argumentuar shumica e anëtarëve të Kolegjit Penal, gjyqtarët në pakicë vlerësojnë se ligjvënësi në ndryshimet e pikës 2 të nenit 403 të KPP-së, nuk ka individualizuar si kriter të vetëm llojin e veprës penale, për sa kohë kriteri ndalues në zbatimin e gjykimit të shkurtuar lidhet me sanksionin e parashikuar në veprat penale përkatëse. Kjo do të thotë se nga analiza e zbatimit të këtij lloj gjykimi të posaçëm nuk mund të shmanget parashikimi i sanksionit që *de jure* dhe *de facto* mund të zbatohet si dënim në përfundimin e gjykimit. Në rastin e të miturit në konflikt me ligjin apo të gjykuarave gra që akuzohen për një vepër penale të rëndë, ligjvënësi ka parashikuar shprehimisht se ndaj tyre nuk mund të aplikohet dënimi me burgim të përjetshëm (natyrisht në rastin kur ato gjenden fajtorë për faktin penal të atribuuar). Ky parashikim ligjor i posaçëm do të zbatohet dhe ka përparësi ndaj çdo rregulli tjetër të përgjithshëm. Në këtë vështrim, gjyqtarët në pakicë pajtohen me qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit Penal se nëse një dispozitë e cilësuar si procedurale për faktin se parashikohet në ligjin procedural, ka një ndikim në ashpërsinë e masës së dënimit që duhet të jepet nga gjykata, atëherë ajo është një dispozitë penale materiale, ndaj të cilës ka vend për t'u zbatuar parimi i sanksionuar në nenin 29, pika 2 të Kushtetutës[36], si dhe nenin 3, pika 3[37] të KP-së. Një konkluzion i tillë gjen mbështetje edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila ka vlerësuar në situata të ngjashme se një dispozitë e tillë procedurale që ndikon në dënimin e caktuar, duhet të cilësohet si një dispozitë penale materiale, ndaj të cilës ka vend për t'u zbatuar nenin 7 paragrafi i parë i KEDNJ-së[38]. GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj ka pohuar se neni 7 i KEDNJ-së, jo vetëm që garanton parimin e mosretroaktivitetit të ligjeve penale më të rrepta, por imponon edhe zbatimin nga gjykata të ligjit penal dispozitat e të cilit janë më të favorshëm për të akuzuarin, pasi në të kundërt kemi dhunim të parimit të ligjshmërisë duke aplikuar një ligj të pafavorshëm për të akuzuarin. Kolegji ka theksuar edhe faktin se, gjykatat në raste të tilla, mes zbatimit të parimit "*tempus regit actum*" dhe zbatimit të ligjit penal më të favorshëm, duhet ti japë përparësi të drejtave dhe garancive kushtetuese të pandehurit. Kolegji edhe më parë ka vënë në dukje se mospranimi i ankimit të pandehurit për riparimin e pasojave të gjykimit të shkurtuar nga gjykata e apelit nuk mund të ketë si shkak ndryshimet ligjore të pikës 2 të nenit 403 të KPP-së, kur fakti penal ka ndodhur përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2017 *(shih vendimin nr. 00-2024-427 (62), datë 7.3.2024; vendimin nr. 00-2024-1242 (176), datë 9.7.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).*

17. Në përfundim të kësaj analize, gjyqtarët në pakicë vlerësojnë se neni 403 pika 2 e KPP-së nuk gjen zbatim në rastin e të miturve në konflikt me ligjin apo të gjykuarave gra, për të cilët në asnjë rast (referuar veprave penale të pjesës së posaçme të KP-së apo të Kodit Penal Ushtarak) nuk mund të zbatohet (por as nuk parashikohet *de facto*) dënimi me burgim të përjetshëm. Gjyqtarët në pakicë vlerësojnë se qëllimi i ligjvënësit në rastin konkret, duhet analizuar edhe në raport me parimet që udhëheqin procesin penal ndaj një të mituri në konflikt me ligjin apo në raport me standardet ndërkombëtare që janë miratuar në mbrojtje të grave. Procesi penal për të miturit, qofshin këto viktimë apo të mitur në konflikt me ligjin, udhëhiqet nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës. Zhvillimi i një procesi gjyqësor të drejtë, të shpejtë dhe efektiv, është parësore në rastin e gjykimeve të tilla. E njëjta

[36] Neni 29/2 i Kushtetutës: *"2. Nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale".*

[37] Neni 3, pika 3 e Kodit Penal *"Kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale".*

[38] Çështja Scoppola kundër Italisë/ kërkesa nr. 10249/03, vendimi i datës 17.9.2009.

situatë mund të verifikohet edhe në rastin kur një grua akuzohet për kryerjen e një vepre penale, sidomos kur është një krim i rëndë. Në këtë vështrim, zhvillimi i një gjykimit sipas procedurës së gjykimit të shkurtuar, kur verifikohet pa asnjë ekuivok dhe dyshim, vullneti i këtyre subjekteve të posaçëm për të hequr dorë nga debati gjyqësor, nuk është në kundërshtim dhe as nuk cenon procesin e rregullt dhe të drejtë ligjor. KDPM-ja përjashton shprehimisht vetëm zbatimin e procedurës së posaçme të parashikuar nga nenet 406/a – 406/f të KPP-së, "urdhri penal" dhe "gjykimi me marrëveshje", duke theksuar se ky i fundit zbatohet në rastin e zbatimit të masës së shmangies, për të miturin në konflikt me ligjin (neni 94 i KDPM-së). Gjithsesi, gjyqtarët në pakicë theksojnë se në rastin e të miturit në konflikt me ligjin apo të gjykuarave gra, nuk ka asnjë pengesë që gjykatat të verifikojnë rrethanat individuale dhe ato lidhur me personalitetin e tyre apo gjendjen personale, familjare ose ekonomike (pavarësisht procedimit me gjykim të shkurtuar, në zbatim të nenit 405 pika 7 e KPP-së).

18. Në përfundim, ne gjyqtarët në pakicë Ilir Panda dhe Albana Boksi, në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete shprehim dakordësinë me konkluzionet e shumicës së anëtarëve të Kolegjit Penal në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal dhe bazueshmërinë e akuzës së atribuuar të miturit në konflikt me ligjin në provat e marra dhe të verifikuara në këtë gjykim në përputhje me kërkesat e neneve 152 dhe 383 të KPP-së. Në këtë rast, referuar konkluzioneve dhe analizës së cituar më lart në lidhje me zbatimin e nenit 403 pika 2 për të miturit në konflikt me ligjin dhe gratë, shprehim votën tonë për ndryshimin e vendimit nr. 188, datë 9.5.2019 të Gjykatës së Apelit Shkodër, duke riparuar pasojat e gjykimit të shkurtuar që në vlerësimin tonë është refuzuar pa të drejtë nga gjykatat e faktit. Në këtë kuptim, duke vlerësuar këtë qëndrim zbatim të ligjit procedura penal, që nuk dikton nevojën e vlerësimit të fakteve apo të provave, çmojmë që dënimi i caktuar nga gjykatat e faktit për të miturin në konflikt me ligjin, Roland Matranxhi, duhet të ishte ulur me 1/3 e tij.

**Tiranë, më 4.7.2024**
**Gjyqtarë:** Ilir Panda, Albana Boksi

| | Formati 61x86/8 |
|---|---|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 512 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2025/04/02 16:12:34 +02'00'
b35f51cdb4184e0484f5f248046a3c602025040216122402031

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)*